Ligji 62/2020 datë 14.05.2020

PËR TREGJET E KAPITALIT[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1.Objekti i këtij ligji është rregullimi i tregjeve të kapitalit, mënyrës dhe kushteve për ofrimin, blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktimi i procedurave për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të instrumenteve financiare.

Ky ligj është përafruarpjesërisht me:

- Direktivën 2014/65/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 maj 2014, "Mbi tregjet e instrumenteve financian dhe që ndryshon direktivën 2002/92/KE dhe direktivën 2011 /61/BE", e ndryshuar. Numri CELEX 32014L0065, Fletorja Zyrtare e Bashkmit Evropian, seria L, nr.173, datë 12.6.2014, f. 349-496.

- Direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 dhjetor 2014, "Mbi harmoniyimin e kërkesave 12 transparencies në lidhje me informacionin rreth emetuesve, letrat me vlerë të të cilëve janë pranuar për t'u tregtuar në tregje të rregullluara dhe që ndryshon direktivën 2001/34/KE", e ndryshuar. Numri CELEX 32004L0109, Fletorja Zyrtare e Bashkmit Evropian, seria L, nr.390, datë 31.12.2004, f. 38-57.

- Direktivën 2014/57/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014 "Mbi dënimet penale për abuymin me tregun" (Direktiva e abugimit t tregut). Numri CELEX 32014L0057, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.173, datë 12.6.2014, f 179-189.

- Rregulloren (BE) nr. 909/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 korrik 2014, "Mbi përmirësimin e shlyerjes së etrave me vlerë në BE dhe depogitarët qendrorë të letrave me vlerë dhe që ndryshon direktivat 98/26/KE dhe 2014/65/BE dhe rregulloren (BE) nr.236/2012", e ndryshuar'. Numri CELEX 32014R0909, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 257, datë 28.8.2014, f 1-72.

- Rregulloren (BE) 2017/1129 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 qershor 2017, "Mbi prospektin që do të publikohet kur letrat me vlerë ofrohen për publikun ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar dhe që shfuqiyon direktivën 2003/71/KE", e ndryshuar-. Numri CELEX 32017R1129, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.168, datë 30.6.2017, f. 12-82.

- Rregulloren (BE) nr. 462/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 maj 2013, "Për ndryshimin e rregullores (KE) nr. 1060/2009 për agjencitë e vlerësimit të kreditit". Numri CELEX 32013R0462, Fletorja Zyrtare e Bashkmit Evropian, seria L, nr. 146, datë 31.5.2013, f. 1-33.

2. Ky ligj përcakton:

a) kushtet për themelimin, licencimin, ushtrimin e aktivitetit, mbikëqyrjen dhe prishjen e shoqërive, që ushtrojnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;

b) kushtet për ofrimin e veprimtarive të rregulluara dhe të shërbimeve ndihmëse përkatëse;

c) kushtet për tregtimin e instrumenteve financiare në një treg të rregulluar ose jashtë një tregu të rregulluar;

ç) kushtet për ofrimin e titujve publikut dhe pranimin e titujve në një treg të rregulluar;

d) detyrimet për dhënien e informacionit nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;

dh) masat e parandalimit të abuzimeve me tregun dhe tregtimit të titujve bazuar në informacion të privilegjuar;

e) kompetencat dhe veprimtarinë e Autoritetit në zbatim të këtij ligji.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha veprimtaritë e rregulluara të përcaktuara në këtë ligj.

2. Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari të rregulluara në territorin e Republikës së Shqipërisë ose nga Republika e Shqipërisë për klientët që ndodhen jashtë saj.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Praktikë e pranuar e tregut” është një praktikë e caktuar tregu në Republikën e Shqipërisë, që pranohet nga Autoriteti ose nga një autoritet kompetent i një vendi anëtar të Bashkimit Evropian ose nga çdo vend tjetër që është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), ose që është anëtar me të drejta të plota i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) dhe që është miratuar nga Autoriteti.

2. “Veprimtari promocionale” është komunikimi lidhur me një ofertë të veçantë të instrumenteve financiare, që i bëhet publikut, ose ftesa e përgjithshme për të investuar në tituj ose për t'u pranuar në një treg të rregulluar titujsh, me synim promovimin e nënshkrimit ose të blerjes së mundshme të instrumenteve financiare.

3. “Marrëveshje” është oferta e bërë nga një shoqëri komisionere verbalisht ose me shkrim, për të ofruar shërbime të rregulluara sipas këtij ligji, e cila pranohet nga pala tjetër.

4. “Veprimtari ndihmëse” është veprimtaria që nuk është veprimtari e rregulluar, por që kryhet:

a) në lidhje me një veprimtari të rregulluar; ose

b) në funksion të një veprimtarie të rregulluar.

5. “Shërbim ndihmës” është secili prej shërbimeve të mëposhtme:

a) ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve;

b) dhënia e kredive ose e huave një investitori për t'i dhënë mundësi të kryejë një transaksion me një ose më shumë instrumente financiare, ku shoqëria që jep kredinë ose huan, ose një subjekt tjetër i lidhur me të, është e përfshirë në transaksion;

c) këshillimi i shoqërive tregtare në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale dhe çështjet e lidhura me to, këshillimi e ofrimi i shërbimeve për bashkimin dhe blerjen e shoqërive tregtare;

ç) shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;

d) identifikimi i investimeve dhe kryerja e analizave financiare lidhur me to ose ofrimi i formave të tjera të rekomandimeve të përgjithshme në lidhje me transaksionet me instrumente financiare;

dh) shërbimet e lidhura me dhënien e angazhimeve për blerjen e titujve;

e) shërbimet dhe veprimtaritë e investimit në tituj, si edhe shërbimet ndihmëse të lidhura me instrumentet derivative kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj ose shërbimeve të tjera ndihmëse.

6. “Tregues reference” është çdo normë, tregues apo vlerë e njohur nga Autoriteti, që:

a) botohet ose bëhet e ditur për publikun;

b) përcaktohet periodikisht ose rregullisht duke përdorur një formulë ose në bazë të vlerës së

një ose më shumë aktivesh ose çmimesh përbërëse, përfshirë çmime të parashikuara, norma interesi faktike ose të parashikuara ose vlera apo statistika të tjera; dhe

c) përdoret si bazë reference për përcaktimin e shumës së pagueshme për një instrument financiar ose për përcaktimin e vlerës së një instrumenti financiar.

7. “Obligacion” është titull afatmesëm ose afatgjatë borxhi, me afat maturimi më të gjatë se një vit, që detyron emetuesin t'i paguajë zotëruesit të obligacionit vlerën nominale dhe interesin në një apo disa këste, në një datë të caktuar.

8. “Dega” është një vend i ushtrimit të veprimtarisë, i ndryshëm nga selia qendrore, që është pjesë e një shoqërie komisionere dhe nuk ka personalitet juridik, e cila regjistrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ofron shërbime dhe/ ose veprimtari investimi në tituj dhe që mund të kryejë edhe shërbime ndihmëse, për të cilat është licencuar, regjistruar ose njohur shoqëria komisionere.

9. “Programi i riblerjes” është blerja e titujve të vet nga një shoqëri.

10. “Kundërpalë qendrore”, shkurt (CCP), është personi juridik, që vendoset në mes të palëve të kontratave të tregtuara në një ose më shumë tregje financiare dhe është blerës për çdo shitës dhe shitës për çdo blerës.

11. “Depozitari qendror” është personi juridik i licencuar nga Autoriteti, në zbatim të këtij ligji, me qëllim ngritjen dhe operimin e një sistemi për regjistrimin qendror të instrumenteve financiare, i cili lejon ose mundëson shlyerjen e transaksioneve të instrumenteve financiare ose tregtimin e instrumenteve financiare pa pasur nevojë për shkëmbimin e certifikatave.

12. “Platformë klerimi” është sistemi për klerimin e transaksioneve të instrumenteve financiare.

13. “Klerim”, referuar veprimtarisë së një shtëpie klerimi, është çdo masë, procedurë, mekanizëm ose shërbim i ofruar nga një person me qëllimi përcaktimin e detyrimeve të të gjitha palëve të përfshira në një transaksion titujsh.

Klerimi përfshin:

a) verifikimin e informacionit për kushtet e transaksioneve, me qëllim konfirmimin e tyre;

b) kompensimin e detyrimeve të palëve në transaksion me detyrimet e subjektit që ofron shërbimin e klerimit;

c) llogaritjen e detyrimeve të palëve në transaksion, pavarësisht nëse në këto llogaritje përfshihen ose jo masat shumëpalëshe të netimit; ose

ç) çdo shërbim tjetër që mund të parashikojë Autoriteti me rregullore.

14. “Shtëpi klerimi” është personi juridik i licencuar sipas këtij ligji dhe në zbatim të ligjit në fuqi “Për sistemin e pagesave”, që është përgjegjës për llogaritjen e pozicioneve neto të institucioneve të tregut, i cili mund të jetë edhe kundërparti qendrore dhe/ose agjent shlyerës.

14.1 “Sistem i klerimit dhe shlyerjes së titujve” është sistemi sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi “Për sistemin e pagesave”.

15. “Anëtar klerimi” është personi juridik i njohur nga shtëpia e klerimit si anëtar i përgjithshëm klerimi, anëtar i drejtpërdrejtë klerimi ose anëtar joklerimi për të bërë klerim dhe shlyerje për llogari të tij ose për llogari të të tretëve, në përputhje me rregulloren e shtëpisë së klerimit.

16. “Klient” është çdo person fizik/individ ose juridik, të cilit shoqëria komisionere i ofron shërbime investimi në tituj dhe/ose shërbime mbështetëse ku përfshihet:

16.1. “Klienti profesionist”, i cili është klienti që përfshihet në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) subjekte, të cilave u kërkohet të licencohen ose të njihen për të ushtruar veprimtari në tregjet financiare, si:

i. bankat;

ii. shoqëritë komisionere;

iii. institucione të tjera financiare të licencuara apo të njohura;

iv. shoqëritë e sigurimeve;

v. sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqëritë administruese dhe administruesit e fondeve të investimeve alternative të këtyre sipërmarrjeve;

vi. fondet e pensionit vullnetar dhe shoqëritë administruese të këtyre fondeve;

vii. tregtuesit e mallrave *(commodities)* si instrumente financiare dhe të derivativëve të mallrave;

viii. shoqëritë vendase, që ofrojnë shërbime investimesh në tituj;

ix. investitorë të tjerë institucionalë;

b) shoqëri tregtare, që përmbushin të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

i. totali i aktivit sipas bilancit është të paktën 2.6 miliardë lekë;

ii. xhiroja neto është të paktën 5.2 miliardë lekë; ose

iii. kapitalet e veta janë të paktën 260 milionë lekë, ose sipas përcaktimeve të vendosura nga Autoriteti me rregullore.

c) institucionet e qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, organet publike, që administrojnë borxhin publik, banka qendrore, institucionet ndërkombëtare, si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe organizata të tjera të ngjashme ndërkombëtare;

ç) investitorë të tjerë institucionalë, veprimtaria kryesore e të cilëve është investimi në instrumente financiare, përfshirë subjektet që kryejnë aktivitetin e konvertimit të aktiveve në tituj të tregtueshëm ose transaksione të tjera financiare.

16.2. "Klienti joprofesionist", i cili është çdo klient që nuk është klient profesionist.

16.3. "Klienti i kualifikuar", i cili është çdo person fizik ose juridik, që kategorizohet si klient joprofesionist, por që me kërkesë të tij trajtohet si klient profesionist, kur përmbush të paktën dy prej kritereve të mëposhtme:

i. klienti ka kryer transaksione në madhësi të konsiderueshme në tregun përkatës, me një frekuencë mesatare prej 10 operacionesh për tremujor përgjatë katër tremujorëve të mëparshëm;

ii. madhësia e portofolit të instrumenteve financiare të klientit, përfshirë depozitat në para dhe instrumentet financiare, i tejkalon 65 milionë lekët;

iii. klienti punon ose ka punuar në sektorin financiar për të paktën një vit në një pozicion profesional, i cili kërkon njohuri të transaksioneve ose shërbimeve të parashikuara.

Për kualifikimin si klient i kualifikuar ndiqet procedura e mëposhtme:

a) klienti duhet t'i deklarojë me shkrim shoqërisë komisionere se dëshiron të trajtohet si klient profesionist në përgjithësi ose në lidhje me një shërbim apo transaksion të caktuar, ose me një lloj transaksioni ose produkti;

b) shoqëria duhet t'i japë klientit një paralajmërim të qartë me shkrim lidhur me mbrojtjen dhe të drejtat e kompensimit të investitorit, që klienti mund të t'i humbasë si rrjedhojë e cilësimit si klient i kualifikuar;

c) klienti duhet të deklarojë me shkrim në një dokument të veçantë nga kontrata se është në dijeni të pasojave të humbjes së mbrojtjes që u ofrohet klientëve joprofesionistë.

16.4 "Palë e pranueshme" është klienti profesionist, të cilit nuk i jepen këshilla. Nëse i jepen këshilla, trajtohet si klient profesionist. Këtu përfshihen:

i. shoqëritë komisionere;

ii. bankat;

iii. shoqëritë e sigurimit;

iv. sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm dhe shoqëritë e tyre administruese;

v. institucionet e tjera financiare të autorizuara ose të rregulluara në zbatim të legjislacionit të Bashkimit Evropian ose të ligjit të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian;

vi. tregtarët e mallrave *(commodities)* dhe tregtarët e derivativëve;

vii. institucionet e qeverisjes qendrore dhe autoritetet përkatëse, përfshirë organet publike që trajtojnë borxhin publik;

viii. banka qendrore dhe institucionet ndërkombëtare.

17. "Lidhje të ngushta" është situata ku dy ose më shumë persona fizikë/individë ose juridikë janë të lidhur nëpërmjet:

a) pjesëmarrjes në kapital, që nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të 20% ose më shumë të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie;

b) kontrollit, që nënkupton marrëdhënien ndërmjet shoqërisë mëmë dhe shoqërisë së kontrolluar, ose një marrëdhënie e ngjashme ndërmjet çdo personi fizik/individi ose juridik dhe një shoqërie, ku çdo shoqëri e kontrolluar nga një shoqëri e kontrolluar konsiderohet gjithashtu si shoqëri e kontrolluar e shoqërisë mëmë, e cila është zotëruesja fundore e këtyre shoqërive;

c) një lidhjeje të përhershme të të dyve ose të të gjithëve me një person të njëjtë nëpërmjet një marrëdhënieje kontrolli;

ç) një marrëveshjeje me shkrim ose verbale për të vepruar në bashkëpunim.

18. "Shoqëri e kontrolluar" është shoqëria:

a) në të cilën një person fizik/individ ose juridik zotëron shumicën e të drejtave të votës; ose

b) në të cilën një person fizik/individ ose juridik ka të drejtën të emërojë ose të shkarkojë shumicën e administratorëve, të anëtarëve të këshillit të administrimit/administratorët apo të këshillit

mbikëqyrës dhe është në të njëjtën kohë aksionar ose ortak i kësaj shoqërie; ose

c) në të cilën një person fizik/individ ose juridik është aksionar ose ortak dhe i vetëm kontrollon shumicën e të drejtave të votës së aksionarëve ose ortakëve, përkatësisht, sipas një marrëveshjeje a një kontrate të lidhur me aksionarët ose ortakët e tjerë të kësaj shoqërie; ose

ç) mbi të cilën një person fizik/individ ose juridik ka fuqinë të ushtrojë, ose ushtron, ndikim dominues ose kontroll.

19. "Vlerësimi i rrezikut të kreditit" është vlerësimi lidhur me besueshmërinë e aftësisë paguese të një subjekti, një borxhi ose një detyrimi financiar, një titulli borxhi, një aksioni me përparësi ose një instrumenti tjetër financiar, ose të një emetuesi të një borxhi apo detyrimi financiar, titulli borxhi, aksioni me përparësi ose instrumenti financiar dhe që jepet mbi bazën e një sistemi të afirmuar dhe të përcaktuar të kategorive të rrezikut.

Sa më poshtë, nuk konsiderohen vlerësime të rrezikut të kreditit:

a) rekomandimet;

b) të dhënat kërkimore për investimet dhe format e tjera të rekomandimeve të përgjithshme, si: "bli", "shit" ose "mbaj", lidhur me transaksionet me instrumente financiare ose me detyrimet financiare; ose

c) opinionet për vlerën e një instrumenti financiar ose një detyrimi financiar.

20. "Veprimtari të vlerësimit të rrezikut të kreditit" janë veprimtaritë e analizimit të të dhënave e informacioneve, si edhe të vlerësimit, miratimit, dhënies e shqyrtimit të vlerësimeve të rrezikut të kreditit.

21. "Agjenci e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit" është personi juridik i licencuar ose i njohur si i tillë, aktiviteti i të cilit përfshin dhënien e vlerësimeve të rrezikut të kreditit në baza profesionale.

22. "Cilësia e kreditit" është kategorizimi i besueshmërisë së aftësisë paguese, që rezulton nga përmbledhja dhe interpretimi i të dhënave, duke u bazuar vetëm në një sistem apo model statistikor të paracaktuar, pa asnjë kontribut të konsiderueshëm shtesë vlerësimi analitik, të kryer nga ana e një analisti vlerësues.

23. "Derivativë të mallrave" janë instrumentet financiare, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjat "d", "dh" "e" dhe "g" të pikës 40 të këtij neni, për një mall ose aktiv bazë.

24. "Autoriteti kompetent" është çdo organ rregullator, i krijuar me ligj në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër.

25. "Kujdestari" është ruajtja dhe administrimi i llogarive të titujve në emër të klientëve.

26. "Tregtimi për llogari të vet" është tregtimi nga një shoqëri komisionere duke përdorur fondet e veta dhe që rezulton në mbylljen e transaksioneve me një ose më shumë instrumente financiare.

27. "Tituj të borxhit" janë obligacione ose forma të tjera titujsh borxhi të transferueshëm, me përjashtim të instrumenteve financiare që janë ekuivalente me aksionet e shoqërive tregtare ose që, nëse konvertohen ose nëse ushtrohen të drejtat që rrjedhin nga to, krijojnë të drejtën e blerjes së aksioneve ose instrumenteve financiare ekuivalente me aksionet.

28. "Procedurë mospërmbushjeje" është procedura ose çdo veprim tjetër i kryer nga shtëpia e klerimit, sipas rregullave të saj.

29. "Rregulloret e mospërmbushjes", në lidhje me shtëpinë e klerimit, janë rregullat që parashikojnë fillimin e procedurës së mospërmbushjes nëse një anëtar klerimi nuk përmbush detyrimet në lidhje me ndonjë kontratë të pashlyer të tregut, palë e së cilës është anëtari i klerimit.

30. "Anëtar në mospërmbushje" është anëtari i klerimit ndaj të cilit fillohet një procedurë mospërmbushjeje.

31. "Anëtar depozitari" është personi fizik ose juridik, i cili ka të drejtë aksesi në sistemet e depozitarit qendror dhe pranohet si pjesëmarrës depozitari në bazë të rregullave të depozitarit qendror.

32. "Dëftesa depozitari" janë instrumentet financiare, të cilat janë të negociueshme në tregun e kapitalit dhe përfaqësojnë pronësinë e instrumenteve financiare të një emetuesi të huaj, por që mund të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar dhe që tregtohen në mënyrë të pavarur nga instrumentet financiare të emetuesit të huaj.

33. "Derivativët" janë instrumentet financiare sipas përcaktimit të dhënë në shkronjat "ç", "d", "dh" "e", "ë", "f ' dhe "g" të pikës 40 të këtij neni.

34. "Mjet i qëndrueshëm komunikimi" është çdo mjet komunikimi, i cili:

a) i jep mundësi klientit të ruajë informacionin që i është drejtuar atij personalisht, në mënyrë që të jetë e mundur të shihet dhe të përdoret në të ardhmen gjatë një periudhe kohore të mjaftueshme për qëllimet e informacionit; dhe

b) mundëson riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.

35. "Mjete elektronike" janë mjetet elektronike të përdorura për përpunimin (përfshirë

kompresimin digjital), ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave, duke përdorur kabllo, radio, teknologji optike ose çdo mjet tjetër elektromagnetik.

36. “Tituj të pjesëmarrjes në kapital” janë aksionet dhe instrumentet e tjera financiare të transferueshme, ekuivalente me aksionet e shoqërive tregtare, si dhe çdo lloj tjetër instrumenti financiar i transferueshëm, i cili jep të drejtën për të blerë këto instrumente financiare, si pasojë e konvertimit të tyre ose e ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga to, me kusht që instrumentet financiare të llojit të dytë të emetohen nga emetuesi i aksioneve bazë ose nga një subjekt që i përket grupit të emetuesit në fjalë.

37. “Tituj jo të pjesëmarrjes në kapital” janë të gjitha instrumentet financiare, të cilat nuk janë instrumente financiare të kapitalit.

38. “Fondi i tregtuar në bursë” është fondi i investimeve që ndjek një indeks nga i cili të paktën një njësi ose një klasë e aksioneve tregtohet gjatë gjithë ditës në të paktën një vend tregtimi dhe me të paktën një krijues tregu, i cili merr masat për të siguruar që çmimi i njësive ose aksioneve të tij në treg nuk ndryshon ndjeshëm nga vlera neto e aktiveve dhe, sipas rastit, nga vlera neto orientuese e aktiveve.

39. “Ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve” janë veprimet e kryera me qëllimin e lidhjes së marrëveshjeve të blerjes ose të shitjes së një ose më shumë instrumenteve financiare për llogari të klientëve, duke përfshirë lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e instrumenteve financiare të emetuara nga një shoqëri komisionere ose nga një bankë në momentin e emetimit të tyre.

40. “Instrumente financiare” janë:

a) titujt e transferueshëm;

b) instrumentet e tregut të parasë;

c) kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

ç) kontratat e opsioneve *(options),* kontratat e së ardhmes *(utureS),* marrëveshjet e shkëmbimit *(swap),*kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative lidhur me tituj, monedha, norma interesi ose kthimi *(yields!),* kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë ose instrumente të tjera derivative, indekse financiare ose njësi financiare, të cilat mund të shlyhen fizikisht ose me para;

d) kontratat e opsioneve *(options),* kontratat e së ardhmes *(future)* marrëveshjet e shkëmbimit *(swap),* kontratat e shitjes në të ardhmen me çmim të paracaktuar *(forwards)* dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me mallra *(commodities)* që duhet të shlyhen në para ose që mund të shlyhen në para me zgjedhjen e njërës prej palëve, duke përjashtuar rastet e zgjidhjes së kontratës për mospërmbushje ose për ndonjë arsye tjetër;

dh) kontratat e opsioneve *(options),* kontratat e së ardhmes (*futures*), marrëveshjet e shkëmbimit *(swap)* dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (*commodities*), që mund të shlyhen fizikisht me kusht që të tregtohen në një treg të rregulluar, në një platformë shumëpalëshe tregtimi, ose në një platformë të organizuar tregtimi, me përjashtim të produkteve energjetike të tregtuara me shumicë në një platformë të organizuar tregtimi, të cilat duhet të shlyhen fizikisht;

e) kontratat e opsioneve (*options*), kontratat e së ardhmes (*futures*), marrëveshjet e shkëmbimit *(swap)* dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (*commodities*), që mund të shlyhen fizikisht e që nuk janë përmendur në shkronjën “dh” më sipër, të cilat nuk mbahen për qëllime tregtare, por kanë karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative;

ë) instrumentet derivative për transferimin e riskut të kredisë;

f) kontratat financiare për diferencat;

g) kontratat e opsioneve (*options*), kontratat e së ardhmes *(future}),* marrëveshjet e shkëmbimit *(swap),* kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me variablat klimaterike, çmimet e transportit të mallrave ose normat e inflacionit, ose statistika të tjera ekonomike zyrtare, e cila duhet të shlyhet me para ose mund të shlyhet me para me zgjedhjen e njërës prej palëve, duke përjashtuar rastin e zgjidhjes së kontratës për mospërmbushje apo ngjarje tjetër, si edhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me aktive, të drejta, detyrime, indekse dhe masa që nuk përmenden më sipër, e cila ka karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative, duke mbajtur parasysh, ndër të tjera, nëse tregtohen në një treg të rregulluar, platformë të organizuar tregtimi ose platformë shumëpalëshe tregtimi.

41. “Autoritet i huaj rregullator” është autoriteti i huaj, i cili ushtron funksione rregullatore dhe mbikëqyrëse, që përkojnë me funksionet e Autoritetit sipas këtij ligji dhe ligjit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

42. “Grup” është shoqëria mëmë së bashku me të gjitha shoqëritë e kontrolluara prej saj.

43. “Vendi i origjinës” është:

a) në rastin e shoqërive komisionere:

i. nëse shoqëria komisionere është një person fizik, vendi në të cilin ndodhet selia e shoqërisë komisionere;

ii. nëse shoqëria komisionere është një person juridik, vendi në të cilin ndodhet selia e regjistruar e shoqërisë komisionere;

iii. nëse shoqëria komisionere në bazë të legjislacionit të vet kombëtar nuk ka seli të regjistruar, vendi në të cilin ndodhet selia qendrore; ose

b) në rastin e një tregu të rregulluar, vendi në të cilin është regjistruar tregu i rregulluar ose, nëse në bazë të legjislacionit të atij vendi nuk ka seli të regjistruar, vendi në të cilin ndodhet selia qendrore e tregut të rregulluar.

44. "Vendi pritës" është vendi që nuk është vendi i origjinës, në territorin e të cilit shoqëria komisionere ka një degë ose ofron shërbime dhe/ose veprimtari investimi, ose vendi në të cilin tregu i rregulluar ofron kushtet e duhura për të mundësuar pjesëmarrjen në tregtim nëpërmjet sistemit të tij nga anëtarë në distancë ose pjesëmarrës të vendosur në atë vend.

45. "Informacioni që rekomandon ose sugjeron një strategji investimi" është informacioni:

a) që jepet nga analisti i pavarur, shoqëria komisionere, banka, media e specializuar ose çdo person tjetër, veprimtaria tregtare kryesore e të cilit është dhënia e rekomandimeve për investime, ose nga personi fizik/individi, që punon për këto subjekte në bazë të një kontrate pune ose në ndonjë mënyrë tjetër, në të cilin shprehet drejtpërdrejt ose tërthorazi një propozim i veçantë investimi për një instrument financiar ose një emetues; ose

b) që jepet nga çdo person i ndryshëm nga personat e përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike, ku propozohet në mënyrë të drejtpërdrejtë një vendim i veçantë investimi për një instrument financiar.

46. "Këshillë investimi" është dhënia e rekomandimeve personale një klienti ekzistues ose një klienti të mundshëm, me kërkesën e tij ose me nismën e vetë shoqërisë komisionere, për një ose më shumë transaksione, që kanë të bëjnë me instrumente financiare.

47. "Shoqëri komisionere" është çdo person juridik, profesioni ose aktiviteti i rregullt tregtar i të cilit është ofrimi i një ose më shumë shërbimesh investimi në tituj palëve të treta dhe/ose kryerja e një ose më shumë veprimtarive të investimit në formë profesionale".

48. "Shërbime investimi" janë shërbimet që ofrohen nga shoqëritë komisionere në kuadër të veprimtarisë së tyre tregtare. Shërbimet e investimit mund të kryhen edhe nga banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbime të tilla, të cilat do të respektojnë kërkesat e këtij ligji.

Këto shërbime përkufizohen si më poshtë:

a) marrja dhe transmetimi i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare;

b) ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve;

c) tregtimi për llogari të vet;

ç) administrimi i portofolit;

d) këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për investime;

dh) nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion;

e) hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje;

ë) operimi i një platforme shumëpalëshe tregtimi; dhe

f) operimi i një platforme të organizuar tregtimi.

49. "Emetues" është personi juridik ose çdo subjekt tjetër juridik i rregulluar me ligj, përfshirë qeverinë ose një organizatë financiare ndërkombëtare të miratuar, i cili emeton tituj.

50. "Person i licencuar", është personi fizik ose juridik, i cili është ose ka qenë në çdo moment i licencuar nga Autoriteti për të kryer një veprimtari të rregulluar dhe disponon një licencë të vlefshme.

51. "Urdhër me kufi" është urdhri për të blerë ose shitur një instrument financiar me një çmim kufi të përcaktuar ose me një çmim më të mirë dhe për një sasi të caktuar.

52. "Treg likuid" është tregu për një instrument financiar ose një kategori të instrumenteve financiare, ku ka në mënyrë të vazhdueshme blerës dhe shitës të gatshëm e të vullnetshëm për sasi të mjaftueshme, i cili vlerësohet në përputhje me kriteret e mëposhtme, duke marrë parasysh strukturat specifike të tregut të instrumentit financiar përkatës ose të kategorisë përkatëse të instrumenteve financiare:

a) shpeshtësia dhe rëndësia mesatare e transaksioneve në një gamë kushtesh tregu, duke pasur parasysh llojin dhe ciklin e jetës së produkteve që përfshihen në kategorinë e instrumentit financiar;

b) numri dhe lloji i shoqërive komisionere, përfshirë raportin e shoqërive komisionere me instrumentet e tregtuara për një produkt të caktuar; ose

c) madhësia mesatare e marzheve *(spreads)*, kur ka.

53. “Shoqëri e listuar” është shoqëria aksionare, titujt e së cilës janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar.

54. “Tregtar derivativësh” është çdo shoqëri tregtare me seli në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që tregton për llogari të vet në tregjet e kontratave financiare të së ardhmes *futures)*, kontratave të opsioneve *(options)* ose kontratave derivative dhe në tregjet e parasë, me qëllimin e vetëm të mbrojtjes së pozicioneve në tregjet e kontratave derivative *(hedging)*, ose e cila tregton për llogari të anëtarëve të tjerë të këtyre tregjeve dhe garantohet nga anëtarët e klerimit të këtyre tregjeve, ku përgjegjësia për të siguruar përmbushjen e kontratave të lidhura nga kjo shoqëri merret përsipër nga këta anëtarë klerimi.

55. “Organ drejtues” është organi ose organet e shoqërisë komisionere ose operatorit të tregut i cili/të cilat janë emëruar në përputhje me përcaktimet ligjore për të përcaktuar strategjinë, objektivat dhe drejtimin e përgjithshëm të subjektit.

56. “Kontroll administrues” është kontrolli i ushtruar në shoqëritë komisionere nga organi drejtues ose nga funksionarët kryesorë.

57. “Marrëveshja e kolateralit financiar” ka të njëjtin kuptim sipas ligjit në fuqi “Për sistemin e pagesave”.

58. “Kolateral financiar” ka të njëjtin kuptim sipas ligjit në fuqi “Për sistemin e pagesave”.

59. “Kontratë tregu” është:

a) kontrata që është objekt i rregulloreve të shtëpisë së klerimit dhe që lidhet nga shtëpia e klerimit me anëtarin e klerimit me qëllim klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve, duke përdorur platformën e klerimit të shtëpisë së klerimit; ose

b) transaksioni që duhet të klerohet ose të shlyhet duke përdorur platformën e klerimit të shtëpisë së klerimit, në përputhje me rregulloret e shtëpisë së klerimit.

60. “Institucion tregu” është çdo subjekt që operon ose ofron një infrastrukturë tregu për tregtimin, regjistrimin ose klerimin e transaksioneve me instrumente financiare.

61. “Krijues tregu” është personi, i cili në mënyrë të vazhdueshme është i pranishëm në tregjet financiare si person i gatshëm të tregtojë për llogari të vet me fondet e veta duke blerë dhe shitur instrumente financiare kundrejt aseteve të veta me çmime që i përcakton vetë.

62. “Operator tregu” është personi që administron dhe/ose ushtron aktivitetin e një tregu të rregulluar ose të një tregu tjetër të organizuar. Operatori i tregut mund të jetë vetë tregu i rregulluar.

63. “Mund”, përdorimi i fjalës “mund” tregon lejim dhe jo detyrim dhe nënkupton se Autoritetit ose një personi tjetër për të cilin përdoret, i jepet mundësia për të ndërmarrë veprime të caktuara sipas gjykimit të vet, por pa pasur detyrimin për t'i ndërmarrë këto veprime. Kur përdoret kjo fjalë, mund të kryhen veprime të cilat konsiderohen si të nevojshme ose të duhura, por personi nuk detyrohet të kryejë këto veprime.

64. “Segment tregu” është ajo pjesë e bursës së rregulluar, e cila ka kategori të ndryshme listimi, sipas madhësisë ose llojit të titullit të listuar.

65. “Tregtim i bazuar në parimin e përputhshmërisë” *(matched principal trading)* është transaksioni në të cilin ndërmjetësi vendoset midis blerësit dhe shitësit të transaksionit, në mënyrë të tillë që të mos ekspozohet asnjëherë ndaj rrezikut të tregut gjatë ekzekutimit të transaksionit, ku të dyja anët e transaksionit ekzekutohen njëkohësisht dhe ku transaksioni kryhet me një çmim që nuk i sjell ndërmjetësit asnjë fitim ose humbje, përveç një tarife ose komisioni mbi transaksionin, i cili i është bërë i ditur më parë autoritetit.

66. “Paratë ose aktivet e klientit” janë paratë ose aktivet e klientit, të cilat mbahen në llogari të veçanta bankare apo në llogari të veçanta titujsh nga shoqëria komisionere dhe që nuk janë pronë e shoqërisë komisionere dhe shërbejnë për kryerjen e transaksioneve të klientëve nga shoqëria komisionere.

67. “Instrumente të tregut të parasë” janë ato kategori të instrumenteve financiare, të cilat tregtohen normalisht në tregun e parasë, siç janë bonot e thesarit, certifikatat e depozitave dhe dëftesat tregtare, por pa përfshirë instrumentet e pagesës.

68. “Sistem shumëpalësh” është çdo sistem ose platformë që lejon ndërveprimin e interesave të shumëfishta të palëve të treta për shitblerjen e instrumenteve financiare.

69. “Platformë shumëpalëshe tregtimi (PSHT)” është sistemi shumëpalësh i operuar nga një shoqëri komisionere ose një operator tregu, i cili bashkon interesat e shumëfishta të shitblerjes së instrumenteve financiare të palëve të treta, në përputhje me rregulla jodiskrecionare, me qëllimin për të mundësuar lidhjen e kontratave.

70. “Ofertë e titujve drejtuar publikut” është një komunikim ndaj çdo personi, në çdo formë dhe me çdo lloj mjeti, që paraqet informacion të mjaftueshëm për kushtet e ofertës dhe titujve që do të ofrohen, në

mënyrë që të bëjë të mundur që investitori të vendosë për blerjen apo nënshkrimin e këtyre titujve. Ky përkufizim aplikohet edhe për vendosjen e titujve nëpërmjet ndërmjetësit financiar.

71. “Vlefshmëria e ofertës” është afati brenda të cilit investitorët e mundshëm mund të blejnë ose të nënshkruajnë instrumentet financiare.

72. “Aktofertë” është dokumenti, i cili nuk është prospekt sipas kuptimit të dhënë në këtë ligj, por është një formë ftese me të cilën një grupi të kufizuar ose të përcaktuar investitorësh i ofrohet të investojnë në titujt që emetuesi i ofron për investitorë të mundshëm.

73. “Platforma e organizuar e tregtimit (POT)” është sistemi shumëpalësh, që nuk është treg i rregulluar apo platformë shumëpalëshe tregtimi, në të cilin lejohet ndërveprimi i interesave të shumëfishta të shitblerjes së palëve të treta për obligacione, produkte financiare të strukturuara, kuota të lejuara për çlirimin e gazeve serrë ose derivativët, në mënyrë të tillë që të mundësojë lidhjen e kontratave.

74. “Shoqëri mëmë” është shoqëria që kontrollon një ose më shumë shoqëri të kontrolluara.

75. “Person” është personi fizik/individi ose personi juridik.

76. “Administrim portofoli” është administrimi i portofolave në përputhje me mandatet e dhëna nga klientët në mënyrë diskrecionare, ku portofolat përfshijnë një ose më shumë instrumente financiare.

77. “Ofertë private” është ofrimi i titujve një grupi të kufizuar ose të përcaktuar investitorësh të mundshëm dhe jo publikut të gjerë, e cila komunikohet pa përdorur mjetet e komunikimit në masë.

78. “Prospekt” është çdo dokument, i cili përbën një lloj ftese që i drejtohet publikut të gjerë, pa kufizim, për ta ftuar të investojë në titujt që emetuesi ua ofron investitorëve të mundshëm.

79. “Ofertë publike” është ofrimi i titujve publikut të gjerë pa kufizim.

80. “Pjesëmarrja influencuese” është pjesëmarrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në kapitalin e një shoqërie komisionere:

a) mbi 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës, duke mbajtur parasysh agregimin; ose

b) që jep mundësi të ushtrohet influencë e konsiderueshme për administrimin e shoqërisë komisionere në të cilën mbahet kjo pjesëmarrje.

81. “Person i njohur” është personi fizik ose juridik, i cili ka marrë licencë nga një autoritet i huaj kompetent për të ushtruar një veprimtari të rregulluar, që njihet nga Autoriteti si ekuivalente me licencën që jep vetë Autoriteti.

82. “Person i regjistruar” është personi, i cili, nën përgjegjësinë e plotë dhe pa kushte të një shoqërie të vetme të licencuar në emër të së cilës ai vepron, promovon shërbime investimesh dhe/ose shërbime ndihmëse te klientë ekzistues ose klientë të mundshëm, merr dhe përcjell udhëzime ose urdhra nga klientë për shërbimet e investimeve ose instrumentet financiare, hedh në treg instrumente financiare dhe/ose u jep këshilla klientëve ekzistues ose klientëve të mundshëm në lidhje me këto instrumente financiare apo shërbime dhe është i regjistruar pranë Autoritetit në përputhje me këtë ligj.

83. “Regjistrim” është veprimi pozitiv që kryhet kur si rezultat i shqyrtimit nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës, informacionet e dhëna në prospekt konsiderohen të plota, konsistente, të kuptueshme dhe në përputhje me rregullat e zbatueshme.

84. “Person i lidhur” me një person është:

a) bashkëshorti/bashkëshortja ose bashkëjetuesi / bashkëjetuesja, sipas kuptimit të dhënë në Kodin e Familjes;

b) fëmija në kujdestari, sipas legjislacionit të zbatueshëm;

c) i afërmi, i cili banon në të njëjtën banesë prej të paktën një viti nga data e transaksionit në fjalë; ose

ç) personi juridik, i cili administrohet nga një person që administron personin në fjalë ose nga një person i lidhur me personin në fjalë sipas shkronjave “a”, “b” ose “c” të kësaj pike, apo kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ky person, apo është themeluar në përfitim të këtij personi ose interesat ekonomike të të cilit janë në thelb ekuivalente me ato të këtij personi.

85. “Klasifikimi i rrezikut të kreditit” është simboli vlerësues, si për shembull, një shkronjë ose një simbol numerik, i cili mund të shoqërohet me shenja identifikuese shtesë, të përdorura në një vlerësim të rrezikut të kreditit për të ofruar një matje relative të riskut dhe për të dalluar karakteristikat e ndryshme të riskut të kreditit për lloje të ndryshme të subjekteve, emetuesve dhe instrumenteve financiare ose aktiveve të tjera të vlerësuara.

86. “Perspektiva e rrezikut të kreditit” është opinioni për perspektivën e mundshme të vlerësimit të rrezikut të kreditit për një periudhë afatshkurtër, afatmesme ose të dyja.

87. “Veprimtari e rregulluar” është ofrimi i shërbimeve të investimit dhe veprimtaria e

institucioneve të tregut, duke përfshirë:

a) marrjen dhe transmetimin e urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare;

b) ekzekutimin e urdhrave në emër të klientëve;

c) tregtimin për llogari të vet;

ç) administrimin e portofolit;

d) veprimtarinë e këshillimit për investime dhe dhënien e rekomandimeve;

dh) nënshkrimin e instrumenteve financiare dhe/ose hedhjen në treg të instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion;

e) hedhjen në treg të instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje;

ë) veprimtarinë e platformës shumëpalëshe të tregtimit;

f) veprimtarinë e platformës së organizuar të tregtimit;

g) veprimtarinë e bursës;

gj) veprimtarinë e depozitarit qendror;

h) veprimtarinë e shtëpisë së klerimit;

i) veprimtarinë e sistemit të shlyerjes;

j) veprimtarinë e kundërpalës qendrore;

k) çdo veprimtari tjetër, që lidhet me emetimin ose tregtimin e titujve ose të instrumenteve të tjera financiare.

88. “Informacion i rregulluar” janë të gjitha informacionet që duhet të bëjë të ditura emetuesi ose çdo person tjetër, që ka paraqitur kërkesë për pranim të instrumenteve financiare për tregtim në një treg të rregulluar pa pëlqimin e emetuesit, të cilat janë të një rëndësie thelbësore për investitorin ekzistues ose investitorin e mundshëm ose që lidhen me përdorimin e informacionit të privilegjuar për përfitime vetjake dhe manipulimin e tregut (abuzimi i tregut) ose që jepen në zbatim të akteve ligjore, nënligjore apo të autoriteteve administrative të çdo vendi.

89. “Treg i rregulluar” është sistemi shumëpalësh i operuar dhe/ose administruar nga një operator tregu, i cili bashkon ose ndihmon në bashkimin e interesave të shumëfishta të shitblerjes së instrumenteve financiare të palëve të treta, në përputhje me rregulloret e tij jodiskrecionale, mundëson pranimin për tregtim të instrumenteve financiare në përputhje me rregulloret dhe/ose sistemet e tij, licencohet, regjistrohet ose njihet dhe rregullohet nga Autoriteti.

90. “Personi përgjegjës” është:

a) çdo person që vepron në lidhje me një shoqëri tregtare, si: likuidues, kujdestar, administrator i përkohshëm, administrator ose ushtron detyra të tjera të ngjashme;

b) çdo person i emëruar në bazë të një vendimi si administrator falimentimi në procedurën e falimentit të pasurisë së një personi të vdekur.

91. “Tituj” janë instrumente financiare, të cilat emetohen për qëllime fitimprurëse nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre dhe janë të tregtueshme. Titujt përfshijnë pa kufizim aksionet e emetuara nga shoqëritë aksionare, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga qeveritë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumentet e tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që përkufizohen si të tilla në këtë ligj.

92. “Tokeni digjital i titujve” janë përfaqësime digjitale të vlerës, të ngjashme me titujt e tjerë të përcaktuar sipas këtij ligji, që bazohen në teknologjinë *block-chain,* të konfirmuar nga një autoritet kompetent kombëtar, kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) janë lirisht të transferueshme;

b) i japin pronarit disa të drejta monetare ose të drejta pronësie mbi projektin, ose nëse ajo ka karakteristika të ndarjes së fitimit, ose një të drejtë të paracaktuar, ose ata japin pushtetin vendimtar për pronarin në projektin e emetuesit.

Tokenat digjitalë të titujve do të konsiderohen si instrumente financiare në kuptim të këtij ligji.

93. “Funksionarë kryesorë” janë personat fizikë/individët, që ushtrojnë funksione drejtuese në një shoqëri komisionere, ose një operator tregu, të cilët janë përgjegjës e japin llogari përpara organit drejtues për administrimin e aktivitetit të përditshëm tregtar të subjektit, përfshirë zbatimin e politikave të përcaktuara nga organi drejtues në lidhje me ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për klientët.

94. “Shlyerja” është veprimi i transferimit të “titujve dhe çmimeve të tyre përfundimtare” midis dy palëve. Palët në transaksione me tituj përmbushin detyrimet që rrjedhin prej tyre, përfshirë detyrimin për të dorëzuar, transferimin e çmimit ose transferimin e titullit mbi instrumentet financiare midis palëve, por nuk përfshin:

a) veprimtaritë e shërbimeve *backofice* të një pjese të transaksioneve të përmendura më sipër;

b) shërbimet e ofruara nga një person, i cili, sipas një marrëveshjeje me një person tjetër (klienti), mban në posedim ose kontrollon instrumentet financiare të klientit, kur këto shërbime nuk janë thelbësore për shlyerjen e transaksioneve me instrumentet financiare.

95. “Aksionar” është çdo person fizik/individ ose juridik, i cili zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi:

a) aksionet e një emetuesi në emër të vet dhe për llogari të vet;

b) aksionet e një emetuesi në emër të vet, por për llogari të një personi tjetër fizik ose juridik;

c) dëftesa depozitari, rast në të cilin mbajtësi i dëftesës së depozitarit duhet të konsiderohet si aksionar për aksionet bazë që përfaqëson dëftesa e depozitarit.

96. “Borxh shtetëror” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancinë shtetërore të huas dhe legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

97. “Emetues shtetëror” është cilido prej listës së mëposhtme, që emeton instrumente borxhi:

a) çdo shtet sovran, përfshirë qeverinë, një autoritet shtetëror, një njësi të vetëqeverisjes vendore ose autoritet tjetër të krijuar me ligj ose subjekti për qëllime të veçanta të atij shteti, emetimet e të cilëve garantohen nga qeveria;

b) një subjekt për qëllime të veçanta, i krijuar nga disa shtete, që është objekt i garancive solidare dhe individuale të këtyre shteteve; ose

c) një institucion financiar ndërkombëtar, i themeluar nga dy ose më shumë shtete, i cili ka për qëllim mobilizimin e fondeve dhe sigurimin e ndihmës financiare në dobi të anëtarëve të tij, që kanë ose rrezikohen të kenë probleme financiare të rënda.

98. “Vlerësimi sovran” është vlerësimi i rrezikut të kreditit, ku subjekti i vlerësuar është një emetues shtetëror.

99. “Stabilizim” është blerja ose oferta për blerjen e instrumenteve financiare, ose instrumenteve ekuivalente të lidhura me to, që kryhet nga një bankë ose një shoqëri komisionere në kuadër të një oferte formale të këtyre instrumenteve financiare, me qëllimin e vetëm për të ruajtur çmimin e tregut të këtyre instrumenteve financiare për një periudhë të paracaktuar, për shkak të presionit për shitje mbi këto instrumente financiare.

100. “Huamarrës i titujve” është personi, i cili ushtron aktivitetin e huamarrjes së titujve nga një person tjetër.

101. “Riblerje e aksioneve të veta” është:

a) zvogëlimi i kapitalit të një emetuesi;

b) përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet financiare të borxhit të cilat janë këmbyeshme me tituj të kapitalit;

c) përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga programet e opsioneve mbi aksione, ose nga shpërndarje të tjera të aksioneve për punonjësit ose për anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit ose të një shoqërie të lidhur me të.

102. “Bursë” është një operator tregu, veprimtaria kryesore e të cilit është vënia në funksion e një tregu të rregulluar.

103. “Depozitë e strukturuar” është një depozitë sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi “Për sigurimin e depozitave”, e cila ripaguhet plotësisht në momentin e maturimit ose sipas një plani të përcaktuar pagesash të pjesshme, sipas kushteve të së cilës interesi ose një prim paguhet ose rrezikohet në bazë të një formule që përfshin faktorë të tillë si:

a) një tregues ose kombinim treguesish, duke përjashtuar depozitat me normë të ndryshueshme, kthimi i të cilave lidhet drejtpërdrejt me një indeks normash interesi, si Euribor ose Libor;

b) një instrument financiar ose kombinim instrumentesh financiare;

c) një mall *(commodity)* ose kombinim mallrash ose aktivesh të tjera të pakëmbyeshme të prekshme apo të paprekshme; ose

ç) një kurs këmbimi valutor ose kombinim i kurseve të këmbimit valutor.

104. ”Produkte të strukturuara financiare” janë ato instrumente financiare të krijuara për të konvertuar në titull dhe për të transferuar riskun e kredisë lidhur me një grup *(pool)* aktivesh financiare, që i japin mbajtësit të titullit të drejtën për të arkëtuar pagesa të rregullta, të cilat varen nga fluksi monetar i aktiveve bazë.

105. ”Internalizues sistematik” është shoqëria komisionere, e cila, në mënyrë të organizuar, të shpeshtë dhe sistematike, tregton për llogari të vet, duke përdorur fondet e veta, nëpërmjet ekzekutimit të urdhrave të klientëve jashtë një tregu të rregulluar, një platforme shumëpalëshe tregtimi ose një platforme të

organizuar tregtimi pa operuar një sistem shumëpalësh.

Treguesi i shpeshtësisë dhe ai sistematik vlerësohen duke u bazuar në numrin e tregtimeve mbi banak të instrumenteve financiare, që kryhen nga shoqëria komisionere për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve.

Treguesi i shpeshtësisë dhe ai sistematik vlerësohet ose duke u bazuar në numrin e tregtimeve mbi banak të kryera nga shoqëria komisionere në raport me numrin total të tregtimeve të kryera nga shoqëria komisionere në lidhje me një titull të veçantë, ose duke u bazuar në numrin e tregtimeve mbi banak të kryera nga shoqëria komisionere në raport me numrin total të tregtimeve në Bashkimin Evropian në lidhje me një titull të veçantë.

Përkufizimi i internalizuesit sistematik përdoret vetëm kur kapërcehen kufijtë e paracaktuar për shpeshtësinë, sistematikën dhe rëndësinë ose kur shoqëria komisionere vendos vullnetarisht të përfshihet në regjimin e internalizuesit sistematik.

106. “Agjent i lidhur” është personi i pavarur fizik ose juridik, i cili, nën përgjegjësinë e plotë dhe pa kushte të vetëm një shoqërie komisionere në emër të së cilës vepron, promovon shërbime investimesh dhe/ose shërbime ndihmëse te klientë ekzistues ose klientë të mundshëm, merr dhe përcjell udhëzime ose urdhra nga klientë për shërbimet e investimeve ose instrumentet financiare, hedh në treg instrumente financiare ose u jep këshilla klientëve ekzistues ose klientëve të mundshëm në lidhje me këto instrumente financiare ose shërbime.

107. “Anëtar tregtimi” është personi, i cili ka të drejtë aksesi në sistemet e bursës dhe pranohet si anëtar tregtimi në bazë të rregulloreve të bursës.

108. “Vend tregtimi” është një treg i rregulluar, një platformë shumëpalëshe tregtimi ose një platformë e organizuar tregtimi.

109. “Urdhërtransferta” ka të njëjtin kuptim të dhënë sipas ligjit në fuqi “Për sistemin e pagesave”.

110. “Tituj të transferueshëm” janë ato klasa të titujve, me përjashtim të instrumenteve të pagesës, të cilat janë lirisht të transferueshme pa kufizime dhe të negociueshme ndërmjet dy palëve në një treg të rregulluar ose jo.

111. “Ditë pune” janë ditë pune të javës, pa përfshirë të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare.

112. “Pjesëmarrje në veprimtari të rregulluar” është lidhja ose oferta për të lidhur një kontratë të shkruar ose verbale për një veprimtari të rregulluar.

Neni 4

Interpretimi

Nëse nuk e kërkon ndryshe konteksti, kur përmendet vetëm një gjini, duhet nënkuptuar se përfshin gjinitë e tjera dhe fjalët në njëjës duhen nënkuptuar se përfshijnë edhe shumësin, ashtu sikurse fjalët në shumës nënkuptojnë që përfshijnë edhe njëjësin.

Neni 5

Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

1. Të gjithë personat që janë subjekt i këtij ligji, duhet të zbatojnë kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Subjektet e licencuara janë të detyruara që, pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Autoritetin për çdo rast kur kanë dijeni apo dyshojnë se është kryer, po kryhet apo tentohet të kryhet pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

3. Në rast se ekziston një dyshim i arsyeshëm se shkeljet lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i raporton autoritetit përgjegjës në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Në rastet kur Autoriteti vlerëson se subjekti i licencuar ka shkelur detyrimet ligjore mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ndaj tij merr një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) urdhëron marrjen e masave për eliminimin e shkeljeve;
b) pezullon apo heq pjesërisht ose plotësisht licencën;
c) urdhëron pezullim ose largim nga puna të personave përgjegjës.

KREU II
AUTORITETI

Neni 6
Autoriteti

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është autoriteti, i cili licencon, mbikëqyr dhe rregullon veprimtaritë e rregulluara sipas këtij ligji.

2. Objektivat e veprimtarisë së Autoritetit, sipas këtij ligji, janë:

a) promovimi dhe garantimi i besimit në paanësinë, efikasitetin, konkurrencën e lirë, transparencën dhe ligjshmërinë e sektorit të tregjeve të kapitalit dhe çdo veprimtarie të lidhur me këtë sektor;

b) mbrojtja e interesave të investitorëve; dhe

c) parandalimi i krimit financiar.

Neni 7
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

1. Në funksion të përmbushjes së objektivave të tij, sipas këtij ligji, Autoriteti ka të drejta të plota:

a) të hartojë, të ndryshojë ose të shfuqizojë rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji;

b) të miratojë kodet e etikës, që duhen respektuar nga personat e licencuar, të regjistruar ose të njohur, sipas këtij ligji;

c) t'u japë udhëzime apo urdhra personave të licencuar, të regjistruar ose të njohur, sipas këtij ligji;

ç) të përcaktojë politikën dhe strategjinë e tij të përgjithshme rregullatore për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e tregut të titujve në Republikën e Shqipërisë; dhe

d) në përgjithësi, të ushtrojë të gjitha kompetencat që i njihen në mënyrë specifike nga ky ligj apo nga ligji në fuqi "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar.

2. Në zbatim të sa më sipër, Autoriteti mund të miratojë rregullore për:

a) nxitjen e standardeve të larta të integritetit dhe të tregtimit të ndershëm gjatë ushtrimit të veprimtarive të rregulluara me këtë ligj;

b) sigurimin e transparencës në dhënien e informacioneve për interesat dhe faktet me rëndësi materiale në transaksionet e kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së rregulluar, përfshirë informacionet për komisione e stimuj të tjerë të arkëtuar ose të arkëtueshëm nga palë të treta në lidhje me këto transaksione;

c) mbrojtjen e parave dhe të aktiveve të klientëve;

ç) mbajtjen e llogarive dhe të regjistrave të duhur nga personi i licencuar, i regjistruar ose i njohur sipas këtij ligji, në formën që mund të përcaktohet nga Autoriteti dhe që garanton kontrollin e tyre nga Autoriteti;

d) aftësitë financiare që duhet të ketë personi i licencuar, i regjistruar ose i njohur sipas këtij ligji, bazuar në veprimtarinë e ushtruar nga personi në fjalë;

dh) përcaktimin e praktikave dhe të procedurave të qeverisjes korporative për personat e licencuar, të regjistruar apo të njohur sipas këtij ligji;

e) praktikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut;

ë) përcaktimin e mënyrës sipas së cilës një person krijon një treg për një lloj të caktuar investimi;

f) përcaktimin e formës dhe të përmbajtjes së reklamave për veprimtaritë e rregulluara sipas këtij ligji;

g) përcaktimin e kufizimeve që drejtuesit e agjentëve të lidhur duhet t'u vendosin veprimtarisë së këtyre të fundit;

gj) përcaktimin e kërkesave për mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit nga shoqëritë e listuara me qëllim sigurimin e transparencës;

h) rregullimin e praktikës së shitjes së instrumenteve financiare të pa zotëruara nga shitësi *(short sale)* ose të rrethanave në të cilat kjo shitje mund të kryhet nga çdo person i licencuar, i regjistruar ose i njohur sipas këtij ligji;

i) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose trajtimin e ankesave drejtuar çdo personi që është i licencuar, i regjistruar ose i njohur sipas këtij ligji;

j) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose trajtimin e ankesave drejtuar Autoritetit;

k) kriteret e vendosjes së masave ndëshkimore dhe gjobave;
l) sigurimin e dëmshpërblimit të arsyeshëm për investitorët.

Neni 8
Kompetencat e Autoritetit në lidhje me këtë ligj

Autoriteti, në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në këtë ligj, kryen këto detyra:

a) i jep udhëzime ose urdhra të përgjithshme ose të veçanta çdo personi që ushtron veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;

b) u kërkon vlerësuesve, audituesve ose ofruesve të shërbimeve ndihmëse për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji, dhënien e çdo informacioni që Autoriteti mund ta konsiderojë të rëndësishëm për kryerjen e funksioneve të tij;

c) licencon ose njeh një person juridik për të ushtruar veprimtari të rregulluara dhe monitoron, mbikëqyr e rregullon sjelljen e tij për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj dhe çdo rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij ligji;

ç) regjistron punonjësin ose agjentin e lidhur të një subjekti përgjegjës për të ushtruar veprimtari të rregulluar në emër të një punëdhënësi ose subjekti përgjegjës të licencuar dhe monitoron, mbikëqyr dhe rregullon veprimtarinë e tyre për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj dhe çdo rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij ligji;

d) mban regjistrin e të gjithë personave të licencuar, të njohur ose të miratuar;

dh) kërkon që shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut të depozitojnë pranë Autoritetit pasqyrat financiare vjetore të certifikuara nga një auditues ligjor, në përputhje me formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti, si dhe informacione dhe raporte financiare të tjera periodike, që mund të kërkohen nga Autoriteti;

e) urdhëron çdo person që ushtron veprimtari të rregulluar sipas këtij ligji për të parandaluar shkeljen e menjëhershme të këtij ligji ose të rregulloreve të nxjerra në zbatim të këtij ligji;

ë) rregullon listimin dhe tregtimin e instrumenteve financiare në bursë, platformën shumëpalëshe të tregtimit ose platformën e organizuar të tregtimit;

f) rregullon emetimin e titujve;

g) pezullon listimin e çdo instrumenti financiar, përjashton nga listimi instrumentet financiare të listuara ose ndalon tregtimin e çdo instrumenti financiar, ose merr hapat që i çmon të nevojshëm ose të përshtatshëm për të siguruar mbrojtjen e investitorëve ose për të siguruar një treg të drejtë dhe të rregullt të titujve, ose për të siguruar integritetin e tregut të titujve;

gj) kryen hetime administrative për veprimtarinë e shoqërisë komisionere ose të institucionit të tregut për t'u siguruar që kjo veprimtari ushtrohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

h) publikon shkeljet e kryera nga shoqëria komisionere ose institucioni i tregut;

i) heton në rrugë administrative çdo pretendim për shkelje të parashikimeve të këtij ligji ose të rregulloreve të nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe vendos sanksionet administrative që i konsideron të nevojshme;

j) shkëmben informacion me Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit dhe kërkon asistencën e tyre për përmbushjen e kompetencave të tij sipas këtij ligji;

k) kërkon asistencën e institucioneve dhe të subjekteve të ndryshme financiare, kur kjo konsiderohet e nevojshme për përmbushjen e kompetencave të Autoritetit sipas këtij ligji, dhe urdhëron këto institucione të marrin masat e menjëhershme të kërkuara nga Autoriteti për të mbrojtur aktivet e investitorëve, operacionet e tregut apo zbatimin e parashikimeve të këtij ligji.

KREU III

LICENCIMI SEKSIONI I

KËRKESAT E PËRGJITHSHME QË U ZBATOHEN SHOQËRIVE KOMISIONERE, INSTITUCIONEVE DHE OPERATORËVE TË TREGUT

Neni 9
Personat që u lejohet të ushtrojnë veprimtaritë e rregulluara

1. Veprimtaritë e rregulluara sipas këtij ligji ushtrohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga personat e licencuar, të regjistruar ose të njohur, në zbatim të këtij ligji.

2. Ushtrimi i veprimtarive të rregulluara në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni konsiderohet vepër penale në kuptim të nenit 170, shkronja "ç", të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

3. Të gjithë personat e licencuar, të regjistruar ose të njohur, sipas këtij ligji duhet:

a) ta kenë selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë; ose

b) të kenë regjistruar një degë ose zyrë përfaqësimi të personit të huaj në Republikën e Shqipërisë;

c) të jenë agjentë të lidhur të një subjekti të licencuar në Republikën e Shqipërisë apo një subjekti të licencuar në një nga vendet e Bashkimit Evropian apo një vendi tjetër të përcaktuar me rregullore nga Autoriteti;

ç) të jenë persona të njohur, pavarësisht se selia e tyre ndodhet në një vend tjetër.

Neni 10

Përjashtimet nga kërkesa për licencim, njohje apo regjistrim

1. Banka e Shqipërisë përjashtohet nga licencimi, regjistrimi, njohja, mbikëqyrja dhe raportimi i të gjitha veprimtarive që rregullohen nga [k]y [li]g[j].

2. Përjashtohen nga kërkesat e kreut III të këtij ligji për shërbimet e investimit dhe kryerjes së veprimtarisë së investimeve:

a) shoqëritë e sigurimit, të risigurimit dhe shoqëritë që kryejnë veprimtari retrocedimi të licencuara në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurimet dhe risigurimet, kur kryejnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;

b) personat që u ofrojnë shërbime investimi vetëm shoqërive të tyre mëmë, shoqërive të tyre të kontrolluara ose shoqërive të tjera të kontrolluara nga shoqëria mëmë;

c) personat që ofrojnë shërbime investimi në mënyrë të rastësishme në rrjedhën e veprimtarisë së tyre profesionale, në rastet kur kjo veprimtari rregullohet nga dispozita ligjore ose nënligjore ose nga një kod etik profesional, që nuk përjashton ofrimin e këtyre shërbimeve;

ç) personat që tregtojnë për llogari të vet instrumente financiare dhe që nuk ofrojnë shërbime investimi, përjashtuar rastet kur këta persona:

i. janë krijues tregu;

ii. janë anëtarë ose pjesëmarrës në një treg të rregulluar ose një PSHT, ose kanë akses elektronik direkt në një vend tregtimi;

iii. zbatojnë teknika të tregtimit algoritmik me shpeshtësi të lartë;

iv. tregtojnë për llogari të vet kur ekzekutojnë urdhrat e klientëve;

d) organet publike përgjegjëse për administrimin e borxhit publik ose që luajnë rol në administrimin e borxhit publik, si dhe organet e tjera publike të krijuara posaçërisht për të ofruar asistencë financiare me objektivin e ruajtjes së stabilitetit financiar;

dh) sipërmarrjet e investimeve kolektive, fondet e pensioneve, si edhe depozitarët dhe shoqëritë administruese/administruesit e tyre, të licencuara në përputhje me kërkesat e legjislacionit të posaçëm në fuqi;

e) personat që tregtojnë për llogari të vet, përfshirë krijuesit e tregut në derivativët e mallrave apo në kuotat e lejuara të çlirimit të gazeve ose derivativët e tyre, duke përjashtuar ata persona që tregtojnë për llogari të vet kur ekzekutojnë urdhrat e klientëve, personat që ofrojnë shërbime investimi, përveç atyre që tregtojnë për llogari të vet në derivativët e mallrave ose në kuotat e lejuara të çlirimit të gazeve ose derivativët e tyre për klientët ose furnitorët e biznesit të tyre kryesor, me kusht që:

i. kjo veprimtari të jetë ndihmëse për aktivitetin e tyre kryesor, e vlerësuar si rast individual apo agregat në bazë grupi;

ii. aktiviteti i tyre kryesor të mos jetë ofrimi i shërbimeve;

iii. këta persona të mos përdorin një teknikë tregtimi algoritmik me frekuencë të lartë;

iv. të njoftojnë çdo vit Autoritetin se po përdorin këtë përjashtim dhe, sipas kërkesës, të raportojnë tek Autoriteti bazën mbi të cilën konsiderojnë se veprimtaria e tyre është ndihmëse kundrejt biznesit të tyre kryesor.

ë) personat që ofrojnë këshilla për investime gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre kryesore profesionale, e cila nuk parashikohet nga ky ligj, me kusht që ofrimi i këshillave të tilla nuk bëhet kundrejt

shpërblimit.

Neni 11
Kontratat ose marrëveshjet e lidhura nga personat e palicencuar

1. Çdo marrëveshje, e shkruar ose verbale, e lidhur nga një person gjatë ushtrimit të veprimtarive të rregulluara pa licencë nuk mund t'i kundrejtohet palës tjetër.

2. Pala që ka lidhur një marrëveshje të pazbatueshme sipas pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë të rimarrë çdo shumë të paguar ose të transferuar sipas marrëveshjes në fjalë, si edhe të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 12
Ndalimi i veprimtarive promocionale nga personat e palicencuar

1. Askush nuk mund të përhapë në asnjë lloj forme oferta ose nxitje për të marrë pjesë në një veprimtari të rregulluar nëse:

a) nuk është person i licencuar, i regjistruar ose i njohur nga Autoriteti;

b) përmbajtja e komunikimit nuk miratohet në kuptim të këtij neni nga një person i licencuar, i regjistruar ose i njohur.

2. Në rastin e komunikimeve me origjinë jashtë Republikës së Shqipërisë, pika 1 e këtij neni zbatohet vetëm nëse oferta merret nga persona në Republikën e Shqipërisë dhe është e tillë që mund të ketë efekt në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore rrethanat në të cilat personi konsiderohet se vepron në kuadër të veprimtarisë së tij tregtare, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

Neni 13
Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi

1. Asnjë person nuk mund të licencohet, të regjistrohet ose të njihet për ushtrimin e një veprimtarie të rregulluar nëse dhe për sa kohë Autoriteti nuk ka marrë dhe miratuar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të konstatuar nëse subjekti kërkues, aksionarët e tij dhe administratorët apo funksionarët kryesorë të parashikuar në nenin 39, kanë aftësitë e duhura dhe plotësojnë kriteret për të ushtruar veprimtarinë e rregulluar.

2. Autoriteti vlerëson nëse subjekti kërkues, aksionarët e tij dhe administratorët kanë aftësitë e duhura për të ushtruar një funksion të caktuar dhe, në veçanti, nëse personi në fjalë:

a) zotëron cilësitë e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës në shoqëri;

b) ka integritetin, ndershmërinë dhe përkushtimin e duhur për të përmbushur detyrat e tij;

c) zotëron kualifikimet e nevojshme dhe plotëson kriteret e përvojës profesionale në përputhje me përgjegjësitë e pozicionit përkatës;

ç) është i aftë të ruajë pavarësinë, në mënyrë që interesat e shoqërisë të mos cenohen nga konfliktet e interesit që mund të krijohen gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Autoriteti vlerëson edhe veprimtarinë tregtare ose financiare dhe sjelljen e subjektit kërkues, aksionarëve të tij apo personave që ushtrojnë kontroll mbi të, në të shkuarën dhe analizon, ndër të tjera, nëse ka prova që dëshmojnë se personi nuk ka aftësitë dhe kriteret e duhura.

4. Për të përcaktuar nëse një person është i aftë dhe i përshtatshëm për të mbajtur një pozicion të caktuar merren parasysh:

a) integriteti, ndershmëria, kujdesi dhe përkushtimi për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me një pozicion të caktuar;

b) kompetenca dhe aftësitë e duhura profesionale për përmbushjen e përgjegjësive që lidhen me pozicionin;

c) aftësitë financiare personale.

5. Vlerësimi i aftësive të përgjithshme, sipas pikës 4 të këtij neni, kryhet duke marrë parasysh sa më poshtë, pavarësisht faktit nëse veprimtaria ose ngjarja ka ndodhur në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër:

a) integritetin;

Në vlerësimin e integritetit, Autoriteti merr parasysh nëse personi:

i) është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krimit ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, si dhe pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ii. ka vepruar në kundërshtim me ndonjë nga kërkesat dhe standardet ligjore shqiptare ose me standardet apo kërkesat e ngjashme të autoriteteve të tjera rregullatore;

iii. është përjashtuar ose pezulluar nga një organ rregullator.

b) aftësitë profesionale;

Në vlerësimin e aftësive profesionale, Autoriteti merr parasysh nëse personi:

i. përmbush kërkesat përkatëse të përgatitjes dhe të aftësive profesionale të përcaktuara nga Autoriteti për detyrën që kryen ose ka për qëllim të kryejë;

ii. ka dëshmuar nëpërmjet përvojës dhe përgatitjes profesionale se është i përshtatshëm ose do të jetë i përshtatshëm, nëse miratohet, për të kryer funksionin.

c) aftësitë financiare;

Në vlerësimin e aftësive financiare, Autoriteti merr parasysh nëse personi:

i. është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose

ii. ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;

iii. është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.

6. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi vlerësohen dhe duhet të përmbushen nga subjekti kërkues, aksionarët e tij, anëtarët e organeve drejtuese dhe nga personat që e kontrollojnë, funksionarët kryesorë, si në momentin e marrjes së funksionit, ashtu edhe gjatë gjithë periudhës që janë në detyrë.

7. Rregullat e detajuara për mënyrën e vlerësimit të kritereve të aftësisë dhe të përshtatshmërisë, në përputhje me pozicionin dhe përgjegjësitë e çdo personi që është objekt i këtij neni, duke pasur parasysh edhe standardet ndërkombëtare në fushën e tregjeve të kapitalit, përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

SEKSIONI II
LICENCIMI, NDRYSHIMET E LICENCËS DHE HEQJA E LICENCËS PËR TË GJITHA VEPRIMTARITË E RREGULLUARA

Neni 14
Kërkesa për licencim

1. Çdo person juridik mund të kërkojë të licencohet për kryerjen e një ose më shumë veprimtarive të rregulluara sipas këtij ligji, duke specifikuar edhe shërbimet ndihmëse.

2. Subjekti që kërkon të licencohet duhet të vërtetojë se anëtarët e organeve drejtuese, funksionarët kryesorë dhe personat që ushtrojnë kontroll mbi të plotësojnë kriteret e aftësisë dhe të përshtatshmërisë, të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesa për licencë duhet t'i paraqitet Autoritetit në formën e përcaktuar me rregullore nga Autoriteti, si edhe të shoqërohet nga dokumentacioni i kërkuar dhe evidenca e pagesës së tarifës së miratuar nga Autoriteti.

4. Autoriteti mund t'i kërkojë subjektit kërkues që personi juridik ose individët, sipas pikës 2 të këtij neni, t'i japin Autoritetit informacione të mëtejshme në lidhje me kërkesën për licencë, sipas formës dhe mënyrës që mund të përcaktojë Autoriteti.

5. Kërkesa për licencim nuk konsiderohet e plotë derisa të përmbushen të gjitha kërkesat sipas këtij ligji apo rregulloreve të miratuara nga Autoriteti. Brenda 3 muajve nga plotësimi i kërkesave, subjekti kërkues njoftohet për vendimin e Autoritetit.

6. Bankat ose degët e bankave të huaja paraqesin kërkesën vetëm në përputhje me dispozitat që parashikohen në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 15
Kërkesa për bankat

1. Bankat, të cilat janë licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtaritë financiare të parashikuara nga ligji në fuqi "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", mund të ofrojnë shërbime investimesh në tituj vetëm pasi të jenë licencuar nga Autoriteti për të ushtruar edhe këtë veprimtari.

2. Në mbështetje të kërkesës së tyre për licencim, bankat duhet të japin informacion për:

a) strukturën organizative të njësisë ose të departamentit përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të investimit, përfshirë politikën e drejtimit të brendshëm të bankës dhe një përshkrim se si kjo njësi është e ndarë nga veprimtaritë e tjera të bankës;

b) personelin kyç të ngarkuar me ushtrimin e veprimtarive të rregulluara, përfshirë CV-të e tyre dhe dokumentet që vërtetojnë se janë të aftë dhe të përshtatshëm, si edhe një deklaratë personale të personave në fjalë se informacioni që përmban *Curriculum Vitae* është i vërtetë;

c) sistemin e teknologjisë së informacionit për kryerjen e veprimtarisë për të cilin kërkohet licencë;

ç) përshkrimin e procedurave që do të ndiqen për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me këtë ligj.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së rregulluar, banka e licencuar vepron në përputhje me nenet 62-69, 79—102 dhe nenet 103—106 të këtij ligji.

Neni 16
Dokumentacioni që shoqëron kërkesën për licencim

1. Kërkesa për licencim për të ushtruar veprimtarinë e rregulluar sipas këtij ligji për shoqëritë komisionere, të cilat nuk janë banka, shoqërohet me:

a) dokumente, që vërtetojnë se subjekti është shoqëri aksionare, e themeluar dhe e regjistruar në përputhje me ligjin në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, statutin, dokumente që provojnë se kapitali minimal i kërkuar është shlyer plotësisht, identitetin e aksionarëve dhe informacion mbi ta, si edhe informacion lidhur me burimin e krijimit të fondeve të paguara për kapitalin;

b) dokumente që vërtetojnë se aksionarët influencues të shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe këshillit të administrimit, personeli kyç, funksionarët kryesorë, audituesi i brendshëm dhe personat e certifikuar janë veçmas dhe bashkërisht të aftë dhe të përshtatshëm për të drejtuar e administruar veprimtarinë e rregulluar sipas përcaktimeve të nenit 13 të këtij ligji, përfshirë:

i. diplomat, certifikatat dhe dokumentet e tjera me rëndësi, që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale;

ii. *Curriculum Vitae* të plotë të këtyre personave, ku detajohet përvoja e tyre profesionale;

iii. deklaratën e personave kyç dhe të funksionarëve kryesorë, ku përfshihen emrat dhe kontaktet e personave që mund të konfirmojnë saktësinë e informacionit të dhënë në *Curriculum Vitae;*

iv. një përshkrim të standardeve të drejtimit të brendshëm, sipas praktikave të mira dhe standardeve që kërkon Autoriteti;

v. rolin e anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit dhe përshkrim me shkrim të detyrave dhe përgjegjësive të tyre;

vi. përshkrimin dhe përcaktimin e çdo sistemi të teknologjisë së informacionit dhe kontabilitetit në pronësi apo në përdorim, për të demonstruar se kanë dhe përdorin në mënyrë efikase burimet e procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë në mënyrën e duhur;

vii. organigramën e shoqërisë me përshkrime të funksioneve dhe përgjegjësive;

viii. manualet për procedurat;

ix. planin e biznesit për një minimum prej tre vjetësh, ku jepet një përshkrim i veprimtarisë tregtare që subjekti ka për qëllim të kryejë, mënyra e përmbushjes së kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë;

x. mënyrat e identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit dhe mënyrat si mund të eliminohen ose mbahen në kontroll dhe bëhen të ditura raste të tilla dhe politikat për tregtimin ose kryerjen e transaksioneve me palët e lidhura në përputhje me rregulloren për transaksionet me palë të lidhura;

xi. përshkrimin e procedurave që do të zbatohen për të garantuar zbatimin e të gjitha kërkesave rregullatore, në mënyrë që të mbrohen interesat e investitorëve dhe integriteti i tregut;

xii. programin për trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë personelit për të përmbushur standardet

për aftësitë profesionale, siç parashikohen në këtë ligj dhe në rregulloret e miratuara në zbatim të tij;

xiii. informacionin për sistemet e kontabilitetit dhe të kontrollit, të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe informacionin për procedurat operacionale;

xiv. informacionin për procedurat që u japin mundësi të jenë në përputhje me kërkesat e raportimit tek Autoriteti;

xv. informacionin për procedurat e raportimit tek investitorët;

xvi. informacionin e hollësishëm për procesin e administrimit të rrezikut;

xvii. përcaktimin e procedurave për përputhshmërinë me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave.

2. Autoriteti miraton me rregullore paketën e dokumenteve të standardizuara për të siguruar që kërkesat e depozituara të jenë të plota.

Neni 17

Kërkesat financiare minimale për shoqëritë komisionere

1. Shoqëria komisionere, që kërkon të licencohet për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë e rregulluara, duhet të plotësojë kërkesat financiare minimale.

2. Kapitali minimal fillestar për shoqërinë komisionere, që nuk tregton në emër të vet apo nuk nënshkruan instrumente financiare në bazë të angazhimit në transaksion, por që ruan e administron llogari instrumentesh financiare të klientit dhe që ofron një ose më shumë nga shërbimet e mëposhtme, duhet të jetë 16.250.000 lekë:

a) marrjen dhe transmetimin e urdhrave të klientëve për instrumentet financiare;

b) ekzekutimin e urdhrave të klientëve për instrumentet financiare;

c) administrimin e portofolave individualë të investimeve në instrumentet financiare.

3. Shoqëria komisionere, që nuk është e miratuar për të ofruar shërbimin ndihmës sipas shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 3 të këtij ligji, e cila ofron një ose më shumë nga shërbimet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “d” të pikës 48 të nenit 3, dhe që nuk lejohet të mbajë llogari titujsh që u përkasin klientëve, kërkohet të ketë:

a) kapital minimal fillestar 6.500.000 lekë; ose

b) policë sigurimi të përgjegjësisë profesionale ose garanci tjetër të ngjashme kundrejt detyrimeve për dëmet e ndodhura si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij, jo më pak se 65.000.000 lekë për çdo dëm dhe jo më pak se 97.500.000 lekë për të gjitha dëmet në një vit kalendarik; ose

c) një kombinim të kapitalit fillestar dhe sigurimit të përgjegjësisë profesionale në një formë që rezulton në një nivel mbulimi të barabartë me atë të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

4. Shoqëria komisionere, që kërkon të kryejë veprimtaritë e rregulluara, të cilat nuk janë parashikuar në pikat e mësipërme të këtij neni, duhet të ketë një kapital fillestar jo më pak se 95.000.000 lekë, përjashtuar përcaktimin e bërë në shkronjat “ë” dhe “f” të pikës 48 të nenit 3.

5. Investimi i kapitalit të shoqërisë komisionere në instrumente financiare nuk konsiderohet si veprimtari e rregulluar — tregtim në emër të vet.

Neni 18

Kushtet për dhënien e licencës

1. Kur miraton një licencë ose regjistrim, Autoriteti mund:

a) të përcaktojë dhe të përshkruajë veprimtarinë ose veprimtaritë e rregulluara për të cilat jepet licenca ose kryhet regjistrimi;

b) të vendosë kushte ose kufizime që i mendon të përshtatshme Autoriteti.

2. Çdo person juridik, i cili licencohet, njihet ose regjistrohet sipas këtij ligji, ose çdo person fizik/individ i regjistruar në zbatim të këtij ligji, është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhshmëri me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në çdo rregullore të miratuar nga Autoriteti, në zbatim të këtij ligji.

3. Çdo person juridik ose person i regjistruar, i cili shkel ndonjë prej kushteve ose të kufizimeve të vendosura në një licencë ose regjistrim, mund të jetë objekt i ndërhyrjes që e mendon të përshtatshme Autoriteti sipas kompetencave të tij, në zbatim të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 19

Procedurat e vendimmarrjes së njëkohshme lidhur me dhënien e licencës

Në momentin e dhënies së licencës një shoqërie komisionere, Autoriteti mund të marrë njëkohësisht vendim edhe për kërkesat e mëposhtme:

a) kërkesën për licencim të depozituar nga shoqëria komisionere;

b) kërkesën e depozituar nga zotëruesit e pjesëmarrjes influencuese, për miratim të blerjes së pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë komisionere;

c) kërkesën për dhënien e miratimit për emërimin e një anëtari të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose për një funksionar kryesor të shoqërisë komisionere.

Neni 20

Refuzimi i licencës

Autoriteti refuzon kërkesën për licencim të shoqërisë komisionere:

a) nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e neneve 13—17 të këtij ligji dhe në veçanti nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të shoqërisë komisionere, Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e aksionarëve, të funksionarëve kryesorë ose të drejtuesve;

b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje t'i përmbushë kërkesat e këtij ligji;

c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit pengohet nga:

i. lidhjet e pronësisë ndërmjet subjektit kërkues dhe personave të tjerë, juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër, që rregullojnë aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë me të cilët subjekti kërkues ka lidhje të ngushta;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 21

Ndryshimi i licencës ose regjistrimit të personit të licencuar ose të regjistruar

1. Autoriteti, me kërkesën e personit të licencuar ose të regjistruar, mund të ndryshojë licencën ose regjistrimin duke shtuar ose përjashtuar një veprimtari të rregulluar nga ato që janë përcaktuar në licencë ose regjistrim.

2. Nëse është dhënë licenca e përmendur në nenin 18, shoqëria komisionere mund të paraqesë kërkesë për zgjerimin e licencës për ofrimin e shërbimeve shtesë të investimit ose të veprimtarive ose shërbimeve ndihmëse të lidhura, të paparashikuara në momentin e licencimit fillestar, si edhe lidhur me instrumentet financiare, të cilat nuk përfshihen në licencën e dhënë.

3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për ndryshim, Autoriteti vlerëson:

a) plotësimin nga subjekti kërkues të të gjitha kërkesave sipas nenit 14 të këtij ligji për veprimtarinë e re;

b) eksperiencën profesionale dhe kompetencat e funksionarit kryesor të caktuar për kryerjen e funksioneve administruese për veprimtarinë e re;

c) nëse subjekti kërkues është në përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore për veprimtarinë e licencuar;

ç) nëse subjekti kërkues gjatë tre vjetëve të fundit ka qenë objekt i vërejtjeve apo sanksioneve për veprimtaritë e rregulluara.

4. Autoriteti mund:

a) të miratojë kërkesën e paraqitur për ndryshimin e licencës ose regjistrimit, me kushtet ose kufizimet që i gjykon të përshtatshme; ose

b) të refuzojë kërkesën për ndryshim të licencës ose regjistrimit, bazuar në një prej shkaqeve të përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji.

5. Kur Autoriteti refuzon kërkesën sipas këtij neni, duhet të japë njoftim.

Neni 22

Kërkesa për regjistrim si agjent i lidhur i një personi të licencuar

1. Çdo person që është ose propozon të bëhet agjent i lidhur i një personi të licencuar mund të depozitojë kërkesë për regjistrim pranë Autoritetit, për t'u lejuar të ushtrojë veprimtarinë e rregulluar për shoqërinë e licencuar komisionere në një ose më shumë cilësi.

2. Agjenti i lidhur i shoqërisë komisionere mund të kryejë vetëm atë ose ato veprimtari të rregulluara që lejohet të ushtrojë subjekti i licencuar me të cilin është lidhur. Megjithatë, kombinimi i veprimtarive të rregulluara që mund të ushtrohen varet nga natyra e veprimtarive të rregulluara dhe nëse ka konflikte të brendshme, që lindin nga ushtrimi i njëkohshëm i disa veprimtarive të rregulluara, të cilat do të përcaktohen nga Autoriteti.

3. Subjekti, që bën kërkesë për regjistrim si agjent i lidhur duhet të dëshmojë se plotëson kriteret e aftësisë dhe të përshtatshmërisë në përputhje me nenin 13 të këtij ligji dhe rregulloret e miratuara nga Autoriteti në zbatim të këtij ligji.

4. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore procedurën e kërkesës për regjistrim, përmbajtjen e kërkesës për regjistrim të agjentit të lidhur, si edhe dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën.

Neni 23

Miratimi i regjistrimit të agjentit të lidhur

1. Gjatë miratimit të regjistrimit, Autoriteti mund:

a) të përcaktojë dhe të përshkruajë veprimtarinë ose veprimtaritë e rregulluara për të cilat miratohet regjistrimi;

b) të përcaktojë që regjistrimi u nënshtrohet kushteve ose kufizimeve që i mendon të përshtatshme Autoriteti.

2. Çdo person, i cili regjistrohet, është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhshmëri me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në çdo rregullore të miratuar nga Autoriteti.

3. Çdo person, i cili shkel ndonjë prej kushteve ose kufizimeve të vendosura për një regjistrim, mund të jetë objekt i ndërhyrjes që e mendon të përshtatshme Autoriteti, sipas kompetencave të tij, në zbatim të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 24

Refuzimi i miratimit të regjistrimit të personit fizik ose të agjentit të lidhur

Autoriteti refuzon regjistrimin:

a) nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e nenit 13 të këtij ligji dhe në veçanti nëse Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e aksionarëve të tij ose të funksionarëve kryesorë; dhe

b) kur në rastin e personit juridik, ushtrimi efektiv i funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit pengohet nga:

i. lidhjet e pronësisë ndërmjet subjektit kërkues dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër, që rregullojnë aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë me të cilët ka lidhje të ngushta subjekti kërkues;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 25

Regjistri i agjentëve të lidhur

1. Autoriteti mban dhe përditëson rregullisht regjistrin e agjentëve të lidhur të licencuar nga Autoriteti.

2. Regjistri i agjentëve të lidhur, sipas pikës 1 të këtij neni, është publik.

3. Regjistri përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe mbiemrin e personit fizik ose emërtimin e shoqërisë dhe selinë e regjistruar të agjentit të lidhur;

b) emrin e shoqërisë komisionere, në emër të së cilës vepron agjenti i lidhur;

c) veprimtaritë e kryera nga agjenti i lidhur në emër të shoqërisë komisionere.

Neni 26

Detyrimet e shoqërisë komisionere për të monitoruar agjentin e lidhur

1. Shoqëria komisionere që emëron agjent të lidhur:

a) monitoron veprimtaritë e agjentit të lidhur në mënyrë që të sigurojë se zbaton dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji gjatë kryerjes së veprimtarive të lejuara;

b) sigurohet që agjenti i lidhur jep informacion për cilësinë me të cilën vepron dhe për shoqërinë komisionere që përfaqëson kur kontakton ose hyn në marrëdhënie tregtimi me çdo klient aktual ose të mundshëm, ose përpara se të ushtrojë ndonjë nga veprimtaritë e lejuara;

c) merr masat e përshtatshme për të shmangur çdo ndikim negativ që mund të kenë veprimtaritë e agjentit të lidhur, të cilat nuk mbulohen nga fushëveprimi i këtij ligji, për veprimtaritë e lejuara e të ushtruara nga agjenti i lidhur në emër të shoqërisë komisionere.

2. Shoqëria komisionere, që për çfarëdolloj arsye zgjidh ose ndërpret marrëdhënien me agjentin e lidhur, i cili është person fizik/individ ose juridik, njofton pa vonesë Autoritetin dhe i jep arsyet përkatëse për ndërprerjen e marrëdhënies.

Neni 27

Kërkesa për njohjen e personit të licencuar në një vend të huaj

1. Kur personi juridik, i vendosur në një vend të huaj, dëshiron të ushtrojë veprimtari investimesh në tituj në Republikën e Shqipërisë dhe është i licencuar nga një autoritet i huaj rregullator, Autoriteti mund ta njohë licencën e dhënë nga autoriteti kompetent i huaj kur konstaton se:

a) personi juridik është vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) personi juridik zotëron një licencë të përgjithshme për të ushtruar veprimtari të investimeve në tituj, sipas ligjit të vendit ku është vendosur, ose një licencë specifike për të kryer llojin e caktuar të veprimtarisë së investimeve, që dëshiron të ushtrojë në Republikën e Shqipërisë;

c) personi juridik dëshmon se anëtarët e organeve drejtuese, funksionarët kryesorë dhe personat që ushtrojnë kontroll mbi subjektin kërkues plotësojnë kriteret e aftësisë dhe të përshtatshmërisë.

2. Në kuptim të këtij ligji, personi juridik quhet se është i vendosur në një vend të huaj nëse selia e tij qendrore ndodhet në atë vend dhe nuk kryen transaksione investimi nga një seli e përhershme tregtare në Republikën e Shqipërisë.
3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore procedurën që ndiqet për të kërkuar njohjen e licencës së personit të huaj.
4. Ky nen zbatohet për personin juridik të huaj vetëm nëse, sipas vlerësimit të Autoritetit, dispozitat e ligjit, në zbatim të të cilave është licencuar personi për të ushtruar veprimtarinë e rregulluar në fjalë, u ofrojnë investitorëve në Republikën e Shqipërisë mbrojtje të paktën të barabartë me atë që u ofrohet nga dispozitat e këtij ligji.
5. Kur vlerëson kërkesën për njohjen e shoqërive të huaja komisionere, Autoriteti merr në konsideratë ekzistencën e rregullave ekuivalente për njohjen e shoqërive të huaja komisionere në legjislacionin e vendit të origjinës të sipërmarrjes kërkuese.

Neni 28

Regjistrimi i degës ose zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë

1. Shoqëria e huaj komisionere mund të ofrojë shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë në përputhje me këtë ligj dhe me çdo akt nënligjor të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, ose nëpërmjet regjistrimit të një dege apo zyre përfaqësimi në Shqipëri, ose duke përdorur një agjent të lidhur në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto shërbime dhe veprimtari të mbulohen nga një licencë e dhënë nga autoriteti kompetent i vendit të saj.

2. Çdo shoqëri e huaj komisionere, që kërkon të regjistrojë një degë ose zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë ose të përdorë agjentë të lidhur të vendosur në Republikën e Shqipërisë, njofton paraprakisht Autoritetin dhe i jep informacionet e mëposhtme:

a) të dhënat e licencës që ka marrë nga autoriteti kompetent i vendit të saj;

b) programin e veprimtarive, ku përshkruhen shërbimet e investimit ose shërbime të tjera që propozon të ofrojë në Republikën e Shqipërisë;

c) strukturën organizative të degës ose zyrës së përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse dega synon të përdorë agjentë të lidhur dhe identitetin e këtyre agjentëve të lidhur;

ç) nëse do të përdoren agjentë të lidhur në Republikën e Shqipërisë, kur shoqëria e huaj komisionere nuk synon të themelojë një degë, një përshkrim të shërbimeve të synuara që do të ofrohen nga agjentët e lidhur dhe strukturën organizative, përfshirë linjat e raportimit, dhe informacion për mënyrën se si shoqëria e huaj komisionere do të sigurojë përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë;

d) adresën në Republikën e Shqipërisë në të cilën mund të merren dokumente;

dh) emrat e funksionarëve kryesorë në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e huaj, të cilët janë përgjegjës për administrimin e degës, zyrës së përfaqësimit ose të agjentit të lidhur.

3. Nëse nuk ka arsye për të dyshuar për përshtatshmërinë e strukturës administrative ose gjendjen financiare të shoqërisë së huaj komisionere, duke pasur parasysh veprimtaritë e parashikuara, brenda tre muajve pas marrjes së informacionit të plotë, Autoriteti njeh shoqërinë e huaj komisionere dhe i njofton vendimin autoritetit rregullator të vendit të origjinës dhe shoqërisë së huaj komisionere.

4. Regjistrimi i një dege në Republikën e Shqipërisë mund të bëhet vetëm nëse:

a) shoqëria e huaj komisionere ose autoriteti rregullator i vendit të origjinës të shoqërisë së huaj komisionere i ka përcjellë Autoritetit informacionet e përcaktuara ose të kërkuara nga Autoriteti;

b) është vendosur bashkëpunim i kënaqshëm mbikëqyrës ndërmjet autoritetit rregullator të vendit të origjinës të shoqërisë komisionere dhe Autoritetit;

c) shoqëria komisionere është objekt i mbikëqyrjes së përshtatshme në vendin e origjinës;

ç) shoqëria komisionere përmbush kërkesat e vendosura për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në vendin e origjinës dhe këto kërkesa u sigurojnë investitorëve në Republikën e Shqipërisë mbrojtje të paktën ekuivalente me atë që u jepet kur investojnë pranë shoqërive vendase komisionere.

5. Kur Autoriteti refuzon të njohë shoqërinë e huaj komisionere, ai njofton autoritetin

rregullator të vendit të origjinës dhe shoqërinë e huaj komisionere, duke dhënë arsyet për refuzimin, brenda tre muajve nga data e depozitimit të kërkesës së plotë.

6. Në rast se ndryshon ndonjë prej informacioneve të vendosura në dispozicion të Autoritetit, sipas pikës 2 të këtij neni, shoqëria e huaj komisionere njofton me shkrim Autoritetin për këtë ndryshim të paktën një muaj përpara vënies në zbatim të ndryshimit.

Neni 29

Ofrimi i shërbimeve në një vend të huaj nga shoqëria shqiptare komisionere

1. Shoqëria vendase komisionere mund të ofrojë shërbime të investimit jashtë Republikës së Shqipërisë nëpërmjet vendosjes së një dege ose duke përdorur një agjent të lidhur në një vend të huaj, me kusht që shërbimet dhe veprimtaritë që propozon të ofrojë jashtë Republikës së Shqipërisë të përfshihen në një licencë të dhënë nga Autoriteti.

2. Shoqëria vendase komisionere, që dëshiron të regjistrojë një degë ose të përdorë agjentë të lidhur jashtë Republikës së Shqipërisë, njofton paraprakisht Autoritetin dhe i jep informacionet e mëposhtme:

a) programin e veprimtarive, ku përshkruhen, ndër të tjera, shërbimet e investimit që propozon të ofrojë në vendin e huaj;

b) strukturën organizative të degës, përfshirë informacionin nëse dega synon të përdorë agjentë të lidhur dhe identitetin e këtyre agjentëve të lidhur;

c) kur përdoren agjentë të lidhur në vendin e huaj dhe kur shoqëria vendase komisionere nuk synon të regjistrojë një degë, një përshkrim të përdorimit të synuar të agjentëve të lidhur dhe një strukturë organizative, përfshirë linjat e raportimit, duke përcaktuar pozicionin e agjentëve të lidhur në strukturën e shoqërisë vendase komisionere;

ç) adresën në vendin e huaj nga e cila mund të merren dokumente;

d) emrat e personave, të cilët janë përgjegjës për administrimin e degës ose të agjentit të lidhur; dhe

dh) konfirmimin nga autoriteti i huaj rregullator se shoqëria vendase komisionere mund të kryejë veprimtaritë e propozuara në vendin e huaj.

Neni 30

Heqja ose pezullimi i licencës, i regjistrimit ose i njohjes

1. Nëse Autoriteti çmon se personi i licencuar, i regjistruar ose i njohur ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose i ka dhënë Autoritetit informacione të rreme, të pasakta ose mashtruese:

a) personit i hiqet licenca, çregjistrohet ose nuk mund të jetë më person i njohur; ose

b) licenca, regjistrimi ose njohja e personit pezullohet për një periudhë të përcaktuar ose deri në përmbushjen e kushteve të përcaktuara.

2. Pezullimi, sipas këtij neni, nuk mund të bëhet për një periudhë më të gjatë se tre muaj. Megjithatë, nëse e konsideron të nevojshme, Autoriteti mund ta zgjasë afatin e pezullimit për një periudhë tjetër jo më të gjatë se tre muaj.

3. Në përfundim të periudhës së pezullimit, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, Autoriteti heq masën e pezullimit ose heq licencën, regjistrimin ose njohjen, sipas gjykimit të Autoritetit.

4. Autoriteti heq ose pezullon licencën, regjistrimin ose njohjen, përveç sa parashikohet në këtë nen, kur:

a) ndaj personit hapen procedura likuidimi ose falimentimi;

b) personi kryen veprimtari të rregulluara, të cilat nuk përfshihen në objektin e licencës;

c) për personin caktohet një administrator i përkohshëm;

ç) personi pushon së ushtruari veprimtarinë e rregulluar për një periudhë prej më shumë se 180 ditësh, me përjashtim të rastit kur ky pushim është miratuar paraprakisht nga Autoriteti;

d) anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose punonjësit kyç të personit në fjalë, sipas vlerësimit të Autoritetit, nuk i kanë kryer funksionet e tyre në mënyrë të ndershme dhe të drejtë;

dh) personi ka shkelur ose nuk ka përmbushur një kusht të zbatueshëm në lidhje me licencën;

e) personi nuk ka zbatuar një urdhër të Autoritetit;

ë) personi nuk i jep Autoritetit informacionet e kërkuara nga ky i fundit;

f) personi jep informacion të rremë ose mashtrues;

g) për ndonjë arsye tjetër, personi nuk plotëson më kriteret e aftësisë dhe përshtatshmërisë për

të mbajtur licencën; ose

gj) personi shkel ndonjë dispozitë tjetër të këtij ligji.

5. Në rastin e një personi të huaj të njohur, Autoriteti mund të konsultohet me autoritetin e huaj kompetent përkatës përpara nxjerrjes së urdhrit të heqjes së njohjes, në zbatim të këtij neni, me përjashtim të rastit kur çmon se është thelbësore për mbrojtjen e interesit të investitorëve që urdhri të jepet menjëherë.

6. Autoriteti publikon çdo vendim për pezullim ose heqje licence të marrë sipas këtij neni.

7. Autoriteti heq licencën e bankës për ofrim të shërbimeve të investimit kur:

a) Banka e Shqipërisë heq licencën e bankës për të ushtruar veprimtari të tilla;

b) banka ndodhet në kushtet e parashikuara në këtë nen për sa është e aplikueshme për bankën.

Neni 31

Procedura e dhënies së urdhrit, e pezullimit ose e heqjes

1. Përpara dhënies së urdhrit ose marrjes së një vendimi pezullimi apo heqjeje, Autoriteti:

a) njofton personin në fjalë, duke parashtruar arsyet për veprimin e propozuar dhe duke i dhënë personit në fjalë mundësinë të shprehet me shkrim; dhe

b) merr hapat që i çmon të realizueshëm në mënyrë të arsyeshme për të njoftuar edhe personat e tjerë, të cilët, sipas mendimit të Autoritetit, ka të ngjarë të preken nga masa në fjalë.

2. Nëse Autoriteti e çmon thelbësore, mund të marrë një urdhër:

a) pa e ndjekur këtë procedurë njoftimi; ose

b) kur Autoriteti ka filluar ta ndjekë procedurën, pavarësisht nëse ka përfunduar ose jo afati që personi të shprehet.

Neni 32

Pasojat e heqjes së licencës, të regjistrimit ose të njohjes

1. Heqja ose pezullimi i licencës, i regjistrimit ose i njohjes:

a) nuk e bën të pavlefshme një marrëveshje, kontratë ose transaksion të lidhur apo të miratuar nga personi në fjalë për një transaksion tregu, përpara marrjes së masës të heqjes apo të pezullimit; ose

b) nuk cenon të drejtat a detyrimet e asnjë personi, që lindin nga marrëveshja apo transaksioni i përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike.

2. Në rast heqjeje ose pezullimi, Autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim:

a) mund t'i kërkojë personit të pezullojë ushtrimin e veprimtarive për një periudhë të caktuar kohore ose derisa Autoriteti t'i japë leje të rifillojë veprimtaritë;

b) mund t'i kërkojë personit në fjalë t'ia kalojë aktivet dhe evidencat e klientëve një personi tjetër të përcaktuar në njoftim nga Autoriteti; ose

c) mund t'i lejojë personit në fjalë, në varësi të kushteve të përcaktuara në njoftim nga Autoriteti:

i. të kryejë operacionet tregtare thelbësore për mbrojtjen e interesave të klientëve gjatë periudhës së pezullimit; ose

ii. në rast heqje, të kryejë operacione tregtare vetëm me qëllim mbylljen e veprimtarisë tregtare.

Neni 33

Tërheqja e kërkesës për licencë, regjistrim ose njohje

1. Kërkesa për licencë, regjistrim ose njohje mund të tërhiqet përpara se të merret në shqyrtim nga Autoriteti.

2. Në varësi të pikave 3 dhe 4 të këtij neni, licenca, regjistrimi ose njohja e dhënë mund të hiqet nga Autoriteti me kërkesën ose me pëlqimin e personit të licencuar, të regjistruar ose të njohur.

3. Autoriteti mund të refuzojë heqjen e çdo licence, regjistrimi ose njohjeje nëse gjykon se interesi publik kërkon që çdo çështje, e cila ka të bëjë me personin në fjalë, të hetohet nga Autoriteti, në zbatim të kompetencave të tij përpara se të merret një vendim për kërkesën për heqje.

4. Autoriteti mund të refuzojë heqjen e licencës, të regjistrimit ose të njohjes edhe kur, sipas vlerësimit të tij, është e përshtatshme që ndaj personit në fjalë të vendoset një ndalim ose kufizim në zbatim të këtij ligji ose të vijohet zbatimi i një ndalimi ose kufizimi të vendosur mbi këtë person më parë.

5. Autoriteti publikon çdo heqje të bërë sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 34
Punësimi i personave të ndaluar

1. Nëse Autoriteti vlerëson se një individ nuk është person i aftë dhe i përshtatshëm ose nuk lejohet më nga ky ligj të punësohet nga apo të veprojë si agjent i lidhur i një personi të licencuar, të njohur ose të regjistruar apo të ushtrojë një veprimtari të rregulluar, Autoriteti mund të nxjerrë urdhër, sipas së cilit personit në fjalë i ndalohet të punësohet apo të ushtrojë veprimtaritë e mësipërme pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

2. Autoriteti mund të bëjë publike urdhrat e skualifikimit.

SEKSIONI III
MIRATIMI I ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË KOMISIONERE DHE CERTIFIKIMI I FUNKSIONARËVE KRYESORË

Neni 35
Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit/anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere

1. Shoqëria komisionere administrohet nga të paktën një administrator, i cili emërohet drejtor i Përgjithshëm. Në varësi të llojit dhe të madhësisë së shoqërisë, Autoriteti mund të kërkojë emërimin e më tepër se një administratori.

Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre anëtarë, të cilët janë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji zbatohen në mënyrë analoge për të gjithë administratorët/ anëtarët e këshillit të administrimit/anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere.

3. Administratorët/anëtarët e këshillit të administrimit/anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere duhet të gëzojnë reputacion mjaft të mirë, të kenë kualifikimet profesionale të kërkuara dhe të kenë përvojë të mjaftueshme, në mënyrë që të sigurojnë një administrim/mbikëqyrje të shëndoshë dhe të kujdesshëm të shoqërisë komisionere.

4. Administratorët e shoqërisë komisionere e drejtojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë me kohë të plotë dhe në bazë të një kontrate pune me shoqërinë komisionere.

5. Administratorët e shoqërisë komisionere e drejtojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë komisionere nga brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Autoriteti miraton me akt nënligjor kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët/anëtarët e këshillit të administrimit/anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere, përmbajtjen e kërkesës për dhënien e miratimit për këtë pozicion, dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën dhe përmbajtjen e dokumenteve.

Neni 36
Miratimi i emërimit

1. Një person mund të emërohet administrator/anëtar i këshillit të administrimit / anëtar i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere vetëm me miratimin paraprak të Autoritetit.
2. Kërkesa për dhënien e miratimit, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të depozitohet nga organi kompetent i shoqërisë komisionere.
3. Subjektet kërkuese, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, duhet t'i bashkëlidhin dokumentacionin që vërteton përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.
4. Personi, i cili ka marrë miratimin e Autoritetit për të njëjtin funksion në një shoqëri komisionere, duhet të aplikojë sërish për të marrë miratimin e Autoritetit përpara emërimit në të njëjtin pozicion në një shoqëri tjetër komisionere.
5. Autoriteti e refuzon dhënien e miratimit për emërimin e një administratori/anëtari të këshillit të administrimit/anëtari të këshillit mbikëqyrës nëse:
a) personi i propozuar nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji;
b) autoriteti ka arsye objektive dhe të provueshme për të besuar se veprimtaritë, të cilat ka ushtruar apo

ushtron personi, përbëjnë rrezik për administrimin e shoqërisë komisionere në përputhje me kërkesat e administrimit të rrezikut të nenit 52 të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji;
c) kërkesa për dhënien e miratimit përmban deklarata ose informacione të rreme.

Neni 37

Revokimi dhe përfundimi i afatit të miratimit për emërimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/anëtarit të këshillit mbikëqyrës

1. Autoriteti revokon miratimin për emërimin e një administratori, anëtari të këshillit të administrimit/anëtari të këshillit mbikëqyrës në këto raste:

a) administratori, anëtari i këshillit të administrimit/anëtari i këshillit mbikëqyrës nuk i përmbush më kushtet fillestare;

b) administratori, anëtari i këshillit të administrimit/anëtari i këshillit mbikëqyrës në mënyrë të përsëritur nuk përmbush detyrimin për të konstatuar dhe vlerësuar efikasitetin e politikave ose të procedurave të brendshme, që synojnë marrjen e të gjitha masave të nevojshme që shoqëria komisionere të jetë në përputhshmëri me këtë ligj, ose nuk përmbush detyrimin për të marrë masat e nevojshme, me qëllim eliminimin e parregullsive në veprimtarinë e shoqërisë komisionere;

c) nëse miratimi është dhënë mbi bazën e të dhënave të rreme.

2. Nëse Autoriteti revokon miratimin e dhënë për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/anëtarin e këshillit mbikëqyrës, shoqëria komisionere merr pa vonesë një vendim për ta zëvendësuar.

3. Në rastin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, shoqëria emëron zëvendësin, pa pëlqimin e Autoritetit, për një mandat maksimal tremujor.

4. Brenda afatit tremujor të përmendur në pikën 3 të këtij neni, zëvendësuesi duhet të miratohet nga Autoriteti në përputhje me procedurën e nenit 36 të këtij ligji.

5. Miratimi që jepet për një administrator, anëtar të këshillit të administrimit/anëtar të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere bëhet i pavlefshëm nëse:

a) personi nuk emërohet ose nuk e merr detyrën me të cilën lidhet miratimi brenda 12 muajve nga data e dhënies së miratimit;

b) përfundon mandati i emërimit të personit;

c) përfundon kontrata e punës e personit me shoqërinë komisionere.

Neni 38

Certifikimi i individëve si funksionarë kryesorë të personit të licencuar

1. Çdo individ që propozohet të punësohet me cilësinë e funksionarit kryesor, siç përcaktohet në nenin 39 të këtij ligji, dhe që ushtron funksione kyçe, pa përfshirë funksionin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/anëtarit të këshillit mbikëqyrës, duhet të certifikohet nga këshilli i administrimit/ këshilli mbikëqyrës i shoqërisë komisionere si person i aftë dhe i përshtatshëm për t'u lejuar të ushtrojë veprimtaritë e rregulluara për punëdhënësin e tij të licencuar, në një ose disa prej cilësive të parashikuara në nenin 39 të këtij ligji.

2. Çdo individ që propozohet të punësohet me cilësinë e funksionarit kryesor, duhet të dëshmojë se është person i aftë dhe i përshtatshëm në përputhje me kërkesat e nenit 13 të këtij ligji dhe rregulloren e Autoritetit për aftësinë dhe përshtatshmërinë.

3. Autoriteti përcakton me rregullore procedurën e certifikimit.

4. Çdo individ që propozohet të punësohet në funksionin e brokerit/këshilltarit të investimeve/ administratorit të portofolit apo pozicioneve të tjera të ngjashme, në përputhje me veprimtaritë për të cilat është licencuar shoqëria komisionere, certifikohet sipas kërkesave të këtij neni dhe rregullores së miratuar nga Autoriteti për këtë qëllim.

5. Shoqëria komisionere certifikon funksionarët kryesorë, duke i pajisur me një dokument për aftësinë dhe përshtatshmërinë e tyre, vlefshmëria e të cilit duhet të rishqyrtohet të paktën një herë në vit ose në momentin kur personi merret në punë nga shoqëria.

6. Shoqëria komisionere sigurohet se personat e certifikuar kanë kualifikimet përkatëse, të përcaktuara në pikën 7 të këtij neni.

7. Autoriteti përcakton me rregullore kualifikimet përkatëse që duhet të kenë personat e certifikuar

të shoqërive komisionere.

8. Personat që nuk janë të certifikuar, nuk lejohet të kryejnë veprimtaritë e përmendura në pikat 1 dhe 4 të këtij neni.

9. Shoqëria komisionere i vendos në dispozicion Autoritetit një listë të punonjësve që ka certifikuar, të paktën një herë në vit ose në çdo moment me kërkesën e Autoritetit.

10. Shoqëria komisionere informon rregullisht Autoritetin në kohën e duhur për çdo punonjës të ri të certifikuar ose për çdo punonjës që është larguar nga shoqëria për çfarëdolloj arsye.

Neni 39

Regjimi i certifikimit të funksionarëve kryesorë

1. Konsiderohen si funksione kyçe dhe funksionari kryesor që kryen detyrat duhet të certifikohet nga këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës si më poshtë:

a) drejtori i Departamentit të Financës;

b) drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;

c) drejtori i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

ç) drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;

d) drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm.

2. Procedura për miratimin, humbjen e vlefshmërisë së miratimit ose revokimin e certifikimit të një funksionari kryesor është e njëjtë me procedurën përkatëse për anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, të parashikuar në nenet 35, 36 dhe 37 të këtij ligji.

3. Për çdo funksionar kryesor, i cili ushtron funksione kyçe, shoqëria komisionere duhet të ketë një deklaratë përgjegjësie, ku të shprehen përgjegjësitë që duhet të kryejë funksionari kryesor në shoqëri dhe kërkesat e raportimit.

4. Është përgjegjësi e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të shoqërisë komisionere të sigurojë që çdo funksionar kryesor, i cili ushtron funksionet kyçe të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përmbush kriteret e aftësisë dhe përshtatshmërisë të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji.

5. Në shoqëri më të vogla, i njëjti person mund të ushtrojë më shumë se një prej përgjegjësive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast shoqëria duhet të jetë në gjendje të argumentojë se kjo është e përshtatshme dhe e justifikueshme. Në deklaratën e përgjegjësisë së personit duhet të përfshihet një shpjegim i qartë i çdo përgjegjësie të parashikuar.

6. Me përjashtim të shkronjave “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, shoqëria mund t'u delegojë një ose disa prej funksioneve të mësipërme palëve të treta, me kusht që palët e treta të plotësojnë të gjitha kërkesat për të qenë të duhura dhe të përshtatshme sipas këtij ligji.

7. Pavarësisht se funksionet më sipër mund të delegohen, shoqëria komisionere mban përgjegjësi për çdo veprim apo mosveprim të palëve të treta, të cilave u është deleguar funksioni.

Neni 40

Mbajtja e regjistrave të personave të miratuar dhe të certifikuar

1. Autoriteti duhet të mbajë një regjistër të të gjithë personave që miratohen si anëtarë të organeve drejtuese.

2. Regjistri përmban të dhënat e secilit anëtar të miratuar të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, që janë verifikuar si të aftë dhe të përshtatshëm.

3. Këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i çdo shoqërie komisionere mban evidencë të të dhënave të çdo personi që ky këshill ka certifikuar si të aftë dhe të përshtatshëm dhe të çdo revokimi ose anulimi certifikimi.

4. Informacioni për çdo funksionar kryesor të certifikuar nga këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës të shoqërisë komisionere si i aftë dhe i përshtatshëm vihet në dispozicion të Autoritetit për kontroll.

5. Regjistri i anëtarëve të miratuar të këshillave të administrimit/këshillave mbikëqyrës përfshin edhe të dhënat për revokimin e miratimit të anëtarëve të organeve drejtuese.

6. Regjistri mbahet konfidencial dhe nuk është publik. Regjistri përdoret nga vetë Autoriteti në rastet kur kërkohet miratim nga një shoqëri komisionere për një person, që ka mbajtur më parë pozicionin e anëtarit të organit drejtues ose të funksionarit kryesor në një tjetër shoqëri komisionere.

Neni 41
Emërimi i funksionarit kryesor

1.Një person emërohet funksionar kryesor i shoqërisë komisionere nga këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i shoqërisë komisionere pas certifikimit të tij.

2.Emërimi, sipas pikës 1 të këtij neni, është i vlefshëm për një periudhë kohore jo më të gjatë se pesë vjet.

3.Personi, i cili ka marrë certifikimin për pozicionin e funksionarit kryesor në një shoqëri komisionere, duhet të ricertifikohet përpara emërimit në pozicionin e funksionarit kryesor në një shoqëri tjetër komisionere.

4.Në rastin e përmendur në pikën 3 të këtij neni, shoqëria komisionere mund të emërojë një zëvendës pa certifikim, për një mandat maksimal prej tre muajsh.

5.Brenda afatit tremujor të përmendur, zëvendësuesi duhet të certifikohet në përputhje me procedurën e nenit 38 të këtij ligji.

Neni 42
Standardet e sjelljes profesionale të personave të certifikuar

1. Gjatë kryerjes së veprimtarive të lidhura me shërbimet e investimit që u ofron klientëve shoqëria komisionere, personat e certifikuar veprojnë në përputhje me:

a) dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji; dhe

b) çdo rregull dhe standard profesional përkatës.

2. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore standardet e sjelljes së personave të certifikuar.

3. Autoriteti i kërkon shoqërisë komisionere të revokojë certifikimin e një personi nëse:

a) personi i certifikuar është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë, krimit ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

b) personi i certifikuar nuk i përmbush më kërkesat fillestare në bazë të të cilave është certifikuar nga shoqëria komisionere;

c) shoqëria komisionere konstaton se certifikimi është bërë në bazë të informacioneve të rreme.

4. Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë komisionere të revokojë certifikimin nëse personi i certifikuar ka shkelur me dashje rregullat e bursës ose të platformës shumëpalëshe të tregtimit, duke u shkaktuar dëme ose humbje klientëve të shoqërisë ose pjesëmarrësve të tjerë të tregut, ose ka përdorur funksionin për përfitime vetjake në dëm të tyre.

5. Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë komisionere të revokojë certifikimin nëse ka informacion se personi i certifikuar ka shkelur rregullat ose rregulloret e një autoriteti të huaj kompetent.

6. Nëse personi i certifikuar shkel dispozitat e këtij ligji ose nëse në mënyrë të vazhdueshme kryen kundërvajtje penale ose vepra penale, Autoriteti mund t'i heqë të drejtën për të vepruar si person i certifikuar në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI IV
DETYRIMET PËR NJOFTIM

Neni 43
Ndryshime të aktivitetit tregtar

1. Shoqëria komisionere njofton Autoritetin paraprakisht nëse ka ndryshime të konsiderueshme:

a) në mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë tregtare ose në llojin e veprimtarisë tregtare që synon të ushtrojë shoqëria, ose do të ndërpresë kryerjen e disa veprimtarive të caktuara të rregulluara;

b) në bazën e synuar të klientëve.

2. Autoriteti mund t'i miratojë këto ndryshime nëse nuk përbëjnë ndryshim të konsiderueshëm të kushteve në bazë të të cilave është dhënë licenca.

3. Nëse ndryshimet e propozuara janë të konsiderueshme, Autoriteti mund të kërkojë që shoqëria të depozitojë kërkesë për ndryshim ose zgjerim të kushteve të licencës.

Neni 44

Ndryshimi i personave që ushtrojnë përgjegjësi drejtuese

1. Të gjitha shoqëritë komisionere duhet t'i njoftojnë paraprakisht Autoritetit identitetin dhe çdo ndryshim të mëpasshëm të anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarëve kryesorë, bashkë me të gjitha informacionet e nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, të cilët, në mënyrë efektive, ushtrojnë përgjegjësi drejtuese në veprimtarinë e saj përpara se të zbatohen këto ndryshime.

2. Autoriteti mund të refuzojë miratimin e ndryshimeve të propozuara kur ka arsye për të besuar se personi ose personat e propozuar nuk janë të aftë dhe të përshtatshëm për të ushtruar në mënyrë efektive përgjegjësinë drejtuese në operacionet e shoqërisë.

Neni 45

Pjesëmarrja influencuese dhe ndikimi i konsiderueshëm mbi shoqërinë komisionere

1. Kur një person kërkon të marrë në zotërim ose ka marrë në zotërim pjesëmarrje influencuese të aksioneve të një personi të licencuar ose të regjistruar nëpërmjet së cilës mund të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm në drejtimin e tij, duhet të njoftojë për këtë Autoritetin, paraprakisht ose kur të marrë dijeni për këtë. Një kontroll i tillë nuk fillon të prodhojë pasoja pa miratimin e Autoritetit.

2. Autoriteti mund të miratojë rregullore me anë të të cilave të kërkojë që personi, i cili propozon të marrë ose ka marrë një pjesëmarrje të tillë influencuese, t'i japë Autoritetit informacionet dhe dokumentet që Autoriteti i gjykon të nevojshme, me qëllim që Autoriteti të mund të konstatojë nëse:

a) personi që merr ose propozon të marrë në zotërim pjesëmarrjen influencuese është i aftë dhe i përshtatshëm për këtë qëllim; dhe

b) ndryshimi i pjesëmarrjes influencuese nuk rrezikon interesat e investitorëve.

3. Autoriteti merr vendim për miratimin ose refuzimin e ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese brenda tre muajve nga data e njoftimit të ndryshimit. Nëse Autoriteti, pas përfundimit të vlerësimit, vendos refuzimin e ndryshimit të pjesës influencuese, jo më vonë se periudha e vlerësimit, informon personin me shkrim dhe jep arsyet për vendimin e refuzimit. Një deklaratë e përshtatshme për arsyet e vendimit mund të bëhet e disponueshme për publikun me kërkesën e personit, por kjo nuk do të pengojë që Autoriteti të bëjë një deklarim të tillë në mungesë të një kërkese nga personi.

4. Miratimi i Autoritetit mund të jepet pa kushte ose mund të jetë objekt i kushteve apo i kufizimeve që i gjykon të përshtatshme Autoriteti.

5. Nëse Autoriteti propozon të vendosë kushte për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese nga një person, duhet ta njoftojë këtë person në përputhje me procedurën e nenit 46 të këtij ligji.

Neni 46

Fitimi i pronësisë mbi aksionet e shoqërisë komisionere në mënyrë të papërshtatshme

Nëse një person ka marrë në zotërim ose ka vijuar të zotërojë aksione të një shoqërie komisionere në kundërshtim me:

a) refuzimin e Autoritetit; ose

b) një kusht të vendosur nga Autoriteti.

Autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, mund të urdhërojë që aksionet në fjalë t'i nënshtrohen, deri në një njoftim të dytë, njërës ose disa prej kufizimeve të mëposhtme:

i. transferimi (ose marrëveshja për transferim) i këtyre aksioneve, ose në rastin e aksioneve të paemetuara, transferimi (ose marrëveshja për transferim) i së drejtës për të marrë në zotërim aksionet e emetuara është i pavlefshëm;

ii. në lidhje me aksionet nuk mund të ushtrohet asnjë e drejtë vote;

iii. asnjë aksion tjetër nuk duhet të emetohet mbi bazën e këtyre aksioneve apo për zotëruesit e tyre;

iv. me përjashtim të një procedure likuidimi, shoqëria komisionere nuk duhet të kryejë asnjë pagesë bazuar mbi këto aksione.

KREUIV
USHTRIMI I VEPRIMTARIVE TË LICENCUARA

SEKSIONI I
PËRGJEGJËSITË E SHOQËRIVE KOMISIONERE

Neni 47
Parimet themelore

1. Gjatë ofrimit të shërbimeve të investimit në instrumente financiare dhe/ose, sipas rastit, të shërbimeve ndihmëse për klientët, shoqëria komisionere duhet të veprojë në përputhje me interesin më të mirë të klientit, me ndershmëri e profesionalizëm dhe në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës, brokerat, funksionarët kryesorë, personat e certifikuar, këshilltarët e investimeve, të punësuarit e tjerë të shoqërisë komisionere dhe agjentët e lidhur duhet të ruajnë sekretin lidhur me informacionin për klientët, gjendjen dhe veprimet e llogarive të klientëve, shërbimet që u japin klientëve, si edhe çdo informacion tjetër për të cilin kanë marrë dijeni gjatë ofrimit të shërbimeve të investimit dhe, sipas rastit, të shërbimeve ndihmëse. Këto informacione konsiderohen konfidenciale dhe personat e përmendur në këtë pikë nuk duhet t'i përdorin ato apo t'i përhapin te palët e treta, dhe as nuk duhet t'u japin mundësi palëve të treta t'i përdorin ato.

3. Informacioni, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk trajtohet si konfidencial kur kërkohet nga Autoriteti, organet gjyqësore dhe administrative në ushtrim të kompetencave të tyre mbikëqyrëse dhe të kompetencave të tjera publike në përputhje me këtë ligj ose me një akt tjetër ligjor, ose kur klientëve u kërkohet të lejojnë përhapjen e një informacioni të caktuar.

Neni 48
Detyrimi për të vepruar me ndershmëri dhe profesionalizëm

1. Të gjithë personat e licencuar, të regjistruar ose të njohur, sipas këtij ligji, duhet:

a) të veprojnë me ndershmëri dhe paanësi në interesin më të mirë të investitorëve dhe të integritetit të tregut;

b) të veprojnë me aftësinë dhe kujdesin e duhur, duke zbatuar rregullat profesionale, praktikën më të mirë tregtare dhe aktet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

c) të ushtrojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj me efikasitet, në mënyrën e kohën e duhur, dhe të mbajnë përgjegjësi për to, pavarësisht nëse ndonjë prej tyre u është deleguar palëve të treta;

ç) të garantojnë ruajtjen e sekretit të të dhënave të klientëve në lidhje me tregtimin ose pronësinë e titujve ose burimeve financiare dhe t'i përhapin këto të dhëna vetëm në bazë të një vendimi të gjykatës, të një marrëveshjeje mirëkuptimi për shkëmbim informacioni, që garanton ruajtjen e ndërsjellë të sekretit apo të kërkesës së një klienti individual ose të një kujdestari të caktuar nga klienti;

d) të sigurojnë që të gjitha materialet reklamuese dhe promocionale, komunikimet dhe njoftimet për klientët që u dërgohen këtyre të fundit ose botohen në shtyp, ose në median elektronike publike, të jenë të qarta, të sakta, jokeqinformuese dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregulloreve të Autoritetit apo të autoritetit kompetent të një shteti tjetër në rastin e personit të njohur ose personit të licencuar ose të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që ushtron veprimtari në një vend tjetër;

dh) të sigurojnë që kontrata e shërbimit ose kontrata për administrimin e portofolit e lidhur me klientin të japë një përshkrim të plotë të shërbimeve që ofrohen, të përcaktojnë koston e tyre dhe të parashikojnë të drejtat e klientëve;

e) të sigurojnë që klientëve të tyre u jepen të gjitha informacionet për natyrën e investimit dhe rrjedhojat financiare të transaksionit, në mënyrë që klientët të mund të marrin një vendim të mirinformuar;

ë) nëse u lejohet të mbajnë aktive të klientëve, të sigurojnë që të gjitha aktivet e klientëve të mbahen në llogari të veçanta;

f) të informojnë klientët për kushtet e transaksionit, duke përfshirë çdo komision ose tarifa të tjera të zbatueshme;

g) të tregtojnë instrumentet financiare në përputhje me licencën e dhënë nga Autoriteti;

gj) të sigurojnë se transaksionet e kryera në emër të klientit janë kryer me kushtet më të mira të mundshme;

h) nëse nuk u lejohet të mbajnë ose të kontrollojnë aktivet ose paratë e klientit, të sigurojnë që aktivet e blera në emër të klientit të depozitohen për ruajtje pranë një kujdestari të licencuar e të caktuar nga klienti;

i) t'i dërgojnë klientit një kopje të të gjitha kontratave origjinale ose dokumenteve të tjera për transaksionet e kryera në emër të klientit, menjëherë pas përgatitjes së këtyre dokumenteve ose pas marrjes së tyre;

j) të mbajnë evidenca për transaksionet që bëhen me titujt dhe aktivet monetare të klientëve, veçmas nga llogaritë e tij, të mbajnë evidenca në lidhje me klientët dhe t'i rakordojnë këto me aktivet e mbajtura nga kujdestari i caktuar nga klienti;

k) t'u raportojnë rregullisht klientëve për portofolat dhe transaksionet, siç është rënë dakord në kontratën fillestare me klientin;

l) të paraqesin pranë Autoritetit raporte periodike, siç është parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji;

ll) t'i raportojnë Autoritetit çdo ndryshim në lidhje me anëtarët e këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës, funksionarët kryesorë, pjesëmarrjet influencuese, kapitalin e paguar dhe burimet financiare, si dhe çdo ndryshim tjetër për kushtet e licencimit apo ndonjë çështje tjetër të miratuar paraprakisht nga Autoriteti, siç i kërkohet nga Autoriteti;

m) të lejojnë Autoritetin të inspektojë regjistrat e shoqërisë së licencuar komisionere dhe t'ia vendosin këto në dispozicion në kohën e duhur, si dhe të lejojnë marrjen në pyetje të çdo personi që kryen një funksion të caktuar në shoqërinë komisionere;

n) të mos lidhin marrëveshje me qëllim kufizimin ose ndryshimin e përgjegjësive dhe të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj. Çdo marrëveshje e tillë konsiderohet e pavlefshme;

nj) të sigurojnë që punonjësit e certifikuar veprojnë në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore përkatëse në fuqi;

o) të administrojnë portofolat për të cilët ka kompetenca diskrecionale administrimi, sipas një kontrate me shkrim me klientin, në përputhje me objektivat e investimit të parashikuara në këtë kontratë;

p) t'i japin porosi të qarta dhe të kuptueshme kujdestarit për çdo veprim që nevojitet për të mbrojtur interesat e klientëve apo për të ushtruar ndonjë të drejtë.

2. Autoriteti miraton me rregullore rregullat e veçanta për kodin e sjelljes.

Neni 49

Përgjegjësitë organizative

Të gjithë personat e licencuar, të regjistruar dhe të njohur, sipas këtij ligji, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të miratojnë një organigramë, që ilustron veprimtaritë e lejuara, përgjegjësitë dhe kufizimet e kompetencave të të gjithë anëtarëve të organeve drejtuese, funksionarëve kryesorë dhe punonjësve të tjerë të certifikuar;

b) të identifikojnë qartë rastet e konfliktit të interesit dhe të kenë procedura të dokumentuara për menaxhimin e pasojave negative të çdo rasti konflikti interesi;

c) të marrin masat e duhura për të administruar rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohen dhe të administrojnë rrezikun në mënyrë të dokumentuar;

ç) të garantojnë që nënkontraktimi i funksioneve të rëndësishme operacionale të mos pengojë në mënyrë thelbësore mekanizmat e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mundësinë e Autoritetit për të mbikëqyrur përmbushjen e detyrimeve ose të kërkesave të këtij ligji ose të rregulloreve që mund të miratojë Autoriteti;

d) të kenë sisteme të përshtatshme për llojin, masën dhe vëllimin e veprimtarisë tregtare që synon të ushtrojë;

dh) fillimisht dhe në vazhdimësi, të kenë burime të mjaftueshme financiare për të mundësuar funksionimin e tyre të rregullt duke pasur parasysh natyrën, masën e shërbimeve të ofruara, shkallën e rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohen dhe të mbajnë llogari për burimet financiare, të cilat të tregojnë kapitalin e paguar dhe aktivet e rregulluara për rrezikun, të mjaftueshme për mbulimin e detyrimeve të tyre në çdo kohë.

Neni 50

Aktet nënligjore lidhur me ushtrimin e veprimtarisë

1. Autoriteti mund të miratojë rregullore në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive komisionere të licencuara, të njohura dhe të regjistruara, të cilat Autoriteti i konsideron të nevojshme për të mbrojtur interesat e klientit, për të siguruar funksionimin e drejtë e të rregullt të tregjeve financiare, për të parandaluar rrezikun sistemik në sistemin financiar dhe për të rritur standardet profesionale të shoqërive komisionere e të personave të regjistruar dhe të njohur.

2. Ndër të tjera këto rregullore mund:

a) të kërkojnë nga shoqëritë komisionere, të cilat përdorin agjentë të lidhur, të vendosin kufizime për veprimtarinë e ushtruar prej agjentëve;

b) të parashikojnë përhapjen e informacionit për interesat dhe rrethanat thelbësore lidhur me transaksionet që kryhen apo për të cilat jepen këshilla gjatë ushtrimit të veprimtarisë së rregulluar, përfshirë informacion për çdo komision ose të ardhura të tjera të arkëtuara ose të arkëtueshme nga një palë e tretë në lidhje me secilin prej këtyre transaksioneve;

c) të kërkojnë që klientit t'i jepen të gjitha informacionet për natyrën e investimit dhe pasojat financiare të një transaksioni, në mënyrë që klienti të mund të marrë një vendim të mirinformuar;

ç) të parashikojnë kërkesa për formën dhe përmbajtjen e reklamave për investimet;

d) të rregullojnë mënyrën me të cilën një person krijon treg për çdolloj investimi;

dh) të parashikojnë procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me klientët;

e) t'i kërkojnë një personi të cilit i zbatohen rregullat, të marrë masa për mbrojtjen e investitorëve në rast të ndërprerjes së veprimtarisë të investimit si pasojë e vdekjes, pazotësisë për të vepruar apo e rrethanave të tjera.

Neni 51

Procedurat organizative dhe të brendshme

1. Të gjitha shoqëritë komisionere të licencuara, të njohura dhe të regjistruara duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet një strukture të përshtatshme administrative dhe llogaridhënieje, e cila përfshin procedura dhe procese të përshtatshme të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të rrezikut, të një madhësie e kapaciteti të përshtatshëm për veprimtarinë dhe që i jep mundësi shoqërisë komisionere të monitorojë rreziqet e përputhshmërinë me këtë ligj dhe me çdo akt nënligjor të miratuar në zbatim të këtij ligji.

2. Kjo strukturë organizative duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë dhe linjat e raportimit te drejtuesit e lartë. Gjithashtu, kjo strukturë duhet të ketë një sistem efikas të brendshëm për shpërndarjen e informacionit.

Neni 52

Funksioni i administrimit të rrezikut

1. Shoqëria komisionere e licencuar, e njohur ose e regjistruar, sipas këtij ligji, duhet të ketë një sistem të administrimit të rrezikut të përshtatshëm për veprimtarinë që ushtron.

2. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë identifikimin, kontrollin dhe zbutjen e të gjitha rreziqeve tregtare dhe operative. Në këto rreziqe përfshihen:

a) moszbatimi i këtij ligji dhe i akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji;

b) mosidentifikimi dhe mosmbajtja në kontroll e konfliktit të interesit;

c) mosmbajtja në kontroll e zbatimit të marrëveshjeve kontraktore me klientët;

ç) moskategorizimi i klientëve si palë të pranueshme, klientë profesionistë, klientë të kualifikuar ose klientë joprofesionistë;

d) moszbatimi i procedurave të duhura për secilën kategori të klientëve;

dh) zbatimi i çmimeve të gabuara ose i çmimeve jo më të mira në transaksione;

e) mostrajtimi me ndershmëri i klientëve dhe i investitorëve;

ë) shkaktimi i humbjeve klientëve si pasojë e mosfunksionimit administrativ;

f) mungesa e komunikimit me furnitorët e shërbimeve dhe mosmbajtja e tyre nën kontroll;

g) mosmbajtja nën kontroll e pikave të shitjeve dhe agjentëve të lidhur;

gj) humbja e besimit të klientëve si pasojë e reklamave mashtruese;

h) humbje biznesi si pasojë e rezultateve të këqija dhe shërbimit të dobët.

3. Këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i shoqërisë komisionere është përgjegjës për të siguruar që:

a) është krijuar dhe zbatohet një sistem i pavarur i administrimit të rrezikut;

b) merr raporte të rregullta për procesin e administrimit të rrezikut;

c) informohet për çdo risk madhor në momentin kur ai lind dhe identifikohet;

ç) identifikohen dhe analizohen në mënyrë sasiore të gjitha rreziqet;

d) hartohet dhe kuptohet kuadri i administrimit të rrezikut;

dh) sistemi i administrimit të rrezikut mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme;

e) bëhen shqyrtime dhe testime të rregullta të kuadrit të administrimit të rrezikut.

4. Sistemi i administrimit të rrezikut është i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose administratorëve.

5. Sistemi i administrimit të rrezikut ka këto p[ër]g[je]gi[ësi:]

a) monitoron dhe vlerëson rreziqet në përputhje me procedurën e rënë dakord;

b) i vendos manuale në dispozicion secilit departament;

c) bën trajnimin e brendshëm të personelit për administrimin dhe identifikimin e rreziqeve;

ç) harton dhe i paraqet këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës raporte të rregullta për administrimin e rrezikut;

d) sugjeron ndryshime në procesin e administrimit të rrezikut, bazuar në përvojat aktuale;

dh) identifikon rreziqet e reja, që lindin si pasojë e ndryshimeve në mjedisin tregtar, në modelin tregtar ose nga produktet e reja.

Neni 53

Auditimi i brendshëm

1. Çdo shoqëri komisionere duhet të ketë një sistem të auditimit të brendshëm, i cili mund të delegohet, por me kusht që të përmbushë të gjitha kërkesat e pikës 2 të këtij neni.

2. Sistemi i auditimit të brendshëm i raporton drejtpërdrejt këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës si më poshtë:

a) nëse shoqëria komisionere është e organizuar në mënyrë të tillë që të nxisë administrimin efektiv dhe të kujdesshëm të veprimtarisë tregtare, si dhe i jep informacion këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës për çështje organizative dhe kontabël;

b) që të gjithë punonjësit janë të trajnuar siç duhet, i kuptojnë funksionet dhe përgjegjësitë dhe pajisen me manuale për procedurat;

c) që i gjithë personeli operativ i respekton rregullat dhe procedurat, që kanë të bëjnë me pozicionet e tyre të veçanta;

ç) për identifikimin e pikave të dobëta të sistemeve dhe masave kontrolluese, që mund të çojnë në humbje ose në mospërputhshmëri;

d) për zbatimin e parimeve të drejtimit të brendshëm të shoqërisë, përcakton politikat dhe strategjitë për respektimin e këtyre parimeve, si dhe vlerëson çdo vit zbatimin e këtyre politikave e strategjive;

dh) për mjaftueshmërinë e kontrollit financiar dhe respektimin e kufizimeve të miratuara të përgjegjësisë për kryerjen e shpenzimeve;

e) për identifikimin dhe hetimin e rasteve të mundshme të vjedhjes, të mashtrimit ose të shkeljeve nga ana e personelit;

ë) për përmirësimin ose rishikimin e objektivave, strategjisë, planeve të biznesit dhe politikave kryesore, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit;

f) për të mundësuar shqyrtimin e objektivave, të strategjisë dhe të politikave të biznesit, si dhe të kontrollojë zbatimin e tyre nga funksionarët kryesorë;

g) për të siguruar që sistemi i kontabilitetit të shoqërisë komisionere ofron informacione të sakta dhe në kohën e duhur lidhur me kapitalin e vet, burimet financiare, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rentabilitetin.

Neni 54

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe burimet financiare

1. Të gjitha shoqëritë vendase komisionere të licencuara nga Autoriteti, duhet të ruajnë burimet financiare të përcaktuara për kategoritë e veprimtarisë së rregulluar për të cilat janë licencuar.

2. Niveli i kapitalit themeltar të shoqërisë komisionere varet nga lloji dhe objekti i shërbimeve dhe veprimtarive të investimit për të cilat shoqëria komisionere paraqet kërkesë për miratim pranë Autoritetit.

3. Autoriteti miraton rregullore për të përcaktuar kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit për secilën kategori të shoqërive komisionere sipas shërbimeve që ofrojnë dhe sipas kombinimit ose madhësisë së tyre.

4. Kapitali fillestar i shoqërisë komisionere duhet të paguhet plotësisht në para dhe aksionet që përbëjnë kapitalin fillestar nuk mund të emetohen pa u paguar çmimi i plotë i emetimit.

Neni 55

Shoqëritë komisionere me shërbime të plota

1. Shoqëritë komisionere quhen shoqëri me shërbime të plota nëse licencohen për të kryer të gjitha veprimtaritë e rregulluara të poshtëshënuara:

a) marrja dhe transmetimi i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare;

b) ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve;

c) tregtimi për llogari të vet;

ç) administrimi i portofolit, duke përjashtuar administrimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, që rregullohet në ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive;

d) veprimtaria e këshillimit për investime;

dh) nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare me angazhim shitjeje;

e) hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje.

2. Shoqëria me shërbime të plota duhet të ruajë mjaftueshmerinë e kapitalit, siç parashikohet me akt nënligjor.

3. Autoriteti mund të parashikojë zbatimin e një formule të bazuar në kapitalin themeltar ose në kërkesat për shpenzimet fikse ose në burimet financiare të bazuara në rrezik, në varësi të madhësisë dhe të llojit të veprimtarive të kryera nga subjekti i licencuar.

4. Autoriteti mund të miratojë me rregullore edhe një format standard për llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit.

5. Autoriteti përcakton me rregullore kërkesa specifike për veprimtarinë e administrimit të portofolit.

Neni 56

Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari të rregulluara të kufizuara

1. Shoqëria me veprimtari të rregulluar të kufizuar, që kryen vetëm ekzekutimin e urdhrave dhe nuk është e licencuar të mbajë para ose aktive të klientëve, mund të ofrojë vetëm këto veprimtari:

a) marrjen dhe transmetimin e urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare;

b) ekzekutimin e urdhrave për llogari të klientëve;

c) veprimtarinë e këshillimit në investime.

2. Fondet e veta të shoqërisë me veprimtari të rregulluara të kufizuara duhet të jenë në çdo moment të barabarta me shumën e kapitalit fiks të përcaktuar me akt nënligjor.

3. Fondet e veta të një shoqërie me veprimtari të rregulluara të kufizuara duhet të mbahen në formë likuide dhe duhet të jenë në gjendje të konvertohen në para brenda 30 ditëve.

Neni 57

Kërkesat e kapitalit për bankat

Bankat, të cilat ushtrojnë veprimtari në tregjet e titujve në përputhje me nenin 15 të këtij ligji dhe në përputhje me parashikimin e pikës 2 të nenit 54 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, zbatojnë kërkesat e kapitalit sipas akteve nënligjore përkatëse, të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 58

Konflikti i interesit dhe transaksionet me palë të lidhura

1. Të gjitha shoqëritë komisionere duhet të kenë sisteme, procedura dhe kontrolle për të identifikuar dhe parandaluar ose menaxhuar konfliktin ekzistues ose të mundshëm të interesit dhe transaksionet me palët e lidhura.

2. Të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës dhe funksionarët kryesorë të shoqërive të licencuara, të regjistruara ose të njohura të titujve duhet të deklarojnë paraprakisht me shkrim çdo interes privat ose tregtar që mund të cenojë gjykimin e tyre lidhur me një transaksion ose çështje të caktuar kurdo që mund të lindë.

3. Interesi privat ose tregtar është interesi që bazohet në ose lind nga:

a) marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta apo të tërthorta të çdolloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër;

c) dhurata, premtime, favore, shpërblime ose trajtime preferenciale;

ç) angazhime në veprimtari të tjera private fitimprurëse ose çdolloj veprimtarie që krijon të ardhura; ose

d) çdo transaksion me palë të lidhura.

4. Shoqëria komisionere mund të krijojë komitete *ad-hoc*, të përbëra nga anëtarë joekzekutivë të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, të cilët ngarkohen me përgjegjësinë për trajtimin, rast pas rasti, të konfliktit të interesit dhe të transaksioneve me palët e lidhura.

5. Kur anëtari i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose funksionari kryesor nuk bën të ditur një interes privat ose tregtar, dhe/ose kur si pasojë e një interesi privat ose tregtar lidhet një kontratë ose miratohet një transaksion me pasoja detyruese ligjore:

a) shoqëria e licencuar, e regjistruar ose e njohur mund ta shpallë të pavlefshme kontratën ose transaksionin;

b) autoriteti mund të urdhërojë personin e licencuar, të regjistruar ose të njohur të marrë masa kundër anëtarit të këshillit ose funksionarit kryesor, duke përfshirë, ndër të tjera, pezullimin dhe/ose shkarkimin e tij.

Neni 59

Tregtimi i instrumenteve financiare nga shoqëria komisionere jashtë tregut të rregulluar

Shoqëria komisionere, nuk duhet:

a) të tregtojë instrumente financiare jashtë një burse ose jashtë një tregu tjetër të rregulluar në të cilin është pjesëmarrës tregtues, pa miratimin paraprak të klientit;

b) të tregtojë instrumente financiare në kundërshtim me rregulloret e Autoritetit, të bursës ose të tregut tjetër të rregulluar;

c) të kryejë një transaksion me mënyra manipuluese apo mashtruese, me qëllim nxitjen ose tentimin e shitblerjes së një instrumenti financiar jashtë një tregu të rregulluar.

Neni 60

Dhënia dhe marrja hua e titujve

Shoqëria komisionere nuk duhet të japë hua ose të organizojë dhënien hua të asnjë titulli për llogari të klientit, pa pëlqimin me shkrim të klientit. Shoqëria komisionere nuk duhet të marrë hua ose të organizojë marrjen hua duke vendosur si kolateral titujt e klientit, pa pëlqimin me shkrim të klientit.

Neni 61

Përgjegjësia kundrejt klientit për shërbime investimi

Shoqëria komisionere mban përgjegjësi përpara klientëve për çdo shërbim investimi dhe/ose shërbime ndihmëse që ka kryer ose propozuar të kryejë, për çdo pakujdesi, mashtrim ose gabim, si edhe për çdo mosveprim nga ana e saj ose nga ana e punonjësve të saj, agjentëve të saj të lidhur dhe/ose çdo palë tjetër që ajo ka kontraktuar për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për veprimtarinë e vet tregtare.

SEKSIONI II
MARRËDHËNIET ME KLIENTËT

Neni 62
Kategorizimi i klientëve

1. Shoqëria komisionere duhet t'i kategorizojë klientët si:
   a) palë të pranueshme;
   b) investitorë profesionistë;
   c) klientë joprofesionistë;
   ç) investitorë të kualifikuar.

2. Procedura e mbajtjes së marrëdhënieve me secilën kategori duhet të dokumentohet. Të gjithë punonjësve, që mund të kenë të bëjnë drejtpërdrejt ose tërthorazi me klientët, u vendoset në dispozicion një manual procedural.

3. Për secilën kategori duhet të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme testi i përshtatshmërisë, i parashikuar në nenin 64 të këtij ligji.

4. Shoqëria komisionere duhet të trajnojë të gjithë punonjësit përkatës dhe të sigurohet që ata e kuptojnë procedurën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 63
Procedura për marrjen e klientëve të rinj

1. Për të garantuar siguri juridike dhe për t'u dhënë mundësi klientëve të kuptojnë më mirë natyrën e shërbimeve të ofruara, shoqëria komisionere, që u ofron klientëve shërbime investimi ose ndihmëse, duhet të lidhë kontratë me shkrim me secilin klient, ku të përcaktohen detyrimet themelore, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë dhe të klientit.

2. Kontrata duhet të përshtatet sipas çdo kategorie investitori.

3. Kontrata me klientin duhet të lidhet me shkrim dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet thelbësore të palëve. Kontrata duhet të përfshijë:

   a) informacion për shoqërinë dhe shërbimet që u ofron klientëve ekzistues dhe të mundshëm, përfshirë:

      i. statusin si person i licencuar, i regjistruar ose i njohur;

      ii. faktin nëse shoqëria është agjent i lidhur i një shoqërie të veçantë komisionere, brenda vendit ose jashtë vendit;

      iii. informacionin për komunikimin, raportimin dhe kontabilitetin;

      iv. çdo konflikt interesi;

      v. një përshkrim të shërbimeve dhe, sipas rastit, të natyrës dhe të masës së këshillimit në investime që do të ofrojë.

   b) instrumentet financiare për të cilat shoqëria ka licencë të kryejë transaksione;

   c) masat për ruajtjen e instrumenteve financiare të klientit ose të parave të klientit;

   ç) komisionet, kostot dhe tarifat përkatëse;

   d) në rastin e shërbimeve të menaxhimit të portofolit, llojet e instrumenteve financiare që mund të blihen dhe të shiten dhe llojet e transaksioneve që mund të kryhen për llogari të klientit, si dhe çdo instrument ose transaksion i ndaluar.

4. Kontrata duhet të përfshijë edhe informacion për të drejtat e klientit dhe procedurën e ankimit kundër shoqërisë komisionere.

5. Kontrata duhet të qëndrojë në fuqi për sa kohë klienti është klient i shoqërisë.

6. Të gjithë klientët duhet të njoftohen nëse ka ndryshime në kushtet e përcaktuara në kontratë, si pasojë e ndryshimeve në akte ligjore ose nënligjore ose në mënyrën me të cilën shoqëria synon të vijojë marrëdhënien me klientin.

7. Shoqëria nuk mund të ndryshojë parashikimet e kontratës, që prekin klientin pa pëlqimin me shkrim të klientit.

Neni 64

Përshtatshmëria dhe njohja e klientit

1. Kur jep rekomandime ose këshilla për investime ose kryen aktivitet të administrimit të portofolit, shoqëria komisionere duhet të marrë informacionet e nevojshme për njohuritë dhe përvojën e klientit ekzistues ose të mundshëm në fushën e investimeve, sa i takon llojit specifik të produktit ose të shërbimit, gjendjen e tij financiare, përfshirë mundësinë dhe aftësinë për të përballuar humbjet dhe objektivat e tij të investimit, përfshirë tolerancën ndaj rrezikut, në mënyrë që shoqëria komisionere të jetë në gjendje t'i rekomandojë klientit shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare që janë të përshtatshme për të dhe, në veçanti, që përputhen me tolerancën e tij ndaj rrezikut dhe aftësinë e tij për të përballuar humbjet.

2. Autoriteti miraton një pyetësor standard, që duhet të plotësohet për çdo klient të shoqërisë komisionere, për të vlerësuar kriteret e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Informacioni i kërkuar duhet të përfshijë:

a) informacion për njohuritë dhe përvojën e klientit:

i. llojet e shërbimit, transaksionet dhe investimet e rregulluara me të cilat klienti ka përvojë;

ii. natyrën, vëllimin, shpeshtësinë e transaksioneve të klientit në fushën e investimeve të rregulluara; dhe

iii. nivelin arsimor, profesionin ose punë të tjera të mëparshme të klientit.

b) informacion për gjendjen financiare të klientit:

i. burimin dhe shkallën e të ardhurave të rregullta të klientit;

ii. pasuritë e klientit, përfshirë pasuritë likuide, investimet dhe pasuritë e paluajtshme; dhe

iii. angazhimet e rregullta financiare të klientit dhe aftësinë e tij për të përballuar humbjet.

c) informacion për objektivat e investimit të klientit:

i. perspektivat afatgjata të investimit të klientit;

ii. preferencat e rrezikut të klientit, profilin e rrezikut dhe tolerancën ndaj rrezikut; dhe

iii. qëllimet e investimit.

Shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike nuk zbatohen për palën e pranueshme, klientin profesionist dhe klientin e kualifikuar.

4. Formulari i plotësuar duhet të nënshkruhet nga një funksionar kryesor i shoqërisë komisionere, si edhe nga klienti, pasi ky i fundit të deklarojë se ka dhënë të gjitha informacionet e nevojshme.

5. Pyetësori i përshtatshmërisë duhet të ruhet dhe të vendoset në dispozicion të Autoritetit, në rast se kërkohet.

6. Klientit duhet t'i kërkohet t'i njoftojë shoqërisë komisionere çdo ndryshim në rrethanat e tij personale, që mund të shkaktojë një ndryshim në statusin e përshtatshmërisë.

7. Shoqëria shqyrton çdo vit përshtatshmërinë e klientit duke kontaktuar klientin me një kërkesë për të konfirmuar se nuk ka pasur ndryshim në statusin e tyre.

8. Për klientët ekzistues, të kategorizuar si joprofesionistë, të shoqërisë komisionere, në varësi të llojit specifik dhe të kompleksitetit të instrumentit, shoqëria komisionere njofton me shkrim ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit për ndryshime thelbësore të riskut të instrumentit. Instrumente komplekse, në kuptim të këtij neni, do të konsiderohen:

a) të gjitha llojet e instrumenteve derivative me kushtin që këto të jenë të transferueshme;

b) obligacione të nënrenditura (borxh i varur) ose instrumente të tjera, subjekt i procedurës së rikapitalizimit nga brenda për zhvlerësimin dhe konvertimin e tij në aksione, në zbatim të ligjit në fuqi “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”;

c) produktet e strukturuara;

ç) kontratat për diferencë;

d) instrumente të tjera, që kanë një strukturë komplekse dhe të vështirë për t'u kuptuar nga ana e klientit.

9. Në lidhje me instrumentet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 8 të këtij neni, shoqëria komisionere në njoftimin e saj jep në mënyrë të veçantë shpjegimin e rrezikut të humbjes së të gjithë investimit, që lidhet me:

a) falimentimin;

b) paaftësinë paguese të emetuesit;

c) rikapitalizimin nga brenda;

ç) zhvlerësimin;

d) konvertimin.

Neni 65

Përshtatshmëria për klientët joprofesionistë, të cilët nuk marrin këshilla ose rekomandime

1. Për klientët joprofesionistë, të cilët nuk marrin këshilla ose rekomandime, shoqëria komisionere kërkon informacion për njohurinë dhe eksperiencën e tyre në fushën e investimeve për produktin apo shërbimin e ofruar apo të kërkuar.

2. Informacioni shërben për të vlerësuar që produkti apo shërbimi i ofruar të jetë i përshtatshëm për klientin. Në rastet kur këto produkte apo shërbime jepen si paketë, vlerësimi merr në konsideratë të gjithë paketën e ofruar, nëse kjo është e përshtatshme.

3. Në rastet kur shoqëria komisionere vlerëson se produkti apo shërbimi i ofruar nuk është i përshtatshëm për klientin aktual apo të mundshëm, shoqëria komisionere paralajmëron klientin që produkti apo shërbimi nuk është i përshtatshëm për të. Ky paralajmërim dokumentohet në një format të standardizuar dhe kryhet me shkrim ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit.

4. Në rastet kur klientët aktualë apo të mundshëm nuk pranojnë të japin informacionin e kërkuar nga shoqëria për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre, ose në rastet kur informacioni i ofruar është i pamjaftueshëm, shoqëria komisionere paralajmëron klientët se shoqëria komisionere nuk mund të përcaktojë nëse produkti apo shërbimi i ofruar është i përshtatshëm për ta. Ky dokumentohet në një format të standardizuar dhe kryhet me shkrim ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit.

5. Plotësimi i kërkesave të këtij neni duhet të provohet nga shoqëria komisionere përmes dokumentacionit. Në rastet kur klienti refuzon dhënien e informacionit, shoqëria komisionere duhet të mbajë dokumentacion që provon plotësimin e kësaj kërkese.

6. Dokumentacioni i testit të përshtatshmërisë duhet të ruhet dhe të vendoset në dispozicion të Autoritetit nëse kërkohet.

7. Pavarësisht sa më sipër, në çdo rast shoqëria komisionere zbaton urdhrin e klientit.

8. Kërkesat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe në rastin e emetimit të titujve për herë të parë nëpërmjet ndërmjetësit financiar ose nga vetë emetuesi.

Neni 66

Përjashtimet nga detyrimi për të zbatuar testin e përshtatshmërisë

1. Shoqëria komisionere mund t'u ofrojë klientëve të saj shërbime investimi, që konsistojnë vetëm në marrjen dhe transmetimin dhe/ose ekzekutimin e urdhrave për llogari të klientit, me ose pa shërbime ndihmëse, dhe pa detyrimin për të marrë informacion ose për të bërë vlerësimin e përmendur në nenin 65 të këtij ligji, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) shërbimet kanë të bëjnë me:

i. aksione të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar, ku këto aksione janë aksione në shoqëri tregtare, duke përjashtuar aksionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat nuk janë sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, dhe aksionet që përmbajnë në strukturën e tyre një instrument derivativ;

ii. obligacione ose forma të tjera të borxhit të titullzuar ose obligacione të garantuara që tregtohen në një treg të rregulluar, tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar ato obligacione ose borxhe të konvertueshme në tituj, që përfshijnë një instrument derivativ ose kanë një strukturë, e cila e bën të vështirë kuptimin e instrumentit nga ana e klientit;

iii. instrumente të tregut të parasë, duke përjashtuar ato instrumente, të cilat përmbajnë një derivativ ose kanë një strukturë që e bën të vështirë kuptimin e instrumentit nga ana e klientit;

iv. kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat janë sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm.

b) shërbimi ofrohet me nismën e klientit ekzistues ose të mundshëm kur klienti ka kërkuar në mënyrë specifike që të mos i jepen këshilla;

c) klienti ekzistues ose i mundshëm është paralajmëruar në mënyrë të qartë se gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve shoqërisë komisionere nuk i kërkohet të vlerësojë nëse instrumenti ose shërbimi i dhënë ose i ofruar është i përshtatshëm për klientin dhe për këtë arsye klienti nuk përfiton nga mbrojtja përkatëse e rregullave të ushtrimit të veprimtarisë. Ky paralajmërim jepet në një format të standardizuar me shkrim ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit

ç) informacioni i plotë për karakteristikat e një instrumenti financiar është në dispozicion të publikut dhe rrjedhimisht një klient joprofesionist është i aftë të marrë një vendim të mirinformuar për kryerjen e një transaksioni me instrumentin në fjalë.

2. Një treg i vendit të tretë do të konsiderohet ekuivalent me tregun e rregulluar në Republikën e Shqipërisë nëse përmbush kërkesa ekuivalente me ato të parashikuara nga ky ligj për tregjet e rregulluara.

Neni 67

Përkufizimi i shërbimit me nismë të klientit

1. Shërbimi konsiderohet se nuk jepet me nismë të klientit në rastin kur klienti e kërkon shërbimin në përgjigje të një komunikimi të personalizuar, që i është dërguar nga shoqëria komisionere ose për llogari të shoqërisë komisionere dhe që përmban një ftesë ose ka për qëllim të ndikojë në vendimmarrjen e klientit në lidhje me një instrument financiar ose transaksion të veçantë.

2. Shërbimi konsiderohet se jepet me nismën e klientit edhe nëse klienti e kërkon atë në përgjigje të një komunikimi, që përmban një promovim ose ofertë të instrumenteve financiare por që, sipas natyrës, është i përgjithshëm dhe i drejtohet publikut, një grupi të madh ose një kategorie të madhe klientësh ekzistues ose të mundshëm.

Neni 68

Mbrojtja e pasurive të klientit dhe kujdestaria

1. Shoqëritë komisionere të autorizuara të kryejnë shërbimin ndihmës të specifikuar sipas shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 3 të këtij ligji, mund të kryejnë shërbimin e ruajtjes e të administrimit të instrumenteve financiare për llogari të klientëve të tyre.

2. Llogaritë në para të klientëve të shoqërisë komisionere mbahen pranë një banke të licencuar, të ndara dhe veç nga aktivet e shoqërisë komisionere.

3. Shoqëria komisionere nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetër me paratë e klientëve, përveç atij të urdhëruar nga klienti.

4. Shoqëria komisionere mund të përdorë paratë e klientëve vetëm për pagesën e detyrimeve në lidhje me shërbimet e investimeve dhe aktiviteteve që i ofron klientit dhe nuk mund t'i përdorë ato për pagesën e detyrimeve të klientëve të tjerë.

5. Paratë në llogaritë e klientëve nuk i përkasin shoqërisë komisionere dhe nuk janë pjesë e aktiveve të saj, ato nuk preken në rast likuidimi apo falimentimi të shoqërisë komisionere.

6. Paratë në llogaritë e klientëve nuk mund të përdoren për ekzekutimin e detyrimeve të shoqërisë komisionere.

7. Shoqëria komisionere mund të hapë një llogari titujsh në emër të saj me Depozitarin Qendror të Titujve.

8. Shoqëria komisionere mund të hapë një llogari klientësh në emër të klientëve me Depozitarin Qendror të Titujve, të veçantë nga llogaria e saj.

9. Shoqëria komisionere duhet të sigurohet që të gjitha veprimet e kryera në emër të klientëve për blerjet apo shitjet e titujve reflektohen te llogaria e titujve të klientëve, në përputhje me urdhrat e shlyerjes së transaksioneve.

10. Shoqëria komisionere mund të përdorë titujt e llogarisë së klientëve vetëm bazuar në urdhrat e klientëve.

11. Shoqëria komisionere duhet të sigurojë që përfitimi i gjeneruar nga huamarrja e titujve të klientëve i përket klientit. Shoqëria komisionere ka të drejtë të faturojë shërbimet e kontraktimit të huadhënies në përputhje me shumën e përcaktuar në listën e çmimeve të shoqërisë komisionere.

12. Shoqëria komisionere mban llogarinë e saj të titujve në një llogari pranë depozitarit qendror ose në rastin e instrumenteve financiare, të cilat mbahen jashtë llogarive të depozitarit qendror, të veçanta nga llogaritë e klientëve, me kusht që këta tituj mund t'i jepen hua klientit, nëse klienti autorizon shoqërinë komisionere për të marrë hua titujt në bazë të një kontrate apo autorizimi me shkrim.

13. Përfitimi i gjeneruar nga huamarrja e titujve të shoqërisë komisionere për një klient do t'i atribuohet shoqërisë komisionere. Shoqëria komisionere nuk mund të tarifojë për huadhënien e titujve të shoqërisë komisionere klientin.

14. Titujt e klientëve të shoqërisë komisionere nuk i përkasin shoqërisë komisionere dhe nuk janë pjesë e aktiveve të saj.

15. Titujt e klientëve të shoqërisë komisionere nuk i nënshtrohen procedurës së likuidimit apo të falimentimit të shoqërisë komisionere.

16. Titujt e klientëve të shoqërisë komisionere nuk i nënshtrohen procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, me qëllimin e shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë komisionere.

17. Për qëllime të ruajtjes së të drejtave të klientëve në lidhje me instrumentet financiare dhe aktivet e klientëve, shoqëria komisionere duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) duhet të mbajë regjistra dhe llogari kur është e nevojshme që t'i mundësojnë asaj në çdo moment të ndajë aktivet që i përkasin një klienti nga klienti tjetër;

b) duhet të mbajë regjistra dhe llogari në atë mënyrë që të sigurohet saktësia dhe në veçanti pronësia e instrumenteve financiare dhe fondeve të klientëve;

c) duhet të kryejë rregullisht kontrolle financiare dhe verifikime ndërmjet llogarive të saj të brendshme dhe regjistrave dhe ato të palëve të treta, aktivet e të cilëve mbahen në kujdestari;

ç) duhet të ketë strukturë të mjaftueshme organizative për të siguruar që rreziku i humbjes së aktiveve të klientit është i minimizuar ose për të siguruar të drejtat në lidhje me këto aktive, si rezultat i keqpërdorimit, mashtrimit, administrimit të keq, mbajtjes së pamjaftueshme të regjistrave ose neglizhencës.

18. Në rastet kur aktivet e klientëve mbahen pranë një kujdestari të jashtëm, të sigurohet që këto aktive i transferohen për ruajtje një kujdestari të licencuar, në mënyrë të tillë që aktivet që u përkasin klientëve të veçantë të identifikohen në mënyrë të veçantë.

19. Shoqëria komisionere për sa më sipër ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm në zbatim të ligjit në fuqi “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

20. Autoriteti mund të miratojë me rregullore dispozita të mëtejshme për trajtimin e aktivitetit të kujdestarisë, si dhe kërkesa për miratim të veprimtarisë së kujdestarisë.

Neni 69

Trajtimi i mosmarrëveshjeve dhe i ankesave

1. Shoqëria komisionere duhet të miratojë dhe të zbatojë procedura për trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo mosmarrëveshjeje dhe ankese të bërë nga klientët.

2. Secilit klient duhet t'i vendoset në dispozicion një shpjegim i të drejtave që ka dhe i procedurës që mund të ndjekë për t'u ankuar ndaj shoqërisë komisionere.

3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore procedurën sipas së cilës ankesat e pazgjidhura kundër shoqërisë komisionere mund t'i drejtohen Autoritetit.

4. Autoriteti mund të miratojë me rregullore parashikime të tjera për trajtimin e mosmarrëveshjeve dhe ankesave ndaj shoqërisë komisionere dhe të kërkojë që kjo e fundit të mbajë një regjistër të ankesave dhe t'i raportojë Autoritetit, në mënyrë periodike ose kur ia kërkon Autoriteti, për numrin dhe natyrën e mosmarrëveshjeve e të ankesave që janë bërë në lidhje me veprimtarinë e saj.

SEKSIONI III

PUNA KËRKIMORE DHE REKOMANDIMET

Neni 70

Kërkesat për shoqërinë komisionere që kryen punë kërkimore për klientët dhe u jep rekomandime klientëve

1. Rekomandimet janë të dhëna kërkimore ose informacione të tjera, që rekomandojnë ose sugjerojnë, në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar, një strategji investimi për një ose disa instrumente financiare ose emetues të instrumenteve financiare, përfshirë çdo opinion për vlerën aktuale ose të ardhshme ose çmimin e këtyre instrumenteve, të parashikuara për t'u shpërndarë në mënyrë të kufizuar ose publikisht. Rekomandim ose sugjerim i shprehur për një strategji investimi do të konsiderohet rekomandimi i formave të tilla si “bli”, “mbaj” ose “shit”. Rekomandim ose sugjerim i nënkuptuar për një strategji investimi është rekomandimi që i referohet një çmimi të synuar ose të ngjashëm.

2. Të dhëna kërkimore ose informacione të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë një strategji investimi janë:

a) informacioni që prodhohet nga një analist i pavarur, një shoqëri komisionere, një bankë, çdo person tjetër, veprimtaria tregtare kryesore e të cilit është dhënia e rekomandimeve për investime, ose personi fizik/individi që punon për këto subjekte, në bazë të një kontrate pune ose në ndonjë mënyrë tjetër, i cili shpreh drejtpërdrejt ose tërthorazi një rekomandim të veçantë investimi për një instrument financiar ose një emetues;

b) informacioni që prodhohet nga çdo person tjetër krahas atyre të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, i cili rekomandon në mënyrë të drejtpërdrejtë një vendim të veçantë investimi për një instrument financiar.

3. Ofruesi i rekomandimeve është personi fizik/individi ose juridik, që jep ose shpërndan rekomandime në ushtrim të profesionit ose veprimtarisë së tij tregtare.

4. “Emetues” është emetuesi i titullit për të cilin jepet drejtpërdrejt ose tërthorazi rekomandimi.

5. Rregullimi i përshtatshëm është rregullimi, përfshirë vetërregullimin, i cili ka për qëllim të garantojë që ofruesi i rekomandimeve, që jep ose shpërndan rekomandime, të kujdeset në mënyrë të arsyeshme për të siguruar që këto rekomandime të paraqiten në mënyrë të drejtë dhe të deklarojë interesat e tij ose konfliktin e interesit në lidhje me instrumentet financiare për të cilat jepen rekomandimet.

Neni 71

Identiteti i ofruesve të rekomandimeve

1. Çdo rekomandim duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të dukshme identitetin e personit përgjegjës për dhënien e tij, në veçanti emrin dhe pozicionin e individit që e ka përgatitur rekomandimin dhe emrin e personit juridik përgjegjës për dhënien e rekomandimit. Kur ofruesi i rekomandimit është një shoqëri komisionere ose një bankë, rekomandimi përcakton identitetin e shoqërisë apo bankës. Kur ofruesi i rekomandimit nuk është as shoqëri investimi as bankë, por është objekt i zbatimit të standardeve vetërregulluese ose kodeve etike, rekomandimi përmban një referencë te këto standarde ose kode.

2. Në rastin e rekomandimeve verbale, kërkesat e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, konsiderohen të përmbushura nëse rekomandimi përcakton vendin ku mund të merren drejtpërdrejt dhe lehtësisht nga publiku informacionet e mësipërme, si për shembull hapësirën në internet të ofruesit të rekomandimeve.

3. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për gazetarët, me kusht që rregullat specifike, që u zbatohen gazetarëve, të arrijnë efekte të ngjashme me ato të pikës 1 dhe me kusht që të respektohen standardet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 74 të këtij ligji.

Neni 72

Standardi i përgjithshëm për paraqitjen e drejtë të rekomandimeve

1.Ofruesi i rekomandimit duhet të tregojë kujdes të arsyeshëm për të siguruar që:

a) faktet të dallohen qartë nga interpretimet, vlerësimet, opinionet dhe llojet e tjera të informacioneve jofaktike;

b) të gjitha burimet të jenë të besueshme ose, kur ka ndonjë dyshim lidhur me besueshmërinë e ndonjë burimi, kjo të tregohet në mënyrë të qartë;

c) të gjitha planifikimet, parashikimet dhe çmimet e synuara të evidentohen qartë si të tilla dhe të përcaktohen supozimet me rëndësi thelbësore të cilat:

i. mbështeten në planifikime, parashikime dhe çmime të tilla të synuara;

ii. përdoren për përgatitjen e këtyre planifikimeve, parashikimeve dhe çmimeve të synuara.

2. Në rastin e rekomandimeve verbale, kërkesat e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, konsiderohen të përmbushura nëse rekomandimi përcakton vendin ku mund të merren drejtpërdrejt dhe lehtësisht nga publiku informacionet e mësipërme, si për shembull hapësirën në internet të ofruesit të rekomandimeve.

3. Me kërkesë të Autoritetit, shoqëria komisionere shpjegon bazat mbi të cilat është dhënë rekomandimi.

4. Rregullat specifike që zbatohen për medien duhet të arrijnë efekte të ngjashme me ato të pikave 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 73

Detyrime të tjera shtesë në lidhje me paraqitjen e drejtë të rekomandimeve

1. Krahas detyrimeve të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji, kur ofruesi i rekomandimit është një analist i pavarur, një shoqëri komisionere, një bankë, çdo person juridik i lidhur, çdo ofrues tjetër rekomandimesh veprimtaria kryesore e të cilit është dhënia e rekomandimeve, ose një person që punon për këto subjekte me kontratë pune ose sipas një marrëdhënieje tjetër, duhet të bëjë kujdes të arsyeshëm për të

siguruar të paktën që:

a) janë përcaktuar të gjitha burimet përkatëse të informacionit, që janë përdorur si bazë për rekomandimin, sipas rastit, përfshirë emrin e emetuesit për të cilin bëhet rekomandimi, dhe faktin nëse rekomandimi i është njoftuar këtij emetuesi dhe është ndryshuar pas këtij njoftimi dhe përpara se të shpërndahet;

b) është dhënë një përmbledhje e përshtatshme për çdo bazë vlerësimi ose metodikë të përdorur për të vlerësuar një instrument financiar ose një emetues, ose për të vendosur një çmim të synuar për titullin;

c) është shpjeguar në mënyrë të përshtatshme kuptimi i çdo rekomandimi të bërë (si "bli", "shit" ose "mbaj"), që mund të përfshijë afatin kohor të investimit me të cilin lidhet rekomandimi, dhe është dhënë çdo paralajmërim përkatës për rrezikun, përfshirë analizën e ndjeshmërisë së supozimeve përkatëse;

ç) është përcaktuar shpeshtësia e planifikuar, nëse ka, e përditësimeve të rekomandimit dhe çdo ndryshim madhor në politikën e mbulimit të deklaruar më parë;

d) është përmendur qartë dhe dukshëm data kur është shpërndarë fillimisht rekomandimi, si edhe data dhe ora përkatëse e çdo çmimi instrumenti financiar që përmendet në rekomandim;

dh) kur rekomandimi ndryshon nga një rekomandim i dhënë gjatë 12 muajve të fundit në lidhje me të njëjtin titull ose emetues, ky ndryshim si edhe data e rekomandimit të mëparshëm tregohen qartë dhe dukshëm.

2. Në rastet kur kërkesat e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 do të ishin joproporcionale me kohëzgjatjen e rekomandimit të shpërndarë, do të mjaftonte të përmendej qartë dhe dukshëm në rekomandim vendi ku mund të merret drejtpërdrejt dhe lehtësisht nga publiku informacioni i nevojshëm, si për shembull nëpërmjet një lidhjeje të drejtpërdrejtë me një hapësirë në internet të ofruesit të rekomandimit, me kusht që të mos ketë ndryshime në metodikën ose bazën e vlerësimit të përdorur.

3. Në rastin e rekomandimeve verbale, standardet e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, konsiderohen të përmbushura nëse rekomandimi përcakton vendin ku mund të merren drejtpërdrejt dhe lehtësisht nga publiku informacionet e mësipërme, si për shembull një hapësirë në internet e ofruesit të rekomandimeve.

Neni 74

Standardi i përgjithshëm për deklarimin e interesave dhe konfliktit të interesit

1. Ofruesi i rekomandimeve bën të ditur të gjitha marrëdhëniet dhe rrethanat që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të cenojnë objektivitetin e rekomandimit, në veçanti kur shoqëria ose çdo shoqëri e lidhur me të zotëron më shumë se 5% të kapitalit të emetuar të emetuesit në një ose më shumë tituj, të cilat janë objekt i rekomandimit, ose kur ekziston një konflikt i rëndësishëm interesi në lidhje me një emetues me të cilin ka të bëjë rekomandimi.

2. Kur ofruesi i rekomandimeve është person juridik, kërkesa e pikës 1 të këtij neni zbatohet edhe për çdo person juridik ose fizik, që punon për të me kontratë pune ose në ndonjë mënyrë tjetër, i cili ka qenë i përfshirë në përgatitjen e rekomandimit.

3. Kur ofruesi i rekomandimeve është person juridik, informacioni që duhet të bëhet i ditur, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përfshin së paku informacionin e mëposhtëm për interesat e tij dhe për konfliktin e interesit:

a) interesat ose konflikti i interesit i ofruesit të rekomandimeve ose i personave juridikë të lidhur me të, që njihen ose që pritet në mënyrë të arsyeshme të njihen nga personat e përfshirë në përgatitjen e rekomandimit;

b) interesat ose konflikti i interesit i ofruesit të rekomandimeve ose i personave juridikë të lidhur me të, për të cilat kanë dijeni personat të cilët, edhe pse nuk kanë qenë të përfshirë në përgatitjen e rekomandimit, kanë pasur ose mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të kishin mundësi të njiheshin me rekomandimin përpara shpërndarjes te klientët ose te publiku.

4. Rekomandimi do të përfshijë informacionet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni. Në rastet kur dhënia e këtij informacioni do të ishte joproporcional me kohëzgjatjen e rekomandimit të shpërndarë, do të mjaftonte të përmendej qartë dhe dukshëm në rekomandim vendi ku mund të merret, drejtpërdrejt dhe lehtësisht, nga publiku informacioni i nevojshëm, si për shembull nëpërmjet një lidhjeje të drejtpërdrejtë me një hapësirë në internet të ofruesit të rekomandimit.

5. Në rastin e rekomandimeve verbale, standardet e parashtruara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, konsiderohen të përmbushura nëse rekomandimi përcakton vendin ku mund të merren, drejtpërdrejt dhe lehtësisht, nga publiku informacionet e mësipërme, si për shembull, një hapësirë në internet e ofruesit të

rekomandimeve.

6. Rregullat specifike që zbatohen për medien duhet të arrijnë efekte të ngjashme me ato të pikave 1 dhe 4 të këtij neni.

Neni 75

Detyrime shtesë në lidhje me deklarimin e interesave ose konfliktit të interesave

1. Krahas detyrimeve të parashikuara në nenin 76 të këtij ligji, kur ofruesi i rekomandimit është një analist i pavarur, një shoqëri komisionere, një bankë, çdo person juridik i lidhur ose çdo ofrues tjetër rekomandimesh, në kuadër të veprimtarisë së tij kryesore tregtare, rekomandimi përcakton qartë dhe dukshëm informacionet e mëposhtme për interesat dhe konfliktin e interesit:

a) pjesëmarrjet e rëndësishme në kapitalin aksionar, që ekzistojnë midis ofruesit të rekomandimit ose ndonjë personi juridik të lidhur me të, nga njëra anë, dhe emetuesit, nga ana tjetër. Këto pjesëmarrje të rëndësishme përfshijnë të paktën rastet e mëposhtme: kur ofruesi i rekomandimit ose ndonjë person juridik i lidhur me të zotëron më shumë se 1% të totalit të kapitalit të emetuar të emetuesit ose kur emetuesi mban më shumë se 1% të totalit të kapitalit të emetuar të ofruesit të rekomandimit ose të personit juridik të lidhur me ofruesin;

b) interesa të tjera të konsiderueshme financiare që ofruesi i rekomandimit ose ndonjë person juridik i lidhur me të mund të ketë tek emetuesi;

c) nëse është e zbatueshme, një deklaratë ku të pranohet se ofruesi i rekomandimit ose ndonjë person juridik i lidhur me të është krijues tregu ose ofrues likuiditeti për titujt e emetuesit;

ç) nëse është e zbatueshme, një deklaratë ku të pranohet se ofruesi i rekomandimit ose ndonjë person juridik i lidhur me të ka qenë kryesuesi ose bashkëkryesuesi gjatë 12 muajve të fundit i ndonjë oferte publike të titujve të emetuesit;

d) nëse është e zbatueshme, një deklaratë ku të pranohet se ofruesi i rekomandimit ose çdo person juridik i lidhur me të është palë në një marrëveshje tjetër me emetuesin lidhur me ofrimin e shërbimeve bankare të investimit, me kusht që kjo marrëdhënie nuk do të shkaktojë përhapjen e asnjë informacioni tregtar konfidencial, dhe me kusht që marrëveshja të ketë qenë në fuqi gjatë 12 muajve të fundit ose të jetë konkretizuar gjatë kësaj periudhe në pagimin e një shpërblimi ose në premtimin e një pagimi shpërblimi;

dh) nëse është e zbatueshme, një deklaratë ku të pranohet se ofruesi i rekomandimit ose ndonjë person juridik i lidhur me të është palë në një marrëveshje me emetuesin lidhur me dhënien e rekomandimit.

2. Shoqëritë komisionere dhe bankat bëjnë të ditur, në terma të përgjithshëm, masat organizative dhe administrative që marrin për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit në lidhje me ofrimin e rekomandimeve, përfshirë edhe masat që marrin për të penguar përhapjen e informacionit.

3. Për personat fizikë/individët ose juridikë, që punojnë për një shoqëri komisionere ose një bankë të nivelit të dytë me kontratë pune ose në ndonjë mënyrë tjetër, të cilët janë përfshirë në përgatitjen e rekomandimit, kërkesa e nenit 76 të këtij ligji do të përfshijë në veçanti informacionin nëse shpërblimi i këtyre personave është ose jo i lidhur me transaksionet e investimit të kryera nga shoqëria komisionere ose nga banka ose nga ndonjë person juridik i lidhur me to. Kur këta persona fizikë/individë blejnë aksione të emetuesve përpara se këto aksione t'i ofrohen publikut, bëhet i ditur edhe çmimi me të cilin janë blerë aksionet, si edhe data e blerjes.

4. Shoqëritë komisionere dhe bankat do të bëjnë të ditur çdo tremujor përqindjen e të gjitha rekomandimeve “bli”, “mbaj”, “shit” ose ekuivalentin e tyre, si edhe përqindjen e emetuesve, që përkojnë me secilën prej këtyre kategorive, të cilëve shoqëria komisionere ose banka u ka dhënë shërbime të konsiderueshme investimesh bankare gjatë 12 muajve të fundit.

5. Rekomandimi do të përfshijë informacionin e kërkuar sipas këtij neni.

6. Në rastet kur kërkesat e mësipërme do të ishin joproporcionale me kohëzgjatjen e rekomandimit të shpërndarë, do të mjaftonte të përmendej qartë dhe dukshëm në rekomandim vendi ku ky informacion mund të merret drejtpërdrejt dhe lehtësisht nga publiku, si për shembull nëpërmjet një lidhjeje të drejtpërdrejtë me një hapësirë në internet të shoqërisë komisionere ose të bankës së nivelit të dytë.

7. Në rastin e rekomandimeve verbale, standardet e parashtruara në pikën 1 të këtij neni konsiderohen të përmbushura nëse rekomandimi bën të ditur vendin ku mund të merren, drejtpërdrejt dhe lehtësisht, nga publiku deklaratat e mësipërme, si për shembull një hapësirë në internet e shoqërisë komisionere ose e bankës së nivelit të dytë.

Neni 76

Shpërndarja e rekomandimeve të palëve të treta

1. Sa herë që një person fizik/individ ose juridik, në ushtrim të profesionit ose të veprimtarisë së tij, shpërndan nën përgjegjësinë e tij një rekomandim të bërë nga një palë e tretë, rekomandimi duhet të përcaktojë qartë dhe dukshëm identitetin e ofruesit të rekomandimit.

2. Kur personi që shpërndan rekomandimin e një personi të tretë e ndryshon atë në mënyrë thelbësore, ky ndryshim bëhet i ditur në mënyrë të qartë dhe të hollësishme.

3. Sa herë që ndryshimi thelbësor sipas pikës 2 të këtij neni përfshin ndryshimin e orientimit të rekomandimit (si ndryshimi nga rekomandimi "bli" në rekomandimin "mbaj" ose "shit", apo anasjelltas), shpërndarësi përmbush kërkesat e pikës 1 të nenit 75 të këtij ligji për ofruesit e rekomandimeve, për sa i përket ndryshimit thelbësor.

4. Personat juridikë, të cilët, vetë ose nëpërmjet personave fizikë/individëve, shpërndajnë një rekomandim të ndryshuar në mënyrë thelbësore, duhet të miratojnë një rregullore formale me shkrim, në mënyrë që personat që marrin informacionin të dinë ku të drejtohen për të mësuar identitetin e ofruesit të rekomandimit, për t'u njohur me rekomandimin dhe me informacionin lidhur me interesat ose konfliktin e interesit të ofruesit, me kusht që këto elemente të jenë bërë publike.

5. Në rastin e shpërndarjes së një përmbledhjeje rekomandimi të një pale të tretë, ofruesi i rekomandimit, i cili shpërndan përmbledhjen, siguron që përmbledhja të jetë e qartë dhe jokeqinformuese, si dhe përcakton burimin dhe vendin ku mund të merret, drejtpërdrejt dhe lehtësisht, nga publiku informacioni i dhënë në lidhje me rekomandimin origjinal, me kusht që ky informacion të jetë bërë publik.

Neni 77

Detyrime të tjera për shoqëritë komisionere dhe bankat

Krahas detyrimeve të parashikuara në këtë seksion, kur ofruesi i rekomandimit është një shoqëri komisionere, një bankë ose një person fizik/individ, që punon për këta persona me kontratë pune ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe shpërndan rekomandime të një pale të tretë, ka detyrimin:

a) të bëjë të ditur, në mënyrë të qartë dhe të dukshme, emrin e autoritetit të tij kompetent;

b) të përmbushë kërkesat e nenit 74 të këtij ligji, kur ofruesi i rekomandimit nuk e ka shpërndarë rekomandimin;

c) të përmbushë kërkesat e nenit 76 të këtij ligji, kur rekomandimi ndryshohet në mënyrë thelbësore.

Neni 78

Statistikat e institucioneve publike dhe institucioneve të tregut

Institucionet publike dhe institucionet e tregut që shpërndajnë statistika, të cilat mund të kenë efekt të konsiderueshëm në tregjet financiare, i shpërndajnë këto statistika në mënyrë të plotë dhe transparente.

SEKSIONI IV
VEPRIMTARIA E SHOQËRIVE KOMISIONERE NË LIDHJE ME
KRYERJEN E TRANSAKSIONEVE PËR LLOGARI TË KLIENTËVE

Neni 79

Urdhrat e klientit

1. Urdhri është shprehje e vullnetit të klientit, drejtuar shoqërisë komisionere, nëpërmjet të cilit e udhëzon këtë të fundit të blejë ose të shesë instrumente financiare për llogari të tij.

2. Me pranimin e urdhrit, shoqëria komisionere lidh kontratë me klientin dhe merr përsipër shitblerjen e instrumenteve financiare në përputhje me urdhrin dhe për llogari të klientit, ndërsa klienti merr përsipër të paguajë shpërblimin për ekzekutimin e këtyre transaksioneve.

3. Nëse shoqëria komisionere nuk e pranon urdhrin, ajo duhet të njoftojë klientin pa vonesë.

Neni 80

Procedura e marrjes së urdhrave të klientit

1. Shoqëria komisionere i pranon urdhrat e klientëve për shitblerjen e instrumenteve financiare në selinë e regjistruar të shoqërisë ose në një degë të përcaktuar për ekzekutimin e urdhrave të klientëve.

2. Shoqëria komisionere mund të marrë edhe urdhra klienti me shkrim në një degë ku nuk ekzekutohen urdhra të klientëve, ose në selinë e regjistruar, ose degën e një agjenti të lidhur, i cili merr urdhra të klientëve në emër të shoqërisë komisionere, nëse klienti kontakton personalisht këtë degë të shoqërisë komisionere ose degë të agjentit të lidhur ose agjentin e lidhur.

3. Kur shoqëria komisionere merr urdhra sipas mënyrës së përshkruar në pikën 2 të këtij neni, kushtet e veçanta të punës duhet të parashikojnë afatin kohor brenda të cilit urdhri duhet të transferohet në selinë e regjistruar të shoqërisë ose në degën që ekzekuton urdhrat e pranuara të klientëve. Shoqëria komisionere e informon në mënyrë të veçantë klientin për këtë parashikim në kushtet e veçanta të punës, në momentin e lidhjes së kontratës.

4. Urdhri konsiderohet se është marrë nga shoqëria komisionere në momentin kur merret nga selia qendrore e shoqërisë komisionere ose nga dega e shoqërisë komisionere, e cila ekzekuton urdhrat e klientit.

Neni 81

Urdhrat nëpërmjet agjentëve të lidhur të shoqërisë komisionere

1. Shoqëria komisionere mund të caktojë një agjent të lidhur, i cili, për llogari të saj, kryen veprimtaritë e mëposhtme:

a) promovon shërbimet e shoqërisë komisionere;

b) ofron shërbimet e shoqërisë komisionere;

c) merr dhe transmeton urdhrat e klientëve ekzistues ose të mundshëm;

ç) hedh në treg instrumente financiare;

d) jep këshilla në lidhje me instrumentet financiare dhe shërbimet e ofruara nga shoqëria komisionere.

2. Agjenti i lidhur nuk duhet të pranojë para dhe/ose instrumente financiare nga klientët ekzistues ose të mundshëm të shoqërisë komisionere.

3. Agjenti i lidhur mund të kryejë veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni vetëm për llogari të një shoqërie komisionere.

Neni 82

Përgjegjësia e shoqërisë komisionere për agjentin e lidhur

1. Kur shoqëria komisionere cakton një agjent të lidhur, ajo vijon të mbajë përgjegjësi të plotë dhe pa kushte për çdo veprim apo mosveprim të agjentit të lidhur kur ky vepron për llogari të shoqërisë.

2. Shoqëria duhet të sigurojë që çdo urdhër që merret nga një prej agjentëve të saj të lidhur të jetë në përputhje me kërkesat për marrjen dhe trajtimin e urdhrave të klientëve.

Neni 83

Konfirmimi i marrjes së urdhrit të klientit

1. Shoqëria komisionere i konfirmon marrjen e urdhrit klientit jo më vonë se dita e parë e punës pas marrjes së urdhrit.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për ndryshimin dhe anulimin e urdhrit të marrë.

Neni 84

Pranimi dhe refuzimi i urdhrave të klientëve

1. Nëse shoqëria komisionere nuk e pranon urdhrin e klientit, ajo duhet ta njoftojë klientin për refuzimin e urdhrit menjëherë pas marrjes së urdhrit, nëse nuk parashikohet afat tjetër sipas pikave 2 ose 3 të këtij neni. Në njoftim, shoqëria komisionere duhet t'i bëjë të ditura arsyet për refuzimin e urdhrit.

2. Nëse kushtet e përgjithshme të punës së shoqërisë komisionere parashikojnë që shoqëria nuk ka

detyrim të pranojë një urdhër për shitjen e instrumenteve financiare derisa klienti t'i japë mundësi shoqërisë komisionere t'i përdorë instrumentet financiare që janë objekt i urdhrit, afati kohor për njoftimin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni fillon:

a) në rastin kur objekt i urdhrit janë tituj të dematerializuar të regjistruar pranë depozitarit qendror:

i. nga momenti kur shoqëria komisionere është në gjendje të konstatojë se klienti nuk ka tituj ose ka tituj të pamjaftueshëm për të përmbushur urdhrin në llogarinë e tij pranë shoqërisë komisionere; ose

ii. nëse klienti i jep shoqërisë komisionere, së bashku me urdhrin e shitjes, urdhrin e duhur për transferimin e titujve nga një llogari tjetër e të njëjtit mbajtës, duke filluar nga momenti kur shoqëria komisionere është në gjendje të konstatojë se ky urdhër nuk mund të ekzekutohet;

b) në rastin kur objekt i urdhrit janë instrumente të tjera financiare, duke filluar nga momenti kur shoqëria komisionere është në gjendje të konstatojë se klienti nuk i ka dhënë mundësi shoqërisë komisionere të marrë këto instrumente.

3. Kur shoqëria komisionere i kërkon klientit, në momentin e marrjes së urdhrit të blerjes, të bëjë një pagesë paradhënie për çmimin e blerjes dhe shpenzimet në lidhje me ekzekutimin e urdhrit, afati kohor për njoftimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni fillon në momentin kur shoqëria komisionere është në gjendje të konstatojë se paradhënia nuk është paguar brenda afatit të rënë dakord.

4. Nëse shoqëria komisionere nuk e refuzon ekzekutimin e urdhrit, konsiderohet se e ka pranuar urdhrin me përfundimin e afatit kohor për dhënien e njoftimit të refuzimit të urdhrit.

Neni 85

Pastrimi i parave, manipulimi i tregut dhe tregtimi i bazuar në informacion të privilegjuar

1. Shoqëria komisionere nuk duhet të pranojë ose të ekzekutojë një urdhër klienti nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se klienti është duke kryer manipulim të tregut, tregti të bazuar në informacion të privilegjuar, pastrim të parave ose financim të terrorizmit.

2. Kur shoqëria komisionere ka vendosur të mos e pranojë ose ekzekutojë urdhrin në bazë të pikës 1 të këtij neni, ajo duhet të dokumentojë me shkrim rrethanat dhe arsyet që çuan në vendimin e saj. Brenda tri ditësh nga refuzimi, shoqëria komisionere i njofton rastin Autoritetit, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në përputhje me legjislacionin e fushës.

Neni 86

Ekzekutimi i urdhrave me kufi të klientëve

1. Urdhri me kufi, në kuptim të këtij ligji, është urdhri për të blerë ose shitur një instrument financiar me një çmim të përcaktuar ose me një çmim më të mirë dhe për një sasi të përcaktuar.

2. Nëse urdhri me kufi i klientit për shitblerjen e titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar nuk mund të ekzekutohet menjëherë në kushtet ekzistuese në treg, shoqëria komisionere merr masat për të ekzekutuar urdhrin sa më shpejt të jetë e mundur, nëse klienti nuk e udhëzon shprehimisht ndryshe.

3. Masat e përmendura në pikën 2 të këtij neni përfshijnë bërjen publike, pa vonesë, të këtij urdhri në mënyrë që të mund t'u bëhet lehtësisht i ditur shoqërive të tjera komisionere.

4. Shoqëria komisionere konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni nëse i transmeton urdhrin me kufi të klientit sistemit të tregtimit të një tregu të rregulluar ose një platforme shumëpalëshe të tregtimit.

Neni 87

Përparësia e urdhrave të klientëve

1. Shoqëria komisionere duhet të ekzekutojë së pari urdhrat e klientëve për kryerje transaksionesh përpara se të kryejë transaksione me të njëjtin instrument financiar për llogari të vet.

2. Shoqëria komisionere duhet t'i ekzekutojë urdhrat e klientëve për kryerje transaksioni sipas instruksionit të përcaktuar në urdhrin e dhënë nga klienti. Shoqëria komisionere nuk duhet t'u japë përparësi urdhrave të klientëve të caktuar ndaj urdhrave të klientëve të tjerë.

3. Shoqërisë komisionere i ndalohet të tregtojë instrumente financiare për llogari të vet, ose për llogari të një klienti tjetër, ose për llogari të një llogarie në të cilën ka interes, përfshirë çdo llogari për të

cilën ka tagrin të marrë vendime, nëse ky tregtim bëhet në bazë të dijenisë paraprake se për të njëjtin instrument financiar ka pasur ose do të ketë një urdhër klienti.

Neni 88

Transaksionet e kryera për llogarinë e tyre nga punonjës individualë të shoqërisë komisionere

1. Anëtarët individualë të organeve drejtuese, funksionarët kryesorë ose punonjësit e regjistruar u nënshtrohen të njëjtave kufizime që zbatohen për shoqërinë komisionere, si më poshtë:

a) transaksioni që kryhet për llogari të tyre është objekt i lejeve specifike, në mënyrë që të konstatohet nëse transaksioni bie ndesh ose jo me ndonjë marrëdhënie ose transaksion tjetër për llogari të klientëve;

b) verifikohet se nuk ka konflikt interesi ose dijeni paraprake për ngjarje për të cilat tregu në përgjithësi nuk ka dijeni;

c) transaksioni kryhet vetëm nëpërmjet shoqërisë komisionere në të cilën ata janë, sipas rastit, anëtarë të organit drejtues, funksionarë kryesorë ose punonjës të regjistruar;

ç) merren masa për regjistrimin e lejes së dhënë dhe vendoset vulë kohore mbi transaksionin.

2. Transaksionet që kryejnë individët për llogari të tyre përjashtohen nga pika 1 e këtij neni nëse kryhen:

a) në një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike;

b) në kuadër të një skeme të licencuar të pensioneve individuale;

c) në lidhje me një skemë të pjesëmarrjes së punonjësve në kapitalin aksionar.

Neni 89

Palët e pranueshme

Shoqëria komisionere mund t'u ofrojë shërbime investimi palëve të pranueshme dhe të kryejë veprimtari investimi për to, por ka detyrimin të përmbushë vetëm detyrimet në bazë të neneve 72— 78 dhe 85 të këtij ligji për këto transaksione ose për çdo shërbim ndihmës që lidhet drejtpërsëdrejti me këto transaksione.

Neni 90

Ekzekutimi në kohë

1. Kur shoqëria komisionere e pranon urdhrin e klientit ose nëse administron një portofol mbi të cilin klienti i ka dhënë liri vendimi, vendos sipas gjykimit të saj të ekzekutojë një urdhër klienti. Ajo duhet ta ekzekutojë urdhrin sa më shpejt të jetë e mundur duke marrë parasysh rrethanat.

2. Marrja e urdhrit nga klienti për të kryer një transaksion, si dhe kryerja e transaksionit duhet të vulosen me vulë kohore, në mënyrë që të ketë provë për respektimin e afatit dhe të rendit të përparësisë.

Neni 91

Ekzekutimi më i mirë

1. Kur shoqëria komisionere tregton me një klient ose në emër të një klienti, ajo duhet të sigurojë ekzekutimin më të mirë.

2. Gjatë ekzekutimit të urdhrave shoqëria komisionere duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar rezultatet më të mira të mundshme për klientët, duke mbajtur parasysh faktorët e ekzekutimit.

3. Autoriteti konsideron se është bërë ekzekutimi më i mirë atëherë kur:

a) vepron në cilësinë e agjentit të klientit, shoqëria komisionere e ekzekuton urdhrin me çmimin më të mirë mbizotërues në treg apo në tregje, për atë madhësi urdhri; ose

b) vepron nga portofoli i vet, shoqëria komisionere ekzekuton urdhrin me një çmim më të

mirë për klientin sesa po ta kishte ekzekutuar urdhrin sipas shkronjës “a” të kësaj pike;

c) shoqëria ka parashikuar dhe zbaton masa efektive për të përmbushur detyrimin e ndjekjes së të gjithë hapave të duhur për të siguruar rezultatet më të mira të mundshme për klientët.

Neni 92

Faktorët që përcaktojnë ekzekutimin më të mirë

1. Gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve, shoqëria komisionere mban parasysh kriteret e mëposhtme për të konstatuar rëndësinë relative të faktorëve:

a) karakteristikat e klientit, përfshirë kategorizimin e klientit si klient individ ose klient profesionist;

b) karakteristikat e urdhrit të klientit;

c) karakteristikat e instrumenteve financiare që janë objekt i urdhrit;

ç) karakteristikat e platformave të ekzekutimit ku mund të orientohet urdhri.

2. Shoqëria komisionere e përmbush detyrimin e parashikuar në këtë nen për ndjekjen e të gjithë hapave të duhur, në funksion të sigurimit të rezultatit më të mirë të mundshëm për klientin, për aq kohë sa e ekzekuton urdhrin ose një aspekt specifik të urdhrit në bazë të udhëzimeve specifike të klientit.

3. Shpejtësia, probabiliteti i ekzekutimit dhe i shlyerjes, madhësia dhe natyra e urdhrit, e veprimit të tregut dhe çdo kosto tjetër e nënkuptuar e transaksionit mund të marrë përparësi mbi konsideratat imediate të çmimit dhe kostos, vetëm për aq kohë sa janë të vlefshme për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm në përgjithësi për klientin joprofesionist.

4. Sa herë që klienti jep një udhëzim specifik, shoqëria duhet ta ekzekutojë urdhrin në bazë të këtij udhëzimi specifik. Megjithatë, shoqëria komisionere nuk duhet ta nxisë klientin që ta udhëzojë, ta ekzekutojë urdhrin në ndonjë mënyrë të veçantë, duke i sugjeruar klientit, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, përmbajtjen e udhëzimit, nëse nga shoqëria pritet në mënyrë të arsyeshme të dijë se një udhëzim i tillë ka të ngjarë të pengojë sigurimin e rezultatit më të mirë të mundshëm për klientin.

5. Kostot që lidhen me ekzekutimin përfshijnë komisionet ose tarifat që shoqëria i ngarkon klientit për qëllime të kufizuara në rastet kur urdhri mund të ekzekutohet në më shumë se një nga platformat e renditura në rregulloren e shoqërisë komisionere për ekzekutimin.

Në raste të tilla mbahen parasysh komisionet e shoqërisë komisionere dhe kostot për ekzekutimin e urdhrit për secilën prej platformave të lejuara të ekzekutimit, në mënyrë që të vlerësohen dhe të krahasohen rezultatet që do të arriheshin për klientin nëse urdhri do të ekzekutohej në secilën prej tyre.

Pavarësisht sa më sipër, shoqëria nuk është e detyruar të krahasojë rezultatet që do të arriheshin për klientin në bazë të procedurave të saj të ekzekutimit, komisioneve dhe tarifave të veta, me rezultate që mund të ishin arritur për të njëjtin klient nga ndonjë shoqëri tjetër komisionere në bazë të procedurave të tjera të ekzekutimit ose një strukture tjetër komisionesh ose tarifash. Gjithashtu, shoqëria nuk është e detyruar të krahasojë dallimet midis komisioneve të veta, të cilat shkaktohen nga dallimet e natyrës së shërbimeve që shoqëria u ofron klientëve.

Neni 93

Komunikimi i rregullores së ekzekutimit më të mirë klientëve

Shoqëria komisionere duhet të miratojë dhe të zbatojë një rregullore të ekzekutimit të urdhrave, e cila i jep mundësi të sigurojë rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave të klientëve. Shoqëria duhet t'ua komunikojë këtë rregullore klientëve, si më poshtë:

a) shoqëria komisionere duhet t'u japë klientëve informacionin e duhur për rregulloren dhe procedurat e saj të ekzekutimit të urdhrave;

b) këto informacione duhet të shpjegojnë qartë se si do t'i ekzekutojë shoqëria urdhrat në emër të klientëve, duke përfshirë:

i. një listë të platformave të ekzekutimit tek të cilat shoqëria mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në përmbushjen e detyrimit për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave të klientit. Në listë duhet specifikuar se cilat platforma ekzekutimi përdoren për secilën klasë të instrumenteve, për urdhrat e klientëve joprofesionistë apo për urdhrat e klientëve profesionistë;

ii. një listë të faktorëve të përdorur në përzgjedhjen e një platforme ekzekutimi, përfshirë faktorët cilësorë, siç janë skemat e klerimit, ndërprerësit e tregtimit automatik, veprimet e planifikuara ose ndonjë faktor tjetër të lidhur. Në listë duhet përcaktuar rëndësia relative e secilit faktor;

iii. informacion për faktorët e përdorur në përzgjedhjen e një platforme ekzekutimi duhet të përputhet me sistemin e kontrollit që përdor shoqëria, për t'u dëshmuar klientëve se ekzekutimi më i mirë është arritur në mënyrë të vazhdueshme kur shqyrton përshtatshmërinë e procedurave dhe të masave të saj;

iv. mënyrën si merren në konsideratë faktorët e ekzekutimit të çmimit, të kostove, të shpejtësisë, të probabilitetit të ekzekutimit dhe çdo faktor tjetër i lidhur me to, në kuadër të të gjithë hapave të duhur që ndërmerren nga shoqëria për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për klientin;

v. sipas rastit, informacion se shoqëria i ekzekuton urdhrat jashtë një platforme tregtimi. Ky informacion përfshin edhe pasojat që mund të rrjedhin nga ekzekutimi jashtë një platforme tregimi, si për shembull risku i kundërpalës. Me kërkesë të klientit, jepet informacion shtesë për pasojat e kësaj mënyre ekzekutimi;

vi. një paralajmërim të qartë dhe të dallueshëm se çdo udhëzim specifik i klientit mund ta pengojë shoqërinë në kryerjen e hapave të planifikuar në rregulloren e saj të ekzekutimit, për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrit;

vii. një përmbledhje të procedurës së përzgjedhjes së platformave të ekzekutimit, strategjive të zbatuara për ekzekutimin, procedurave të ndjekura për të analizuar cilësinë e siguruar të ekzekutimit dhe të mënyrës si shoqëria monitoron dhe verifikon se janë siguruar rezultatet më të mira të mundshme për klientin.

Neni 94

Demonstrimi i ekzekutimit më të mirë

Shoqëria komisionere duhet të jetë në gjendje t'i demonstrojë klientit, me kërkesën e këtij të fundit, se urdhri është ekzekutuar në përputhje me rregulloren e shoqërisë komisionere për ekzekutimin e urdhrave dhe t'i demonstrojë Autoritetit, me kërkesën e këtij të fundit, se e ka zbatuar këtë nen.

Neni 95

Ekzekutimi më i mirë për transaksionet e financimit me tituj

Për të përmbushur detyrimin e ekzekutimit më të mirë për klientët profesionistë, si rregull, shoqëria komisionere mund të mos përdorë të njëjtat platforma ekzekutimi për transaksionet e financimit me tituj dhe për transaksione të tjera.

Transaksionet e financimit me tituj do të përdoren si burim financimi, bazuar në angazhimin e huamarrësit në kthimin e titujve ekuivalentë në një datë të ardhshme. Kushtet e transaksioneve të financimit me tituj zakonisht përcaktohen nga palët përpara ekzekutimit.

Përzgjedhja e platformave të ekzekutimit për transaksionet e financimit me tituj është më e kufizuar sesa në rastin e transaksioneve të tjera, duke qenë se varet nga kushtet specifike të përcaktuara paraprakisht midis palëve dhe nga fakti nëse ekziston një kërkesë specifike në këto platforma ekzekutimi për instrumentet financiare në fjalë. Rregullorja e ekzekutimit të urdhrave, e miratuar nga shoqëria, duhet të marrë parasysh karakteristikat e veçanta të transaksioneve të financimit me tituj. Kjo rregullore duhet të përcaktojë veçmas platformat e ekzekutimit të përdorura për transaksionet e financimit me tituj.

Neni 96

Leja për ekzekutimin e urdhrave jashtë një tregu të rregulluar

1. Kur një rregullore e ekzekutimit të urdhrave e një shoqërie komisionere parashikon që urdhrat e klientit mund të ekzekutohen jashtë një tregu të rregulluar, shoqëria duhet t'i informojë klientët për këtë mundësi.

2. Shoqëria komisionere duhet të marrë pëlqimin paraprak të klientëve përpara se të ndërmarrë procedurat e ekzekutimit të urdhrave të tyre jashtë një tregu të rregulluar.

3. Pëlqimi i klientit mund të jepet në formën e një kontrate të përgjithshme ose veçmas për çdo transaksionin specifik.

Neni 97

Kalimi pa vonesë në llogarinë e klientit

Gjatë ekzekutimit të një transaksioni të bazuar në një urdhër klienti, shoqëria komisionere duhet të sigurojë që transaksioni të kalojë pa vonesë në llogarinë e klientit.

Neni 98

Bashkimi i urdhrave të klientëve dhe shpërndarja e drejtë

Nëse urdhrat e klientit për transaksione që kërkohet të kryhen si një transaksion i vetëm me të njëjtat kushte dhe në të njëjtën kohë bashkohen nga shoqëria komisionere me urdhra të klientëve të tjerë, shoqëria komisionere duhet:

a) t'i shpërndajë titujt në mënyrë të drejtë mes klientëve, urdhrat e të cilëve janë bashkuar, në përpjesëtim me vlerën e secilit urdhër;

b) nëse si rezultat i bashkimit, totali i urdhrave të ekzekutuar të klientëve nuk e arrin vlerën e totalit të urdhrave të kërkuar, sasia e titujve të blerë ose të shitur duhet të shpërndahet proporcionalisht për secilin klient të përfshirë në bashkim, në përpjesëtim me vlerën e urdhrit të kërkuar të secilit klient;

c) të mbartë pjesën e papërfunduar të një urdhri të bashkuar deri në ditën kur bëhet i mundur tregtimi dhe atëherë zbaton parimin e parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike;

ç) të mos bashkojë urdhrin e klientit me urdhrat e vet, nëse urdhri është për një titull të tregtuar në një treg të rregulluar, përveç rastit kur një bashkim i tillë bëhet në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti ose nga bursa, ose nga tregu i rregulluar.

Neni 99

Rekomandimet

1. Shoqëria komisionere nuk duhet t'i japë rekomandime në lidhje me asnjë instrument financiar një personi nga i cili mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të mbështetet në këto rekomandime, nëse shoqëria komisionere nuk ka një bazë të arsyeshme për dhënien e rekomandimeve. Në çdo rast, shoqëria komisionere duhet të paralajmërojë personin në fjalë se vlera e instrumenteve financiare mund të luhatet.

2. Kur shoqëria komisionere dërgon një komunikim në të cilin një person bën një rekomandim, në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar, në lidhje me një instrument financiar, shoqëria sigurohet që komunikimi përmban një deklaratë të përmbledhur të natyrës së çdo interesi që mban personi ose ndonjë person i lidhur me të në instrumentet financiare, ose në blerjen ose shitjen e instrumenteve financiare në datën kur dërgohet komunikimi.

Neni 100

Ndalimi i praktikave abuzuese me qëllim sigurimin e fitimit

Shoqëria komisionere nuk duhet ta këshillojë klientin ose t'i kërkojë klientit të tregtojë, ose të organizojë një tregtim, nëse ky tregtim do të konsiderohej në mënyrë të arsyeshme se bie ndesh me interesin e klientit, duke marrë në konsideratë numrin dhe frekuencën e tregtimeve në raport me objektivat e investimit, gjendjen financiare, madhësinë dhe karakterin e llogarisë së klientit.

Neni 101

Transaksionet për llogari të ose nëpërmjet shoqërive të tjera komisionere

1. Kur shoqëria komisionere merr nëpërmjet një shoqërie tjetër komisionere një udhëzim për të kryer një investim, një transaksion ose një shërbim ndihmës për llogari të një klienti, ajo nuk është e detyruar të verifikojë plotësinë dhe saktësinë e informacioneve për klientin dhe udhëzimet e klientit për shërbimet në fjalë.

2. Përgjegjësia për plotësinë dhe saktësinë e informacionit të transmetuar i mbetet shoqërisë komisionere që përcjell udhëzimet.

3. Shoqëria komisionere, e cila merr udhëzime për të ofruar shërbime për llogari të një klienti sipas pikës 1 të këtij neni, mund të mbështetet në çdo rekomandim në lidhje me shërbimin ose transaksionin që i është ofruar klientit nga një shoqëri tjetër komisionere.

4. Përgjegjësia për përshtatshmërinë e rekomandimeve ose të këshillave në raport me klientin i mbetet shoqërisë komisionere që përcjell udhëzimet.

5. Shoqëria komisionere, e cila merr udhëzime ose urdhra klienti nëpërmjet një shoqërie tjetër komisionere, është përgjegjëse për kryerjen e shërbimit ose transaksionit, në bazë të informacionit ose të rekomandimeve të përcaktuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 102

Kontrolli i procedurave për ekzekutimin më të mirë

Shoqëria komisionere duhet të monitorojë efektivitetin e procedurave të ekzekutimit të urdhrave për të identifikuar dhe, sipas rastit, për të ndrequr çdo mangësi. Në veçanti, shoqëria komisionere duhet të vlerësojë rregullisht nëse platformat e ekzekutimit të përfshira në rregulloren për ekzekutimin e urdhrave sigurojnë rezultatin më të mirë të mundshëm për klientin ose nëse duhet të miratojë ndryshime në procedurat e ekzekutimit.

SEKSIONI V

MBAJTJA E REGJISTRAVE DHE AUDITUESIT

Neni 103

Mbajtja e regjistrave

1. Shoqëria komisionere duhet të mbajë llogaritë dhe regjistrat e duhur, që tregojnë transaksionet e kryera për llogari të saj ose për llogari të të tretëve dhe pozicionin financiar të veprimtarisë së saj të rregulluar.

2. Regjistrat dhe llogaritë e mbajtura në bazë të pikës 1 të këtij neni duhet:

a) të paraqesin me saktësi pozicionin financiar të shoqërisë komisionere në çdo moment;

b) t'i japin mundësi shoqërisë komisionere të hartojë pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në çdo moment, sipas formatit të përcaktuar nga Autoriteti; dhe

c) të tregojnë nëse shoqëria komisionere ka burime të mjaftueshme financiare për të përmbushur angazhimet tregtare dhe për të përballuar rreziqet ndaj të cilave ekspozohet veprimtaria e saj.

Neni 104

Përditësimi i regjistrave

1. Shoqëria komisionere duhet të sigurojë që regjistrat e saj përditësohen në mënyrë të përditshme.

2. Shoqëria komisionere duhet të miratojë procedura që sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat për burimet financiare, aktivet e klientit dhe kapitalin qarkullues.

3. Gjithashtu, shoqëria komisionere duhet të miratojë procedura për:

a) rakordimet ditore të fondeve të mbajtura në llogaritë e klientëve;

b) llogaritjet ditore të kapitalit qarkullues dhe burimeve financiare; dhe

c) mbajtjen e evidencave për llogaritjet dhe rakordimet ditore.

Neni 105

Përputhshmëria me standardet e kontabilitetit

1. Shoqëria komisionere duhet t'i mbajë regjistrat kontabël në përputhje me standardet e kontabilitetit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. Autoriteti mund të miratojë me rregullore parashikime të mëtejshme për kërkesat mbi standardet e kontabilitetit për shoqëritë komisionere.

Neni 106

Ruajtja e regjistrave

Shoqëria komisionere duhet t'i ruajë regjistrat e saj kontabël për periudhën kohore të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 107
Kërkesa të përgjithshme për kontabilitetin

1. Shoqëria komisionere i mban llogaritë, i harton dhe publikon pasqyrat financiare vjetore dhe raportet vjetore në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe me rregullat e aktet e tjera nënligjore, që rregullojnë kontabilitetin e shoqërive tregtare dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.

2. Shoqëria komisionere i mban llogaritë dhe i harton pasqyrat financiare vjetore në atë mënyrë që mundëson verifikimin e ngjarjeve të regjistruara tregtare, pozicionin e saj financiar dhe performancën e veprimtarisë së saj tregtare.

3. Autoriteti parashikon me rregullore përmbajtjen dhe formatin e raportimeve të shoqërive komisionere, si dhe metodat e afatet për dorëzimin e tyre.

Neni 108
Pasqyrat financiare vjetore

Shoqëria komisionere në fund të vitit financiar duhet të hartojë pasqyrat financiare vjetore sipas formatit që parashikon Autoriteti, të përbëra nga:

a) pasqyra e pozicionit financiar, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e situatës së shoqërisë komisionere, siç është në mbyllje të vitit ushtrimor;

b) pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e fitimit ose e humbjes së shoqërisë komisionere për vitin ushtrimor;

c) pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar;

ç) pasqyra e flukseve monetare; dhe

d) një përshkrim të politikave kontabël, që ka zbatuar shoqëria komisionere gjatë hartimit të pasqyrave financiare.

Neni 109
Raportet dhe pasqyrat financiare vjetore

1. Shoqëria komisionere, brenda katër muajve nga data e mbylljes së vitit ushtrimor, duhet të depozitojë pranë Autoritetit një raport vjetor, i cili duhet të përfshijë:

a) një raport për politikën e drejtimit të brendshëm të shoqërisë komisionere dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti;

b) pasqyrat financiare të audituara, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me kërkesat e tjera që mund të parashikojë me rregullore Autoriteti; dhe

c) pasqyrat financiare të konsoliduara, kur shoqëria komisionere është shoqëri tip *holding* ose shoqëri e kontrolluar.

2. Pasqyrat financiare që përfshihen në raportin vjetor sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajnë informacionin e parashikuar në nenin 108 të këtij ligji.

3. Raporti vjetor duhet të përfshijë edhe një raport të audituar për procedurat e administrimit të rrezikut dhe zbatimin e tyre dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti.

4. Raporti vjetor duhet të përfshijë të gjithë informacionin e parashikuar më lart, krahas informacionit që kërkon legjislacioni në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 110
Raporti i auditimit

1. Shoqëria komisionere, brenda katër muajve nga data e mbylljes së vitit ushtrimor, duhet të depozitojë pranë Autoritetit raportin e auditimit së bashku me:

a) pasqyrat financiare vjetore; dhe

b) një konfirmim me shkrim se i ka përmbushur dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji dhe çdo kërkesë tjetër të miratuar nga Autoriteti.

2. Kur audituesi jep opinion të modifikuar për shoqërinë komisionere, për shkak të pasigurisë së audituesit lidhur me plotësinë ose saktësinë e regjistrave kontabël, shoqëria komisionere e shoqëron raportin që dorëzon pranë Autoritetit me një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga dy anëtarë të këshillit të

administrimit/këshillit mbikëqyrës, ku deklarohet nëse:

a) të gjithë regjistrat kontabël të shoqërisë komisionere i janë vënë në dispozicion audituesit në funksion të auditimit;

b) të gjitha transaksionet e kryera nga shoqëria komisionere janë pasqyruar dhe regjistruar siç duhet në regjistrat e saj kontabël; dhe

c) të gjithë regjistrat e tjerë të shoqërisë komisionere dhe informacionet e lidhura me to i janë vënë në dispozicion audituesit.

Neni 111

Publikimi i raporteve

1. Shoqëria komisionere publikon pasqyrat financiare vjetore të audituara, ose kur shoqëria komisionere është shoqëri mëmë, pasqyrat vjetore financiare të konsoliduara të audituara për të gjithë grupin, sipas mënyrës së parashikuar në rregullat për kontabilitetin e shoqërive tregtare dhe në zbatim të standardeve të raportimit financiar.

2. Shoqëria komisionere me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, e cila ka themeluar një degë në Republikën e Shqipërisë, publikon në gjuhën shqipe, në faqen e internetit të degës, pasqyrat financiare vjetore të përgatitura dhe të audituara në përputhje me rregullat e vendit të origjinës të shoqërisë mëmë, si edhe raportin vjetor, përfshirë raportin e audituesit, jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të afatit për publikimin e tyre në vendin e origjinës së shoqërisë mëmë.

Neni 112

Emërimi i audituesve ligjorë

1. Shoqëria komisionere duhet të emërojë një auditues ligjor sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

2. Audituesi ligjor i shoqërisë komisionere duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara me rregullore të Autoritetit.

Neni 113

Vënia në dispozicion e informacionit Autoritetit nga audituesi ligjor i jashtëm

1. Autoriteti, me njoftim me shkrim, mund t'i kërkojë personit që është ose ka qenë auditues ligjor i jashtëm:

a) i një personi të licencuar ose të regjistruar; ose

b) i një shoqërie të kontrolluar ose një shoqërie të grupit të personit të licencuar ose të regjistruar, t'i japë Autoritetit ato informacione për personin e licencuar ose të regjistruar, shoqërinë e kontrolluar ose shoqërinë e grupit të personit të licencuar ose të regjistruar, të cilat Autoriteti i konsideron të nevojshme për të kryer funksionet e tij.

2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, asnjë detyrim i audituesit ligjor të personit të licencuar ose të regjistruar nuk do të konsiderohet si i shkelur për shkak të komunikimit në mirëbesim të Autoritetit, në përgjigje ose jo të një kërkese që ka bërë ky i fundit, të informacioneve ose opinioneve për të cilat audituesi ka marrë dijeni për shkak të cilësisë së tij si auditues ligjor i personit të licencuar ose të regjistruar, të cilat kanë lidhje me funksionet e Autoritetit në bazë të këtij ligji.

3. Kur audituesi ligjor, të cilit i bëhet kërkesë për të dhënë informacion në bazë të pikës 1 të këtij neni, nuk jep, refuzon ose neglizhon të japë informacion, ose jep informacione të rreme ose keqinformuese, Autoriteti mund ta përjashtojë nga mundësia e emërimit si auditues ligjor i një personi të licencuar ose të regjistruar.

4. Shoqëria komisionere nuk emëron si auditues ligjor një person të përjashtuar në bazë të këtij ligji.

Neni 114

Detyrimet e audituesit ligjor

1. Nëse audituesi ligjor i shoqërisë komisionere gjatë kryerjes së detyrave merr dijeni për:

a) çdo çështje që, sipas tij, ndikon ose mund të ndikojë negativisht dhe në mënyrë të

konsiderueshme në pozicionin financiar të shoqërisë komisionere;

b) çdo çështje që, sipas tij, përbën ose mund të përbëjë shkelje të ndonjë prej dispozitave të këtij ligji ose një vepër penale, që përfshin mashtrimin, veprime të pandershme ose pastrim parash me ndikim të konsiderueshëm në stabilitetin financiar të shoqërisë komisionere; ose

c) çdo parregullsi që ka ose mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në llogaritë e shoqërisë komisionere, përfshirë çdo parregullsi që ndikon ose mund të ndikojë negativisht në aktivet, fondet ose pasuritë e investitorëve të instrumenteve financiare, ai duhet t'i dërgojë menjëherë këshillit të administrimit një raport me shkrim për çështjen ose parregullsinë dhe t'i vendosë në dispozicion një kopje të raportit Autoritetit.

2. Audituesi ligjor i shoqërisë komisionere nuk mban përgjegjësi për deklaratat e tij në raportin e hartuar në zbatim të pikës 1 të këtij neni, me kusht që të ketë vepruar në mirëbesim.

3. Autoriteti mund t'i ngarkojë audituesit ligjor të shoqërisë komisionere të gjitha ose ndonjë nga detyrimet e mëposhtme:

a) detyrimin për të paraqitur informacione dhe raporte të tjera shtesë në lidhje me auditimin, siç e konsideron të nevojshëm Autoriteti;

b) detyrimin për të zgjeruar ose ndryshuar objektin e auditimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë komisionere;

c) detyrimin për të kryer vlerësime të tjera ose për të përcaktuar një procedurë për një rast të veçantë, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi;

ç) detyrimin për të paraqitur një raport për çdo çështje që del nga auditimi, vlerësimi ose përcaktimi i procedurës së përmendur në shkronjën “b” ose “c” të kësaj pike.

4. Audituesi ligjor duhet t'i kryejë këto detyra krahas objektit të zakonshëm të auditimit për dhënien e një opinioni të pavarur mbi pasqyrat financiare.

5. Shoqëria komisionere e shpërblen audituesin ligjor sipas planit të shpërblimit të publikuar nga Autoriteti për përmbushjen e të gjitha ose të një prej detyrimeve të përmendura në pikën 3 të këtij neni.

6. Në rrethana të caktuara, kur nevojitet auditim i mëtejshëm, shpërblimi duhet të paguhet nga fondet e Autoritetit.

Neni 115

Komiteti i auditimit

1. Shoqëria komisionere krijon komitetin e auditimit me jo më pak se tre anëtarë, shumica e të cilëve janë anëtarë joekzekutivë të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës.

2. Të paktën një nga anëtarët e komitetit të auditimit duhet të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë në fushën e kontabilitetit ose auditimit ose të ketë një kualifikim profesional për kontabilitet.

3. Komiteti i auditimit ndihmon këshillin e administrimit/këshillin mbikëqyrës në përmbushjen e funksioneve të veta mbikëqyrëse në interes të aksionarëve dhe të palëve të interesit. Në përmbushje të këtij funksioni, komiteti i auditimit, ndër të tjera, ka këto detyra:

a) monitoron procedurat e raportimit financiar dhe vlerëson integritetin e pasqyrave financiare të shoqërisë komisionere;

b) monitoron mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrolleve të brendshme të shoqërisë komisionere;

c) monitoron përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e procedurave të projektuara për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;

ç) propozon drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm;

d) propozon audituesin e jashtëm dhe shqyrton e monitoron pavarësinë e shoqërisë audituese.

4. Komiteti i auditimit mblidhet jo më pak se katër herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli i administrimit apo këshilli mbikëqyrës i shoqërisë së auditimit. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Abstenimi nuk lejohet.

5. Komiteti i auditimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

6. Pagat dhe shpërblimet e anëtarëve të komitetit të auditimit përcaktohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë komisionere.

7. Komiteti i auditimit i raporton këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës apo këshillit mbikëqyrës dhe i ndihmon këto të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës së shoqërisë

komisionere.

8. Autoriteti mund të bëjë parashikime të mëtejshme me rregullore për funksionimin e komitetit të auditimit të brendshëm.

Neni 116

Kompetenca për të kërkuar auditim të dytë

1. Autoriteti, nëse nuk është dakord me raportin e auditimit, mund t'i kërkojë audituesit:

a) informacione të tjera shtesë;

b) të japë shpjegime për raportin e auditimit;

c) të zgjerojë objektin e auditimit apo të kryejë procedura të tjera, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

2. Në rast se Autoriteti nuk është dakord edhe pas këtyre hapave, mund të kërkojë kontrollin e cilësisë së auditimit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

3. Kur e refuzon raportin e auditimit, Autoriteti mund të kërkojë dhe miratojë emërimin e një audituesi tjetër, për llogari të personit të licencuar ose të regjistruar dhe përcakton shpërblimin që i paguhet audituesit të dytë nga personi i licencuar ose i regjistruar.

KREU V

INSTITUCIONET E TREGUT

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR INSTITUCIONET E TREGUT

Neni 117

Rregullorja e institucionit të tregut

1. Rregulloret e institucionit të tregut, të cilat miratohen nga Autoriteti, janë detyruese për institucionin e tregut dhe anëtarët e tij.

2. Institucioni i tregut dhe anëtarët e tij konsiderohet se kanë rënë dakord të përmbushin detyrimet e parashikuara nga rregulloret në fuqi, për aq sa parashikimet e rregulloreve janë të zbatueshme për institucionin e tregut, emetuesin ose pjesëmarrësin tregtues të tregut, anëtarin e klerimit ose pjesëmarrësin e depozitarit, sipas rastit.

3. Rregullorja e institucionit të tregut që miratohet nga Autoriteti nuk mund të ndryshohet apo të shfuqizohet pa miratimin paraprak të Autoritetit.

4. Institucioni i tregut, që propozon të bëjë ndryshime në rregulloret e tij, i paraqet me shkrim Autoritetit ndryshimet e propozuara, pavarësisht nëse propozimi është në formën e shfuqizimit, të ndryshimit ose të plotësimit të rregulloreve.

5. Brenda 28 (njëzet e tetë) ditëve pune nga marrja e kërkesës për ndryshim të rregullores, Autoriteti konsultohet me institucionin e tregut dhe i njofton këtij të fundit me shkrim nëse miraton ose jo ndryshimet e propozuara. Në rast se ndryshimi i propozuar refuzohet, Autoriteti i njofton institucionit të tregut me shkrim edhe arsyet e refuzimit.

6. Pas marrjes së njoftimit të miratimit të ndryshimeve sipas pikës 5 të këtij neni, institucioni i tregut duhet zbatojë menjëherë rregullat e ndryshuara.

7. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 6 të këtij neni, Autoriteti mund t'i ndryshojë rregulloret e çdo institucioni tregu me kërkesën e institucionit të tregut sipas pikës 5 të këtij neni. Ndryshime të tilla hyjnë menjëherë në fuqi.

Neni 118

Kompetenca e Autoritetit për të urdhëruar zbatimin e rregulloreve të institucioneve të tregut

Kur një person, i cili ka detyrimin të zbatojë apo të sigurojë zbatimin e rregulloreve të një institucioni tregu, nuk e përmbush këtë detyrim, Autoriteti, kryesisht apo me kërkesën e institucionit të tregut ose të një personi të dëmtuar nga moszbatimi, mund të urdhërojë personin në fjalë të zbatojë apo të sigurojë zbatimin e rregullores së institucionit të tregut.

Neni 119

Procedurat organizative dhe të brendshme të institucioneve të tregut

1. Të gjitha institucionet e tregut duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet një strukture të përshtatshme administrative dhe llogaridhënieje të një madhësie dhe kapaciteti të përshtatshëm për veprimtarinë e institucionit. Kjo strukturë përcakton procedurat dhe praktikat e përshtatshme të auditimit të brendshëm dhe të administrimit të rrezikut dhe monitoron rreziqet e përputhshmërinë me këtë ligj dhe me çdo akt nënligjor, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

2. Struktura organizative duhet të përcaktojë mënyrën e organizimit të brendshëm dhe rolin e organeve drejtuese e të administratorëve.

3. Struktura organizative duhet të ndajë dhe të caktojë qartë përgjegjësitë e funksionarëve kryesorë, si dhe të krijojë një sistem të brendshëm efektiv të shpërndarjes së informacionit.

Neni 120

Kërkesat për njoftim

1. Të gjitha institucionet e tregut njoftojnë paraprakisht Autoritetin për identitetin dhe çdo ndryshim të mëpasshëm të anëtarëve të organeve drejtuese dhe të personave të tjerë, të cilët drejtojnë konkretisht veprimtarinë e tyre përpara se të zbatohen këto ndryshime.

2. Autoriteti mund të refuzojë miratimin e ndryshimeve të propozuara kur ka arsye për të besuar se personi ose personat e propozuar për të drejtuar veprimtarinë e institucionit nuk janë të aftë dhe të përshtatshëm.

Neni 121

Pjesëmarrja influencuese dhe ushtrimi i ndikimit të konsiderueshëm mbi institucionin e tregut

1. Personi, që propozon të zotërojë ose zotëron pjesëmarrje influencuese në kapitalin e një institucioni të tregut, nëpërmjet së cilës mund të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm mbi administrimin e institucionit, i drejtohet Autoritetit për miratim ose kur merr dijeni për këtë. Zotërimi i pjesëmarrjes influencuese nuk krijon pasoja pa miratimin e Autoritetit.

2. Autoriteti me rregullore mund të kërkojë nga personi, i cili propozon të zotërojë ose zotëron pjesëmarrje influencuese në kapitalin e një institucioni të tregut, të vendosë në dispozicion të Autoritetit informacionet dhe dokumentet që i gjykon të nevojshme Autoriteti, me qëllim që Autoriteti të mund të konstatojë nëse:

a) personi që zotëron ose propozon të zotërojë pjesëmarrjen influencuese është i aftë dhe i përshtatshëm për këtë qëllim; dhe

b) zotërimi i pjesëmarrjes influencuese nga personi në fjalë nuk rrezikon interesat e investitorëve.

3. Autoriteti njofton refuzimin e propozimit të transferimit të pjesëmarrjes influencuese brenda tre muajve nga data e njoftimit.

4. Autoriteti njofton miratimin e transferimit të pjesëmarrjes influencuese brenda tre muajve nga data e njoftimit.

5. Autoriteti mund të miratojë transferimin e pjesëmarrjes influencuese pa kushte ose me kushtet ose kufizimet që i gjykon të përshtatshme Autoriteti.

6. Nëse Autoriteti miraton transferimin e pjesëmarrjes influencuese me kushte, vendimi njoftohet në përputhje me procedurën e përcaktuar.

Neni 122

Blerja e parregullt e aksioneve të një institucioni të tregut

Nëse një person ka blerë ose ka vijuar të zotërojë aksione të një institucioni tregu në kundërshtim me:

a) refuzimin e Autoritetit; ose

b) një kusht të vendosur nga Autoriteti,

Autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim të dhënë në përputhje me procedurën e përcaktuar në

nenin 121 të këtij ligji, mund të urdhërojë që aksionet në fjalë t'i nënshtrohen njërit ose disa prej kufizimeve të mëposhtme deri në një njoftim të dytë:

i. kontrata për transferimin e këtyre aksioneve, ose në rastin e aksioneve të paemetuara, kontrata për transferimin e të drejtës për të nënshkruar aksionet e emetuara, është e pavlefshme;

ii. asnjë e drejtë vote nuk mund të ushtrohet në lidhje me këto aksione;

iii. asnjë emetim i ri aksionesh nuk mund të kryhet mbi bazën e këtyre aksioneve ose në bazë të ndonjë oferte të bërë ndaj mbajtësit të tyre;

iv. me përjashtim të një procedure likuidimi, shoqëria nuk mund të kryejë asnjë pagesë në lidhje me këto aksione.

Neni 123

Konflikti i interesit dhe transaksionet me palë të lidhura

1. Të gjitha institucionet e tregut duhet të krijojnë sisteme, procedura dhe kontrolle për të identifikuar dhe menaxhuar konfliktin ekzistues ose të mundshëm të interesit dhe transaksionet me palët e lidhura.

2. Të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, administratorët dhe funksionarët kryesorë të institucioneve të tregut duhet të deklarojnë paraprakisht me shkrim çdo interes privat që mund të cenojë gjykimin e tyre lidhur me një transaksion ose me një çështje të caktuar sa herë që një situatë e tillë mund të shfaqet.

3. Interesi privat është interesi që bazohet në ose lind nga:

a) marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta apo të tërthorta të çdolloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër;

c) dhurata, premtime, favore, shpërblime ose trajtime preferenciale;

ç) angazhime në veprimtari të tjera private, me qëllim fitimi ose çdolloj veprimtarie që krijon të ardhura; ose

d) çdo transaksion me palët e lidhura.

4. Institucioni i tregut mund të krijojë komitete *ad-hoc*, të përbëra nga anëtarë joekzekutivë të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, të cilët ngarkohen me përgjegjësinë për trajtimin, rast pas rasti, të konfliktit të interesit dhe të transaksioneve me palët e lidhura.

5. Kur anëtari i organit drejtues ose funksionari kryesor nuk deklaron një interes privat, ose kur lidhet a miratohet një kontratë, marrëveshje ose ndonjë transaksion si pasojë e një interesi privat:

a) Autoriteti, kryesisht apo me kërkesë të personit të licencuar, të regjistruar ose të njohur, mund të shpallë të pavlefshme kontratën, marrëveshjen ose transaksionin në fjalë;

b) Autoriteti mund të urdhërojë që personi i licencuar, i regjistruar ose i njohur të marrë masa kundër anëtarit të organit drejtues ose funksionarit kryesor, duke përfshirë, ndër të tjera, pezullimin dhe/ose shkarkimin e tij.

Neni 124

Pavlefshmëria e kontratave të institucioneve të tregut

Autoriteti mund të shpallë të pavlefshme çdo kontratë të lidhur nga institucioni i tregut, e cila në gjykimin e Autoritetit nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Neni 125

Detyrimi për bashkëpunim me Autoritetin

Institucioni i tregut i vendos në dispozicion Autoritetit ose personit që vepron në emër të Autoritetit asistencën e kërkuar nga Autoriteti, përfshirë vënien në dispozicion të regjistrave dhe të informacioneve lidhur me veprimtarinë e institucionit.

Neni 126

Ruajtja e dokumentacionit

Institucioni i tregut ruan regjistrat kontabël për një periudhë dhjetëvjeçare duke filluar nga data e

regjistrimit të veprimit.

Neni 127
Pasqyrat financiare vjetore

Në mbyllje të vitit ushtrimor institucioni i tregut harton pasqyrat financiare vjetore, të cilat përbëhen nga:

a) pasqyra e pozicionit financiar, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e situatës financiare të institucionit të tregut, në ditën e fundit të vitit ushtrimor;

b) pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e fitimit ose humbjes së institucionit të tregut për vitin ushtrimor;

c) pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar; ç) pasqyra e flukseve monetare; dhe

d) një përshkrim i politikave kontabël që ka zbatuar institucioni i tregut gjatë hartimit të pasqyrave financiare.

Neni 128
Raportet vjetore

1. Institucioni i tregut, brenda katër muajve nga data e mbylljes së vitit ushtrimor, duhet të depozitojë pranë Autoritetit një raport vjetor i cili duhet të përfshijë:

a) një raport për politikën e drejtimit të brendshëm të institucionit të tregut dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti;

b) pasqyrat financiare të audituara, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me kërkesa të tjera që mund të parashikojë me rregullore Autoriteti; dhe

c) pasqyrat financiare të konsoliduara, kur institucioni i tregut është shoqëri tip *holding* ose shoqëri e kontrolluar.

2. Pasqyrat financiare, që përfshihen në raportin vjetor sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajnë informacionin e parashikuar në nenin 127 të këtij ligji.

3. Raporti vjetor duhet të përfshijë edhe një raport të audituar për procedurat e administrimit të rrezikut e zbatimin e tyre dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti.

4. Raporti vjetor duhet të përfshijë të gjithë informacionin e parashikuar më lart dhe çdo informacion tjetër që kërkohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Neni 129
Kompetenca e Autoritetit për të kërkuar raporte periodike

Institucioni i tregut i vendos në dispozicion Autoritetit raporte të tilla si auditimi i administrimit të rrezikut, sipas formës, mënyrës dhe shpeshtësisë që mund të përcaktojë me rregullore Autoriteti.

Neni 130
Raporti i auditimit

1. Institucioni i tregut, brenda katër muajve pas mbylljes së vitit ushtrimor, duhet të depozitojë pranë Autoritetit raportin e auditimit së bashku me:

a) pasqyrat financiare vjetore; dhe

b) një konfirmim me shkrim se i ka përmbushur dispozitat e këtij ligji, të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji dhe çdo kërkesë tjetër të miratuar nga Autoriteti.

2. Kur audituesi jep opinion të modifikuar për institucionin e tregut, për shkak të pasigurisë së audituesit lidhur me plotësinë ose saktësinë e regjistrave kontabël, institucioni i tregut e shoqëron raportin e dorëzuar pranë Autoritetit me një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga të paktën dy anëtarë të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të institucionit të tregut, ku deklarohet nëse:

a) audituesit i janë vënë në dispozicion të gjithë regjistrat kontabël të institucionit të tregut në funksion të auditimit;

b) të gjitha transaksionet e kryera nga institucioni i tregut janë pasqyruar dhe regjistruar siç duhet në regjistrat e saj kontabël; dhe

c) audituesit i janë vënë në dispozicion të gjithë regjistrat e tjerë të institucionit të tregut dhe informacionet e lidhura me to.

Neni 131
Emërimi i audituesve

Institucioni i tregut duhet të emërojë një auditues të miratuar nga Autoriteti.

Neni 132
Kompetenca për të kërkuar auditim të dytë

1. Autoriteti, nëse nuk është dakord me raportin e auditimit, mund t'i kërkojë audituesit:
a) informacione të tjera shtesë;
b) të japë shpjegime për raportin e auditimit;
c) të zgjerojë objektin e auditimit apo të kryejë procedura të tjera, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

2. Në rast se Autoriteti nuk është dakord edhe pas këtyre hapave, mund të kërkojë kontrollin e cilësisë së auditimit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

3. Kur refuzon raportin e auditimit, Autoriteti mund të kërkojë dhe miratojë një auditues për llogari të institucionit të tregut. Autoriteti përcakton shpërblimin që i paguhet audituesit të dytë nga institucioni i tregut.

Neni 133
Detyrimi i audituesit të jashtëm t'i japë informacion Autoritetit

1. Autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, mund t'i kërkojë personit që është ose ka qenë auditues i jashtëm:
a) i një institucioni tregu; ose
b) i një shoqërie të kontrolluar ose një shoqërie të lidhur me një institucioni tregu, t'i japë Autoritetit ato informacione për institucionin e tregut, shoqërinë e kontrolluar nga institucioni i tregut ose shoqërinë e lidhur me institucionin e tregut, të cilat Autoriteti i konsideron të nevojshme për ta ndihmuar në kryerjen e funksioneve të tij.

2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, audituesi i institucionit të tregut nuk do të konsiderohet se ka shkelur ndonjë detyrim ligjor nëse i jep në mirëbesim Autoritetit, në përgjigje ose jo të një kërkese që ka bërë ky i fundit, informacione ose opinione lidhur me një çështje për të cilën audituesi ka marrë dijeni për shkak të cilësisë si auditues i institucionit të tregut dhe që ka lidhje me funksionet e Autoritetit në bazë të këtij ligji.

3. Autoriteti mund të përjashtojë nga mundësia e të vepruarit si auditues i një personi të licencuar ose të regjistruar një auditues të cilit i kërkohet të japë informacion në bazë të pikës 1 të këtij neni dhe ai nuk arrin, refuzon ose neglizhon të japë informacionin e kërkuar ose jep informacione të rreme ose keqinformuese.

4. Institucioni i tregut nuk mund të emërojë si auditues një person të skualifikuar në bazë të këtij ligji.

Neni 134
Detyrimet e audituesit

1. Nëse gjatë kryerjes së detyrave të tij audituesi i institucionit të tregut merr dijeni për:
a) çdo çështje, e cila, në gjykimin e tij, ndikon ose mund të ndikojë negativisht në pozicionin financiar të institucionit të tregut në mënyrë të konsiderueshme;
b) çdo çështje, e cila, në gjykimin e tij, përbën ose mund të përbëjë shkelje të ndonjë prej dispozitave të këtij ligji ose vepër penale në formën e mashtrimit ose pandershmërisë dhe që ndikon në mënyrë të konsiderueshme në stabilitetin financiar të institucionit të tregut; ose
c) çdo parregullsi që ka ose mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në llogaritë e institucionit të tregut, përfshirë çdo parregullsi që ndikon ose mund të ndikojë negativisht në fondet ose pasuritë e investitorëve të instrumenteve financiare, audituesi duhet t'i dërgojë menjëherë këshillit të administrimit një

raport me shkrim për çështjen ose parregullsinë e zbuluar dhe i dorëzon një kopje të raportit Autoritetit.

2. Audituesi i institucionit të tregut nuk mban përgjegjësi për deklaratat e tij në raportin e hartuar në zbatim të pikës 1, me kusht që të ketë vepruar në mirëbesim.

3. Autoriteti mund t'i ngarkojë audituesit të institucionit të tregut të gjitha ose ndonjë nga detyrimet e mëposhtme:

a) detyrimin për të paraqitur informacione dhe raporte të tjera shtesë në lidhje me auditimin, siç e konsideron të nevojshme Autoriteti;

b) detyrimin për të zgjeruar ose ndryshuar objektin e auditimit të veprimtarisë tregtare të institucionit të tregut;

c) detyrimin për të kryer vlerësime të tjera ose për të përcaktuar një procedurë për një rast të veçantë, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi;

ç) detyrimin për të paraqitur një raport për çdo çështje që del nga auditimi, vlerësimi ose përcaktimi i procedurës së përmendur në shkronjën "b" ose "c" të kësaj pike.

Audituesi duhet t'i kryejë këto detyra krahas objektit të zakonshëm të auditimit për dhënien e një opinioni të pavarur për pasqyrat financiare.

4. Institucioni i tregut e shpërblen audituesin sipas planit të shpërblimit të publikuar nga Autoriteti në lidhje me përmbushjen e të gjitha ose të një prej detyrimeve të përmendura në pikën 3 të këtij neni. Në rrethana të caktuara, kur nevojitet hetim i mëtejshëm, shpërblimi duhet të paguhet nga fondet e Autoritetit.

Neni 135

Tarifa vjetore

Institucioni i tregut i paguan Autoritetit tarifën vjetore të përcaktuar me akt nënligjor.

SEKSIONI II

PROCEDURA E DHËNIES SË URDHRAVE TË PËRGJITHSHËM DHE MASAVE TË REVOKIMIT

Neni 136

Dhënia e urdhrave dhe revokimet

1. Përpara dhënies së urdhrit ose marrjes së një mase revokimi, Autoriteti:

a) njofton personin në fjalë, duke parashtruar arsyet për veprimin e propozuar dhe duke i dhënë personit në fjalë mundësinë të shprehet me shkrim; dhe

b) merr hapat që i konsideron të përshtatshëm për t'u njoftuar masën e marrë personave të tjerë të cilët, sipas mendimit të Autoritetit, ka të ngjarë të preken nga ajo.

2. Nëse Autoriteti e çmon thelbësore, ai mund të japë një urdhër:

a) pa ndjekur procedurën e mësipërme, kur Autoriteti argumenton me shkrim se masa mbështetet në nevojën për një veprim imediat në mbrojtje të aktiveve të investitorëve apo në mbrojtje të operacioneve të ndershme dhe të rregullta të tregjeve apo edhe për të parandaluar çrregullime të konsiderueshme të tregut, ose në nevojën për të siguruar stabilitetin e tregjeve financiare; ose

b) nëse Autoriteti ka filluar ta ndjekë procedurën, pavarësisht nëse ka përfunduar ose jo afati që personi të shprehet.

3. Nëse Autoriteti ka ndjekur procedurën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në lidhje me një çështje të veçantë, ai nuk e ndjek atë sërish nëse për të njëjtën çështje vendos të marrë masa të tjera nga ato që përcaktohen në njoftim.

Neni 137

Pasojat e heqjes së licencës ose njohjes

1. Heqja ose pezullimi i licencës ose i njohjes:

a) nuk e bën të pavlefshme dhe nuk ka pasoja për një kontratë, transaksion ose masë të lidhur apo të miratuar nga personi në fjalë përpara heqjes apo pezullimit; dhe

b) nuk cenon të drejtat a detyrimet e asnjë personi, që lindin nga kontrata, transaksioni a masa.

2. Në rast heqjeje ose pezullimi, Autoriteti nëpërmjet një njoftimi me shkrim:

a) mund t'i kërkojë personit në fjalë t'i kalojë pasuritë dhe regjistrat e klientëve një personi tjetër të përcaktuar në njoftim nga Autoriteti; ose

b) mund t'i lejojë personit në fjalë, në varësi të kushteve të përcaktuara në njoftim nga Autoriteti:

i. të kryejë veprimtaritë tregtare thelbësore për mbrojtjen e interesave të klientëve gjatë periudhës së pezullimit; ose

ii. në rast heqjeje, të kryejë veprimtari tregtare me qëllim mbylljen e aktivitetit tregtar.

Neni 138

Tërheqja e kërkesës për licencë ose njohje

1. Kërkesa për licencë ose njohje mund të tërhiqet përpara se të merret në shqyrtim nga Autoriteti.

2. Duke përjashtuar rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, licenca ose njohja e dhënë mund të hiqet nga Autoriteti me kërkesën ose me pëlqimin e personit të licencuar ose të njohur.

3. Autoriteti mund të refuzojë heqjen e çdo licence ose njohjeje nëse gjykon se është në interesin e përgjithshëm që Autoriteti të hetojë çdo çështje, e cila ka të bëjë me personin që kërkon heqjen përpara se të marrë një vendim për kërkesën.

4. Autoriteti mund të refuzojë heqjen e licencës ose njohjes kur gjykon se për personin që kërkon heqjen duhet të vendoset një ndalim ose kufizim në zbatim të këtij ligji ose duhet të vijojë të zbatohet një ndalim ose kufizim i vendosur për të më parë.

5. Autoriteti publikon në faqen zyrtare *web* të tij heqjen e çdo licence ose njohjeje të bërë në zbatim të pikës 2 të këtij neni.

Neni 139

Kompetenca e Autoritetit për t'u kërkuar informacion institucioneve të tregut

Autoriteti mund t'i kërkojë institucionit të licencuar ose të njohur të tregut t'i njoftojë Autoritetit ngjarje të lidhura me veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të Autoritetit, përfshirë, ndër të tjera, çdo ndryshim të rregulloreve ose sistemeve të institucionit të tregut.

Neni 140

Njohja e institucioneve të huaja të tregut

1. Çdo person juridik, i cili është licencuar si institucion tregu në një vend të huaj, mund të paraqesë kërkesë për njohje pranë Autoritetit.

2. Autoriteti mund të miratojë rregullore për mënyrën dhe formën e aplikimit për njohje.

3. Autoriteti mund të njohë operatorin e institucionit të huaj të tregut kur konstaton se institucioni i tregut zbaton kërkesa ekuivalente me kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

SEKSIONI III

BURSAT

Neni 141

Ndalimi i krijimit të bursës pa licencë

1. Asnjë person nuk mund të krijojë ose të operojë një bursë, të asistojë në krijimin ose operimin ose të pretendojë se ofron apo operon një bursë, nëse ky person nuk është i licencuar ose i njohur nga Autoriteti.

2. Me përjashtim të rastit kur Autoriteti jep miratimin me shkrim, asnjë person, që nuk është bursë e licencuar ose e njohur, nuk mund të marrë, të përdorë, të bashkëlidhë apo të ekspozojë në asnjë vend:

a) një titull apo një përshkrim në çfarëdolloj gjuhe, i cili tregon se personi është "bursë", "bursë kapitali" ose "bursë titujsh"; ose

b) një titull apo një përshkrim të ngjashëm me titullin apo përshkrimin e përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike, ose i cili nënkupton se personi është bursë e licencuar.

Neni 142
Bursa

1. Bursa themelohet si shoqëri aksionare në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të ligjit në fuqi “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Organet drejtuese të bursës janë asambleja e përgjithshme, këshilli mbikëqyrës/këshilli i administrimit dhe administratorët.

3. Kapitali themeltar i bursës përcaktohet me akt nënligjor.

4. Të gjitha aksionet e bursës duhet të jenë aksione të regjistruara.

5. Kapitali fillestar i bursës paguhet plotësisht në para. Aksionet që përbëjnë kapitalin themeltar nuk mund të emetohen përpara se të jetë paguar vlera e plotë e tyre.

6. Aksionet e bursës mund të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar vetëm me miratimin e Autoritetit dhe me kusht që të jenë përmbushur kërkesat përkatëse të listimit të parashikuara në kreun VI të këtij ligji.

Neni 143
Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës

1. Bursa administrohet nga të paktën një administrator, i cili emërohet drejtor i Përgjithshëm. Në varësi të llojit, të madhësisë dhe të aktivitetit të bursës, Autoriteti mund të kërkojë emërimin e më tepër se një administratori.

2. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës duhet të gëzojnë reputacion të mirë, të plotësojnë kualifikimet e përshtatshme profesionale dhe të kenë përvojën e nevojshme për të drejtuar dhe administruar një treg të rregulluar me kujdesin e duhur profesional.

3. Administratorët e bursës duhet të jenë punonjës me kohë të plotë.

4. Administratorët e bursës administrojnë operacionet e bursës duke qenë të pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës u nënshtrohen kërkesave të aftësisë dhe përshtatshmërisë sipas nenit 13 të këtij ligji.

6. Anëtarët e pavarur të këshillit të administrimit dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës të bursës nuk duhet të kenë lidhje tregtare, familjare apo lidhje të tjera me bursën, me aksionarin/aksionarët e shumicës së bursës apo me një grup të aksionarëve të shumicës së bursës apo me anëtarët e tjerë të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës.

7. Autoriteti miraton paraprakisht administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës.

Neni 144
Anëtari i pavarur i këshillit të administrimit dhe anëtari i këshillit mbikëqyrës

1. Anëtari i pavarur i këshillit të administrimit dhe anëtari i këshillit mbikëqyrës të bursës:

a) nuk është person i lidhur me bursën, nuk është aksionar i shumicës dhe nuk përfaqëson një aksionar të shumicës ose një grup aksionarësh të shumicës, nuk është bashkëshorti/bashkëshortja dhe nuk ka lidhje gjaku apo lidhje krushqie deri në shkallën e dytë me asnjë person të grupeve të lartpërmendura dhe nuk është person i lidhur me shoqëritë tregtare të lidhura me aksionarin e shumicës;

b) nuk ka qenë administrator i bursës dhe i asnjë prej shoqërive të kontrolluara të bursës apo të një shoqërie të lidhur me të, për të paktën pesë vjetët e fundit;

c) nuk merr ose nuk ka marrë një pagesë nga bursa, me përjashtim të honorarit për punën si anëtar i pavarur i këshillit të administrimit apo anëtar i këshillit mbikëqyrës, pa përfshirë dividendë. Honorarët do të përfshijnë edhe shpërblimet në varësi të performancës dhe shpërblime të tjera të lidhura me performancën, siç janë opsionet mbi aksione, por përjashtohen shpërblimet lidhur me të ardhurat nga skema e pensionit për një shërbim të mëparshëm për shoqërinë;

ç) nuk ka qenë, të paktën tri vjetët e fundit, ortak, aksionar ose punonjës i një shoqërie auditimi, e cila i ofron ose i ka ofruar shërbime auditimi bursës ose një shoqërie të lidhur me të;

d) nuk ka qenë administrator i një shoqërie tjetër në të cilën ndonjë prej anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës është anëtar i këshillit mbikëqyrës, dhe as nuk ka lidhje të konsiderueshme me administratorët e bursës nëpërmjet pjesëmarrjes në organizata, organizma apo shoqëri të tjera;

dh) nuk është bashkëshorti/bashkëshortja ose nuk ka lidhje të afërta gjaku apo krushqie me

ndonjë prej administratorëve ose me personat që kanë kryer ndonjë prej funksioneve të përmendura në pikat e mëparshme.

2. Nëse anëtari i pavarur i këshillit të administrimit ose anëtari i këshillit mbikëqyrës bëhet objekt i ndikimit të parregullt ose kufizimeve të ushtruara nga aksionari i shumicës, çka cenon kryerjen e detyrave të tij, anëtari i pavarur i këshillit të administrimit ose anëtari i këshillit mbikëqyrës është i detyruar të njoftojë përkatësisht këshillin e administrimit apo këshillin mbikëqyrës. Pavarësisht nga sa më sipër, anëtari i pavarur i këshillit të administrimit ose anëtari i këshillit mbikëqyrës mban qëndrim të pavarur gjatë ushtrimit të të drejtave të votës ose jep dorëheqjen, sipas rastit, në bazë të rrethanave.

3. Anëtari i pavarur i këshillit të administrimit ose anëtari i këshillit mbikëqyrës, i cili e kryen këtë funksion për më shumë se dy mandate, duhet të japë një deklaratë me shkrim ku konfirmon statusin e tij si i pavarur.

Neni 145

Revokimi i miratimit për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit, anëtarët e këshillit mbikëqyrës

1. Autoriteti revokon miratimin për emërimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit, anëtarit të këshillit mbikëqyrës të bursës në këto raste:

a) nëse administratori, anëtari i këshillit të administrimit, anëtari i këshillit mbikëqyrës nuk i përmbush më kushtet, në bazë të të cilave është dhënë miratimi;

b) nëse miratimi është dhënë në bazë të të dhënave të pasakta ose të rreme.

2. Nëse Autoriteti revokon miratimin e dhënë për emërimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit, anëtarit të këshillit mbikëqyrës, organi drejtues kompetent i bursës do të miratojë pa vonesë një vendim për revokimin e emërimit të tij.

3. Në rastin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, organi drejtues kompetent do të emërojë administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit apo anëtarin e këshillit mbikëqyrës, pa pëlqimin e Autoritetit, për një mandat maksimal prej tre muajsh.

4. Miratimi i emërimit të administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit, anëtarit të këshillit mbikëqyrës të bursës nuk është më i vlefshëm nëse:

a) personi në fjalë nuk është emëruar ose nuk e ka marrë detyrën për të cilën është dhënë miratimi brenda një viti pas dhënies së miratimit;

b) përfundon detyra për të cilën është dhënë miratimi, duke filluar nga data e përfundimit;

c) përfundon kontrata e punës me bursën, nga data e përfundimit të kontratës.

Neni 146

Zotëruesit e pjesëmarrjes influencuese në kapitalin e bursës

1. Parashikimet e neneve 45 dhe 46 të këtij ligji, të cilat zbatohen për shoqëritë komisionere, do të zbatohen përkatësisht edhe për zotëruesit e pjesëmarrjes influencuese në kapitalin e bursës dhe për çdo ndryshim pjesëmarrjeje influencuese në kapitalin e bursës, lidhjet e ngushta, pasojat ligjore të fitimit të pjesëmarrjes influencuese pa miratimin e Autoritetit dhe masat e marra nga Autoriteti në rastet kur vihet në dyshim administrimi me kujdesin e duhur profesional i tregut të rregulluar. Në këtë rast, sa herë në parashikimet e lartpërmendura përdoren fjalët “shoqëri komisionere”, do të konsiderohet se i referohet bursës.

2. Bursa i njofton Autoritetit të gjithë informacionin për strukturën e pronësisë dhe, në veçanti, për pronarët e pjesëmarrjeve influencuese, si dhe për identitetin e të gjithë personave që mund të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm për administrimin e tregut të rregulluar.

3. Bursa i njofton Autoritetit të gjithë informacionin për çdo ndryshim të strukturës së pronësisë, i cili mund të shkaktojë një ndryshim të identitetit të personave, që ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm mbi administrimin e tregut të rregulluar.

4. Bursa i publikon të dhënat e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Të dhënat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, konsiderohen të publikuara nëse bursa i bën publike të paktën në faqen e saj në internet.

Neni 147

Licencimi i veprimtarisë së bursës

1. Kërkesa për licencim të veprimtarisë së bursës i paraqitet Autoritetit sipas mënyrës dhe formatit që mund të përcaktohet nga Autoriteti. Subjekti, që kërkon dhënien e licencës, paguan një tarifë në momentin e paraqitjes së kërkesës, e cila do të përcaktohet nga Autoriteti. Kjo tarifë nuk kthehet edhe në rast të refuzimit të kërkesës nga Autoriteti.

2. Kërkesa për licencim si bursë shoqërohet me të gjitha informacionet e nevojshme, në bazë të të cilave Autoriteti mund të vlerësojë nëse subjekti kërkues ka marrë në momentin e licencimit të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

3. Autoriteti mund vendosë të japë licencën si bursë duke vendosur kushtet që i çmon të arsyeshme, me kusht që të jenë depozituar të gjitha informacionet e kërkuara.

4. Rregullorja e subjektit kërkues duhet të përmbajë përcaktime të përshtatshme për sa më poshtë:

a) për të siguruar që subjekti kërkues, për aq sa është e realizueshme në mënyrë të arsyeshme, do të operojë një treg të rregullt dhe të drejtë në lidhje me instrumentet që tregtohen nëpërmjet shërbimeve të tij;

b) për të siguruar që subjekti kërkues do të administrojë me kujdes çdo rrezik që lidhet me veprimtarinë dhe operacionet e tij;

c) për të siguruar që subjekti kërkues, në përmbushje të detyrimeve në bazë të shkronjës “a” të kësaj pike, nuk do të veprojë në kundërshtim me interesin publik dhe në veçanti me interesin e investitorëve;

ç) për të siguruar që subjekti kërkues do të mund të ndërmarrë veprimet e duhura ndaj anëtarëve pjesëmarrës, të cilët janë objekt i rregulloreve;

d) për të siguruar që rregulloret e miratuara nga subjekti kërkues do të jenë transparente dhe jodiskrecionale dhe do të përmbajnë përcaktime të mjaftueshme për:

i. pranimin e pjesëmarrësve në tregtim;

ii. rregullimin dhe mbikëqyrjen e duhur të anëtarëve;

iii. përjashtimin e anëtarëve që nuk përmbushin kriterin e aftësisë dhe përshtatshmërisë;

iv. përjashtimin, pezullimin ose disiplinimin e anëtarëve, përfshirë vendosjen e gjobave ndaj tyre;

v. rregullat e listimit në lidhje me kushtet me të cilat mund të listohen ose të ofrohen për tregtim klasat e titujve në tregun që propozon të zhvillojë subjekti kërkues;

vi. kushtet që rregullojnë tregtimin e titujve nga anëtarët;

vii. ndalimin e abuzimit të tregut, sjelljeve të parregullta ose tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar;

viii. pezullimin e tregtimit të çdo titulli të caktuar, në funksion të mbrojtjes së investitorëve, ruajtjes së një tregu të rregullt dhe të drejtë ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme;

ix. emërimin e një komiteti disiplinor;

x. lidhjen e kontratave midis subjektit kërkues dhe anëtarëve, sipas të cilave anëtarët bien dakord të zbatojnë rregullat e subjektit kërkues;

xi. në përgjithësi, kryerjen e veprimtarisë së bursës, duke i kushtuar rëndësinë e duhur mbrojtjes së investitorëve dhe interesit publik;

e) për të siguruar një metodë të shpejtë dhe të drejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

i. midis bursës dhe anëtarëve të saj; dhe

ii. midis anëtarëve;

ë) subjekti kërkues duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe të tjera për të garantuar:

i. një treg të rregullt dhe të drejtë në lidhje me titujt që tregtohen nëpërmjet shërbimeve të tij;

ii. mjedise të përshtatshme dhe të pajisura siç duhet për ushtrimin e veprimtarisë;

iii. një personel kompetent për ushtrimin e veprimtarisë;

iv. sisteme të automatizuara me kapacitet adekuat, masa sigurie dhe mundësi për t'u bërë ballë situatave të jashtëzakonshme; dhe

v. planet dhe mjetet e duhura për rikuperimin e situatës në rast katastrofe;

f) që dhënia e licencës do të jetë në interes të publikut ose të tregut.

5. Subjekti kërkues, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet t'i japë Autoritetit ato informacione që Autoriteti i konsideron të nevojshme për të marrë vendim për kërkesën.

6. Pa cenuar karakterin e përgjithshëm të kushteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni,

Autoriteti mund të ndryshojë, të revokojë ose të vendosë kushte dhe afate të reja nëse çmon se ato janë të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve ose për rregullimin e duhur të tregut.

7. Autoriteti miraton paraprakisht të gjitha rregulloret e bursës dhe çdo ndryshim të mëtejshëm të tyre.

8. Çdo bursë e licencuar në zbatim të këtij ligji është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhje me detyrimet fillestare të licencimit dhe me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 148

Refuzimi i licencës

Autoriteti refuzon dhënien e licencës:

a) nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë prej kërkesave të neneve 143—147 të këtij ligji dhe, në veçanti, nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e mirë dhe të kujdesshëm të bursës, Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e zotëruesve të pjesëmarrjeve influencuese të saj, organit të administrimit dhe funksionarëve kryesorë;

b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e këtij ligji; dhe

c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:

i. lidhjet e ngushta midis bursës dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër, që rregullojnë aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë, me të cilët bursa ka lidhje të ngushta;

iii. vështirësitë që lidhen me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 149

Kërkesa për veprimtari shtesë

1.Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, bursa ka të drejtë t'i kërkojë Autoritetit të lejohet të kryejë një veprimtari shtesë.

2.Kërkesa për të ushtruar veprimtari shtesë bëhet nga këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i bursës.

Neni 150

Anëtarët e bursës

1. Anëtarësimi në bursë është i hapur për subjektet e mëposhtme:

a) shoqëritë komisionere ose bankat me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të licencuara për të ofruar shërbime investimi dhe për të kryer veprimtari të rregulluara investimesh;

b) shoqëritë komisionere ose bankat e huaja, të cilat kanë licencë të përshtatshme, të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës dhe i njohur nga Autoriteti në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji, pas marrjes së konfirmimit nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës.

2. Në rregulloren e saj, bursa mund të parashikojë që anëtari i bursës të mund të bëhet edhe personi, i cili i përmbush kriteret e mëposhtme:

a) ka reputacion të mirë, njohuri të përshtatshme profesionale dhe kualifikimet e nevojshme profesionale për tregtim në një treg të rregulluar dhe ka organizimin e duhur, sipas rastit;

b) ka burime të mjaftueshme për veprimtarinë që do të kryhet, duke mbajtur parasysh marrëveshjet financiare të nënshkruara nga bursa me qëllim shlyerjen e transaksioneve.

3. Bursa i njofton Autoritetit listën e anëtarëve, e cila përditësohet rregullisht.

Neni 151

Mbikëqyrja e anëtarëve të bursës

Bursa miraton, zbaton dhe mban procedura efikase për monitorimin e rregullt të përputhshmërisë së anëtarëve dhe punonjësve të tyre me rregulloren e tregut të rregulluar, të administruar prej saj.

Neni 152

Detyrimet e bursës

1. Bursa garanton një treg të rregullt e të drejtë dhe merr masa efektive për të ndihmuar finalizimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kleruara dhe të shlyera në sistemet e tij.

2. Gjatë përmbushjes së kësaj detyre, bursa duhet:

a) të veprojë në interesin publik duke pasur parasysh mbrojtjen e investitorëve; dhe

b) të ketë burime të mjaftueshme operative, teknike, njerëzore dhe financiare për të mundësuar funksionimin e rregullt të saj, duke mbajtur parasysh natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve të ofruara, si dhe gamën e shkallën e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet.

3. Pavarësisht nga parashikimet e tjera ligjore, anëtari i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të bursës ka për detyrë të veprojë në çdo kohë në interesin publik, duke mbajtur parasysh veçanërisht nevojën për të mbrojtur investitorët. Kur ka konflikt midis kësaj detyre dhe detyrimit të anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës në zbatim të një ligji tjetër, epërsi ka detyrimi sipas këtij ligji.

4. Bursa ndërmerr veprimet e duhura sipas përcaktimeve të rregulloreve të saj për të siguruar mbikëqyrjen e anëtarëve dhe zbatimin e rregulloreve.

5. Bursa njofton menjëherë Autoritetin nëse merr dijeni për:

a) çdo çështje që cenon ose ka të ngjarë të cenojë aftësinë e ndonjë pjesëmarrësi në tregtim për të përmbushur detyrimet e tij për veprimtarinë e licencuar; ose

b) çdo parregullsi ose shkelje të ndonjë dispozite të këtij ligji ose të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

6. Pa cenuar pikën 5 të këtij neni, brenda tri ditëve pune nga tërheqja e vëmendjes, gjobitja, përjashtimi ose marrja e ndonjë mase disiplinore ndaj ndonjë prej pjesëmarrësve në tregtim, bursa i jep Autoritetit informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e biznesit të pjesëmarrësit në tregtim;

b) arsyen dhe natyrën e masës së marrë;

c) periudhën e pezullimit dhe vlerën e çdo g^{jobe};

ç) çdo veprim tjetër disiplinues.

Neni 153

Procedurat mbikëqyrëse të bursës

1. Bursa mbikëqyr transaksionet e kryera nga anëtarët në tregun e rregulluar, të cilin e administron për të identifikuar shkeljet e rregullores, kushtet jo të rregullta të tregtimit ose sjelljet që përbëjnë abuzim të tregut. Mbikëqyrja e tregtimit mbështetet në një sistem të përshtatshëm monitorimi kompjuterik, që mundëson mbledhjen dhe vlerësimin sistematik e të plotë të të dhënave në lidhje me tregtimin, për të ndihmuar procedurat e nevojshme të hetimit.

2. Bursa njofton Autoritetin menjëherë në rast se merr dijeni për shkelje të rregullores, kushte të parregullta të tregtimit ose sjellje që përbëjnë abuzim të tregut.

3. Në rastet e abuzimit të tregut, bursa ia dorëzon menjëherë të gjitha të dhënat Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe autoritetit kompetent për ndjekjen penale, si dhe bashkëpunon me ta gjatë procesit të mbikëqyrjes dhe hetimit.

Neni 154

Raportimi i bursës në Autoritet

1. Bursa njofton pa vonesë Autoritetin për çdo ndryshim të identitetit të anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës dhe për çdo ndryshim të të dhënave të përfshira në kërkesën për licencim.

2. Bursa, si shoqëri aksionare, harton pasqyrat financiare vjetore dhe raportin vjetor të menaxhimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kontabilitetin e shoqërive tregtare, si edhe në përputhje me standardet e raportimit financiar, dhe ia dorëzon ato Autoritetit së bashku me raportin e auditimit brenda 15 ditëve nga data e miratimit të raportit të auditimit, por jo më vonë se 4 muaj nga data e mbylljes së vitit ushtrimor.

3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore përmbajtjen dhe strukturën e pasqyrave financiare vjetore të bursës dhe formën e mënyrën e raportimit në Autoritet, përfshirë çdo informacion shtesë, përtej

informacionit që kërkohet normalisht për raportet vjetore financiare të shoqërive aksionare.

4. Bursa i dorëzon Autoritetit një raport ditor, i cili përmban të dhëna për transaksionet me tituj të kryera në tregun e rregulluar, të administruar nga bursa, dhe/ose i mundëson akses në sistemin e tregtimit në kohë reale, sipas gjykimit të Autoritetit.

5. Bursa raporton menjëherë çdo rast të tregtimit bazuar në informacion të privilegjuar manipulimi të tregut ose pastrimi të parave, që zbulohet gjatë kryerjes së detyrave të saj mbikëqyrëse.

6. Këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i bursës i raporton çdo muaj Autoritetit për blerjen apo shitjen e titujve të zotëruar nga anëtarët e këshillit të administrimit, anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe funksionarët kryesorë të bursës.

7. Detyrimi i përcaktuar në pikën 6 të këtij neni zbatohet edhe për blerjen dhe shitjen e titujve nga bashkëshorti/bashkëshortja, fëmija biologjik ose i birësuar, prindi biologjik ose birësues dhe persona të tjerë, që banojnë me një anëtar të këshillit të administrimit, anëtar të këshillit mbikëqyrës ose punonjës të bursës, blerjen dhe shitjen e titujve nga personat juridikë, ku këta persona zotërojnë pjesëmarrje të shumicës dhe për blerjen dhe shitjen e titujve nga personat tek të cilët bursa ka nënkontraktuar shërbime.

8. Autoriteti përcakton me rregullore kërkesat për formën, përmbajtjen, afatet dhe mënyrën me të cilën duhet të dorëzohen raportet e përmendura në pikat 4, 5 dhe 6 të këtij neni.

9. Bursa, e cila administron një platformë shumëpalëshe tregtimi, njofton autoritetin e shtetit të huaj në të cilin synon të ofrojë shërbimet e platformës shumëpalëshe të tregtimit.

10. Autoriteti u përcjell autoriteteve kompetente përkatëse të shtetit të huaj informacionin e përmendur në pikën 9 të këtij neni brenda 30 ditëve nga marrja e tij.

Neni 155

Heqja e licencës së bursës

1. Autoriteti, me njoftim me shkrim:

a) mund të heqë licencën që i është dhënë bursës në zbatim të këtij ligji; ose

b) mund të urdhërojë bursën të pushojë ofrimin e një shërbimi të caktuar ose operimin e një platforme të caktuar në datën e përcaktuar në njoftim.

2. Autoriteti mund të mos heqë licencën ose mund të mos e japë urdhrin, përveçse kur e çmon se është në interes të mbrojtjes së investitorëve ose rregullimit të duhur të tregut, në rastet e mëposhtme:

a) bursa pushon së ushtruari aktivitet;

b) bursa është në procedurë likuidimi në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;

c) bursa ka shkelur ndonjë afat ose kusht të licencës së saj ose parashikimet e këtij ligji;

ç) bursa nuk zbaton një urdhër të dhënë në zbatim të këtij ligji;

d) bursa i jep Autoritetit informacione të rreme ose keqinformuese;

dh) bursa nuk ka shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet që i janë ngarkuar me vendim gjykate;

e) në lidhje me ndonjë pasuri të bursës, është emëruar një administrator falimentimi ose një likuidues në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;

ë) bursa ka lidhur një marrëveshje kompromisi me kreditorët e saj në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj; ose

f) bursa, me nismën e saj, i ka kërkuar Autoritetit heqjen e licencës dhe Autoriteti e ka miratuar këtë kërkesë.

3. Në kuptim të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, kur bursa ka pushuar aktivitetin në treg për një periudhë prej 28 ditësh pune, ajo konsiderohet se ka pushuar së operuari tregun e saj, me përjashtim të rastit kur pushimi është miratuar paraprakisht nga Autoriteti.

4. Pavarësisht nga heqja e licencës ose nga urdhri i dhënë, Autoriteti mund t'i lejojë bursës të vijojë edhe në datën e hyrjes në fuqi të heqjes ose urdhrit apo pas kësaj date ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara nga Autoriteti në funksion të:

a) mbylljes së bursës; ose

b) mbrojtjes së interesit të investitorëve ose interesit publik.

5. Kur Autoriteti vepron në zbatim të pikës 1 të këtij neni, ai mund të emërojë, nëse e gjykon të nevojshme, një këshill të përkohshëm administrimi për një periudhë deri në gjashtë muaj për të administruar aktivitetin e bursës deri në emërimin e një këshilli të ri.

6. Kur Autoriteti ka autorizuar bursën të kryejë veprimtari të caktuara në zbatim të pikës 4 të këtij neni, bursa nuk mund të konsiderohet se, duke kryer këto veprimtari, ka vepruar në shkelje të pikës 1 të këtij neni.

7. Autoriteti nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim në bazë të pikës 1 të këtij neni, pa i dhënë mundësi bursës të shprehet me shkrim.

8. Bursa, e cila ka pësuar një dëm nga një vendim i Autoritetit, mund të ankohet në gjykatë.

9. Autoriteti publikon çdo heqje licence ose çdo urdhër të lëshuar në zbatim të këtij neni.

Neni 156

Pasojat e heqjes së licencës

Asnjë heqje licence apo urdhër i lëshuar nga Autoriteti nuk mund:

a) të shfuqizojë ose të cenojë një kontratë, transaksion ose marrëveshje të lidhur në tregun e operuar nga bursa;

b) të cenojë të drejtat ose detyrimet, që lindin nga një kontratë apo transaksion i tillë.

Neni 157

Mbyllja e bursës në situata të jashtëzakonshme

1. Autoriteti, pas konsultimit të drejtpërdrejtë me bursën, mund t'i japë urdhër me shkrim bursës të mbyllë tregun e saj për një periudhë jo më të gjatë se 5 ditë pune, nëse Autoriteti gjykon se është e pamundur të sigurohet një treg i rregullt dhe i drejtë për tregtim për shkak se:

a) ka ndodhur një situatë e jashtëzakonshme ose fatkeqësi natyrore në territorin e Republikës së Shqipërisë; ose

b) ekziston një krizë ekonomike ose financiare ose rrethana të tjera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

2. Autoriteti mund të zgjasë periudhën e mbylljes së tregut sipas pikës 1 të këtij neni me periudha të tjera kohore, por asnjë prej këtyre periudhave shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se 5 ditë pune.

3. Autoriteti duhet të përcaktojë arsyet për mbylljen e bursës dhe për çdo zgjatje të mëtejshme të afatit të mbylljes.

4. Kur ushtron kompetencat në zbatim të këtij neni, Autoriteti duhet të njoftojë menjëherë Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar, duke dhënë edhe arsyet për masat e marra.

SEKSIONI IV

PLATFORMA SHUMËPALËSHE E TREGTIMIT (PSHT)

Neni 158

Autorizimi dhe funksionimi i platformave shumëpalëshe të tregtimit

1. Platformat shumëpalëshe të tregtimit mund të operohen nga një shoqëri komisionere ose një bursë (e quajtur më tej: operatori i PSHT-së) me autorizim të dhënë nga Autoriteti.

2. Bursa e licencuar nga Autoriteti për të administruar dhe operuar veprimtarinë e tregut të rregulluar mund të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi nëse përmbush kërkesat e këtij ligji.

Neni 159

Dhënia e licencës për të operuar platformën shumëpalëshe të tregtimit

1. Shoqëria komisionere ose bursa, që synon të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi, i drejtohet Autoritetit me një kërkesë për licencë, së cilës i bashkëlidh informacione për:

a) sistemin e tregtimit;

b) aksesueshmërinë e të dhënave në lidhje me oferta, kërkesat dhe të dhënat e tregtimit, të destinuara për përdoruesit dhe publikun;

c) përdoruesit e mundshëm të sistemit;

ç) instrumentet financiare që mund të tregtohen brenda sistemit;

d) mekanizmat dhe metodat e shlyerjes së transaksioneve;

dh) masat që do të sigurojnë përputh- shmërinë me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji;

2. Shoqëria komisionere ose bursa, që synon të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi, i bashkëlidh kërkesës së përmendur në pikën 1 të këtij neni rregulloren e platformës shumëpalëshe të tregtimit.

3. Shoqëria komisionere ose bursa, që synon të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi, i vërteton Autoritetit se:

a) ka marrë masat e duhura për të administruar rreziqet ndaj të cilave ekspozohet, për të zbatuar masat dhe sistemet e duhura për identifikimin e të gjitha rreziqeve të rëndësishme të aktivitetit dhe për të zbutur rreziqet e mundshme;

b) ka marrë masat e duhura për të mundësuar finalizimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kryera në sistemet e saj; dhe

c) zotëron në momentin e licencimit dhe do të ruajë në vijimësi burime të mjaftueshme financiare për të mundësuar funksionimin e rregullt të saj, duke mbajtur parasysh natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve të ofruara, si dhe gamën e shkallën e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet.

4. Operatori i PSHT-së njofton pa vonesë Autoritetin për çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara në zbatim të pikës 1 të këtij neni.

5. Autoriteti mund të parashikojë me rregullore kërkesat dhe procedurat për dhënien e licencave për të operuar një platformë shumëpalëshe tregtimi, përmbajtjen e kërkesës për licencë, dokumentet shoqëruese të kërkuara dhe përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

Neni 160

Refuzimi i licencës

Autoriteti nuk miraton kërkesën për licencë si platformë shumëpalëshe tregtimi nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë prej kushteve të përcaktuara në nenin 159 të këtij ligji,

Neni 161

Rregullorja e platformës shumëpalëshe të tregtimit

1. Operatori i PSHT-së miraton, zbaton dhe mban rregulla e procedura transparente për:

a) të drejtën e aksesit në platformën që operon;

b) kriteret për përcaktimin e instrumenteve financiare që mund të tregtohen në sistemet e saj;

c) tregtimin;

ç) shlyerjen e transaksioneve.

2. Rregullat dhe procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni u japin mundësi përdoruesve të përdorin sistemin në mënyrë efikase dhe të kuptojnë rreziqet e lidhura me përdorimin e platformës.

3. Autoriteti mund të parashikojë me rregullore kërkesat për përmbajtjen e rregulloreve të platformës shumëpalëshe të tregtimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 162

E drejta e aksesit në platformën shumëpalëshe të tregimit

1. Operatori i PSHT-së miraton dhe zbaton rregulla transparente për të drejtën e aksesit në platformat e tij.

2. Operatori i PSHT-së garanton që e drejta e aksesit në platformat e tij bazohet në kritere objektive.

3. Operatori i PSHT-së mund të lejojë si përdorues të platformave të tij personat që janë anëtarë të bursës. Dispozitat e këtij ligji për anëtarët e tregut zbatohen edhe për përdoruesit e platformës shumëpalëshe të tregtimit.

Neni 163

Instrumentet financiare të tregtuara në platformën shumëpalëshe të tregtimit

1. Operatori i PSHT-së publikon informacione të mjaftueshme për instrumentet financiare të tregtuara në sistemin e tij, për t'u dhënë mundësi përdoruesve të saj të marrin vendime investimi.

2. Operatori i PSHT-së jep informacion për instrumentet financiare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në momentin kur instrumentet financiare pranohen për tregtim, si edhe gjatë tregtimit të tyre.

3. Gjatë zbatimit të kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, operatori i PSHT-së mban parasysh natyrën dhe llojet e instrumenteve të tregtuara në sistemin e tij.

4. Operatori i PSHT-së zbaton menjëherë çdo vendim të Autoritetit për të pezulluar ose përjashtuar

një instrument financiar nga tregtimi.

Neni 164

Dhënia e informacioneve platformës shumëpalëshe të tregtimit nga emetuesit

Kur një titull i transferueshëm, i cili është pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, tregtohet edhe në një platformë shumëpalëshe tregtimi pa pëlqimin e emetuesit, emetuesi nuk ka asnjë detyrim për dhënien e informacioneve në lidhje me platformën shumëpalëshe të tregtimit në fjalë.

Neni 165

Procesi i tregtimit dhe finalizimi i transaksioneve në platformën shumëpalëshe të tregtimit

Operatori i PSHT-së siguron tregtim dhe caktim çmimesh të drejtë e të rregullt, përfshirë çmimet e referencës, si dhe ekzekutim efikas të urdhrave. Rregullat e tregtimit dhe të përcaktimit të çmimeve nuk i lejojnë operatorit të PSHT-së të bëjë vlerësime diskrecionale.

Neni 166

Shlyerja e transaksioneve

1. Operatori i PSHT-së miraton masat e nevojshme për të mundësuar shlyerjen efikase të transaksioneve të kryera në sistemet e platformës shumëpalëshe të tregtimit.

2. Operatori i PSHT-së njofton në mënyrë të qartë përdoruesit për përgjegjësitë e tyre për shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në këtë platformë.

Neni 167

Monitorimi i përputhshmërisë me rregulloren e platformës shumëpalëshe të tregtimit

1. Përdoruesit e platformës shumëpalëshe të tregtimit duhet të zbatojnë parashikimet e këtij ligji, të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji dhe rregulloren e platformës shumëpalëshe të tregtimit.

2. Operatori i PSHT-së miraton dhe zbaton masa dhe procedura efektive për monitorimin e rregullt të transaksioneve të kryera nga përdoruesit e platformës, me qëllim identifikimin e shkeljeve të mundshme të rregullave, kushteve të parregullta të tregtimit ose sjelljeve që përbëjnë abuzim të tregut.

3. Operatori i PSHT-së miraton masa dhe procedura efektive për monitorimin e rregullt të përputhshmërisë së përdoruesve me parashikimet e këtij ligji, me aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji dhe me rregulloren e platformës shumëpalëshe të tregtimit.

4. Operatori i PSHT-së njofton pa vonesë Autoritetin kur konstaton ekzistencën e ndonjërës prej situatave të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

5. Kur konstaton ekzistencën e ndonjërës prej situatave të përmendura në pikën 2 të këtij neni, operatori i PSHT-së mund të përjashtojë përdoruesin në fjalë nga sistemi për një afat të caktuar ose pa afat.

6. Operatori i PSHT-së, me kërkesë të Autoritetit dhe pa vonesë, i jep Autoritetit çdo informacion që është me rëndësi për mbikëqyrjen e rasteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

7. Operatori i PSHT-së i jep Autoritetit asistencë të plotë në mbikëqyrjen e rasteve të abuzimit të tregut që ndodhin brenda sistemit të tij.

Neni 168

Transparenca përpara tregtimit

Operatori i PSHT-së publikon çmimet e kuotuara të shitjes e blerjes dhe nivelin e interesave të tregtimit në lidhje me aksionet e pranuara për tregtim në një treg të rregulluar, të cilat tregtohen brenda një sistemi të operuar prej tij. Ky publikim kryhet sipas kushteve tregtare të arsyeshme dhe në vazhdimësi gjatë orarit normal të tregtimit.

Neni 169

Përjashtimi nga detyrimi për informim

1. Autoriteti mund të përjashtojë operatorin e PSHT -së ose një operator tjetër të një tregu të rregulluar nga detyrimi për të bërë publik informacionin e përmendur në nenin 168 të këtij ligji nëse ndodhet

brenda shpërndarjes së ponderuar sipas vëllimit, siç pasqyrohet në librin e urdhrave ose në kuotimet e krijuesve të tregut për këtë aksion, ose kur aksioni nuk tregtohet vazhdimisht, brenda një përqindjeje të një çmimi të përshtatshëm reference të përcaktuar paraprakisht nga operatori i tregut të rregulluar ose i platformës shumëpalëshe të tregtimit ose u nënshtrohet kushteve të ndryshme nga çmimi aktual i tregut të aksioneve (për shembull, transaksion me çmim mesatar të ponderuar me vëllimin).

2. Urdhri konsiderohet se është i madh në krahasim me madhësinë normale të tregut nëse është i barabartë ose më i madh se madhësia minimale e urdhrit të përcaktuar nga Autoriteti me rregullore.

Neni 170

Transparenca pas tregtimit

1. Operatori i PSHT-së ose operatori i tregjeve të tjera të rregulluara publikon çmimin, vëllimin dhe orën e transaksioneve të kryera në sistemin e tij me tituj të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, sa më afër kohës reale.

2. Operatori i PSHT-së publikon të dhënat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, mbi baza të arsyeshme tregtare.

Neni 171

Leja për të shtyrë raportimin e transaksioneve të caktuara

1. Me kërkesë të operatorit të PSHT-së ose operatorit të tregjeve të tjera të rregulluara, Autoriteti mund të lejojë publikimin e mëvonshëm të informacionit për çmimet pas tregtimit, bazuar në llojin ose madhësinë e transaksioneve.

2. Publikimi i mëvonshëm mund të lejohet në lidhje me transaksionet që janë të mëdha krahasuar me madhësinë normale të tregut për klasat individuale të aksioneve.

3. Operatori i PSHT-së u bën të ditura në mënyrë të qartë pjesëmarrësve të tregut dhe publikut masat e marra për publikimin e shtyrë në kohë.

Neni 172

Rregullat për dhënien e informacionit nga platforma shumëpalëshe e tregtimit ose operatorët e tregjeve të tjera të rregulluara

Autoriteti mund të miratojë me rregullore parashikime më të hollësishme për:

a) spektrin e kërkesës dhe ofertës ose kuotimet e krijuesve të tregut dhe nivelin e interesit të tregtimit me këto çmime, që duhet të bëhen publike;

b) madhësinë dhe llojin e urdhrave, të cilët mund të përjashtohen nga detyrimi për transparencë përpara tregtimit, sipas parashikimeve të nenit 169 të këtij ligji;

c) modelin e tregut, i cili mund të përjashtohet nga detyrimi për transparencë përpara tregtimit dhe, në veçanti, për zbatueshmërinë e detyrimit për metodat e tregtimit;

ç) të dhënat për tregtimin, të cilat operatori i PSHT-së ose operatorët e tregjeve të tjera të rregulluara janë të detyruar të bëjnë publike;

d) përmbajtjen e të dhënave të përmendura në shkronjën "ç";

dh) kushtet në të cilat operatorët e PSHT-ve ose operatorët e tregjeve të tjera të rregulluara mund të parashikojnë shtyrjen në kohë të publikimit të të dhënave;

e) kriteret që duhet të respektojë operatori i PSHT-së ose operatori i tregjeve të tjera të rregulluara për të vendosur se cilat transaksione janë të përshtatshme për publikim të shtyrë në kohë, bazuar në madhësinë e transaksioneve ose llojin e aksioneve të tregtuara.

SEKSIONI V
INTERNALIZUESIT SISTEMATIKË

Neni 173

Kriteret për të përcaktuar nëse shoqëria komisionere është internalizues sistematik

Shoqëria komisionere, që vepron për llogari të vet duke ekzekutuar urdhrat e klientëve në instrumente financiare jashtë një tregu të rregulluar ose një platforme shumëpalëshe tregtimi, trajtohet si

internalizues sistematik në kuptim të këtij ligji.

Neni 174
Detyrimi për të njoftuar Autoritetin

1. Shoqëria komisionere njofton paraprakisht Autoritetin lidhur me synimin e saj për të marrë statusin e internalizuesit sistematik.

2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të përfshijë:

a) një përshkrim të organizimit të njësisë organizative të shoqërisë, e cila do të jetë përgjegjëse për internalizimin sistematik;

b) një përshkrim të rregullave dhe procedurave që do të ndiqen gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie;

c) një listë të personelit dhe/ose cilësive të sistemit teknik të caktuar për ushtrimin e këtij funksioni;

ç) një përshkrim të sistemit që do të përdoret për publikimin e angazhimeve të detyrueshme për blerje dhe shitje;

d) një listë të instrumenteve financiare për të cilat shoqëria komisionere synon të veprojë si internalizues sistematik.

Neni 175
Detyrimet e internalizuesit sistematik

1. Internalizuesi sistematik i instrumenteve financiare bën kuotime të panegociueshme në lidhje me instrumentet financiare të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar për të cilat vepron si internalizues sistematik dhe për të cilat ekziston një treg likuid.

2. Internalizuesi sistematik i instrumenteve financiare publikon kuotimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rastin e instrumenteve financiare, për të cilat nuk ekziston një treg likuid, internalizuesi sistematik u njofton kuotimet klientëve, me kërkesë të këtyre të fundit.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për internalizuesit sistematikë kur këta tregtojnë me volume deri në volumin standard të tregut. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për internalizuesit sistematikë që tregtojnë vetëm me volume më të mëdha se volumi standard i tregut.

5. I njëjti person juridik nuk mund të ushtrojë njëkohësisht aktivitetin e platformës së organizuar të tregtimit dhe të internalizimit sistematik. Platforma e organizuar e tregtimit nuk duhet të lidhet me një internalizues sistematik në mënyrë të tillë që të mundësojë ndërveprimin e urdhrave të platformës së organizuar dhe urdhrave të internalizuesit sistematik.

Neni 176
Volumet e kuotimeve

1. Internalizuesi sistematik mund të përcaktojë volumin ose volumet me të cilat do të kuotojë. Për një instrument financiar të veçantë, secili kuotim duhet të përfshijë një çmim të panegociueshëm kërkese dhe/ose oferte ose çmime për madhësi, të cilat mund të jenë deri në volumin standard të tregut për klasën e aksioneve së cilës i përket instrumenti financiar. Çmimi ose çmimet pasqyrojnë edhe kushtet mbizotëruese të tregut për atë instrument financiar.

2. Instrumentet financiare grupohen në klasa në bazë të vlerës mesatare aritmetike të urdhrave të ekzekutuar në treg për atë instrument financiar. Volumi standard i tregut për secilin instrument financiar është volumi që përfaqëson vlerën mesatare aritmetike të urdhrave të ekzekutuara në treg për instrumentet financiare të përfshira në secilën klasë të instrumentit financiar.

3. Volumi caktohet në një nivel të përshtatshëm për të siguruar që tregtohet një volum i tillë, që të ndikohet në mënyrë thelbësore në caktimin e çmimeve, duke përjashtuar në të njëjtën kohë tregtimin e një volumi aq të vogël sa që nuk do të justifikonte detyrimin për të përmbushur kërkesat e zbatueshme për internalizuesit sistematikë.

4. Në lidhje me kriteret konkrete, shpeshtësia dhe rregullsia vlerësohen për numrin e tregtimeve me instrumente financiare të kryera nga shoqëria komisionere për llogari të vet, gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve.

5. Autoriteti ka kompetencën:

a) të përcaktojë për secilin instrument financiar, të paktën një herë në vit, në bazë të vlerës mesatare aritmetike të urdhrave të ekzekutuar në treg për atë instrument financiar, klasën e instrumenteve financiare të cilës i përket;

b) të krijojë dhe të publikojë një listë të të gjitha instrumenteve financiare likuide për të cilat është autoriteti kompetent.

Neni 177

Publikimi i kuotimeve

1. Internalizuesi sistematik bën publike kuotimet e veta në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë orarit normal të tregtimit.

2. Internalizuesi sistematik ka të drejtë të përditësojë në çdo kohë kuotimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Internalizuesi sistematik ka, gjithashtu, të drejtë që, në kushte të jashtëzakonshme të tregut, të tërheqë kuotimet e tij.

4. Internalizuesi sistematik publikon kuotimet në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut mbi baza të arsyeshme tregtare.

Neni 178

Ekzekutimi i urdhrave nga internalizuesit sistematikë për klientët joprofesionistë dhe profesionistë dhe për palët e lejuara

1. Në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të klientëve joprofesionistë, internalizuesi sistematik, në përputhje me parashikimet e këtij ligji për ekzekutimin e urdhrave me kushtet më të favorshme për klientin, i ekzekuton urdhrat që merr nga klientët joprofesionistë në lidhje me instrumentet financiare për të cilat është internalizues sistematik me çmimet e kuotuara në momentin e marrjes së urdhrit.

2. Në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të klientëve profesionistë:

a) internalizuesi sistematik i ekzekuton urdhrat që merr nga klientët profesionistë për instrumentet financiare, për të cilat është internalizues sistematik, me çmimin e kuotuar në momentin e marrjes së urdhrit;

b) Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, internalizuesit sistematik mund të mos i kërkohet të ekzekutojë urdhrat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, me një çmim më të mirë në raste të justifikuara;

c) Internalizuesi sistematik mund të ekzekutojë urdhrat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, me çmime të ndryshme nga çmimi i kuotuar pa pasur detyrimin të zbatojë parashikimet e pikës 2 të këtij neni për transaksionet, ku ekzekutimi i disa titujve të ndryshëm është pjesë e të njëjtit transaksion ose për urdhrat që janë objekt i kushteve të tjera nga ai i çmimit aktual të tregut.

Neni 179

Përmbushja e pjesshme e urdhrave

1. Kur internalizuesi sistematik, i cili bën vetëm një kuotim ose kuotimi më i lartë i të cilit është më i ulët se madhësia standarde e tregut, merr një urdhër klienti me madhësi më të madhe se madhësia e kuotimit, por më të vogël se madhësia standarde e tregut, ai mund të vendosë të ekzekutojë edhe atë pjesë të urdhrit që tejkalon madhësinë e kuotimit, me kusht që të ekzekutohet në madhësinë e kuotuar.

2. Kur internalizuesi sistematik kuoton me madhësi të ndryshme dhe merr një urdhër midis këtyre madhësive, të cilin vendos ta ekzekutojë, ai e ekzekuton atë në njërën nga madhësitë e kuotuara.

Neni 180

Aksesi i investitorëve në kuotimet e intemalizuesit sistematik

1. Internalizuesit sistematik i lejohet të vendosë, në bazë të politikës së tij tregtare dhe në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese, se cilëve investitorë do t'u japë mundësi aksesi në kuotimet e tij. Për këtë qëllim ai duhet të ketë standarde të qarta për të rregulluar të drejtën e aksesit në kuotime.

2. Internalizuesi sistematik mund të refuzojë të lidhë ose mund të ndërpresë marrëdhënie tregtare me investitorë në bazë të konsideratave tregtare, siç është statusi i kredisë së investitorit, rreziku i kundërpalës dhe shlyerja përfundimtare e transaksionit.

3. Për të kufizuar rrezikun e ekspozimit ndaj transaksioneve të shumëfishta me të njëjtin klient, internalizuesi sistematik mund të kufizojë në mënyrë jodiskriminuese numrin e transaksioneve nga i njëjti klient, të cilat merr përsipër t'i kryejë me kushtet e publikuara.

4. Internalizuesi sistematik mund gjithashtu të kufizojë në një mënyrë jodiskriminuese numrin total të transaksioneve të kryera me klientë të ndryshëm në të njëjtën kohë, me kusht që kjo të mund të kryhet vetëm në rastet kur numri dhe/ose vëllimi i urdhrave të bëra nga klientët e tejkalon në mënyrë të konsiderueshme normën.

Neni 181

Pushimi i veprimtarisë si internalizues sistematik

1. Shoqëria komisionere pushon së vepruari si internalizues sistematik për një ose më shumë instrumente financiare sipas mënyrës së miratuar me rregullore nga Autoriteti.

2. Shoqëria komisionere, që pushon së vepruari si internalizues sistematik për një ose më shumë instrumente financiare, njofton përdoruesit dhe Autoritetin.

3. Autoriteti mund të miratojë me rregullore parashikime të mëtejshme për pushimin e veprimtarisë së internalizuesit sistematik.

Neni 182

Lista e internalizuesve sistematikë

1. Autoriteti publikon listën e internalizuesve sistematikë në lidhje me instrumentet financiare të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti e publikon listën e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe e përditëson vazhdimisht në faqen e Autoritetit në internet.

Neni 183

Mbikëqyrja e internalizuesve sistematikë

Autoriteti monitoron në mënyrë të rregullt nëse:

a) internalizuesit sistematikë përditësojnë rregullisht çmimet e kërkesës dhe/ose ofertës, sipas mënyrës së parashikuar;

b) internalizuesit sistematikë ruajnë çmime që pasqyrojnë kushtet mbizotëruese të tregut;

c) internalizuesit sistematikë janë në përputhje me dispozitat e tjera të këtij ligji për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së internalizuesve sistematikë.

SEKSIONI VI

TREGTIMI I TITUJVE TË PALISTUAR E TË PAPRANUAR PËR TREGTIM

Neni 184

Objekti dhe qëllimi

Parashikimet e këtij seksioni të ligjit kanë për qëllim:

a) të ofrojnë një platformë për shitblerjen transparente të titujve jo të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë për investitorët vendas dhe të huaj nëpërmjet një operatori të njohur të tregut; dhe

b) të përcaktojnë informacionet që u jepen investitorëve vendas dhe të huaj, në mënyrë transparente, në lidhje me titujt jo të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar.

Një treg i tillë mundet ose jo të funksionojë si pjesë e një platforme shumëpalëshe tregtimi ose një tregu tjetër të rregulluar.

Neni 185

Themelimi i operatorit të njohur të tregut

1. Asnjë person nuk mund të veprojë si operator i njohur i tregut, sipas kësaj pjese, nëse nuk është i regjistruar pranë Autoritetit dhe nuk është në gjendje të krijojë interes për tregtime që kryhen në mënyrë transparente jashtë bursës.

2. Kushtet e tregtimit dhe lloji i investitorëve të lejuar për të tregtuar në platformën e një operatori të tillë të njohur të tregut dhe niveli i informacionit që duhet të japin palët e një transaksioni me tituj jo të listuar përcaktohen nga Autoriteti me rregullore.

Neni 186
Operatori i njohur i tregut

Në kuptim të nenit 185 të këtij ligji, Autoriteti mund ta regjistrojë personin juridik si operator i njohur i tregut, me kërkesë të personit juridik, sipas kushteve që miratohen nga Autoriteti.

Neni 187
Kërkesa për regjistrim

1. Kërkesa për t'u regjistruar si operator i njohur i tregut duhet të shoqërohet me dokumentet dhe informacionet, që mund të përcaktohen me rregullore nga Autoriteti dhe të bëhet sipas mënyrës së përcaktuar nga Autoriteti.

2. Kërkesa për regjistrim, e bërë nga çdo person në zbatim të këtij neni, duhet të vërtetojë se subjekti kërkues:

a) është i aftë dhe i përshtatshëm sipas nenit 13 të këtij ligji dhe rregullave të përcaktuara nga Autoriteti;

b) ka burime të mjaftueshme financiare, operative, teknike dhe njerëzore;

c) ka përvojë në tregtime të ekzekutuara në një platformë;

ç) ka burime dhe sisteme adekuate për të mbikëqyrur tregtimin dhe operacionet e tregut;

d) ka marrë masat e nevojshme për klerimin dhe shlyerjen e tregtimeve të ekzekutuara në platformë;

dh) i jep publikut në kohën e duhur informacione për çmimet e kuotuara, vëllimin dhe çmimet e ekzekutuara në përputhshmëri me kërkesat e Autoritetit.

Neni 188
Funksionet dhe detyrat e operatorit të njohur të tregut

Funksionet dhe detyrat e operatorit të njohur të tregut janë:

a) të sigurojë një platformë për shitblerjen e titujve, të cilët nuk pranohen për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë;

b) t’i japë informacione për titujt jo të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë bashkësisë financiare vendase dhe të huaj;

c) të parashikojë kriteret për pranimin dhe standardet rregullatore për anëtarët e tij të tregtimit;

ç) të zbatojë çdo urdhër që i jep Autoriteti; dhe

d) t’i japë Autoritetit ose personit që vepron në emër të Autoritetit asistencën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti ose nga personi.

Neni 189
Tregtimi në platformë

Çdo person që blen dhe shet instrumente financiare në një platformë, duhet t’i ekzekutojë urdhrat e vet nëpërmjet anëtarëve të tregtimit të pranuar në platformë.

Neni 190
Rregullat e miratuara nga Autoriteti

Autoriteti mund të miratojë rregullore për të përcaktuar:

a) llojin e instrumenteve financiare, që mund të tregtohen në një platformë;

b) llojin e emetuesve, që mund të raportojnë tregtime në një platformë;

c) llojin e investitorëve, që mund të tregtojnë në një platformë;

ç) procedurën e pranimit dhe llojin e anëtarëve të tregtimit, që mund të tregtojnë në një platformë;

d) nivelin e informacionit, që duhet të jepet në një platformë;

dh) standardin e sjelljes tregtare, që kërkohet për shitblerjen e instrumenteve financiare të regjistruar në një platformë.

Neni 191

Heqja e regjistrimit

1. Autoriteti mund të heqë regjistrimin nëpërmjet njoftimit me shkrim, me efekt nga data e përcaktuar në njoftim, kur gjykon se heqja është në interes të investitorëve, të publikut ose të nevojës për të ruajtur një treg të rregullt dhe të drejtë.

2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të bëhet në përputhje me procedurën e nenit 30 të këtij ligji dhe të përmbajë arsyet që shërbejnë si bazë për heqjen.

3. Pavarësisht nga heqja e bërë në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund t'i lejojë subjektit të vijojë edhe në datën kur hyn në fuqi tërheqja ose edhe pas kësaj date ushtrimin e veprimtarive të prekura nga heqja, siç mund të përcaktohen nga Autoriteti në funksion të:

a) mbylljes së operacioneve të operatorit të njohur të tregut, me të cilin ka të bëjë heqja; ose

b) mbrojtjes së interesit të investitorëve ose interesit publik.

4. Kur Autoriteti ka autorizuar operatorin të vijojë një veprimtari të caktuar në zbatim të pikës 3 të këtij neni, operatori nuk duhet të konsiderohet se ka shkelur dispozitat e këtij ligji për shkak të kryerjes së veprimtarisë në përputhje me autorizimin.

5. Autoriteti nuk duhet ta ushtrojë kompetencën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni për një operator të njohur tregu, nëse nuk i ka dhënë operatorit të njohur të tregut mundësi për t'u shprehur.

6. Asnjë heqje e regjistrimit të kryer në zbatim të këtij neni nuk mund:

a) të shfuqizojë ose të cenojë një kontratë, transaksion ose masë të lidhur/marrë nga operatori i njohur i tregut, pavarësisht nëse kontrata, transaksioni ose masa është lidhur/marrë përpara ose pas heqjes së regjistrimit; ose

b) të cenojë të drejtat ose detyrimet që lindin nga një kontratë, marrëveshje ose transaksion i tillë.

Neni 192

Vlerësimi i performancës së operatorit të njohur të tregut

1. Autoriteti mund të vlerësojë herë pas here performancën e operatorit të njohur të tregut.

2. Autoriteti mund t'u kushtojë vëmendje kritereve të mëposhtme gjatë vlerësimit të statusit të operatorit të njohur të tregut:

a) elementit të rrezikut sistemik të platformës;

b) impaktit në interesin publik;

c) madhësisë dhe strukturës së platformës;

ç) klasës së titujve të palistuar, të cilët tregtohen në platformë;

d) natyrës së investitorëve dhe pjesëmarrësve që përdorin platformën.

Neni 193

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për titujt,
që nuk pranohen për tregtim në një treg të rregulluar

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për shitjen, blerjen dhe transferimin e titujve të palistuar, të vendosur në një platformë nga një operator i njohur tregu, me përjashtim të dispozitave të këtij ligji, të cilat i zbatohen institucioneve të tregut.

SEKSIONI VII
SHTËPIA E KLERIMIT

Neni 194

Sistemi i klerimit dhe shlyerjes

1. Sistem klerimi dhe shlyerjeje është sistemi i cili:

a) administrohet ose operohet nga personi juridik i licencuar nga Autoriteti kompetent në zbatim të legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave për të operuar sistemin e klerimit dhe shlyerjes;

b) mundëson klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve të instrumenteve financiare të ekzekutuara në një treg të rregulluar ose platformë shumëpalëshe tregtimi, ose jashtë një tregu të rregulluar dhe një platforme shumëpalëshe tregtimi, në përputhje me rregullat e sistemit, të cilat miratohen paraprakisht;

c) rregullon marrëdhëniet juridike mes anëtarëve të saj dhe midis këtyre anëtarëve e operatorit të sistemit dhe të drejtat e detyrimet reciproke të këtyre palëve në lidhje me klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve të instrumenteve financiare.

2. Klerimi dhe shlyerja e transaksioneve të ekzekutuara në një treg të rregulluar ose në një platformë shumëpalëshe tregtimi në Republikën e Shqipërisë, me tituj të dematerializuar, të regjistruar në një depozitar të licencuar, bëhet nëpërmjet sistemit të klerimit dhe shlyerjes së operuar nga operatori i licencuar i klerimit dhe shlyerjes, me përjashtim të rastit kur bursa ose operatori i PSHT- së përzgjedh një sistem klerimi dhe shlyerjeje të administruar nga një subjekt tjetër i licencuar nga një Autoritet tjetër dhe i njohur nga Autoriteti.

Neni 195

Kërkesa për licencim

1. Kërkesa për licencë për të krijuar dhe/ose për të operuar një shtëpi klerimi, edhe kur vepron në cilësinë e kundërpalës qendrore, e cila garanton klerimin dhe shlyerjen, i paraqitet Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave. Kërkesa shoqërohet me pagesën e një tarife të pakthyeshme, e cila përcaktohet nga Autoriteti.

2. Kërkesa për licencë për të krijuar dhe/ose operuar një shtëpi klerimi mund të bëhet vetëm nga një person juridik.

3. Subjekti kërkues duhet të japë të gjitha informacionet e nevojshme, në bazë të të cilave Autoriteti mund të vlerësojë nëse subjekti kërkues ka marrë, në momentin e licencimit, të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

4. Autoriteti mund të miratojë kërkesën për licencë për të operuar shtëpinë e klerimit, duke vendosur kushtet që i çmon të arsyeshme, me kusht që subjekti kërkues të ketë depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

5. Rregullorja e shtëpisë së propozuar të klerimit duhet të përmbajë parashikime të mjaftueshme për sa më poshtë:

a) për të siguruar që subjekti kërkues, në mënyrë të arsyeshme, do të operojë një treg të rregullt dhe të drejtë në lidhje me instrumentet që do të klerohen nëpërmjet shërbimeve të tij;

b) për të siguruar që subjekti kërkues do të administrojë me kujdes çdo rrezik që lidhet me veprimtarinë e tij;

c) për të siguruar që subjekti kërkues, në përmbushje të detyrimeve në bazë të shkronjës “a” të kësaj pike, nuk do të veprojë në kundërshtim me interesin publik dhe në veçanti në kundërshtim me interesin e investitorëve;

ç) për të siguruar që subjekti kërkues do të mund të ndërmarrë masat e duhura ndaj anëtarëve të cilët janë objekt i rregullores;

d) për të siguruar që rregullat e subjektit kërkues janë transparente dhe jodiskrecionale dhe përmbajnë parashikime të mjaftueshme lidhur me:

i. pranimin e anëtarëve të klerimit;

ii. rregullimin dhe mbikëqyrjen e duhur të anëtarëve;

iii. përjashtimin e anëtarëve që nuk përmbushin kriterin e aftësisë dhe përshtatshmërisë;

iv. përjashtimin, pezullimin ose disiplinimin e anëtarëve, përfshirë vendosjen e gjobave ndaj tyre;

v. kushtet sipas të cilave do të kryhet klerimi;

vi. ndalimin e abuzimit të tregut, shkeljeve të parregullta ose tregtimit bazuar në informacion të privilegjuar;

vii. pezullimin e sistemit të klerimit në funksion të mbrojtjes së investitorëve ose për të mbajtur një treg të rregullt ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme;

viii. emërimin e një komiteti disiplinor, ku shumica e anëtarëve nuk janë anëtarë klerimi;

ix. lidhjen e kontratave midis operatorit të sistemit të klerimit dhe anëtarëve, në të cilat u

kërkohet anëtarëve të zbatojnë rregullat e operatorit;

x. kryerjen e veprimtarisë së shtëpisë së klerimit, duke pasur parasysh nevojën për mbrojtjen e investitorëve dhe interesin publik;

dh) për të siguruar një metodë të shpejtë dhe të drejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

i. midis shtëpisë së klerimit dhe anëtarëve të saj;

ii. midis anëtarëve të klerimit;

e) dispozita në lidhje me klasat e instrumenteve financiare, që mund të klerohen në sistemet e saj;

ë) dispozita në lidhje me administrimin e fondit të garancisë së shlyerjes;

f) dispozita në lidhje me fillimin e procedurës së mospërmbushjes nëse një anëtar nuk arrin t'i përmbushë detyrimet, dhe në lidhje me procedurat e administrimit të rrezikut të zbatueshme kur një anëtar duket se nuk është ose se nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë detyrimet;

g) momentin e regjistrimit të urdhrave të shlyerjes në sistemin e shlyerjes dhe momentin kur këto urdhra marrin formë përfundimtare dhe të pakthyeshme;

gj) kur shtëpia e klerimit kryen funksionin e kundërpalës qendrore, rregullat duhet të parashikojnë momentin e zëvendësimit të kundërpalës në masat netuese, momentin kur shlyerja bëhet përfundimtare dhe çdo detyrim e funksion tjetër të lidhur me kundërpalën qendrore;

h) rregulla për rrezikun e shlyerjes, për të mundësuar shërbim të pandërprerë të shtëpisë së klerimit kur shtëpia e klerimit pëson humbje nga mos shlyerja e detyrimit nga anëtari ose në rrethana të tjera të cilat vënë në rrezik aftësinë paguese të shtëpisë së klerimit; dhe

i) për rregullimin e kolateralit, përfshirë depozitimin, perfeksionimin dhe ekzekutimin e kolateralit në rast mos shlyerjeje ose paaftësie paguese të anëtarit;

j) për të siguruar që subjekti kërkues të ketë burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe të tjera për të siguruar ofrimin:

i. e një tregu të rregullt dhe të drejtë në lidhje me instrumentet financiare që klerohen nëpërmjet shërbimeve të tij;

ii. e mjediseve të përshtatshme dhe të pajisura siç duhet për ushtrimin e veprimtarisë;

iii. e rregullave të pronësisë, menaxhimit dhe të një organi drejtues, që përbëhet nga persona të cilët përmbushin kriteret e aftësisë dhe përshtatshmërisë së nenit 13 të këtij ligji;

iv. e personelit kompetent për ushtrimin e veprimtarisë;

v. e sistemeve të automatizuara me kapacitet të përshtatshëm, masa sigurie dhe mundësi për t'u bërë ballë situatave të jashtëzakonshme;

k) për të bindur Autoritetin se dhënia e licencës është në interes të publikut ose të tregut.

6. Subjekti kërkues, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, i jep Autoritetit ato informacione që Autoriteti i konsideron të nevojshme për të marrë vendim në lidhje me kërkesën.

7. Pa cenuar kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, Autoriteti mund të ndryshojë, të shfuqizojë ose të vendosë kushte të reja ose të kërkojë shtimin apo ndryshimin e rregullave të shtëpisë së klerimit nëse çmon se kjo është e nevojshme në mbrojtje të investitorëve ose për të garantuar rregullimin e duhur të tregut.

8. Të gjitha rregulloret e shtëpisë së klerimit dhe ndryshimet e mëpasshme të tyre miratohen nga Autoriteti.

9. Shtëpia e klerimit, së cilës i është dhënë licencë në zbatim të këtij ligji, është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhshmëri me detyrimet fillestare të licencimit dhe me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 196

Refuzimi i licencës

Autoriteti i refuzon licencën shtëpisë së klerimit:

a) nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e nenit 197 të këtij ligji dhe, në veçanti, nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të shtëpisë së klerimit, Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, organit drejtues dhe funksionarëve kryesorë;

b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e këtij ligji;

c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:

i. lidhjet e ngushta midis shtëpisë së klerimit dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër, që rregullojnë

aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë me të cilët ka lidhje të ngushta shtëpia e klerimit;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 197

Detyrimet e shtëpisë së klerimit

1. Shtëpia e klerimit:

a) duhet të disponojë dhe menaxhojë mjetet e duhura që lehtësojnë procesin e realizimit të transaksionit me tituj.

b) duhet të sigurojë që instrumentet e përmendura në shkronjën "a" garantojnë klerim të drejtë, transparent dhe efikas, si edhe procedura shlyerjeje për transaksionet e kleruara ose të shlyera nëpërmjet instrumenteve të saj;

c) duhet të sigurojë marrjen e masave të mjaftueshme për të parandaluar dhe zbutur rrezikun e mashtrimit ose të çdo mekanizmi tjetër të manipulimit të tregut, për të garantuar:

1. mbrojtjen nga falsifikimi i të dhënave ose llogarive që duhen mbajtur në zbatim të këtij ligji;

ii. një sistem të përshtatshëm dhe efikas për gjurmimin, verifikimin, inspektimin, identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve;

iii. marrjen e miratimit për çdo tarifë që propozon të vendosë në lidhje me shërbimet që ofron; dhe

iv. miradministrimin e rreziqeve që lidhen me veprimtarinë dhe operacionet e tij.

2. Shtëpia e klerimit, gjatë përmbushjes së detyrave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të veprojë në interes të investitorëve dhe publikut.

3. Shtëpia e klerimit duhet t'i operojë sistemet e veta dhe t'i përmbushë detyrat e veta në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti.

4. Shtëpia e klerimit, në ushtrim të veprimtarisë së saj, në çdo moment duhet të mbajë:

a) mjedise të përshtatshme dhe të pajisura siç duhet;

b) personel kompetent;

c) sisteme të automatizuara me kapacitet dhe aftësi të mjaftueshme, masa sigurie dhe mbështetje teknike për t'u bërë ballë situatave të paparashikuara ose fatkeqësive, të miratuara nga Autoriteti.

5. Shtëpia e klerimit duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit që mban në lidhje me anëtarët dhe klientët e tyre, me kusht që këto informacione të mund t'i bëhen të ditura Autoritetit, kur kjo kërkohet me shkrim nga Autoriteti, ose me kërkesën me shkrim të bursës së titujve, së cilës i shërben si shtëpi klerimi, ose kur ka detyrim ligjor ta bëjë një gjë të tillë.

6. Shtëpia e klerimit njofton menjëherë Autoritetin nëse merr dijeni për:

a) pamundësinë e ndonjë prej anëtarëve të saj për të zbatuar ndonjë nga rregullat e saj;

b) një parregullsi financiare ose ndonjë çështje tjetër, e cila, në gjykimin e shtëpisë së klerimit ose të operatorit të saj, mund të tregojë se integriteti ose gjendja financiare e një anëtari është e diskutueshme; ose

c) mundësinë se një anëtar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ligjore.

7. Shtëpia e klerimit ka të drejtë të kërkojë tarifa për shërbimet dhe sistemet e saj, të cilat miratohen nga Autoriteti.

8. Autoriteti mund të parashikojë me rregullore detyrime të tjera për shtëpinë e klerimit, siç e konsideron të përshtatshme Autoriteti.

Neni 198

Heqja e licencës së shtëpisë së klerimit

1. Autoriteti, me njoftim me shkrim:

a) mund t'i heqë licencën e dhënë shtëpisë së klerimit, me efekt nga data e përcaktuar në njoftim; ose

b) mund t'i japë urdhër shtëpisë së klerimit të pushojë në një datë të përcaktuar ofrimin e shërbimeve ose operimin e sistemeve të përcaktuara në njoftim.

2. Autoriteti heq licencën ose jep urdhër për pushimin e aktivitetit kur çmon se marrja e kësaj mase është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e investitorëve ose rregullimin e duhur të tregut, si në rastet e mëposhtme:

a) shtëpia e klerimit pushon së operuari platformat e klerimit;

b) shtëpia e klerimit është në procedurë likuidimi në Republikën e Shqipërisë ose në vende të tjera;

c) shtëpia e klerimit është në shkelje të ndonjë kushti të licencës së saj ose është në shkelje të këtij ligji;

ç) shtëpia e klerimit nuk zbaton urdhrin e dhënë në zbatim të këtij ligji;

d) shtëpia e klerimit i jep Autoritetit informacione të rreme ose keqinformuese;

dh) shtëpia e klerimit nuk ka shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet e saj të caktuara me vendim gjykate;

e) në lidhje me ndonjë pasuri të shtëpisë së klerimit është emëruar një administrator falimentimi ose një likuidues në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;

ë) shtëpia e klerimit ka lidhur një marrëveshje kompromisi me kreditorët e saj në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj në kuadrin e një procedure organizimi; ose

f) shtëpia e klerimit, me nismën e saj, i ka kërkuar Autoritetit revokimin e licencës dhe Autoriteti e ka miratuar këtë kërkesë.

3. Në kuptim të shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni, shtëpia e klerimit konsiderohet se ka pushuar së operuari platformën e klerimit nëse ka pushuar së ofruari këtë shërbim për një periudhë prej 28 ditësh pune, duke përjashtuar rastin kur pushimi është miratuar paraprakisht nga Autoriteti.

4. Pavarësisht nga heqja e licencës ose nga urdhri i dhënë, Autoriteti mund t'i lejojë shtëpisë së klerimit të vazhdojë të ushtrojë, në datën e hyrjes në fuqi të heqjes ose pas saj, ato veprimtari të prekura nga heqja ose urdhrat, të cilat mund të përcaktohen nga Autoriteti në funksion të:

a) mbylljes së veprimtarisë së shtëpisë së klerimit ose pushimit të ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në njoftim; ose

b) mbrojtjes së investitorëve ose interesit publik.

5. Kur Autoriteti vepron në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të emërojë, nëse është e nevojshme, një këshill të përkohshëm administrimi për një periudhë gjashtëmujore për të administruar aktivitetin e shtëpisë së klerimit deri në emërimin e një këshilli të ri. Mandati i këshillit të përkohshëm të administrimit mund të zgjatet deri në një vit.

6. Kur Autoriteti ka miratuar vazhdimin e veprimtarive të shtëpisë së klerimit në zbatim të pikës 4 të këtij neni, shtëpia e klerimit nuk mund të konsiderohet se ka vepruar në shkelje të parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, si rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarive të tilla.

7. Autoriteti nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim në bazë të pikës 1 të këtij neni, pa i dhënë mundësi shtëpisë së klerimit të shprehet me shkrim.

8. Shtëpia e klerimit, e cila cenohet nga një vendim i Autoritetit, mund të bëjë ankim në gjykatë.

9. Autoriteti publikon çdo vendim për heqje licence ose çdo urdhër të lëshuar në zbatim të këtij neni.

Neni 199

Pasojat e heqjes së licencës për shtëpinë e klerimit

Asnjë heqje licence apo urdhër i lëshuar nga Autoriteti nuk mund:

a) të shfuqizojë ose të cenojë ndonjë kontratë apo transaksion të lidhur ose masë të marrë nga shtëpia e klerimit pavarësisht nëse kontrata, transaksioni ose masa është lidhur apo marrë përpara ose pas tërheqjes paraprake të licencës ose dhënies së urdhrit; ose

b) të cenojë të drejtat ose detyrimet që lindin nga një kontratë ose transaksion i tillë.

Neni 200

Rregullat për mospërmbushjen

Me qëllim administrimin e rrezikut, shtëpia e klerimit mund të nisë procedurat e mospërmbushjes në bazë të rregulloreve të saj, nëse një anëtar klerimi nuk është në gjendje ose ka të ngjarë të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet në lidhje me ndonjë apo të gjitha kontratat e pashlyera të tregut, palë e së cilës/ave është anëtari i klerimit.

Neni 201

Përparësia e procedurës së mospërmbushjes e shtëpisë së klerimit

1. Procedura e mospërmbushjes e filluar nga shtëpia e klerimit duhet të ketë përparësi mbi çdo proces tjetër ligjor lidhur me shpërndarjen e aktiveve të një personi në kuadër të falimentimit në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në instrumentet si më poshtë:

a) një kontratë tregu;

b) rregulloret e një shtëpie klerimi në lidhje me shlyerjen e një kontrate tregu;

c) çdo procedurë ose masë tjetër e ndërmarrë në bazë të rregullave të shtëpisë së klerimit për shlyerjen e një kontrate tregu;

ç) një marrëveshje kolaterali financiar;

d) një kolateral financiar;

dh) rregulloret e shtëpisë së klerimit për mospërmbushjen; ose

e) çdo procedurë mospërmbushjeje.

2. Pa cenuar parashikimet e pikës 1 të këtij neni, asnjë kompetencë në lidhje me procedurat e likuidimit, sipas ligjit në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nuk mund të ushtrohet në mënyrë të tillë që të parandalojë ose të ndërhyjë në:

a) shlyerjen e një kontrate tregu në përputhje me rregullat e shtëpisë së klerimit; ose

b) çdo procedurë mospërmbushjeje.

Neni 202

Detyrimi për të raportuar përfundimin e procedurës së mospërmbushjes

1. Pas përfundimit të çdo procedure mospërmbushjeje, shtëpia e klerimit duhet të vendosë në dispozicion të personave të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni një raport për çdo person që ka qenë në mospërmbushje për sa më poshtë:

a) shuma neto, nëse ka, e certifikuar nga shtëpia e klerimit, e cila duhet të paguhet nga ose duhet t'i paguhet personit që ka qenë në mospërmbushje;

b) faktin se asnjë shumë nuk është e pagueshme; dhe

c) çdo informacion tjetër specifik në lidhje me procedurën e mospërmbushjes, si të gjykohet e përshtatshme nga shtëpia e klerimit.

2. Raporti, i përgatitur sipas pikës 1 të këtij neni, i vihet menjëherë në dispozicion:

a) autoritetit;

b) personit përgjegjës që vepron për personin që ka qenë në mospërmbushje me të cilin lidhet raporti ose përfaqësuesit të tij; ose

c) kur nuk ka përfaqësues sipas shkronjës "b", të kësaj pike, personit që ka qenë në mospërmbushje dhe me të cilin lidhet raporti.

3. Kur merr një raport sipas pikës 2 të këtij neni, në lidhje me pikën 1, Autoriteti mund të publikojë një njoftim për t'ua njoftuar atë kreditorëve të personit që ka qenë në mospërmbushje dhe me të cilin lidhet raporti.

4. Kur personi përgjegjës ose personi që ka qenë në mospërmbushje merr një raport sipas pikës 1 të këtij neni, me kërkesë të cilitdo prej kreditorëve të tij, ai:

a) i vendos raportin në dispozicion kreditorit për njohuri brenda dy ditëve nga marrja e një kërkese të tillë; ose

b) kundrejt pagimit të një tarife të përcaktuar nga personi përgjegjës ose nga personi që ka qenë në mospërmbushje, i jep kreditorit të gjithë ose ndonjë pjesë të këtij raporti, sipas kërkesës.

Neni 203

Shuma neto e pagueshme në përfundim të procedurës së mospërmbushjes

1. Me përfundimin e procedurës së mospërmbushjes, shuma neto e certifikuar, në zbatim të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 202, nga shtëpia e klerimit duhet të paguhet nga personi që ka qenë në mospërmbushje ose t'i paguhet personit që ka qenë në mospërmbushje.

2. Pavarësisht nga çdo parashikim i ligjit në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, kur është dhënë urdhër për likuidim, shuma neto e përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të mbahet parasysh në lidhje me këto procedura.

Neni 204

Anëtari i klerimit si palë e transaksioneve të caktuara me cilësinë e subjektit përgjegjës

Anëtari i klerimit, i cili bëhet palë në një transaksion, përfshirë një kontratë tregu me një shtëpi klerimi, quhet palë e këtij transaksioni si agjent, por në kuptim të këtij neni duhet të konsiderohet se është, në çdo aspekt (përfshirë çdo padi civile apo kërkesë tjetër) palë në këtë transaksion me cilësinë e subjektit përgjegjës dhe jo të agjentit, pavarësisht nga çdo dispozitë në ndonjë ligj tjetër.

Neni 205

Instrumentet financiare që i dorëzohen shtëpisë së klerimit

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e ndonjë ligji tjetër, kur instrumentet financiare i dorëzohen shtëpisë së klerimit për shlyerjen e një kontrate tregu ose jepen si kolateral financiar, ose në bazë të një marrëveshjeje kolaterali financiar, nga një anëtar klerimi në përputhje me rregulloret e shtëpisë së klerimit, kundër shtëpisë së klerimit nuk mund të ngrihet apo të lejohet asnjë pretendim në lidhje me ndonjë të drejtë, titull ose interes për instrumentet financiare të dorëzuara shtëpisë së klerimit.

Neni 206

Ekzekutimi i kolateralit, objekt i marrëveshjes së kolateralit financiar

Shtëpia e klerimit duhet të ketë të drejtën e ekzekutimit të kolateralit, që është objekt i një marrëveshjeje kolaterali financiar, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregulloren e shtëpisë së klerimit.

Neni 207

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, objekt i marrëveshjes së kolateralit financiar

Kur një pasuri është objekt i një marrëveshjeje kolaterali financiar ose është vendosur si kolateral financiar, shitja e kësaj pasurie nga shtëpia e klerimit nuk mund të pengohet nga asnjë proces tjetër ligjor përmbarimi apo urdhër ekzekutimi dhe kjo pasuri nuk mund të përdoret për asnjë shlyerje tjetër nga personi përgjegjës, që kërkon ekzekutimin e interesave apo garancive të vendosura mbi pasurinë, me përjashtim të rastit kur kjo miratohet nga shtëpia e klerimit, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera.

Neni 208

Transferimi i instrumenteve financiare në shlyerje

1. Depozitari i licencuar dhe sistemi i pagesave duhet të zbatojnë çdo urdhër transferimi nga institucioni përkatës i tregut, me kusht që ky urdhër të bëhet në funksion të shlyerjes së një kontrate tregu.

2. Kur një urdhër transferimi për instrumente financiare jepet në përputhje me pikën 1 të këtij neni, asnjë titull mbi këto instrumente financiare nuk mund të transferohet përveçse siç parashikohet në rregullat e depozitarit qendror.

3. Kur kryhet një urdhër transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, nga sistemi përkatës, konfirmimi që merr institucioni përkatës i tregut për shlyerjen nga sistemi përkatës në përputhje me urdhrin e transferimit, i parashikuar në rregullat e institucionit përkatës të tregut, duhet të jetë përfundimtar dhe i parevokueshëm dhe nuk duhet t'i nënshtrohet asnjë padie nga ndonjë person.

Neni 209

Shitblerja e instrumenteve financiare

1. Shtëpia e klerimit mund të udhëzojë ndërmjetësin që të kryejë në emër të shtëpisë së klerimit një shitje ose blerje të instrumenteve financiare nëse një shitje apo blerje e tillë, sipas rastit, kryhet në funksion të shlyerjes së një kontrate tregu ose në kuadër të një procedure mospërmbushjeje ose për t'i dhënë mundësi shtëpisë së klerimit të ekzekutojë një aktiv të përfshirë në një marrëveshje kolaterali financiar ose të vendosur si kolateral financiar. Bursa duhet ta zbatojë këtë udhëzim.

2. Kur shitja ose blerja e instrumenteve financiare bëhet në emër të shtëpisë së klerimit në përputhje me pikën 1 të këtij neni nga një ndërmjetës, kundër ndërmjetësit nuk mund të ngrejë padi asnjë person dhe ndërmjetësi nuk mban përgjegjësi ndaj askujt.

Neni 210
Imuniteti nga përgjegjësia penale dhe civile

1. Personat e mëposhtëm nuk mund të jenë objekt i asnjë përgjegjësie penale ose civile:

a) personi që përmbush një detyrim në bazë të delegimit sipas rregulloreve të mospërmbushjes së shtëpisë të klerimit në lidhje me ndonjë procedurë mospërmbushjeje; ose

b) çdo person që vepron në emër të personit të përmendur në shkronjën "a", përfshirë:

i. çdo anëtar të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të personit të përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike; dhe

ii. çdo anëtar të çdo komiteti të ngritur nga personi i përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike, për çdo veprim (përfshirë deklarata të dhëna) ose mosveprim në mirëbesim gjatë përmbushjes së këtij detyrimi, ose në lidhje me përmbushjen faktike ose të synuar të këtij detyrimi.

2. Kur personi përgjegjës vepron në lidhje me pasurinë e një personi, që është në mospërmbushje, në bazë të rregulloreve të mospërmbushjes së shtëpisë së klerimit dhe në mënyrë të arsyeshme beson ose ka baza të arsyeshme për të besuar se ai ka të drejtë ta kryejë këtë veprim, personi përgjegjës nuk mban përgjegjësi për humbjet ose dëmtimet që rezultojnë nga një veprim i tillë, përveçse kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga pakujdesia.

SEKSIONI VIII
REGJISTRARI OSE DEPOZITARI QENDROR I TITUJVE (DQT)

Neni 211
Shërbimet kryesore të Depozitarit Qendror të Titujve

Shërbimet kryesore të Depozitarit Qendror të Titujve janë:

1. Regjistrimi fillestar i titujve në një sistem regjistrimi ("Shërbimi i Regjistrimit Fillestar").

2. Ofrimi dhe mbajtja e llogarive të titujve ("Shërbimi Qendror i Mirëmbajtjes së Llogarive").

3. Operimi i sistemit të shlyerjes së titujve ("Shërbimi i Shlyerjes") në zbatim të ligjit në fuqi "Për sistemin e pagesave".

Neni 212
Shërbimet e tjera të Depozitarit Qendror të Titujve

1. Depozitari Qendror i Titujve ofron edhe shërbime të tjera ndihmëse jobankare, të cilat nuk përfshijnë rrezik kredie ose likuiditeti dhe që kontribuojnë në rritjen e sigurisë, efikasitetit dhe transparencës së tregjeve të titujve, të tilla si:

a) shërbime të lidhura me sistemin e shlyerjes, si:

i. organizimi i një mekanizmi të huadhënies së titujve, si agjent midis pjesëmarrësve të sistemit të shlyerjes së titujve;

ii. ofrimi i shërbimeve të administrimit të kolateralit, si agjent për pjesëmarrësit në sistemin e shlyerjes së titujve;

iii. koordinimi i pagesave, transmetimi i urdhrave, konfirmimi i tregtimit, verifikimi i tregtimit;

b) shërbime të lidhura me shërbimet e regjistrimit fillestar dhe të mirëmbajtjes qendrore të llogarive, si:

i. shërbimet që lidhen me mbajtjen e regjistrave të aksionarëve;

ii. ofrimi i asistencës për trajtimin e procedurave të shoqërisë tregtare, përfshirë ato tatimore, asambletë e përgjithshme dhe shërbimet e informacionit;

iii. shërbimet lidhur me emetimet e reja, përfshirë caktimin dhe administrimin e kodeve ndërkombëtare të identifikimit të titujve ISIN dhe kodeve të tjera të ngjashme;

l 7ft 1 ft

iv. transmetimi dhe përpunimi i urdhrave, mbledhja dhe përpunimi i tarifave dhe raportimet lidhur me to.

2. Krijimi i ndërlidhjeve të depozitarit qendror të titujve, ofrimi, mirëmbajtja ose operimi i llogarive të titujve për shërbimin e shlyerjes, administrimin e kolateralit dhe shërbime të tjera ndihmëse.

3. Çdo shërbim tjetër, si:

a) ofrimi i shërbimeve të përgjithshme të administrimit të kolateralit si agjent;

b) ofrimi i shërbimit të raportimit rregullator;

c) ofrimi i informacionit, të dhënave dhe statistikave zyrave të tregut/censit ose subjekteve të tjera shtetërore ose ndërqeveritare;

ç) ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Neni 213

Ndalimi i ushtrimit të aktivitetit si depozitar qendror ose regjistrar pa licencë

Asnjë person nuk mund të themelojë, të operojë ose të pretendojë sikur ofron apo operon një depozitar qendror ose regjistrar për menaxhimin dhe regjistrimin e instrumenteve financiare, pavarësisht nëse këto instrumente financiare janë të listuara në ndonjë bursë apo jo, pa marrë më parë licencë nga Autoriteti.

Neni 214

Autorizimi për të ofruar shërbime ndihmëse të natyrës bankare

Depozitari Qendror i Titujve nuk mund të ofrojë shërbime ndihmëse të natyrës bankare nëse nuk ka marrë autorizim shtesë për të ofruar shërbime të tilla në përputhje me ligjin në fuqi “Për bankat”.

Neni 215

Detyrimi për të dematerializuar titujt

Çdo emetues, që emeton ose ka emetuar tituj të transferueshëm, të cilët pranohen për tregtim ose tregtohen në platforma tregtimi, duhet të marrë masat që këta tituj të ngurtësohen nëpërmjet regjistrimit ose të dematerializohen menjëherë pas emetimit.

Neni 216

Regjistrimi përpara datës së shlyerjes

Kur transaksioni me tituj të transferueshëm kryhet në një platformë tregtimi, titujt përkatës regjistrohen në regjistrin e Depozitarit Qendror të Titujve në datën e synuar të shlyerjes ose përpara kësaj date, nëse nuk janë regjistruar më parë.

Neni 217

Shlyerja

1. Çdo pjesëmarrës i një sistemi të shlyerjes së titujve, i cili bën shlyerje në këtë sistem për llogari të vet ose për llogari të transaksioneve me tituj të transferueshëm të një personi të tretë, instrumente të tregut të parasë ose kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, duhet t'i shlyejë këto transaksione në datën e synuar të shlyerjes.

2. Në lidhje me transaksionet me tituj të transferueshëm, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të cilat ekzekutohen në platforma tregtimi, data e synuar e shlyerjes nuk mund të jetë më vonë se dita e dytë e punës pas kryerjes së tregtimit. Kjo kërkesë nuk zbatohet për transaksionet që negociohen privatisht, por ekzekutohen në një platformë tregtimi, për transaksionet që ekzekutohen në mënyrë dypalëshe, por i raportohen një platforme tregtimi, ose për transaksionin e parë të titujve të transferueshëm, të cilët janë objekt regjistrimi fillestar në një regjistër.

Neni 218

Parandalimi i rasteve të mosshlyerjes

1. Platformat e tregtimit miratojnë procedura, që mundësojnë konfirmimin e të dhënave përkatëse të transaksioneve me instrumente financiare në datën kur ekzekutohet transaksioni.

2. Pavarësisht nga kërkesat e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, shoqëritë komisionere, sipas rastit, marrin masa për të kufizuar numrin e mosshlyerjeve. Këto masa, si minimum, konsistojnë në marrëveshje midis shoqërisë komisionere dhe klientëve të saj profesionistë, për të siguruar komunikimin e menjëhershëm në lidhje me konfirmimet përkatëse për të ekzekutuar transferimin e titujve, subjekt i një

transaksioni, përpara datës së shlyerjes.

3. Për secilin sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve miraton procedura, që synojnë të sigurojnë shlyerjen e transaksioneve me instrumente financiare të përmendura në nenin 217 të këtij ligji, në datën e synuar të shlyerjes, me ekspozim minimal të pjesëmarrësve ndaj rreziqeve të kundërpalës dhe likuiditetit dhe një numër të vogël rastesh mosshlyerjeje. Depozitari Qendror i Titujve përpiqet të sigurojë shlyerjen e shpejtë të transaksioneve në datën e synuar të shlyerjes nëpërmjet mekanizmave të duhur.

4. Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve merr masa për të nxitur dhe garantuar shlyerjen në afat të transaksioneve nga pjesëmarrësit. Depozitari Qendror i Titujve u kërkon pjesëmarrësve të shlyejnë transaksionet në datën e synuar të shlyerjes.

Neni 219

Masat për trajtimin e rasteve të mosshlyerjeve

1. Për secilin sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve krijon një sistem, që monitoron rastet e mosshlyerjes së transaksioneve me instrumente financiare. Depozitari Qendror i Titujve i raporton rregullisht Autoritetit për numrin dhe detajet e rasteve të mosshlyerjes dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, përfshirë masat e parashikuara nga Depozitari Qendror i Titujve dhe pjesëmarrësit e tij për të përmirësuar efikasitetin e shlyerjeve. Këto raporte bëhen publike në baza vjetore nga Depozitari Qendror i Titujve në formë të përmbledhur dhe anonime.

2. Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve miraton procedura që synojnë të sigurojnë shlyerjen e transaksioneve me instrumente financiare, të cilat nuk janë shlyer në datën e synuar të shlyerjes. Këto procedura parashikojnë edhe një mekanizëm ndëshkimor, i cili shërben si frenues efektiv për pjesëmarrësit që shkaktojnë raste mosshlyerjeje.

3. Përpara miratimit të procedurave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, Depozitari Qendror i Titujve konsultohet me platformat përkatëse të tregtimit dhe kundërpalët qendrore, të cilave u ofron shërbimet e shlyerjes.

Neni 220

Kriteret për pjesëmarrjen

1. Depozitari Qendror i Titujve publikon kriteret e pjesëmarrjes në çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon. Këto kritere u ofrojnë akses të drejtë dhe të hapur në sistem të gjithë personave juridikë që synojnë të bëhen pjesëmarrës. Këto kritere duhet të jenë transparente, objektive dhe jodiskriminuese, në mënyrë që të sigurojnë akses të drejtë te Depozitari Qendror i Titujve, duke marrë parasysh rreziqet e cenimit të stabilitetit financiar dhe rregullsisë së tregjeve. Kriteret që kufizojnë aksesin do të lejohen vetëm nëse qëllimi i tyre është të kontrollojnë në mënyrë të arsyeshme një rrezik specifik për Depozitarin Qendror të Titujve.

2. Depozitari Qendror i Titujve u përgjigjet kërkesave për pranim brenda një muaji nga marrja e tyre. Procedurat për vlerësimin e kërkesave për pranim bëhen publike.

3. Depozitari Qendror i Titujve u refuzon aksesin pjesëmarrësve, të cilët plotësojnë kriteret e pikës 1 të këtij neni, vetëm kur refuzimi arsyetohet me shkrim dhe mbështetet në një vlerësim të gjithanshëm rreziku. Në rast refuzimi, pjesëmarrësi kërkues ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit kompetent të Depozitarit Qendror të Titujve, që i ka refuzuar të drejtën e pranimit. Ky autoritet shqyrton ankesën duke vlerësuar arsyet e refuzimit dhe i jep pjesëmarrësit kërkues një përgjigje të arsyetuar. Kur refuzimi i pranimit nga Depozitari Qendror i Titujve konsiderohet si i pajustifikuar, autoriteti licencues i Depozitarit Qendror të Titujve, që ka refuzuar të drejtën e pranimit, i jep urdhër Depozitarit Qendror të Titujve të pranojë pjesëmarrësin kërkues.

4. Depozitari Qendror i Titujve miraton procedura objektive dhe transparente për pezullimin dhe përjashtimin e pjesëmarrësve, që nuk plotësojnë më kriteret për pjesëmarrje sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 221

Transparenca

1. Depozitari Qendror i Titujve publikon çmimet dhe tarifat e lidhura me secilin sistem të shlyerjes së titujve që operon, si dhe me secilën nga shërbimet e tjera kryesore që ofron. Depozitari Qendror i Titujve publikon çmimet dhe tarifat për çdo shërbim të ofruar në mënyrë të veçantë, përfshirë zbritjet dhe

rimbursimet dhe kushtet për të përfituar nga këto zbritje. Depozitari Qendror i Titujve u jep përdoruesve të drejtën të përdorin veçmas secilin prej shërbimeve specifike të ofruara.

2. Depozitari Qendror i Titujve publikon listën e çmimeve, në mënyrë që të mundësojë krahasimin e ofertave dhe t'u japë mundësi klientëve të parashikojnë çmimin që duhet të paguajnë për përdorimin e shërbimeve.

3. Depozitari Qendror i Titujve është i detyruar të zbatojë politikën e publikuar të çmimeve për shërbimet e bazë.

4. Depozitari Qendror i Titujve u jep klientëve informacionin e nevojshëm për të kryer rakordimin e faturave me listat e publikuara të çmimeve.

5. Depozitari Qendror i Titujve u jep të gjithë klientëve informacionin e nevojshëm për të kryer vlerësimin e rrezikut për shërbimet e ofruara.

6. Depozitari Qendror i Titujve kontabilizon veçmas kostot dhe të ardhurat e shërbimeve bazë të ofruara dhe ia njofton këtë informacion autoritetit kompetent.

7. Depozitari Qendror i Titujve kontabilizon kostot dhe të ardhurat e shërbimeve ndihmëse të ofruara në formë të agreguar dhe ia njofton këtë informacion autoritetit kompetent.

8. Për të siguruar zbatim efektiv të rregullave të konkurrencës dhe për të mundësuar identifikimin, ndër të tjera, e rasteve të ndërsubvencionimit të kostove të shërbimeve ndihmëse nga të ardhurat e shërbimeve kryesore, Depozitari Qendror i Titujve mban kontabilitet analitik për veprimtaritë e tij. Këto llogari analitike paraqesin veçmas, të paktën, kostot dhe të ardhurat, që lidhen me secilën prej shërbimeve kryesore, në mënyrë të veçuar nga kostot dhe të ardhurat, që lidhen me shërbimet ndihmëse.

Neni 222

Rregullat dhe procedurat e mospërmbushjes së pjesëmarrësve

1. Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve miraton rregulla dhe procedura efektive e të qarta për të menaxhuar rastet e mospërmbushjes nga një ose më shumë prej pjesëmarrësve të tij dhe për të siguruar që Depozitari Qendror i Titujve të mund të marrë në kohën e duhur masat për të kufizuar humbjet dhe presionin mbi likuiditetin dhe për të qenë në gjendje të vazhdojë të përmbushë detyrimet.

2. Rregullat dhe procedurat përkatëse të Depozitarit Qendror të Titujve për rastet e mospërmbushjes bëhen publike.

3. Depozitari Qendror i Titujve së bashku me pjesëmarrësit dhe palët e tjera të interesit testojnë dhe shqyrtojnë në mënyrë periodike procedurat për rastet e mospërmbushjes për të siguruar që ato janë praktike dhe efektive.

Neni 223

Ndërlidhja midis Depozitarit Qendror të Titujve dhe një infrastrukture tjetër tregu

1. Kundërpala qendrore dhe platformat e tregtimit vendosin në dispozicion të Depozitarit Qendror të Titujve dhe me kërkesë të këtij të fundit informacion për transaksionet në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Me përjashtim të rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ky shërbim mund të ofrohet përkundrejt një tarife të arsyeshme të përcaktuar në bazë të kostove të shërbimit.

Depozitari Qendror i Titujve i jep kundërpalës qendrore ose platformës së tregtimit të drejtën e aksesit në sistemet e veta të shlyerjes së titujve në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Me përjashtim të rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ky shërbim mund të ofrohet përkundrejt një tarife të arsyeshme të përcaktuar në bazë të kostove të shërbimit.

2. Kur njëra palë i kërkon të drejtën e aksesit palës tjetër në përputhje me pikën 1 të këtij neni, kjo kërkesë trajtohet me prioritet dhe palës kërkuese i jepet përgjigje brenda një afati tremujor nga kërkesa.

3. Pala së cilës i drejtohet kërkesa refuzon aksesin vetëm nëse ai do të cenonte funksionimin e rregullt dhe të qetë të tregjeve financiare ose do të shkaktonte rrezik sistemik. Kërkesa nuk mund të refuzohet për shkak të humbjes së pjesës së tregut. Pala që refuzon kërkesën për akses i jep me shkrim palës kërkuese arsyet e plota të refuzimit, bazuar në një vlerësim të gjithanshëm të riskut. Në rast refuzimi, pala kërkuese ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit kompetent të palës që i ka refuzuar të drejtën e aksesit. Autoriteti shqyrton ankesën, duke vlerësuar arsyet e refuzimit dhe i jep palës kërkuese një përgjigje të arsyetuar.

Neni 224

Aplikimi për licencë si Depozitar Qendror i Titujve ose regjistrar titujsh

1. Aplikimi për licencë për të themeluar dhe/ose për të operuar një regjistrar ose një depozitar qendror i paraqitet Autoritetit sipas mënyrës dhe formës që përcaktohet nga Autoriteti. Kërkesa shoqërohet me pagesën e një tarife të pakthyeshme, e cila përcaktohet nga Autoriteti.

2. Aplikimi për licencë për të themeluar dhe/ose për të operuar një regjistrar ose depozitar qendror mund të bëhet vetëm nga një person juridik.

3. Subjekti kërkues duhet t'i japë Autoritetit të gjithë informacionin e nevojshëm në mënyrë që ky i fundit të mund të vlerësojë nëse subjekti kërkues ka marrë në momentin e licencimit të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

4. Autoriteti mund ta japë licencën për të operuar një regjistrar ose depozitar qendror me kushtet dhe afatet që i çmon të arsyeshme nëse i është vendosur në dispozicion i gjithë dokumentacioni përkatës.

5. Rregullorja e regjistrarit ose Depozitarit Qendror të propozuar duhet të përmbajë dispozita të mjaftueshme si më poshtë:

a) mbajtjen e llogarive të titujve për llogari të zotëruesve të këtyre titujve;

b) për të siguruar që subjekti kërkues do të administrojë me kujdes çdo rrezik që lidhet me aktivitetin e tij tregtar dhe veprimtarinë e tij;

c) për të siguruar që subjekti kërkues, në përmbushje të detyrimeve sipas shkronjës "a" të kësaj pike, nuk do të veprojë në kundërshtim me interesat e mbajtësve të llogarive;

ç) kushtet për regjistrimin, fshirjen ose transferimin e titujve në regjistrin e tij;

d) mbrojtjen e interesave të mbajtësve të llogarive dhe ruajtjen e fshehtësisë së informacionit për titujt e regjistruar dhe transaksionet me to;

dh) për të siguruar një metodë të shpejtë dhe të drejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

e) për të siguruar që subjekti kërkues ka burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe të tjera për të garantuar:

i. një organizim të rregullt dhe të drejtë për mbajtjen e llogarive të zotëruesve dhe të titujve të regjistruar;

ii. mjedise të përshtatshme dhe të pajisura siç duhet për ushtrimin e veprimtarisë;

iii. masa të menaxhimit të brendshëm dhe një organ drejtues, që përbëhet nga persona të cilët përmbushin kriteret e aftësisë dhe përshtatshmërisë;

iv. një personel kompetent për ushtrimin e veprimtarisë;

v. sisteme me kapacitet të mjaftueshëm, masa të sigurisë;

ë) mundësitë për t'u bërë ballë situatave të jashtëzakonshme;

f) miratimin e licencës, që do të jetë në interes të publikut ose tregut në përgjithësi.

6. Subjekti kërkues sipas pikës 1 të këtij neni, duhet t'i japë Autoritetit ato informacione që Autoriteti i konsideron të nevojshme për të marrë vendim për kërkesën.

7. Autoriteti mund të parashikojë me rregullore procedurën e saktë për aplikimin për licencë.

8. Pa cenuar përgjithësinë e kushteve të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, Autoriteti mund të ndryshojë, të revokojë ose të vendosë kushte dhe afate të reja nëse çmon se kjo është e nevojshme në mbrojtje të investitorëve ose të rregullimit të duhur të tregut.

9. Autoriteti miraton paraprakisht të gjitha rregulloret e Depozitarit Qendror dhe ndryshimet e tyre.

10. Depozitari Qendror, të cilit i është dhënë licencë në zbatim të këtij ligji, është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhshmëri me detyrimet fillestare të licencimit dhe me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 225

Refuzimi i licencës

Autoriteti refuzon licencën e regjistrarit ose Depozitarit Qendror:

a) nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë prej kërkesave të nenit 224 të këtij ligji dhe, në veçanti, nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të regjistrarit ose Depozitarit Qendror, Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e personave që zotërojnë pjesëmarrje influencuese, të anëtarëve të organeve drejtues dhe funksionarëve kryesorë;

b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të zbatojë kërkesat e këtij ligji;

c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:

i. lidhjet e ngushta midis regjistrarit ose Depozitarit Qendror dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër, që rregullojnë aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë me të cilët regjistrari ose Depozitari Qendror ka lidhje të ngushta;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 226

Detyrat e regjistrarit ose Depozitarit Qendror

1. Depozitari Qendror:

a) duhet të sigurojë dhe të operojë instrumente për regjistrimin e titujve në mënyrë qendrore;

b) duhet të sigurojë që instrumentet e parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike të sigurojnë masa të drejta, transparente dhe efikase për titujt e regjistruar prej tij;

c) duhet të marrë masat e nevojshme për të parandaluar dhe zbutur rrezikun e mashtrimit ose të çdo mekanizmi tjetër të manipulimit të sistemit:

1. për të siguruar kujdestari të sigurt të certifikatave dhe dokumenteve të tjera të depozituara pranë regjistrarit ose Depozitarit Qendror;

ii. për të mbrojtur nga falsifikimi të dhënat ose llogaritë që mbahen në zbatim të këtij ligji; dhe

iii. për të siguruar një sistem të duhur dhe efikas për gjurmimin, verifikimin, inspektimin, identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve të kryera pranë regjistrarit ose Depozitarit Qendror;

ç) duhet të përcaktojë tarifat për shërbimet që ofron në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

d) duhet të sigurojë se rreziqet që lidhen me aktivitetin dhe veprimtaritë e tij administrohen siç duhet.

2. Regjistrari ose Depozitari Qendror, gjatë përmbushjes së detyrave të parashikuara në pikën , të këtij neni, vepron në interes të investitorëve dhe publikut.

3. Regjistrari ose Depozitari Qendror operon instrumentet e veta dhe përmbush detyrat e veta në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti.

4. Regjistrari ose Depozitari Qendror miraton dhe zbaton procedurat e duhura për të siguruar që anëtarët e tij janë në përputhshmëri me rregullat e tij.

5. Regjistrari ose Depozitari Qendror në çdo kohë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së licencuar siguron:

a) mjedise të përshtatshme dhe të pajisura siç duhet;

b) personel kompetent;

c) sisteme të automatizuara të miratuara nga Autoriteti, me kapacitet dhe aftësi të mjaftueshme, masa sigurie dhe mbështetje teknike për t'u bërë ballë situatave të paparashikuara ose fatkeqësive.

6. Regjistrari ose Depozitari Qendror ruan fshehtësinë e informacionit që mban në lidhje me anëtarët dhe klientët. Ky informacion mund t'i jepet vetëm Autoritetit apo bursës së titujve, së cilës i shërben si Depozitar Qendror apo regjistrar, nëse kjo kërkohet me shkrim, ose nëse kërkohet nga një ligj i caktuar.

7. Regjistrari ose Depozitari Qendror njofton menjëherë Autoritetin nëse vjen në dijeni të:

a) pamundësisë së ndonjë prej anëtarëve të tij për të zbatuar ndonjë nga rregullat e tij;

b) një parregullsie financiare ose ndonjë çështjeje tjetër, e cila, sipas mendimit të regjistrarit ose Depozitarit Qendror, mund të tregojë se integriteti ose gjendja financiare e një anëtari është e diskutueshme; ose

c) një informacioni që tregon se një anëtar mund të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ligjore.

8. Depozitari Qendror ose regjistrari zbaton tarifa për shërbimet dhe sistemet e tij, të cilat miratohen nga Autoriteti.

9. Autoriteti mund të parashikojë me rregullore detyrime të tjera për t'u kryer nga regjistrari ose Depozitari Qendror, siç e konsideron të përshtatshme.

Neni 227

Heqja e licencës së Depozitarit Qendror

1. Autoriteti, me njoftim me shkrim:

a) mund të heqë një licencë, me efekt nga data e përcaktuar në njoftim; ose

b) mund t'i japë urdhër regjistrarit ose Depozitarit Qendror të pushojë së ofruari shërbimet e përcaktuara në njoftim duke filluar nga data e përcaktuar në njoftim.

2. Autoriteti mund të heqë licencën ose të japë një urdhër, kur çmon se është e nevojshme për mbrojtjen e investitorëve ose për rregullimin e duhur të tregut, në rastet e mëposhtme:

a) regjistrari ose Depozitari Qendror pushon së ofruari sisteme të përshtatshme;

b) regjistrari ose Depozitari Qendror është në procedurë likuidimi;

c) regjistrari ose Depozitari Qendror ka shkelur ndonjë prej kushteve apo afateve të licencës ose parashikimeve të këtij ligji;

ç) regjistrari ose Depozitari Qendror nuk zbaton një urdhër të dhënë në zbatim të këtij ligji;

d) regjistrari ose Depozitari Qendror i ka dhënë Autoritetit informacione të rreme ose keqinformuese në lidhje me një aspekt thelbësor;

dh) regjistrari ose Depozitari Qendror nuk ka shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet, të cilat i janë caktuar me vendim të gjykatës;

e) për ndonjë pronë të regjistrarit ose Depozitarit Qendror është emëruar një administrator falimentimi ose një likuidues në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;

ë) regjistrari ose Depozitari Qendror ka lidhur një marrëveshje kompromisi me kreditorët në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, në kuadër të një procedure riorganizimi; ose

f) regjistrari ose Depozitari Qendror, me nismën e vet, i ka kërkuar Autoritetit revokimin e licencës dhe Autoriteti e ka miratuar këtë kërkesë.

3. Në kuptim të shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni, regjistrari ose Depozitari Qendror do të konsiderohet se ka pushuar së operuari sistemin për mbajtjen qendrore të titujve nëse ka pushuar së operuari këto sisteme për një periudhë prej 28 ditësh pune, me përjashtim të rastit kur pezullimi është miratuar paraprakisht nga Autoriteti.

4. Pavarësisht nga heqja e licencës ose nga urdhri i dhënë në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të lejojë regjistrarin ose Depozitarin Qendror të vijojë edhe në datën e hyrjes në fuqi të heqjes ose urdhrit apo pas kësaj date ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara nga Autoriteti në funksion të:

a) mbylljes së veprimtarisë të regjistrarit ose Depozitarit Qendror; ose

b) mbrojtjes së interesit të depozituesve ose interesit publik.

5. Kur Autoriteti vepron në zbatim të pikës 1 të këtij neni, ai mund të emërojë, nëse e gjykon të nevojshme, një këshill të përkohshëm administrimi për një periudhë deri në gjashtë muaj, për të administruar aktivitetin e regjistrarit ose të Depozitarit Qendror.

6. Kur Autoriteti ka autorizuar regjistrarin ose Depozitarin Qendror në zbatim të pikës 4 të këtij neni, regjistrari apo Depozitari Qendror nuk mund të konsiderohet se, duke kryer veprimtaritë në fjalë, ka vepruar në shkelje të parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.

7. Autoriteti nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim në bazë të pikës 1 të këtij neni, pa i dhënë mundësi regjistrarit ose Depozitarit Qendror të shprehet me shkrim.

8. Regjistrari ose Depozitari Qendror, i cili ka pësuar një dëm nga një vendim i Autoritetit, mund të ankohet në gjykatë.

9. Autoriteti publikon çdo vendim për heqje licence ose çdo urdhër të nxjerrë në zbatim të këtij neni.

10. Autoriteti miraton rregullore për procesin e transferimit në rast të heqjes së licencës te një operator tjetër i licencuar ose te një subjekt tjetër, sipas gjykimit të Autoritetit.

Neni 228

Pasojat e heqjes së licencës për Depozitarin Qendror

Asnjë heqje licence apo urdhër i lëshuar nga Autoriteti në zbatim të dispozitave të mësipërme nuk mund:

a) të shfuqizojë ose të cenojë ndonjë kontratë, transaksion ose marrëveshje të lidhur në sistemin kompjuterik të operuar nga regjistrari ose Depozitari Qendror, pavarësisht nëse kontrata, marrëveshja apo transaksioni është lidhur përpara ose pas revokimit të licencës ose dhënies së urdhrit; ose

b) të cenojë të drejtat ose detyrimet që lindin nga një kontratë apo transaksion i tillë.

Neni 229
Llogaritë e instrumenteve financiare

1. Regjistrari ose Depozitari Qendror mund të krijojë lloje të ndryshme të llogarive të titujve për çdo llogari instrumentesh financiare të hapur pranë Depozitarit Qendror.

2. Me kërkesë të Autoritetit ose me urdhër të gjykatës, depozitari mund t'i kërkojë mbajtësit të llogarisë ose kujdestarit të bëjë të ditur identitetin e përfituesit fundor të titujve për llogari të të cilit mban në kujdestari këta tituj.

Neni 230
Regjistrimi i instrumenteve financiare të depozituara pranë regjistrarit ose Depozitarit Qendror

Të gjitha regjistrimet e instrumenteve financiare të mbajtura pranë Depozitarit Qendror kryhen nëpërmjet shënimit në llogaritë e regjistrarit ose Depozitarit Qendror në formë të dematerializuar pa pasur nevojë për dorëzim fizik.

Neni 231
Regjistrimi në llogari

Regjistrimi në llogarinë e mbajtur pranë regjistruesit ose Depozitarit Qendror përbën provë paraprake për vërtetësinë e regjistrimit.

Neni 232
Mbrojtja e përfituesit fundor të titujve të mbajtura pranë regjistrarit ose Depozitarit Qendror

1. Kur regjistrari ose Depozitari Qendror mban instrumente financiare me urdhër të palëve të treta, të cilat i depozitojnë ato për llogari të klientëve të tyre, instrumentet në fjalë nuk janë pronë e depozitarit ose e palës së tretë që i ka depozituar këto instrumente, por mbeten në pronësi të klientit ose përfituesit fundor të instrumentit në fjalë.

2. Kur Depozitari Qendror mban instrumente financiare me urdhër të palëve të treta, të cilat i depozitojnë ato për llogari të klientëve të tyre, sistemi i regjistrarit ose depozitarit qendror duhet të jetë në gjendje të regjistrojë dhe të ruajë:

a) emrat dhe të dhënat e përfituesit fundor;

b) të drejtat dhe detyrimet, që lidhen me instrumentet financiare të mbajtura në llogaritë e regjistrarit ose Depozitarit Qendror, mund të ushtrohen vetëm nga përfituesi i identifikuar në llogarinë përkatëse të mbajtur pranë regjistrarit ose Depozitarit Qendror.

3. Emërimi i likuiduesit, administratorit të falimentimit ose administratorit të përkohshëm ose hapja e një procedure falimentimi kundër një depozitari, një anëtari të depozitarit ose një regjistrari nuk cenon të drejtat e përfituesve fundorë të instrumenteve financiare të mbajtura pranë Depozitarit Qendror në llogarinë e anëtarit të depozitarit.

Neni 233
Konfirmimi

Regjistrimi i instrumenteve financiare pranë një regjistrari ose depozitari përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji konsiderohet i vlefshëm, pavarësisht faktit se regjistrimi nuk është kryer në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

SEKSIONI IX
AGJENCITË E VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË KREDITIT

Neni 234
Ndalimi i aktivitetit të palicencuar të Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Asnjë person nuk mund të themelojë, të ushtrojë aktivitetin, të mbajë, apo të asistojë në themelimin, ushtrimin e aktivitetit ose mbajtjen, ose të pretendojë se ofron shërbime si agjenci e vlerësimit të

rrezikut kreditor, nëse:

a) nuk është licencuar nga Autoriteti;

b) nuk është njohur nga Autoriteti, nëse është agjenci e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Këto parashikime zbatohen për vlerësimet e rrezikut të kreditit të kryera nga agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit, të cilat bëhen publike apo i shpërndahen publikut me anë të abonimit.

2. Për qëllimet e këtij ligji, pika 1 nuk zbatohet për:

a) vlerësimet private të rrezikut të kreditit, të kryera në bazë të një urdhri individual, të cilat i ofrohen ekskluzivisht personit që ka dhënë urdhrin dhe nuk janë të destinuara për publikun apo abonentët;

b) sistemet e vlerësimit të cilësisë së kreditit ose vlerësime të ngjashme në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënie investimi, tregtare ose industriale;

c) vlerësimet e rrezikut të kreditit të kryera nga agjencitë e kredive të eksportit; ose

ç) vlerësimet e rrezikut të kreditit të kryera nga banka qendrore:

i. të cilat nuk paguhen nga subjekti i vlerësuar;

ii. të cilat nuk i bëhen të ditura publikut;

iii. të cilat nxirren në përputhje me parimet, standardet dhe procedurat, që sigurojnë integritetin dhe pavarësinë e duhur të veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, siç parashikohet nga rregulloret e miratuara nga Autoriteti; dhe

iv. të cilat nuk kanë të bëjnë me instrumente financiare të emetuara nga shteti përkatës i bankës qendrore.

3. Në kuptim të këtij ligji, sa më poshtë nuk konsiderohen si vlerësime të rrezikut të kreditit:

a) rekomandimet, të cilat përfshijnë të dhëna kërkimore ose informacione të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë, në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar, një strategji investimi për një ose disa instrumente investimi ose emetues të instrumenteve të investimit, përfshirë çdo opinion për vlerën aktuale ose të ardhshme ose çmimin e këtyre instrumenteve, të cilat shpërndahen nëpërmjet kanaleve të shpërndarjes ose i drejtohen publikut;

b) të dhënat kërkimore për investimet lidhur me kërkesat organizative dhe operacionale të shoqërive komisionere;

c) format e tjera të rekomandimeve të përgjithshme, si “bli”, “shit” ose “mbaj”, për transaksionet me instrumente të investimeve ose me detyrime financiare; ose

ç) opinionet nga pjesëmarrësit e tregut për vlerën e një instrumenti investimi ose një detyrimi financiar.

Neni 235

Aplikimi për licencë për të themeluar dhe operuar një agjenci vendase të vlerësimit të rrezikut të kreditit

1. Autoriteti miraton kërkesën për licencë si Agjenci e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit vetëm kur konsideron se operatori i agjencisë është i aftë dhe i përshtatshëm dhe se sistemet e tij janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Operatori i Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit i jep Autoritetit të gjithë informacionin që mund të kërkohet nga ky i fundit për veprimtaritë e propozuara, përfshirë ato tregtare dhe strukturën organizative të nevojshme, në mënyrë që Autoriteti të mund të vlerësojë nëse operatori i Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit ka marrë, në momentin e licencimit, të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Çdo kërkesë për licencë si operator i një Agjencie të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, e cila bëhet në zbatim të këtij ligji, duhet të shoqërohet me:

a) informacion për çdo masë që operatori zbaton ose propozon të zbatojë për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të tij; dhe

b) informacion për masat organizative.

4. Operatori i Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, të cilit i është dhënë licencë në zbatim të këtij ligji, është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhshmëri me këtë ligj dhe me çdo akt nënligjor të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 236

Refuzimi i licencës

Autoriteti refuzon licencën për Agjenci të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit:

a) nëse subjekti kërkues nuk përmbush ndonjë prej kërkesave për licencim dhe në veçanti nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, organit drejtues dhe funksionarëve kryesorë;

b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet sipas këtij ligji; dhe

c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:

i. lidhjet e ngushta midis Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër që rregullojnë aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë me të cilët ka lidhje të ngushta agjencia e vlerësimit kreditor;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 237

Kërkesat organizative për operatorin e Agjencisë vendase të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Personi, i cili administron efektivisht aktivitetin tregtar dhe veprimtaritë e Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, duhet të përmbushë kërkesat e aftësisë dhe përshtatshmërisë sipas nenit 13 të këtij ligji dhe të ketë reputacion të mirë e përvojë të mjaftueshme për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të agjencisë.

2. Operatori i Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit i njofton Autoritetit identitetin dhe çdo ndryshim të mëpasshëm të personit që në mënyrë efektive drejton aktivitetin tregtar dhe veprimtaritë e Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit përpara se të zbatohen këto ndryshime.

3. Autoriteti nuk miraton ndryshimet e propozuara kur gjykon se ka arsye për të besuar se personi ose personat e propozuar për të drejtuar aktivitetin tregtar të Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit rrezikon ose rrezikojnë në mënyrë thelbësore administrimin dhe veprimtarinë e shëndoshë e të kujdesshme të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Neni 238

Rregulloret për operatorin e Agjencisë së licencuar vendase të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

Autoriteti mund t'i kërkojë me rregullore operatorit të Agjencisë vendase të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit të marrë masat e nevojshme organizative:

a) për të identifikuar qartë dhe për të administruar pasojat e mundshme negative, që mund të shkaktohen në aktivitetin e përditshëm tregtar apo klientëve, si pasojë e konfliktit të interesit midis interesit të aksionarëve apo ortakëve të operatorit ose operatorit dhe funksionimit të shëndoshë të veprimtarisë tregtare;

b) për të qenë i pajisur në mënyrë adekuate për të administruar rreziqet ndaj të cilave ekspozohet, për të zbatuar masat dhe sistemet e duhura për identifikimin e të gjitha rreziqeve të rëndësishme ndaj veprimtarisë së tij dhe për të zbatuar masa efektive për zbutjen e këtyre rreziqeve;

c) për administrimin e shëndoshë të operacioneve teknike të sistemeve, përfshirë edhe nënkontraktimin tek të tretë dhe miratimin e masave efektive rezervë për t'i bërë ballë rrezikut të ndërprerjes së funksionimit të sistemeve;

ç) për të siguruar verifikimin e mjaftueshmërisë dhe cilësisë së informacionit mbi të cilin agjencia bazon vlerësimet e saj;

d) për të siguruar dhënien e informacionit për modelet, metodikat dhe supozimet kyçe mbi të cilat bazohen vlerësimet;

dh) për të publikuar një raport vjetor të transparencës;

e) për krijimin e një funksioni të brendshëm për të kontrolluar cilësinë e vlerësimeve të dhëna nga agjencia; dhe

ë) për të siguruar, në momentin e licencimit dhe në vijimësi, burime të mjaftueshme financiare për të mundësuar funksionimin e rregullt të saj, duke mbajtur parasysh natyrën dhe shtrirjen e veprimtarisë tregtare, si dhe natyrën dhe shkallën e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet.

Neni 239

Njohja e Agjencisë së huaj të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Çdo person juridik, i licencuar ose i njohur si Agjenci e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit në një vend të huaj mund të paraqesë kërkesë për njohje si Agjenci e huaj e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit pranë Autoritetit.

2. Autoriteti mund të miratojë rregullore lidhur me mënyrën dhe formatin e kërkesës.

3. Nëse Autoriteti gjykon se operatori i agjencisë së huaj të vlerësimit të rrezikut të kreditit përmbush kërkesat e pikës 4, të këtij neni, Autoriteti njeh subjektin kërkues si agjenci e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit.

4. Kriteret për njohjen si Agjenci e huaj e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit janë si më poshtë:

a) konsumatorëve u sigurohet mbrojtje e njëjtë me mbrojtjen që do të gëzonin nëse operatori në fjalë do të ishte i detyruar të përmbushte kërkesat e licencimit si Agjenci e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit në zbatim të kësaj pjese;

b) subjekti kërkues është i aftë dhe i gatshëm të bashkëpunojë me Autoritetin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe në mënyra të tjera; dhe

c) ekzistojnë masa adekuate për bashkëpunimin midis Autoritetit dhe personave përgjegjës për mbikëqyrjen e subjektit kërkues në vendin ose territorin në të cilin ndodhet selia qendrore e subjektit kërkues.

5. Pavarësisht sa parashikohet në këtë nen, Autoriteti njeh automatikisht të gjitha agjencitë e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, të licencuara/ regjistruara apo të njohura nga Autoriteti Evropian i Tregjeve të Titujve (ESMA).

Neni 240

Kërkesat e raportimit për Agjencinë e njohur të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Të paktën një herë në vit, çdo Agjenci e huaj e njohur e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit përgatit një raport për Autoritetin, që përfshin edhe një deklaratë nëse kanë ndodhur ngjarje, të cilat mund:

a) të ndikojnë në vlerësimin e Autoritetit nëse plotësohen kërkesat për njohjen; ose

b) të kenë ndikim në konkurrencën në treg.

2. Raporti duhet të përmbajë edhe informacione të tjera, të cilat mund të kërkohen me rregullore të miratuar nga Autoriteti.

Neni 241

Kompetenca për të dhënë urdhra në rast mospërmbushjeje

1. Ky nen zbatohet në rastet kur Autoriteti gjykon se operatori i Agjencisë së licencuar ose të njohur të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit:

a) nuk ka përmbushur ose ka mundësi të mos përmbushë kërkesat për licencim ose njohje; ose

b) nuk ka përmbushur ndonjë detyrim tjetër, që i vendoset nga ky ligj ose në zbatim të këtij ligji ose të ndonjë akti nënligjor të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

2. Autoriteti mund t'i japë urdhër operatorit të Agjencisë së licencuar ose të njohur të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit të marrë masa të caktuara me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me:

a) kërkesat për licencim ose njohje; ose

b) çdo detyrim tjetër ligjor.

Neni 242

Heqja e licencës ose njohjes së Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Nëse në vlerësimin e Autoritetit, Agjencia e licencuar ose e njohur e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit ka shkelur ndonjë dispozitë të këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose për zbatimin e pretenduar të dispozitave ligjore i ka dhënë Autoritetit informacione të rreme, të pasakta ose

keqinformuese, ose ka shkelur ndonjë ndalim ose kërkesë të vendosur në zbatim të këtij ligji, Autoriteti mund të urdhërojë me shkrim:

a) heqjen e licencimit ose njohjes së personit në fjalë; ose

b) pezullimin e licencës ose njohjes së personit në fjalë për një periudhë të përcaktuar ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje të caktuar ose deri në përmbushjen e kushteve të caktuara.

2. Pezullimi sipas këtij neni nuk mund të bëhet për një periudhë më të gjatë se tre muaj. Megjithatë, nëse e konsideron të nevojshme, Autoriteti mund të zgjasë afatin e pezullimit për një periudhë tjetër jo më të gjatë se tre muaj. Autoriteti përcakton me rregullore rastet se kur zgjatet afati i pezullimit.

3. Në përfundim të periudhës së pezullimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, Autoriteti duhet të heqë masën e pezullimit ose të heqë licencën, regjistrimin ose njohjen, siç e gjykon të përshtatshme Autoriteti.

4. Autoriteti mund të heqë ose të pezullojë licencën ose njohjen pa i dhënë personit në fjalë mundësi të shprehet kur:

a) personi bëhet subjekt i një procedure likuidimi ose falimentimi;

b) personi kryen veprimtari të rregulluara jashtë objektit të licencës;

c) është emëruar një administrator falimentimi ose një administrator tjetër i ngjashëm për një pjesë të konsiderueshme të pasurisë së personit të licencuar ose të njohur;

ç) personi pushon së ushtruari veprimtarinë e rregulluar për një periudhë prej më shumë se 30 ditësh, me përjashtim të rastit kur ka marrë miratimin paraprak nga Autoriteti;

d) anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose punonjësit kyç të personit në fjalë, në vlerësimin e Autoritetit, nuk kanë kryer detyrat e tyre në mënyrë të ndershme dhe të drejtë;

dh) personi ka shkelur ose nuk ka përmbushur një kusht të zbatueshëm në lidhje me licencën ose njohjen;

e) personi nuk ka zbatuar një urdhër të Autoritetit;

ë) personi nuk i jep Autoritetit informacionet e kërkuara nga ky i fundit;

f) personi jep informacion të rremë ose keqinformues;

g) personi nuk është më i aftë dhe i përshtatshëm për të ushtruar aktivitetin e licencuar ose njohur; ose

gj) personi shkel ndonjë dispozitë tjetër të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

5. Në rastin e një personi të huaj të njohur, Autoriteti mund të konsultohet me autoritetin e huaj rregullator përkatës përpara dhënies së urdhrit në zbatim të këtij neni, me përjashtim të rastit kur e çmon thelbësore në interes të investitorëve që urdhri të jepet menjëherë.

6. Autoriteti bën njoftim publik për çdo vendim të marrë sipas këtyre parashikimeve.

KREU VI
OFERTA E TITUJVE DHE SHOQËRITË E LISTUARA

SEKSIONI I
KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR OFERTËN E TITUJVE

Neni 243
Oferta e titujve

1. Titujt e emetuar nëpërmjet ofertës së titujve drejtuar publikut duhet të listohen në një treg të rregulluar, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 244 dhe 245 të këtij ligji.

2. Titujt e emetuar nëpërmjet ofertës së titujve, objekt i përjashtimeve të neneve 244 dhe 245 të këtij ligji, mund të listohen dhe pranohen për tregtim vullnetarisht në një treg të rregulluar. Listimi dhe pranimi për tregtim i këtyre titujve, objekt përjashtimi të neneve 244 dhe 245 të këtij ligji, shoqërohet me publikimin e prospektit të plotë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, me përjashtim të shkronjave “a”, “d”, “dh” dhe “e” të nenit 245 të këtij ligji.

3. Asnjë person nuk duhet të bëjë ofertë për nënshkrim ose blerje titujsh në Republikën e Shqipërisë, me qëllim kërkimin e fondeve nga publiku, nëse kjo ofertë nuk bëhet nëpërmjet një prospekti të plotë të nxjerrë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e Autoritetit, duke përjashtuar rastet e parashikuara në nenet 244 dhe 245 të këtij $^{li}g^{ji}$.

4. Në rastin e emetimit të titujve të borxhit, për të cilët kërkohet nxjerrja e një prospekti apo

aktoferte në zbatim të këtij ligji, obligacionmbajtësit caktojnë një përfaqësues, i cili është përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre. Në rast se nuk është e mundur që obligacionmbajtësit të zgjedhin përfaqësues, ky përfaqësues zgjidhet nga emetuesi. Përfaqësues të obligacionmbajtësit mund të jenë shoqëritë komisionere dhe shoqëri të tjera të caktuara nga obligacionmbajtësit. Nuk mund të zgjidhen si përfaqësues të obligacionmbajtësve administratorët apo personat që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me emetuesin. Pagesa e përfaqësuesit të obligacionmbajtësve paguhet nga emetuesi.

Neni 244
Përjashtimet nga publikimi i prospektit

1. Kërkesa për nxjerrjen e prospektit të plotë nuk zbatohet:

a) për ofertën e titujve, e cila u drejtohet vetëm palëve të pranueshme, investitorëve profesionistë dhe/ose të kualifikuar;

b) për ofertën e titujve, e cila u drejtohet më pak se 100 investitorëve të ndryshëm nga investitorët e përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike, të përllogaritur në numër total përgjatë një periudhe 12-mujore;

c) për ofertën e titujve, kur vlera për njësi e titullit është të paktën 6.000.000 lekë, 50.000 euro ose 50.000 USD;

ç) për ofertën e titujve, e cila u jepet vetëm klientëve që blejnë tituj me një vlerë prej të paktën 6.000.000 lekësh, 50.000 eurosh ose 50.000 USD- sh për klient, për çdo ofertë veçmas;

d) për aksionet e emetuara në zëvendësim të aksioneve të së njëjtës kategori, të emetuara më parë, nëse emetimi i aksioneve të reja nuk përfshin zmadhim të kapitalit të emetuar;

dh) aksionet e emetuara në funksion të rritjes së kapitalit fillestar, kur aksionet blihen nga aksionerët ekzistues

e) për titujt e ofruar në lidhje me marrjen në kontroll nëpërmjet një oferte për këmbim titujsh, me kusht që publikut t'i vihet në dispozicion një dokument, ku të jepen informacione për transaksionin dhe ndikimin që ka transaksioni tek emetuesi;

ë) për titujt e ofruar, që janë shpërndarë ose që do të shpërndahen në lidhje me një bashkim ose ndarje shoqërie tregtare, me kusht që publikut t'i vihet në dispozicion një dokument, ku të jepen informacione për transaksionin dhe ndikimin që ka transaksioni tek emetuesi;

f) për dividendët e paguar aksionarëve ekzistues në formën e aksioneve të së njëjtës klasë me aksionet për të cilët paguhen këta dividendë, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument, i cili përmban informacion për numrin, natyrën e aksioneve, arsyet dhe detajet e ofertës;

g) për titujt e ofruar, që u janë shpërndarë apo që do t'u shpërndahen anëtarëve ekzistues ose të mëparshëm të organeve drejtuese ose punonjësve ekzistues ose të mëparshëm, nga punëdhënësi i tyre ose nga një shoqëri e lidhur me të, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument, i cili përmban informacion për numrin, natyrën e titujve, arsyet dhe detajet e ofertës ose shpërndarjes;

gj) për tituj jo të pjesëmarrjes në kapital, të emetuar në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur nga një bankë, kur shuma totale agregate e titujve të ofruar është më e vogël se 8 miliardë lekë për bankë, e llogaritur për një periudhë 12- mujore, me kusht që këta tituj:

1. të mos jenë të nënrenditur (borxh i varur), të konvertueshëm ose të këmbyeshëm;

ii. të mos japin të drejtë për të nënshkruar ose blerë lloje të tjera titujsh dhe të mos jenë të lidhur me një instrument derivativ.

2. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni dhe, pavarësisht parashikimeve të nenit 243 të këtij ligji, kërkesa për nxjerrjen e një prospekti të plotë nuk zbatohet për ofertën e titujve me vlerë totale më të vogël se 130.000.000 lekë, e llogaritur gjatë një periudhe 12-mujore.

Neni 245
Titujt e përjashtuar

Përjashtohen nga detyrimi për të publikuar prospekt ose dokument tjetër, sipas kërkesave të këtij ligji:

a) titujt e emetuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë;

b) aksionet e emetuara gjatë krijimit të një shoqërie aksionare me ofertë private;

c) aksionet e emetuara në funksion të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë tregtare duke përdorur për këtë qëllim fitimin, rezervat ose fitimin e pashpërndarë;

ç) kuotat e emetuara nga sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat kanë detyrimin për të publikuar prospekt sipas ligjit në fuqi “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;

d) titujt jo të pjesëmarrjes në kapital të emetuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një prej autoriteteve rajonale ose vendore të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, nga organizmat publikë ndërkombëtarë, ku janë anëtarë një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian, nga Banka Qendrore Evropiane ose nga bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;

dh) aksionet e kapitalit të bankave qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;

e) titujt e garantuar pa kushte dhe në mënyrë të parevokueshme nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një prej autoriteteve rajonale ose vendore të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian.

Neni 246

Regjistrimi i emetimit të titujve nga Autoriteti

1. Çdo person, që propozon të bëjë një ofertë publike të titujve që do të listohen në një bursë, duhet të regjistrojë emetimin pranë Autoritetit.

2. Shoqëria e listuar duhet të regjistrojë pranë Autoritetit:

a) çdo emetim të ri ose ofertë për shitjen e titujve publikut, pavarësisht nëse ky emetim ose ofertë shitjeje bëhet me ofertë publike apo ndryshe;

b) emetimin e të drejtave për t'u nënshkruar aksione aksionarëve ekzistues;

c) emetimin e aksioneve në formë shpërblimi për aksionarët ekzistues; dhe

ç) marrëveshjet e ristrukturimit, skemat e riorganizimit, skemat e marrjes në kontroll, skemat e opsioneve për aksione dhe marrjet në pronësi të aktiveve nëpërmjet emetimit të titujve.

3. Çdo regjistrim i ofertave të tilla të titujve duhet t'i njoftohet Autoritetit brenda një periudhe prej tridhjetë ditësh kalendarike, nëse Autoriteti nuk përcakton afat tjetër me shkrim.

4. Këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i çdo shoqërie të listuar merr masat që shoqëria të jetë në përputhje me rregulloret dhe kërkesat e bursës në të cilën është listuar, në mënyrë të vazhdueshme për sa kohë që shoqëria vijon të jetë e listuar në atë bursë.

Neni 247

Emetuesit me seli jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Emetuesi me seli jashtë Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë tituj në Republikën e Shqipërisë duke ofruar një prospekt të përgatitur në përputhje me ligjet e vendit të origjinës, me kusht që:

a) prospekti është përgatitur në përputhje me kërkesa e vendit të origjinës dhe është miratuar nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës;

b) kërkesat për informacion, të vendosura nga vendi i origjinës, janë ekuivalente me kërkesat për informacion të kërkuara nga ky ligj.

c) autoriteti kompetent i vendit të origjinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me Autoritetin në kuadër të marrëveshjes së IOSCO-s (Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve).

2. Emetuesi me seli jashtë Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë tituj në Republikën e Shqipërisë duke dorëzuar një prospekt apo aktofertë të përgatitur në përputhje me kërkesat e këtij ligji, me kusht që:

a) autoriteti kompetent i vendit të origjinës ka nënshkruar marrëveshje për shkëmbimin e informacionit me Autoritetin në kuadër të marrëveshjes së IOSCO-s (Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve); ose

b) emetimi kryhet nëpërmjet një shoqërie komisionere, e cila garanton vërtetësinë e informacionit që jepet në prospekt apo aktofertë. Në këtë rast shoqëria komisionere është përgjegjëse dhe subjekt i sanksioneve të parashikuara në këtë ligj në rast të shkeljeve të kryera nga emetuesi.

3. Prospekti apo aktoferta në të gjitha rastet ofrohet në gjuhën shqipe.

4. Pasqyrat financiare të emetuesit me seli jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të përgatitura sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (SNRF).

Në lidhje me parashikimet e shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti miraton rregullore se çfarë konsiderohet si kërkesë ekuivalente në zbatim të këtij ligji.

SEKSIONI II
PROSPEKTI

Neni 248
Kompetencat dhe detyrimet e Autoritetit

1. Autoriteti mund të bëjë parashikime të mëtejshme me rregullore për formën dhe përmbajtjen e prospektit të plotë, elementet kryesore të të cilit parashikohen në nenet 249-281 të këtij ligji.

2. Në rastin e përjashtimeve nga prospekti, të parashikuara në nenin 244 të këtij ligji, përgatitet një aktofertë sipas formës së parashikuar me rregullore nga Autoriteti.

3. Prospekti ose çdo dokument tjetër i përgatitur nga personi që bën ofertën, pavarësisht nëse oferta i bëhet publikut përpara listimit në bursë, duhet të jetë në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti.

4. Autoriteti regjistron aktofertat sipas procedurës së parashikuar me rregullore.

5. Autoriteti miraton dhe regjistron çdo prospekt të përgatitur nga një person që ofron tituj me qëllimin e marrjes së fondeve nga publiku, si dhe çdo prospekt të plotë që kërkohet nga ky ligj.

6. Autoriteti verifikon nëse prospekti i plotë përmban të gjithë informacionin e kërkuar sipas neneve 249-281 të këtij ligji. Autoriteti nuk verifikon saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në prospekt, si dhe nuk mban përgjegjësi për saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në prospekt.

7. Autoriteti merr vendim për miratimin e draftprospektit brenda 30 ditëve të punës nga depozitimi i dokumentacionit të plotë. Ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera në rast të një emetuesi të ri, i cili nuk ka publikuar më përpara prospekt.

8. Në rast se Autoriteti gjykon se draftprospekti nuk ka përmbushur standardet e kërkuara sipas neneve 249-281 të këtij ligji, duhet:

a) të njoftojë emetuesin brenda limitit kohor të përcaktuar në këtë nen;
b) të specifikojë ndryshimet apo informacionin shtesë që kërkohet.

Në këto raste, limiti kohor i përcaktuar në këtë nen aplikohet nga data kur draftprospekti i rishikuar së bashku me informacionin shtesë të kërkuar depozitohen në Autoritet.

9. Në rastet kur emetuesi nuk është në gjendje ose nuk ka dëshirë të bëjë ndryshimet e kërkuara dhe të ofrojë informacionin shtesë, Autoriteti ka të drejtë të refuzojë miratimin e prospektit dhe të përfundojë procesin e rishikimit.

Në këto raste Autoriteti njofton emetuesin për këtë vendim, duke shpjeguar edhe arsyet për refuzimin.

10. Mosmarrja e vendimit brenda afatit të përcaktuar në këtë nen nuk nënkupton miratim të prospektit në heshtje.

Neni 249
Përbërja e prospektit

1. Prospekti duhet të përfshijë:

a) dokumentin e regjistrimit, i cili përmban informacion për emetuesin;
b) një shënim mbi titullin, i cili përmban informacion për titullin/titujt që do t'i ofrohen publikut apo do të pranohen në një treg të rregulluar; dhe
c) përmbledhjen e prospektit.

2. Prospekti duhet të përfshijë informacionin që kërkohet sipas përcaktimit të neneve 250-281 të këtij ligji.

3. Prospekti mund të paraqitet si një dokument i vetëm ose si disa dokumente të veçanta.

4. Çdo ngjarje e rëndësishme, gabim ose pasaktësi materiale në lidhje me informacionin e përfshirë në prospekt, e cila mund të ndikojë në vlerësimin e titujve dhe që ndodh ndërmjet kohës që prospekti miratohet dhe mbylljes së periudhës së ofertës, dhe mbylljen e periudhës së ofertës dhe kohën kur titujt pranohen për tregtim në treg të rregulluar, duhet të jepet në një suplement që i shtohet prospektit pa vonesa nga emetuesi. Forma dhe përmbajtja e këtij suplementi përcaktohen me rregullore nga Autoriteti.

5. Autoriteti mund të bëjë parashikime të mëtejshme me rregullore në lidhje me formën dhe përmbajtjen e dokumenteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 250
Përgjegjësia për informacionin

1. Të gjithë personat përgjegjës për informacionet që jepen në dokumentin e regjistrimit dhe, sipas rastit, për disa pjesë të caktuara të tyre, duhet të identifikohen në dokument, duke saktësuar edhe pjesët përkatëse për të cilat janë përgjegjës. Në rastin e personave fizikë/individëve, përfshirë edhe anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, përcaktohet edhe emri dhe funksioni i personit; në rastin e personave juridikë, bëhet i ditur emërtimi dhe selia e regjistruar.

2. Një deklaratë nga personat përgjegjës për dokumentin e regjistrimit se kanë treguar të gjithë kujdesin e arsyeshëm për të siguruar që, dhe se në dijeninë e tyre, informacioni që përmban dokumenti i regjistrimit përputhet me faktet dhe nuk përjashton asnjë informacion që do të cenonte faktet e paraqitura në të.

3. Kur informacionet kanë si origjinë një person të tretë, jepet një konfirmim se këto informacione janë riprodhuar me saktësi dhe për aq sa ka dijeni emetuesi dhe është në gjendje të vlerësojë nga informacionet e publikuara nga pala e tretë, nuk është përjashtuar asnjë informacion që do ta bënte të pasaktë apo keqinformues informacionin e riprodhuar. Përveç kësaj, identifikohet burimi ose burimet e informacionit.

Neni 251
Audituesit ligjorë

1. Emrat dhe adresat e audituesve të emetuesit për periudhën e mbuluar nga pasqyrat financiare vjetore përcaktohen në dokumentin e regjistrimit.

2. Nëse audituesit kanë dhënë dorëheqjen, janë shkarkuar ose nuk janë riemëruar gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare vjetore, bëhen të ditura të dhënat nëse kanë rëndësi thelbësore.

Neni 252
Faktorët e rrezikut

1. Dokumenti i regjistrimit përmban në mënyrë të dukshme në një rubrikë të titulluar “Faktorët e rrezikut” një përshkrim të faktorëve të rrezikut me rëndësi thelbësore të lidhura me emetuesin për një numër të kufizuar kategorish.

2. Në secilën kategori duhet të përmenden fillimisht rreziqet thelbësore, sipas gjykimit të emetuesit, ofertuesit ose personit që kërkon pranimin në tregtim në një treg të rregulluar, duke mbajtur parasysh ndikimin e tyre tek emetuesi dhe probabilitetin e shfaqjes së tyre. Rreziqet duhet të argumentohen në dokumentin e regjistrimit.

Neni 253
Informacioni për emetuesin

Informacioni për emetuesin përfshin si më poshtë:

1. Historikun dhe zhvillimin e emetuesit.

2. Emërtimin dhe emrin tregtar të emetuesit.

3. Vendin e regjistrimit të emetuesit, numrin e regjistrimit dhe numrin e identifikimit si subjekt juridik.

4. Datën e themelimit dhe kohëzgjatjen e emetuesit, nëse nuk është themeluar për një periudhë të pacaktuar.

5. Selinë qendrore dhe formën juridike të emetuesit, legjislacionin në bazë të të cilit ushtron aktivitet emetuesi, vendin e themelimit dhe adresën, numrin e telefonit të selisë së regjistruar (ose vendin kryesor të veprimtarisë tregtare nëse nuk është i njëjtë me selinë e regjistruar) dhe faqen në internet së bashku me një paralajmërim se informacioni në faqen në internet nuk është pjesë e prospektit.

Neni 254
Përshkrimi i aktivitetit

Përshkrimi i aktivitetit ndahet sipas kategorive të parashikuara në nenet 255—272 të këtij ligji.

Neni 255
Veprimtaritë kryesore

Në rubrikën "Veprimtaritë kryesore" përfshihet:

1. Përshkrimi i faktorëve kryesorë për natyrën e operacioneve të emetuesit dhe veprimtaritë e tij kryesore, duke përcaktuar kategoritë kryesore të produkteve të shitura dhe/ose shërbimeve të kryera për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike të pasqyrave financiare vjetore.

2. Një përshkrim i çdo produkti dhe/ose shërbimi të ri të rëndësishëm të futur rishtazi, me kusht që zhvillimi i këtyre produkteve apo shërbimeve të reja të jetë bërë publik dhe të tregohet statusi i zhvillimit të tyre.

Neni 256
Tregjet kryesore

1. Një përshkrim i tregjeve kryesore, në të cilat konkurron emetuesi, përfshirë një pasqyrë të të ardhurave sipas segmenteve të tregut të produktit dhe atij gjeografik për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike të pasqyrave financiare vjetore. Ngjarjet e rëndësishme në zhvillimin e aktivitetit tregtar të emetuesit.

2. Burimin e çdo deklarate të bërë nga emetuesi lidhur me pozicionin e tij konkurrues në treg.

Neni 257
Strategjia dhe objektivat

1. Një përshkrim i strategjisë dhe objektivave tregtarë të emetuesit (financiarë dhe jofinanciarë, nëse ka). Ky përshkrim mban parasysh sfidat dhe perspektivat e ardhshme të emetuesit.

2. Nëse janë të një rëndësie thelbësore për veprimtarinë tregtare ose të ardhurat e emetuesit, informacione përmbledhëse për nivelin e vartësisë së emetuesit nga patenta ose licenca, kontrata industriale, tregtare ose financiare ose procese të reja prodhimi.

3. Burimin e çdo deklarate të bërë nga emetuesi për pozicionin e tij konkurrues në treg.

Neni 258
Investimet

1. Një përshkrim (përfshirë shumën) të investimeve kryesore të emetuesit për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare deri në datën e dokumentit të regjistrimit.

2. Një përshkrim të investimeve kryesore të emetuesit, të cilat janë në proces ose për të cilat janë marrë përsipër angazhime, përfshirë shpërndarjen gjeografike të këtyre investimeve (brenda dhe jashtë vendit) dhe mënyrën e financimit (të brendshëm ose të jashtëm).

3. Informacion në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta, ku emetuesi është pjesëmarrës, dhe shoqëritë në të cilat emetuesi zotëron një pjesëmarrje të tillë në kapital, që ka mundësi të ketë një efekt të konsiderueshëm në vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve të veta, pozicionit financiar ose fitimit dhe humbjes.

4. Një përshkrim i çdo problemi mjedisor, që mund të ndikojë në përdorimin që u bën emetuesi aktiveve afatgjata materiale.

Neni 259
Struktura organizative

1. Nëse emetuesi është pjesë e një grupi, në strukturën organizative duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i grupit dhe i pozicionit të emetuesit brenda grupit. Kjo mund të jetë në formën e një diagrami të strukturës organizative ose mund të shoqërohet me një diagram të tillë, nëse kjo ndihmon në sqarimin e strukturës.

2. Një listë e shoqërive të kontrolluara më të rëndësishme, përfshirë emrin, vendin e themelimit ose vendin e selisë, pjesën e interesit të pronësisë, dhe, nëse është e ndryshme, të drejtat e votës që zotëron, duhet të jepen në strukturën organizative.

Neni 260
Aktivet afatgjata materiale

1. Informacion për aktivet afatgjata materiale, ekzistuese ose të planifikuara, përfshirë pronat me qira dhe çdo barrë të vendosur mbi to.

2. Një përshkrim i çdo problemi mjedisor, që mund të ndikojë në përdorimin që u bën emetuesi aktiveve afatgjata materiale.

Neni 261
Vlerësimi operacional dhe financiar

1. Për aq sa nuk mbulohet diku tjetër në dokumentin e regjistrimit, të jepet një përshkrim i gjendjes financiare të emetuesit, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rezultatet e aktivitetit për çdo vit dhe për periudhat e ndërmjetme, për të cilat kërkohen të dhëna historike financiare, përfshirë shkaqet e ndryshimeve kryesore nga viti në vit në të dhënat financiare Ky informacion jepet me qëllimin për të kuptuar veprimtarinë tregtare të emetuesit në tërësi, duke dhënë një vlerësim të drejtë të zhvillimit dhe të performancës së veprimtarisë tregtare të emetuesit dhe pozicionit të tij. Vlerësimi i kryer do të jetë një analizë e drejtpeshuar dhe gjithëpërfshirëse e zhvillimit dhe rezultatit të veprimtarisë tregtare të emetuesit dhe pozicionit të tij, i përshtatur sipas madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë tregtare.

2. Për aq sa nuk mbulohet diku tjetër në dokumentin e regjistrimit dhe për aq sa është e nevojshme për të kuptuar veprimtarinë tregtare të emetuesit në tërësi, vlerësimi përmban edhe tregues për:

a) zhvillimin e mundshëm të emetuesit në të ardhmen;
b) veprimtaritë në fushën e kërkim-zhvillimit.

Neni 262
Rezultatet e aktivitetit tregtar

1. Informacion për faktorët e rëndësishëm, përfshirë ngjarje të pazakonta, të rralla ose zhvillime të reja, që ndikojnë në mënyrë thelbësore tek të ardhurat e emetuesit nga aktiviteti tregtar, duke përcaktuar masën me të cilën preken të ardhurat.

2. Kur pasqyrat vjetore financiare historike paraqesin ndryshime thelbësore në të ardhurat ose shitjet neto, jepet një përshkrim i arsyeve për këto ndryshime.

3. Informacion për çdo politikë qeveritare, ekonomike, fiskale, monetare ose politike ose faktorë që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore, ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetin tregtar të emetuesit.

Neni 263
Burimet e kapitalit

Rubrika “ Burimet e kapitalit” përfshin:

1. Informacion për burimet e kapitalit të emetuesit (afatshkurtra dhe afatgjata).

2. Një shpjegim të burimeve dhe shumave dhe një përshkrim të flukseve monetare të emetuesit.

3. Informacion për kërkesat për huamarrjen dhe strukturën e financimit të emetuesit duke përfshirë burimet e financimit.

4. Informacion për çdo kufizim për përdorimin e burimeve të kapitalit, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetin tregtar të emetuesit.

5. Informacion për burimet e financimit për investimet kryesore të përcaktuara në pikën 2 të nenit 258 të këtij ligji.

Neni 264

Kërkim-zhvillimi, patentat, licencat dhe mjedisi rregullator

Një përshkrim i mjedisit rregullator në të cilin ushtron veprimtari emetuesi dhe që mund të ketë ndikim në veprimtarinë e tij, së bashku me informacionin për çdo politikë qeveritare, ekonomike, fiskale, monetare ose politike ose faktorë, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetin tregtar të emetuesi. Kur kanë rëndësi thelbësore, të jepet një përshkrim i politikave të kërkim-zhvillimit të emetuesit për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare, përfshirë shumën e shpenzuar për veprimtari kërkim-zhvillimi të mbështetura nga emetuesi.

Neni 265

Informacion për tendencat

1. Një përshkrim të tendencave më të rëndësishëm të kohëve të fundit sa i takon prodhimit, shitjes e inventarit, kostove dhe çmimeve të shitjes që nga mbyllja e vitit të fundit financiar deri në datën e dokumentit të regjistrimit dhe i çdo ndryshimi të konsiderueshëm në ecurinë financiare të grupit që nga mbyllja e periudhës së fundit financiare, për të cilën është publikuar informacioni financiar, deri në datën e dokumentit të regjistrimit.

2. Informacion për çdo tendencë, pasiguri, kërkesë, angazhime ose ngjarje të ditura, të cilat ka mundësi të arsyeshme të kenë një ndikim thelbësor në perspektivat e emetuesit për të paktën vitin aktual financiar.

Neni 266

Parashikimet ose vlerësimet e fitimeve

1. Kur emetuesi ka publikuar një parashikim të fitimit ose një vlerësim të fitimit (që është ende i parealizuar dhe i vlefshëm), ky parashikim ose vlerësim duhet të përfshihet në dokumentin e regjistrimit.

2. Nëse është publikuar një parashikim fitimi ose një vlerësim fitimi i parealizuar, por që nuk është më i vlefshëm, atëherë ky informacion deklarohet dhe shoqërohet nga një shpjegim përse parashikimi ose vlerësimi nuk është më i vlefshëm.

3. Kur emetuesi vendos të përfshijë një parashikim të ri të fitimit ose një vlerësim të ri të fitimit, ose kur emetuesi përfshin një parashikim të publikuar më parë, ose një vlerësim fitimi të publikuar paraprakisht, parashikimi ose vlerësimi i fitimit duhet të jetë i qartë, të mos lërë vend për keqkuptime dhe të shoqërohet nga një deklaratë, e cila përcakton supozimet kryesore mbi të cilat e ka mbështetur emetuesi parashikimin ose vlerësimin.

4. Parashikimi ose vlerësimi kryhet në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) duhet të ketë dallim të qartë midis supozimeve rreth faktorëve që mund të ndikohen nga anëtarët e organeve drejtuese dhe supozimeve rreth faktorëve që janë plotësisht jashtë ndikimit të tyre;

b) supozimet duhet të jenë të arsyeshme, lehtësisht të kuptueshme për investitorët, specifike dhe precize dhe të mos lidhen me saktësinë e përgjithshme të vlerësimeve mbi të cilat bazohet parashikimi;

c) në rastin e parashikimit, supozimet duhet të tërheqin vëmendjen e investitorit te faktorët e pasigurt, të cilët mund të ndryshojnë rezultatin e parashikimit në mënyrë thelbësore.

5. Parashikimet ose vlerësimet duhet të shoqërohen nga një raport i përgatitur dhe i miratuar nga këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës, ku të shprehet se parashikimi ose vlerësimi është kryer në mënyrën e duhur dhe se baza kontabël e përdorur për parashikimin apo vlerësimin e fitimit është në përputhje me standardet kontabël të emetuesit.

6. Prospekti duhet të përfshijë një deklaratë se parashikimi ose vlerësimi i fitimit është hartuar mbi bazën e deklaruar dhe se kjo bazë është:

a) e krahasueshme me informacionet e pasqyrave financiare vjetore historike;

b) në përputhje me politikat kontabël të emetuesit.

Neni 267

Të dhënat për administrimin

Në lidhje me administrimin e shoqërisë emetuese, jepen emrat, adresat dhe funksionet që mbajnë

pranë emetuesit, si edhe informacion për veprimtaritë kryesore të kryera jashtë emetuesit, kur këto janë të rëndësishme për emetuesin, për personat e mëposhtëm:

a) anëtarët e organeve drejtuese ose mbikëqyrëse;

b) aksionarët;

c) themeluesit, nëse emetuesi është krijuar brenda pesë vjetëve të fundit; dhe

ç) çdo funksionar kryesor, i cili ka rëndësi për të vlerësuar nëse emetuesi ka ekspertizën dhe përvojën e duhur për administrimin e veprimtarisë të tij tregtare.

Neni 268

Shpërblimi dhe përfitimet

1. Në rubrikën "Shpërblimi dhe përfitimet" janë shumat e shpërblimit të paguar (përfshirë çdo kompensim të kushtëzuar ose të shtyrë) dhe përfitimet në natyrë, që u jepen personave të tillë nga emetuesi dhe shoqëritë e tij të kontrolluara për shërbimet e ofruara emetuesit dhe shoqërive e tij të kontrolluara.

2. Ky informacion duhet të jepet në mënyrë individuale, përveç rastit kur dhënia e informacionit në mënyrë individuale nuk kërkohet në vendin e origjinës së emetuesit dhe është bërë publike nga emetuesi.

3. Shumat totale të vëna rezervë ose të akumuluara nga emetuesi ose shoqëritë e tij të kontrolluara për pensione pleqërie ose për përfitime të ngjashme.

Neni 269

Praktikat e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës

1. Në lidhje me vitin e mbyllur ushtrimor të emetuesit, nëse nuk është specifikuar ndryshe, në lidhje me anëtarët e këshillit të administrimit / këshillit mbikëqyrës dhe funksionarët kryesorë, jepet informacion për datën e përfundimit të mandatit aktual, nëse ka, dhe periudhën gjatë së cilës personi ka ushtruar këtë aktivitet.

2. Për kontratat e anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose funksionarët e lartë me emetuesin ose me ndonjë prej shoqërive të kontrolluara prej emetuesit jepet informacion, ku parashikohen përfitimet nga zgjidhja e marrëdhënies së punës.

3. Për komitetin e auditimit dhe komitetin e pagave të emetuesit, nëse ka, përfshirë emrat e anëtarëve të komitetit, jepet informacion dhe një përmbledhje e rregullave në bazë të të cilave vepron komiteti.

4. Duhet të jepet një deklaratë nëse emetuesi është ose jo në përputhshmëri me regjimin e drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare, i cili është i zbatueshëm për emetuesin. Në rast se emetuesi nuk është në përputhshmëri me një regjim të tillë, duhet të përfshihet një deklaratë për këtë, së bashku me një shpjegim përse emetuesi nuk është në përputhshmëri.

5. Duhet të jepet një deklaratë për ndikimet e reja të mundshme thelbësore në drejtimin e brendshëm të shoqërisë, përfshirë ndryshimet e ardhshme në përbërjen e këshillit dhe të komiteteve (nëse për këtë është marrë tashmë vendim nga këshilli dhe/ose nga asambleja e përgjithshme).

Neni 270

Punëmarrësit

1. Lidhur me punëmarrësit, duhet të jepet informacion për numrin e punëmarrësve në fund të periudhës ose mesatarja për secilin vit ushtrimor për periudhën e mbuluar nga të dhënat e pasqyrave financiare vjetore historike deri në datën e dokumentit të regjistrimit (dhe ndryshimet e këtyre numrave, nëse janë thelbësore) dhe, nëse e mundur dhe me rëndësi, një informacion për numrin e personave të punësuar sipas kategorive kryesore të veprimtarisë dhe vendndodhjes gjeografike.

2. Nëse emetuesi punëson një numër të konsiderueshëm punonjësish të përkohshëm, jepet numri mesatar i punonjësve të përkohshëm gjatë vitit të fundit ushtrimor.

3. Lidhur me pjesëmarrjet në kapital dhe opsionet për aksione për anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, funksionarët e lartë dhe punëmarrësit të jepen të dhëna së bashku me informacionin për të drejtat e tyre të pronësisë, për aksione apo opsione për aksione të emetuesit në datën më të fundit të mundshme.

4. Duhet të jepet një përshkrim i marrëveshjeve, nëse ka, për përfshirjen e anëtarëve e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, funksionarët kryesorë ose punëmarrësve në kapitalin e emetuesit.

Neni 271

Aksionarët me pjesëmarrje të lartë

1. Për aq sa ka dijeni emetuesi, duhet të jepet emri i çdo personi, që nuk është anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse, i cili, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron interes në kapitalin ose të drejtat e votës së emetuesit, interes i cili duhet të njoftohet në bazë të ligjit që rregullon aktivitetin e emetuesit, së bashku me informacionin për vlerën e interesit të secilit prej këtyre personave në datën e dokumentit të regjistrimit. Nëse nuk ka persona të tillë, të deklarohet mungesa e interesit në fjalë.

2. Duhet të jepet një deklaratë nëse aksionarët me pjesëmarrje të lartë në kapitalin e emetuesit kanë ose jo të drejta të ndryshme vote, sipas rastit.

3. Për aq sa ka dijeni emetuesi, të deklarohet nëse emetuesi është, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në pronësi ose në kontroll të një personi tjetër, të jepet informacion për identitetin e këtyre personave të tjerë, të përshkruhet natyra e kontrollit dhe masat që janë marrë për të siguruar që nuk do të ketë abuzime me këtë kontroll.

4. Duhet të jepet edhe një përshkrim i çdo marrëveshjeje, për të cilën ka dijeni emetuesi, zbatimi i së cilës mund të sjellë ndryshim në kontrollin e emetuesit në një datë të ardhshme.

Neni 272

Transaksionet me palët e lidhura

1. Duhet të jepen, në përputhje me standardin përkatës, të dhëna për transaksione të kryera nga emetuesi me palë të lidhura gjatë periudhës së mbuluar nga të dhënat e pasqyrave financiare vjetore historike deri në datën e dokumentit të regjistrimit.

2. Nëse për emetuesin nuk zbatohen standarde të tilla, të jepen informacionet e mëposhtme:

a) natyra dhe efektet e çdo transaksioni që është, më vete ose në formë agregate, me rëndësi materiale për emetuesin. Kur transaksionet me palët e lidhura nuk janë kryer sipas kushteve të zakonshme të tregut, të jepet një shpjegim përse këto transaksione nuk janë kryer me kushte të zakonshme të tregut. Në rastin e kredive të pashlyera, përfshirë garancitë e çdo lloji, të bëhet e ditur shuma e detyrimit të mbetur; dhe

b) shuma ose përqindja që përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura në raport me xhiron e emetuesit.

Neni 273

Të dhënat financiare

Prospekti duhet të shoqërohet me:

a) informacion financiar për aktivet dhe pasivet e emetuesit, pozicionin financiar dhe rezultatin e tij ushtrimor;

b) informacion financiar historik, pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare historike të audituara të 3 vjetëve të fundit ushtrimor, ose një periudhë më të shkurtër nëse emetuesi ushtron veprimtari prej një periudhe më të shkurtër, dhe raportin e auditimit për secilin nga këto vite;

c) ndryshimin e datës së periudhës kontabël të raportimit, nëse emetuesi e ka ndryshuar këtë datë gjatë periudhës për të cilën kërkohen pasqyrat financiare vjetore historike.

ç) pasqyrat financiare vjetore historike duhet të mbulojnë të paktën 36 muaj, ose të gjithë periudhën gjatë së cilës emetuesi ka ushtruar veprimtari nëse është më e shkurtër.

Neni 274

Standardet e kontabilitetit për pasqyrat

Pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)/Standardet Kombëtare nëse aplikohen.

Neni 275

Të dhënat e përkohshme financiare dhe të tjera

1. Nëse emetuesi ka publikuar informacion financiar mbi baza tremujore ose gjashtëmujore që nga data e pasqyrave financiare të fundit të audituara, këto duhet të përfshihen në dokumentin e regjistrimit.

2. Nëse informacioni financiar tremujor ose gjashtëmujor është audituar ose është kontrolluar,

duhet të përfshihet edhe raporti i auditimit ose raporti i kontrollit. Nëse nuk janë të audituara apo të kontrolluara, atëherë deklarohet edhe ky fakt.

3. Nëse dokumenti i regjistrimit hartohet më shumë se nëntë muaj pas datës së mbylljes të pasqyrave të fundit financiare të audituara, ai duhet të përmbajë edhe informacion të ndërmjetëm financiar për të paktën gjashtë muajt e parë të vitit financiar. Ky informacion i ndërmjetëm mund të jetë i paaudituar dhe, në këtë rast, edhe ky informacion deklarohet.

4. Informacioni i ndërmjetëm financiar duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e SNRF-ve/standardet kombëtare nëse aplikohet.

Neni 276

Auditimi i pasqyrave financiare vjetore

1. Pasqyrat financiare vjetore historike duhet të jenë të audituara nga audituesi ligjor.

2. Në rast se pasqyrat financiare të vitit të fundit janë ende të paaudituara për shkak se procesi i auditimit nuk ka përfunduar ende, duhet të deklarohet se këto pasqyra financiare janë të paaudituara dhe se drejtimi i shoqërisë merr përsipër paraqitjen me vërtetësi të tyre.

Neni 277

Informacionet

1. Nga të dhënat që duhet të jepen është edhe informacioni përshkrues i politikës së emetuesit për shpërndarjen e dividendëve dhe çdo kufizim i vendosur mbi të, si dhe shuma e dividendit për aksion për secilin vit ushtrimor të mbuluar nga pasqyrat financiare vjetore historike, të korrigjuara, kur ka pasur ndryshim në numrin e aksioneve të emetuesit, për ta bërë këtë informacion të krahasueshëm.

2. Për çdo procedurë shtetërore, ligjore ose arbitrazhi, përfshirë edhe procese të tilla, që janë ende të papërfunduara apo që pritet të fillojnë, për të cilat ka dijeni emetuesi, gjatë periudhës së fundit 12-mujore, nga të cilat emetuesi dhe/ose grupi mund të ketë ose ka pasur në të shkuarën pasoja sa i takon pozicionit financiar apo fitimeve të tij, duhet të jepet informacion. Në mungesë të procedurave të tilla të lëshohet një deklaratë për të konfirmuar këtë fakt.

3. Duhet të jepet edhe një përshkrim i çdo ndryshimi të konsiderueshëm në pozicionin financiar ose pozicionin tregtues të grupit, që ka ndodhur pas mbylljes së periudhës së fundit ushtrimore për të cilën janë publikuar pasqyrat financiare të audituara ose informacionet financiare të ndërmjetme, ose, nëse nuk ka pasur ndryshime të tilla, të lëshohet një deklaratë për ta konfirmuar këtë fakt.

Neni 278

Informacion shtesë për kapitalin aksionar

1. Në lidhje me kapitalin aksionar, jepet informacioni mbi shumën e kapitalit të emetuar për çdo klasë të aksioneve, sipas të dhënave në datën e bilancit më të fundit, të përfshirë në pasqyrat financiare vjetore.

2. Shuma e kapitalit të emetuar dhe për çdo klasë të aksioneve përfshin:

a) numrin total të aksioneve të emetuesit;

b) numrin e aksioneve të emetuara dhe të paguara plotësisht dhe të emetuara, por jo të paguara plotësisht;

c) vlerën nominale për aksion; dhe

ç) një rakordim të numrit të aksioneve të papaguara në fillim dhe në fund të vitit financiar.

3. Nëse më shumë se 10% e kapitalit është paguar me kontribute në natyrë dhe jo me mjete monetare brenda periudhës së mbuluar nga informacionet e pasqyrave financiare vjetore historike, të deklarohet ky fakt.

4. Nëse ka aksione që nuk përfaqësojnë pjesëmarrje në kapital, të jepet numri dhe karakteristikat kryesore të këtyre aksioneve.

5. Numri, vlera kontabël dhe vlera nominale e aksioneve të emetuesit, të cilat mbahen nga vetë emetuesi ose nga shoqëritë e kontrolluara të emetuesit ose mbahen për llogari të emetuesit ose të shoqërive të kontrolluara të emetuesit.

6. Vlera e çdo titulli të konvertueshëm, titulli të këmbyeshëm ose titulli me garanci, duke bërë të ditura kushtet dhe procedurat për konvertimin, këmbimin ose nënshkrimin.

7. Informacion për kushtet e çdo të drejte dhe/ose detyrimi blerjeje mbi kapitalin e autorizuar, por të paemetuar ose në lidhje me angazhimin për zmadhim kapitali.

8. Informacion për kapitalin e çdo anëtari të grupit, që është objekt opsioni ose marrëveshjeje, me kushte ose pa kushte, për të qenë objekt opsioni, dhe të dhënat e opsionet të tilla, përfshirë edhe personat me të cilët lidhen këto opsione.

9. Një historik të kapitalit aksionar, me informacionin për çdo ndryshim për periudhën e mbuluar nga të dhënat e pasqyrave financiare vjetore historike.

Neni 279

Akti i themelimit dhe statuti

1. Regjistrimi në regjistrin tregtar, numri i regjistrimit në të dhe një përshkrim i shkurtër i objektit të shoqërisë, qëllimeve të emetuesit dhe informacion se ku mund të gjenden këto të dhëna në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

2. Një përmbledhje e çdo dispozite të statutit ose akteve të tjera të brendshme të emetuesit për anëtarët e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse, të cilat kanë ndryshime materiale nga sa parashikohet në ligjin në fuqi “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

3. Kur ka më shumë se një klasë aksionesh, një përshkrim i të drejtave, preferencave dhe kufizimeve që lidhen me secilën prej tyre.

4. Një përshkrim të veprimeve që duhen ndërmarrë për të ndryshuar të drejtat e aksionarëve, duke përcaktuar ndryshimet nga kërkesat ligjore, nëse ka.

5. Një përshkrim i kushteve që rregullojnë mënyrën se si thirren mbledhjet vjetore të asamblesë së përgjithshme dhe mbledhjet e jashtëzakonshme të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, përfshirë kushtet e pranimit.

6. Një përshkrim i shkurtër i çdo dispozite të statutit ose akteve të brendshme të emetuesit, që do të kishin për pasojë vonimin, shtyrjen ose pengimin e një ndryshimi në kontrollin e emetuesit.

7. Informacion nëse ka në statut ose akte të tjera të brendshme të emetuesit ndonjë dispozitë që rregullon kufirin e pjesëmarrjes në kapital, i cili është objekt publikimi.

8. Një përshkrim i kushteve të vendosura nga akti i themelimit, statuti ose ndonjë akt tjetër i brendshëm i shoqërisë, të cilat rregullojnë ndryshimet në kapitalin aksionar, kur këto kushte parashikojnë kërkesa shtesë nga ato ligjore.

Neni 280

Kontratat me rëndësi materiale

Një përmbledhje e çdo kontrate me rëndësi materiale, përveç kontratave të lidhura në rrjedhën e aktivitetit të përditshëm tregtar, në të cilën është palë emetuesi ose ndonjë anëtar i grupit, për dy vjetët e fundit përpara publikimit të dokumentit të regjistrimit. Një përmbledhje e çdo kontrate tjetër (që nuk është kontratë e lidhur në rrjedhën e aktivitetit të përditshëm tregtar) të lidhur nga çdo anëtar i grupit, e cila përmban ndonjë dispozitë në bazë të së cilës ndonjë prej anëtarëve të grupit ka ndonjë detyrim ose të drejtë, që në datën e dokumentit të regjistrimit ka rëndësi materiale për grupin.

Neni 281

Dokumentet në dispozicion

Duhet të vihet në dispozicion një deklaratë, sipas së cilës dokumentet e mëposhtme (ose kopje të tyre), kur ka, do të mund të inspektohen gjatë periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të regjistrimit:

a) statuti dhe akti i themelimit i emetuesit në variantin e tyre më të fundit;

b) të gjitha raportet, letrat dhe dokumentet, vlerësimet dhe deklaratat e tjera të përgatitura nga çdo ekspert me kërkesë të emetuesit, pjesë të të cilave janë përfshirë ose përmendur në dokumentin e regjistrimit;

c) të dhënat financiare historike të emetuesit ose, në rastin e grupit, të dhënat historike financiare për emetuesin dhe shoqëritë e kontrolluara të tij, për secilin prej dy vjetëve ushtrimor që i paraprijnë datës së publikimit të dokumentit të regjistrimit. Adresa e faqes së internetit, ku mund të konsultohen dokumentet me anë të mjeteve fizike ose elektronike.

Neni 282
Urdhri i ndalimit

1. Autoriteti mund t'i japë urdhër emetuesit të mos shpërndajë, emetojë, ofrojë ose të bëjë ftesë për të nënshkruar apo të blejë ose të shesë tituj të mëtejshëm në lidhje me ofertat, kur sipas mendimit të Autoritetit:

a) prospekti ose ndonjë dokument tjetër i ngjashëm nuk është në përputhshmëri me kërkesat e parashikuara nga Autoriteti;

b) prospekti ose ndonjë dokument tjetër i ngjashëm përmban një deklaratë ose informacion që është i rremë, keqinformues ose fsheh të dhëna me rëndësi materiale; ose

c) emetuesi ka shkelur dispozitat e këtij ligji ose të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

2. Autoriteti mund të miratojë një urdhër të përkohshëm pa i dhënë të drejtën për t'u dëgjuar emetuesit nëse Autoriteti gjykon se çdo vonesë në miratimin e një urdhri të tillë në zbatim të pikës 1 do të cenonte interesin publik.

3. Në varësi të pikave 2 dhe 4 të këtij neni, Autoriteti nuk mund të miratojë një urdhër sipas pikës 1, nëse Autoriteti nuk i ka dhënë një mundësi të arsyeshme për t'u dëgjuar personit të cenuar.

4. Urdhri i përkohshëm, i miratuar në zbatim të pikës 2 të këtij neni, nëse nuk revokohet më parë, është i vlefshëm deri në përfundimin e ditës së dytë të punës pas ditës kur është miratuar ose deri në përfundim të seancës dëgjimore të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, cilado datë që është më pas.

5. Urdhri i përkohshëm, i miratuar në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të revokohet nga Autoriteti me anë të një urdhri tjetër, nëse Autoriteti çmon se rrethanat që kanë çuar në miratimin e urdhrit të mëparshëm nuk janë më të vlefshme.

6. Kur kërkesat për të nënshkruar ose blerë tituj, për të cilat është bërë prospekti ose ndonjë dokument tjetër i ngjashëm, janë depozituar përpara nxjerrjes së urdhrit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni:

a) kur titujt nuk janë emetuar për llogari të subjekteve kërkuese, kërkesat duhet të konsiderohen se janë tërhequr dhe anuluar dhe emetuesi ose personi tjetër, i cili arkëton pagesat, duhet menjëherë të kthejë pa interes të gjitha shumat e arkëtuara nga subjekti kërkues. Nëse këto shuma nuk kthehen brenda katërmbëdhjetë ditëve nga urdhri i ndalimit, emetuesi paguan interes mbi shumat e papaguara, sipas përcaktimeve të Autoritetit, duke filluar nga përfundimi i këtij afati; ose

b) kur titujt janë emetuar për llogari të subjekteve kërkuese, emetimi i titujve duhet të konsiderohet i pavlefshëm dhe emetuesi ose çdo person tjetër duhet:

i. të kthejë menjëherë pa interes të gjitha shumat e arkëtuara nga subjektet kërkuese dhe, nëse shumat nuk kthehen brenda katërmbëdhjetë ditëve nga urdhri i ndalimit, emetuesi duhet të kthejë fondet me interes, sipas normës së interesit të përcaktuar nga Autoriteti, duke filluar nga përfundimi i këtij afati; dhe

ii. të marrë hapat e nevojshëm për të zbatuar urdhrin e ndalimit.

7. Pavarësisht nga pika 6 e këtij neni, Autoriteti nuk duhet të lëshojë urdhër ndalimi nëse ndonjë prej titujve, për të cilët është nxjerrë prospekti, është i listuar në bursë dhe tregtimi i tij ka filluar.

SEKSIONI III
PRANIMI PËR LISTIM DHE TREGTIM NË NJË TREG TË RREGULLUAR

Neni 283
Titujt e tregtuar në tregun e rregulluar

1. Titujt mund të pranohen në një treg të rregulluar vetëm nëse janë plotësuar kushtet për pranim.

2. Titujt e emetuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, në një treg të njohur nga Autoriteti ose jashtë tregut të rregulluar pa asnjë kufizim.

Neni 284
Kushtet për pranimin për tregtim në tregun e rregulluar

1. Në tregun e rregulluar mund të pranohen vetëm titujt që mund të tregtohen në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase.

2. Titujt e pranuar për tregtim në tregun e rregulluar duhet të plotësojnë këto kritere:

a) titujt për të cilët depozitohet kërkesë për pranim duhet të emetohen në përputhje me rregullat

që u zbatohen dhe duhet të jenë të transferueshëm lirisht pa asnjë kufizim;

b) të drejtat e votës duhet të jenë të barabarta për të gjithë titujt e pjesëmarrjes në kapital të emetuara nga një emetues;

c) statusi ligjor i emetuesit të titujve duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë ose të shtetit, ku ndodhet selia e regjistruar e emetuesit, si edhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

ç) emetuesi ose ofruesi i titujve duhet të zbatojë detyrimin e hartimit të një prospekti në përputhje me seksionin II të këtij kreu, me përjashtim të titujve të emetuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Neni 285

Karakteristikat e titujve të tregtuar në tregun e rregulluar

1. Titujt pranohen për tregtim në tregun e rregulluar vetëm nëse emetohen në formë të dematerializuar.

2. Në tregun e rregulluar mund të pranohen për tregtim vetëm derivativët e krijuar në atë mënyrë, që mundëson përcaktimin korrekt të çmimit dhe shlyerjen efektive.

3. Autoriteti mund miratojë parashikime të mëtejshme me rregullore për karakteristikat e titujve, që merren në konsideratë për të vlerësuar nëse instrumentet i plotësojnë kushtet e pranimit për tregtim në tregun e rregulluar.

4. Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, krahas kushteve të vendosura në këtë nen, duhet të plotësojnë edhe kushtet e parashikuara në ligjin në fuqi “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 286

Miratimi i listimit dhe tregtimit

1. Tregtimi dhe listimi i titujve në tregun e rregulluar duhet të bëhet me miratimin e bursës/operatorit të tregut.

2. Vetëm emetuesi ose personi i autorizuar nga emetuesi mund të paraqesë kërkesë për pranim për tregtim në një treg të rregulluar.

3. Titujt e pranuar për tregtim në tregun e rregulluar duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 284 të këtij ligji.

Neni 287

Refuzimi i pranimit për listim dhe tregtim

Bursa/operatori i tregut e refuzon kërkesën për pranim për tregtim të një titulli në tregun e rregulluar nëse:

a) nuk plotësohen kushtet e parashikuara në nenet 283 dhe 284 të këtij ligji;

b) sipas të dhënave të disponueshme, bursa çmon se pranimi do të ndikonte negativisht në interesat e investitorëve.

Neni 288

Vendimmarrja për pranimin për tregtim në tregun e rregulluar

1. Vendimi për pranimin e titujve për tregtim në tregun e rregulluar merret nga këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës i bursës.

2. Bursa/ operatori i tregut parashikon në rregulloren e saj kushtet që duhet të përmbushë kërkesa për pranim për t'u konsideruar e rregullt.

3. Vendimi i përmendur në pikën 1 është përfundimtar dhe subjekti kërkues mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit.

4. Bursa/operatori i tregut e informon Autoritetin për çdo kërkesë që ka marrë për pranim titujsh për tregtim dhe për vendimet e saj lidhur me këto kërkesa.

5. Bursa/operatori i tregut publikon rregullisht të gjitha të dhënat për pranimin e titujve për tregtim në tregun e rregulluar të administruar prej saj, në faqen e saj në internet.

Neni 289

Pranimi i titujve pa pëlqimin e emetuesit

1. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 2 të nenit 286 të këtij ligji, titujt e transferueshëm mund të pranohen për tregtim në tregun e rregulluar edhe pa pëlqimin e emetuesit, nëse janë pranuar në një treg tjetër të rregulluar si më poshtë:

a) një treg tjetër i rregulluar në Republikën e Shqipërisë,

b) tregu i rregulluar i një vendi tjetër ose bursa/operatori i tregut i një vendi të tretë nëse në lidhje me dispozitat e vendit tjetër:

i. kërkesat për pranimin e titujve për tregtim janë të ngjashme me ato të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji;

ii. prospekti për emetimin ose prospekti për pranimin e titujve për tregtim është i ngjashëm me prospektin që përgatitet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji;

iii. kriteret e transparencës në tregun e huaj të rregulluar janë të ngjashme me ato të tregut të brendshëm të rregulluar;

iv. është kryer shkëmbimi i informacioneve të lidhura me tregtimin me autoritetet kompetente të vendit në fjalë;

v. sigurohet procesi i klerimit dhe shlyerjes së këtyre titujve.

2. Kur titujt pranohen për tregtim në tregun e rregulluar në përputhje me këtë nen, bursa / operatori i tregut njofton emetuesin se titujt po tregtohen në tregun e rregulluar të operuar prej saj.

3. Kur titujt pranohen për tregtim në tregun e rregulluar në përputhje me këtë nen, bursa njofton Autoritetin. Ky njoftim për pranimin e titujve për tregtim bëhet publik pa vonesë.

4. Kur në përputhje me pikën 1 të këtij neni titujt pranohen për tregtim në tregun e rregulluar pa pëlqimin e emetuesit, emetuesi mund të japë pëlqimin për vijimin e tregtimit duke pranuar gjithashtu detyrimin për t'i dhënë tregut të rregulluar, në të cilin janë pranuar për tregtim titujt pa pëlqimin e tij, informacionin e nevojshëm, ose mund të kërkojë që tregtimi të ndërpritet.

Neni 290

Kushtet që duhet të përmbushin emetuesit e titujve

1. Statusi ligjor i emetuesit duhet të jetë në përputhje me rregullat e vendit në të cilin ka selinë e regjistruar, veçanërisht në lidhje me themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë.

2. Kapitalizimi i parashikuar i tregut të aksioneve, për të cilat depozitohet kërkesë për pranim në listimin zyrtar, duhet të jetë në përputhje me rregullat e bursës/operatorit të tregut për kapitalin aksionar dhe kushtet e veçanta që mund të kufizojnë pronësinë.

3. Emetuesi duhet të ketë publikuar ose depozituar raportet vjetore financiare në përputhje me legjislacionin e vendit ku ka selinë e regjistruar për tri vjetët e fundit financiare përpara depozitimit të kërkesës për pranim për tregtim në tregun e rregulluar.

4. Përjashtimisht, bursa/operatori i tregut mund ta miratojë kërkesën për pranimin në tregtim të aksioneve të emetuesve, që nuk përmbushin kushtet e këtij neni, nëse bursa/operatori i tregut mund të provojë se investitorët i kanë të dhënat e nevojshme për të vlerësuar emetuesin dhe aksionet për të cilat kërkohet pranimi për tregtim në tregun zyrtar dhe me kusht që tregtimi të jetë në interes të emetuesit ose në interes të investitorit.

Neni 291

Kushtet për aksionet që pranohen për tregtim në tregun e rregulluar

1. Nëse pranimi për tregtim në tregun e rregulluar paraprihet nga një emetim publik, pranimi i parë për tregtim mund të bëhet vetëm pas përfundimit të periudhës së nënshkrimit dhe shlyerjes në kuadër të emetimit publik.

2. Përpara pranimit të aksioneve për tregtim në tregun e rregulluar, një numër i mjaftueshëm aksionesh duhet t'i shpërndahen publikut, siç parashikohet në rregullat e prospektit.

3. Nëse aksionet i shpërndahen publikut nëpërmjet një tregu të rregulluar, pranimi për tregtim mund të miratohet pa qenë në përputhshmëri me kushtet e përmendura në këtë nen, vetëm nëse bursa/operatori i tregut merr përsipër se një numër i mjaftueshëm aksionesh do të shpërndahet nëpërmjet

tregut të rregulluar brenda një periudhe të shkurtër kohore.

4. Kur kërkesa për pranim për tregtim në tregun e rregulluar depozitohet për një bllok të mëtejshëm aksionesh të së njëjtës kategori, bursa/operatori i tregut mund ta bëjë vlerësimin e përmendur në këtë nen për numrin e mjaftueshëm të aksioneve të shpërndara për publikun, për të gjitha aksionet e emetuara dhe jo vetëm në lidhje me bllokun e dytë.

5. Bursa/operatori i tregut mund të miratojë kërkesën për pranim për tregtim në tregun e rregulluar të aksioneve të atyre emetuesve, aksionet e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar të një vendi të tretë, nëse një numër i mjaftueshëm aksionesh është shpërndarë në publik në këtë vend të tretë.

6. Në kuptim të këtij ligji, konsiderohet se publikut i është shpërndarë një numër i mjaftueshëm aksionesh nëse:

a) të paktën 25% e klasës së aksioneve për të cilat bëhet kërkesë për pranim i është shpërndarë publikut;

b) duke pasur parasysh numrin e madh të aksioneve të së njëjtës kategori dhe përqindjen e shpërndarjes së tyre publikut, tregu do të jetë në gjendje të funksionojë siç duhet edhe nëse përqindja e aksioneve që i shpërndahet publikut është më e ulët.

7. Bursa/operatori i tregut parashikon në rregulloren e tij se cilat aksione nuk konsiderohen si aksione të shpërndara për publikun.

8. Kërkesa për pranim për listim duhet të bëhet në lidhje me të gjitha aksionet e emetuara të së njëjtës klasë.

9. Përjashtimisht nga sa parashikohet në këtë nen, kërkesa për pranim nuk ka nevojë të përfshijë aksionet që:

a) u përkasin blloqeve që shërbejnë për të ruajtur kontrollin e shoqërisë; ose

b) nuk janë të negociueshme, në bazë të një kontrate, për një periudhë të caktuar kohe, me kusht që publiku të informohet për situatat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, dhe të mos ekzistojë rreziku që situata të tilla të mund të cenojnë interesat e mbajtësit të aksioneve për të cilat është bërë kërkesë për pranim.

Neni 292

Kushtet e veçanta për pranimin e titujve të borxhit

1. Forma dhe përmbajtja e titujve të borxhit, për të cilët bëhet kërkesë për pranim për tregtim në tregun zyrtar, duhet të jenë në përputhje me rregullat të cilat zbatohen. Këta tituj duhet të jenë lirisht të negociueshëm.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, bursa mund t'i trajtojë titujt e borxhit, që nuk janë shlyer plotësisht, si lirisht të negociueshëm nëse ekzistojnë mekanizma për të siguruar që negociueshmëria e këtyre titujve të borxhit nuk është e kufizuar dhe nëse tregtimi bëhet transparent dhe në formën e duhur, duke i siguruar publikut të gjitha informacionet e duhura.

3. Nëse pranimi për tregtim në tregun zyrtar paraprihet nga një emetim publik, pranimi i parë për tregtim në tregun zyrtar mund të bëhet vetëm pas përfundimit të periudhës së nënshkrimit dhe shlyerjes në kuadër të emetimit publik.

4. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në rastin e shitjes të titujve të borxhit të emetuar më parë, për të cilët afati i fundit i nënshkrimit nuk është i përcaktuar.

5. Kërkesa për pranim në listim zyrtar duhet të bëhet për të gjithë titujt e borxhit të të njëjtit rend.

Neni 293

Titujt e borxhit që janë të konvertueshëm ose që japin të drejta të tjera

1. Titujt e konvertueshëm ose të këmbyeshëm të borxhit dhe titujt e borxhit me garanci mund të pranohen për tregtim në tregun zyrtar vetëm nëse:

a) aksionet e lidhura me to janë pranuar për tregtim në të njëjtin treg të rregulluar; ose

b) aksionet e lidhura me to janë pranuar për tregtim në një treg tjetër të rregulluar; ose

c) pranohen për tregtim njëkohësisht me aksionet e lidhura me to.

2. Bursa mund ta miratojë pranimin e titujve të borxhit të përmendur në këtë nen për tregtim në tregun zyrtar vetëm nëse konstaton se mbajtësit e këtyre titujve i kanë në dispozicion të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësimin e vlerës së aksioneve me të cilat lidhen këta tituj borxhi.

Neni 294

Pranimi për tregtim në tregun e rregulluar të titujve të borxhit të emetuar nga një shtet, autoritetet e tij rajonale ose vendore ose nga një organizëm publik ndërkombëtar

1. Kur pranimi për tregtim në tregun zyrtar paraprihet nga një emetim publik, pranimi i parë për tregtim në tregun zyrtar mund të bëhet vetëm pas përfundimit të periudhës së nënshkrimit dhe shlyerjes në kuadër të emetimit publik.

2. Titujt e borxhit, të emetuar nga një vend tjetër ose nga autoritetet e tij rajonale ose vendore apo nga organizmat publikë ndërkombëtarë, duhet të garantojnë në mënyrë të mjaftueshme mbrojtjen e investitorit.

3. Përcaktimi i pikës 2 të këtij neni nuk zbatohet për nënshkrimet, për të cilat afati i fundit i nënshkrimit nuk është i përcaktuar.

4. Kërkesa për pranim për tregtim në tregun zyrtar duhet të bëhet në lidhje me të gjithë titujt e të njëjtit rend.

Neni 295

Detyrimet e emetuesit për të dhënë informacion

1. Emetuesi, titujt e të cilit pranohen për tregtim në tregun e rregulluar, ka për detyrë t'i japë bursës të gjitha informacionet, të cilat bursa i çmon të rëndësishme për mbrojtjen e investitorëve dhe për sigurimin e funksionimit të mirë të tregut.

2. Bursa i publikon këto informacione nëpërmjet sistemit të saj për informimin e publikut.

3. Kur e kërkon mbrojtja e investitorëve dhe funksionimi efektiv i tregut, bursa mund të kërkojë që emetuesi t'i bëjë publike këto informacione. Forma dhe afatet e publikimit të këtyre informacioneve përcaktohen nga Autoriteti me rregullore të veçantë.

4. Nëse emetuesi nuk i bën publike informacionet e parashikuara në këtë nen, bursa i bën publike këto informacione, pasi të ketë marrë një deklaratë nga emetuesi.

5. Bursa bën publik faktin se emetuesi nuk i përmbush detyrimet që i rrjedhin nga pranimi në një treg të rregulluar sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 296

Detyrimet e bursës për monitorim të zbatimit të rregullores së saj

1. Bursa monitoron rregullisht nëse titujt e pranuar për tregtim në tregun e rregulluar që operon i përmbushin kushtet për pranim, siç parashikohet në këtë ligj, në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe në rregulloren e saj.

2. Bursa duhet të miratojë dhe të zbatojë procedura efektive për të kontrolluar nëse emetuesit e titujve të pranuar për tregtim në tregun e rregulluar që operon janë në përputhshmëri me dispozitat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore.

3. Bursa miraton procedura dhe mjete për t'u dhënë mundësi anëtarëve dhe publikut të gjerë të kenë akses tek të dhënat dhe informacionet që bëhen publike.

Neni 297

Pezullimi dhe përjashtimi i titujve nga tregtimi

1. Bursa duhet ta pezullojë tregtimin ose të përjashtojë titullin nga tregtimi, pa vonesë, në bazë të vendimit të Autoritetit.

2. Bursa duhet të marrë vendim për pezullimin e tregtimit ose përjashtimin e titullit nga tregtimi kur këtë e kërkon mbrojtja e investitorëve, në rast se ka informacion se emetuesi ose një palë tjetër ka dhënë informacion të pamjaftueshëm ose keqinformues, si pasojë e të cilit është krijuar ose ka të ngjarë të krijohet një treg i rremë.

3. Bursa nuk e pezullon tregtimin ose nuk përjashton titullin nga tregtimi nëse pezullimi ose përjashtimi mund t'u shkaktonte dëme të konsiderueshme interesave të investitorëve ose funksionimit të duhur të tregut, me përjashtim të rastit kur ekzistojnë rrethanat e përshkruara në pikën 2 të këtij neni.

4. Bursa njofton pa vonesë Autoritetin dhe publikun për vendimin që merr në zbatim të këtij neni.

Neni 298

Vendimi i emetuesit për të tërhequr titujt nga listimi në tregun e rregulluar

1. Asambleja e përgjithshme e emetuesit mund të marrë vendim për tërheqjen e titujve nga listimi në tregun e rregulluar.

2. Vendimi i përmendur në këtë nen merret me votën e aksionarëve, që përfaqësojnë të paktën tri të katërtat e kapitalit të emetuar të përfaqësuar në asamblenë e përgjithshme gjatë marrjes së vendimit.

3. Publikimi i tërheqjes nga listimi në një treg të rregulluar, duke qenë një pikë e rendit të ditës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, është i vlefshëm vetëm nëse përfshin edhe një deklaratë të parevokueshme të shoqërisë, nëpërmjet së cilës shoqëria angazhohet t'i blejë me një çmim të drejtë aksionet e të gjithë aksionarëve që votojnë kundër një vendimi të tillë.

4. Vendimi i tërheqjes nga listimi në një treg të rregulluar duhet të përcaktojë shoqërinë, selinë qendrore, të dhënat në lidhje me titullin dhe të dhëna të tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit.

5. Secili aksionar i shoqërisë, që ka votuar kundër vendimit për tërheqjen nga listimi në një treg të rregulluar, mund t'i kërkojë shoqërisë t'ia blejë aksionet me një çmim të drejtë. Të njëjtën të drejtë e gëzon edhe aksionari që nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për shkak se mbledhja nuk është thirrur në mënyrë të saktë dhe në kohën e duhur.

6. Vendimi i tërheqjes së titujve nga listimi në një treg të rregulluar nuk mund të kundërshtohet duke u bazuar në çmimin e padrejtë të blerjes së aksioneve. E drejta e aksionarëve për të ngritur padi parashkruhet pas dy muajve nga dita kur vendimi i tërheqjes nga listimi në një treg të rregulluar miratohet nga asambleja e përgjithshme.

7. Çmimi mesatar i aksioneve, i arritur në një treg të rregulluar, i llogaritur si mesatare e ponderuar e të gjitha çmimeve të arritura në një treg të rregulluar brenda tre muajve para marrjes së vendimit të tërheqjes nga tregu i rregulluar, konsiderohet si çmim i drejtë në funksion të këtij neni.

Neni 299

Shitblerja ose transferimi i titujve

1. Personi, që zotëron titujt e një shoqërie të listuar në bursë, nuk duhet të blejë, të shesë, të dhurojë ose të tregtojë në forma të tjera këta tituj jashtë platformës së tregtimit ose sistemit të tregtimit pa miratimin paraprak të Autoritetit, përveç rastit kur ky transaksion kryhet në përputhje me procedurën e tregtimit të miratuar nga bursa.

2. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, personi mund t'ia dhurojë titujt në fjalë një personi me të cilin ka lidhje të ngushtë, pa e bërë këtë në përputhje me procedurat e tregtimit të bursës, nëse ia njofton paraprakisht dhurimin Autoritetit dhe bursës, së bashku me detajet e dhurimit të propozuar.

SEKSIONI IV

DETYRIMET PËR DHËNIEN E INFORMACIONEVE

Neni 300

Raportimet fillestare

1. Shoqëria e listuar duhet:

a) të dorëzojë pranë Autoritetit dhe të publikojë raporte në mënyrë periodike dhe të paktën çdo gjashtëmujor;

b) të njoftojë Autoritetin dhe të bëjë publike informacione për zhvillimet e konsiderueshme, të cilat mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme çmimin e tregut të titujve, jo më vonë se brenda mbylljes së ditës së dytë të punës pasi vjen në dijeni të një zhvillimi të tillë, ose më shpejt nëse është e nevojshme për të mbrojtur investitorët ose tregun.

2. Çdo emetues i një titulli të listuar për tregtim në bursë duhet të depozitojë pranë bursës edhe kopje të çdo raporti të dorëzuar pranë Autoritetit sipas kërkesave të këtij neni.

Neni 301

Kërkesat për raportim financiar

1. Autoriteti mund të parashikojë me rregullore kërkesat dhe procedurat për përmbajtjen dhe

formën e raporteve financiare të shoqërive të listuara.

2. Autoriteti mund të kërkojë zbatimin e standardeve ndërkombëtare për auditimin e raporteve financiare të shoqërive të listuara.

3. Të gjitha raportet, përfshirë pasqyrat financiare, të kërkuara për t'u depozituar pranë Autoritetit, duhet të përmbushin kërkesat për formën, informacionet dhe afatet e caktuara nga Autoriteti. Këto kërkesa janë krahas raporteve ose pasqyrave financiare që kërkohen nga dispozita të tjera të këtij ligji.

Neni 302

Kërkesat për raportimin financiar vjetor

1. Çdo shoqëri e listuar duhet të bëjë publike në kohën e duhur një raport vjetor, i cili duhet të përfshijë pasqyrat financiare, raportin e audituesit dhe raportin e administratorëve.

2. Raporti vjetor, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë të gjitha informacionet materiale lidhur me gjendjen financiare dhe performancën ushtrimore të shoqërisë në periudhën përkatëse, si edhe zhvillimin e saj e perspektivat për të ardhmen, përfshirë ndër të tjera:

a) rezultatin financiar dhe ekonomik të shoqërisë;

b) objektivat e shoqërisë;

c) aksionarët influencues dhe një përshkrim të të drejtave të votës;

ç) politikën e pagave për anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarët e lartë, si edhe informacion për anëtarët e këshillit, përfshirë kualifikimet e tyre, procesin e përzgjedhjes, postet e tjera drejtuese në shoqëri të tjera dhe faktin nëse ato konsiderohen të pavarura nga këshilli;

d) transaksionet me palët e lidhura;

dh) faktorët e parashikueshëm të rrezikut;

e) çështjet e lidhura me punonjësit dhe palët e tjera të interesit; dhe

ë) strukturat dhe politikat e drejtimit të brendshëm, në veçanti përmbajtjen e ndonjë politike ose kodi të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe procesit me të cilin vihet në zbatim.

3. Shoqëria duhet të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore të japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes së saj financiare në mbyllje të vitit ushtrimor.

Neni 303

Dhënia e informacioneve që kanë ndikim mbi çmimet

1. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të këtij neni, shoqëria e listuar duhet t'i bëjë menjëherë të ditur publikut çdo informacion për të cilin vihet në dijeni, që mund të ndikojë mbi çmimet, ka lidhje me shoqërinë ose me shoqëritë e saj të kontrolluara dhe do të kishte rëndësi materiale për vendimmarrjen e investitorit përfshirë:

a) informacionin që është i nevojshëm për t'i dhënë mundësi publikut të vlerësojë pozicionin e shoqërisë dhe të shoqërive të saj të kontrolluara;

b) informacionin që është i nevojshëm për të shmangur krijimin ose vijimin e një tregu të rremë të titujve të shoqërisë, pra një treg i cili bazohet në informacione të paplota ose të pasakta; ose

c) informacionin që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojë në mënyrë thelbësore në aktivitetin e tregut dhe në çmimin e titujve të saj.

2. Për shpërndarjen e informacionit në bazë të pikës 1, shkronjat nga “a” deri në “c”, shoqëria e listuar duhet të sigurojë që të përdorë mjete nga të cilat mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të sigurojnë mundësi informimi të barabartë në kohë dhe efektive për zotëruesit e titujve të shoqërisë dhe për investitorët.

3. Shoqëria e listuar konsiderohet se përmbush kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni kur informacioni që prek tregun ose një sektor të tregut në përgjithësi bëhet publik në atë mënyrë që ka të ngjarë t'u tërheqë vëmendjen investitorëve që zakonisht investojnë në tituj të një lloji të caktuar, çmimi ose vlera e të cilëve mund të ndikohet nga informacioni.

4. Shoqëria e listuar me përgjegjësinë e vet dhe me pëlqimin e Autoritetit, mund ta vonojë publikimin e informacioneve, që mund të ndikojnë mbi çmimet, për të mos cenuar interesat e saj legjitime për një periudhë që përcaktohet me shkrim nga Autoriteti, me kusht që:

a) një mosveprim i tillë të mos ketë mundësi të sjellë si pasojë keqinformimin e investitorëve publikë;

b) çdo person që e merr informacionin ka detyrimin të ruajë fshehtësinë e informacionit kundrejt shoqërisë, pavarësisht nëse ky detyrim mbështetet në ndonjë akt të shkruar, statut ose kontratë; dhe

c) shoqëria është në gjendje të sigurojë ruajtjen e fshehtësisë së këtij informacioni.

5. Shoqëria që tregtohet ose listohet edhe në një bursë të huaj duhet të sigurojë që, nëse informacioni publikohet në tregjet e tjera, të njëjtat të dhëna do të publikohen edhe në Republikën e Shqipërisë njëkohësisht ose sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 304

Dhënia e detyrueshme e informacioneve në rast çmimesh ose vëllimesh të pazakonta të tregtimit

Shoqëria e listuar duhet të përgjigjet menjëherë ose brenda 24 orëve pasi informohet nga Autoriteti ose bursa se ka lëvizje të pazakonta në çmimin ose vëllimin e titujve të tregtuar, duke i bërë të ditur publikut:

a) hollësi për çdo çështje ose zhvillim për të cilin ka dijeni dhe që ka ose mund të ketë lidhje me lëvizjet e pazakonta; ose

b) një deklaratë se nuk është në dijeni për ndonjë çështje apo zhvillim të tillë.

SEKSIONI V

KOMPETENCAT E AUTORITETIT NË LIDHJE ME SHOQËRITË E LISTUARA

Neni 305

Kompetencat e Autoritetit

1. Kur Autoriteti gjykon se:

a) nga informacionet e bëra publike rezulton se ekzistojnë rrethana të tilla që sugjerojnë se veprimtaria tregtare e shoqërisë së listuar është ushtruar:

i. për një qëllim mashtrues ose të paligjshëm;

ii. në një mënyrë që ndikon negativisht në aktivitetin tregtar të shoqërisë; ose

iii. në një mënyrë që cenon interesin publik;

b) ka rrethana që sugjerojnë se shoqëria është listuar për një qëllim mashtrues ose të paligjshëm;

c) ka rrethana që sugjerojnë se personat e lidhur me listimin e shoqërisë ose me administrimin e aktiviteteve të saj tregtare në lidhje me listimin janë shpallur fajtorë për krim ekonomik, mashtrim ose shkelje të tjera të detyrës ndaj saj; ose

ç) ka rrethana që sugjerojnë se anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose funksionarët kryesorë të shoqërisë së listuar kanë fshehur qëllimisht informacione në lidhje me aktivitetin e shoqërisë, të cilat duhet të ishin bërë të ditura në zbatim të këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji ose të cilat priten në mënyrë të arsyeshme t'i bëhen të ditura publikut,

Autoriteti mund të urdhërojë anëtarët e këshillit ose funksionarët kryesorë të shoqërisë së listuar ose vetë shoqërinë, të vendosin në dispozicion dokumente, të dhëna elektronike ose informacione të tjera të përcaktuara në urdhrin e Autoritetit, në kohën dhe vendin e përcaktuar në të.

2. Autoriteti mund t'i delegojë autoritetin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni një personi të caktuar prej tij, për të kërkuar dorëzimin e dokumenteve, të dhënave elektronike ose të çdo informacioni tjetër në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

3. Autoriteti ose personi i caktuar prej tij mund të kërkojë vënien në dispozicion të dokumenteve dhe të dhënave elektronike nga shoqëria e listuar dhe nga çdo person që mendohet se i ka këto dokumente dhe të dhëna dhe:

a) kur këto dokumente ose dokumente elektronike vihen në dispozicion, mund t'i kërkojë shoqërisë së listuar:

i. të marrë kopje ose ekstrakte të tyre; dhe

ii. t'i kërkojë personit ose ndonjë personi tjetër, që është funksionar i tanishëm ose i mëparshëm i shoqërisë së listuar ose që ka qenë i punësuar në çdo moment nga shoqëria e listuar, të japë një shpjegim për cilindo prej tyre;

b) kur nuk janë vënë në dispozicion evidenca, dokumente dhe të dhëna elektronike, personi që duhej t'i kishte vënë në dispozicion të japë një shpjegim për cilindo prej tyre;

c) kur nuk janë vënë në dispozicion dokumentet dhe të dhënat elektronike, personi që duhej t'i kishte vënë në dispozicion duhet të bëjë të ditur vendndodhjen e tyre, sipas dijenisë dhe besimit të tij.

Neni 306

Kompetenca e Autoritetit për dhënien e urdhrave shoqërive të listuara

Nëse Autoriteti gjykon se shoqëria e listuar ka shkelur ose nuk ka zbatuar ndonjë dispozitë të këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose urdhrat e Autoritetit ose duke pretenduar zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të rregulloreve ose të urdhrave të Autoritetit, i ka dhënë Autoritetit informacione të rreme, të pasakta ose keqorientuese, Autoriteti mund të japë urdhër me shkrim që shoqëria e listuar:

a) të pushojë shkeljen;

b) të kryejë ose pushojë së kryeri një veprim të përcaktuar në urdhër;

c) të vendosë sanksione ose;

ç) të ushtrojë ndonjë prej kompetencave të tjera në zbatim të këtij ligji ose të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

SEKSIONI VI
AUDITUESIT E SHOQËRIVE TË LISTUARA

Neni 307

Detyrat e audituesve të shoqërive të listuara

1. Nëse në rrjedhën normale të kryerjes së detyrave si auditues i shoqërisë së listuar, audituesi formon opinion profesional se ka pasur shkelje apo mosrespektim të ndonjë kërkese ose dispozite të këtij ligji ose të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji, ose shkelje të rregullores së bursës së licencuar, ose ka pasur ndonjë çështje, e cila mund të cenojë në masë materiale pozicionin financiar të shoqërisë së listuar, ai duhet t'ia raportojë menjëherë çështjen ose shkeljen këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së listuar.

2. Nëse këshilli i administrimit/këshillit mbikëqyrës nuk ndërmerr veprime në zbatim të pikës 1 të këtij neni për të ndrequr shkeljen ose mospërputhjen brenda një jave, audituesi duhet t'i paraqesë menjëherë një raport të shkruar në lidhje me këtë çështje:

a) Autoritetit, në rast të mospërputhshmërisë me kërkesat e këtij ligji, akteve nënligjore ose urdhrave të nxjerra në zbatim të tij;

b) Autoritetit dhe institucionit të tregut, në rast të mospërputhshmërisë me rregulloren e institucionit të tregut; ose

c) Autoritetit dhe institucionit të tregut, në rast se audituesi vjen në dijeni të sjelljes faktike ose të synuar të shoqërisë, për të cilën audituesi ka arsye të besojë se do të përbënte shkelje imediate të një akti ligjor ose nënligjor ose veprim mashtrues, i cili mund të dëmtojë në mënyrë të konsiderueshme pozicionin financiar të shoqërisë së listuar.

3. Asnjë auditues nuk mban përgjegjësi për raportet e dorëzuara prej tij në mirëbesim dhe në ushtrim të detyrave, të cilat i ngarkohen në zbatim të këtij neni.

4. Autoriteti, në çdo kohë gjatë ose pas auditimit, mund t'i kërkojë audituesit të shoqërisë së listuar:

a) të paraqesë informacione dhe raporte të tjera shtesë në lidhje me auditimin, që mund të përcaktojë Autoriteti;

b) ta zgjerojë objektin e auditimit të veprimtarisë tregtare dhe të punëve të shoqërisë së listuar në atë mënyrë ose masë që mund të përcaktojë Autoriteti;

c) të kryejë vlerësime të tjera ose të miratojë procedura për raste të veçanta, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi; ose

ç) të përgatisë një raport përfundimtar ose të përkohshëm për çdo çështje të përmendur në shkronjat nga “a” deri në “c”.

Autoriteti mund të përcaktojë kohën se kur duhet t'i përmbushë këto kërkesa audituesi.

5. Audituesi duhet të përmbushë çdo kërkesë të Autoritetit sipas pikës 3 të këtij neni. Për kryerjen e detyrimeve shtesë sipas këtij neni, shoqëria e listuar shpërblen audituesin sipas tarifave të përcaktuara nga Autoriteti.

6. Shoqëria e listuar duhet t'i japë audituesit informacionin dhe aksesin në informacionin e kërkuar nga ky i fundit në funksion të përmbushjes së detyrave shtesë sipas këtij neni.

KREU VII
ZBATUESHMËRIA

SEKSIONI I
TË PËRGJITHSHME

Neni 308
Kompetenca për të kërkuar informacion

1. Autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar personit të licencuar, të regjistruar ose të njohur, mund t'i kërkojë këtij personi:
   a) të japë informacione të caktuara për një fushë të caktuar; ose
   b) të japë dokumente të caktuara ose në lidhje me një fushë të caktuar.
2. Informacionet ose dokumentet duhet të jepen ose të vihen në dispozicion:
   a) përpara përfundimit të një afati të arsyeshëm të përcaktuar; dhe
   b) në vendin e përcaktuar.
3. Ky nen zbatohet vetëm për informacionet dhe dokumentet e kërkuara në mënyrë të arsyeshme për ushtrimin e funksioneve që i jep Autoritetit ky ligj ose që i jepen në zbatim të këtij ligji.

4. Autoriteti mund të kërkojë që çdo informacion i dhënë në zbatim të këtij neni të jepet sipas formës së kërkuar prej tij në mënyrë të arsyeshme.
5. Autoriteti mund të kërkojë që çdo informacion i dhënë, pavarësisht nëse është pjesë e një dokumenti, të verifikohet ose të noterizohet sipas mënyrës së kërkuar prej tij në mënyrë të arsyeshme.
6. Kompetencat e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, mund të ushtrohen edhe për të vendosur kërkesa ndaj një personi që është i lidhur me një person të licencuar, të regjistruar ose të njohur.

Neni 309
Kompetenca për të kërkuar aktekspertizë

1. Autoriteti, me njoftim me shkrim drejtuar personit të licencuar, të regjistruar ose të njohur, në zbatim të këtij ligji, mund t'i kërkojë personit në fjalë t'i vendosë në dispozicion Autoritetit një raport eksperti për çdo çështje, për të cilën Autoriteti ka kërkuar ose mund të kërkojë dhënien e informacioneve ose vënien në dispozicion të dokumenteve.
2. Autoriteti mund të kërkojë që raporti i ekspertit të jetë sipas formës së përcaktuar në kërkesën e Autoritetit.
3. Personi i ngarkuar për të bërë një raport eksperti, në zbatim të pikës 1 të këtij neni:
   a) duhet të jetë person i propozuar ose i njohur nga Autoriteti; dhe
   b) duhet të konsiderohet nga Autoriteti se i ka aftësitë e nevojshme për të bërë një raport për çështjen në fjalë.
4. Personi i licencuar, i regjistruar ose i njohur ka për detyrë të bashkëpunojë plotësisht me personin që harton raportin e ekspertit.
5. Koston e raportit të ekspertit e mbulon shoqëria komisionere ose subjekti tjetër përgjegjës, që është objekt i raportit.

SEKSIONI II
HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 310
Emërimi i ekspertëve

1. Nëse çmon se ka arsye të mjaftueshme për të vepruar ose nëse ka arsye për të dyshuar se është kryer një vepër penale, Autoriteti mund të caktojë një ose më shumë ekspertë për të kryer një hetim në emër të tij:
   a) për natyrën e sjelljes ose për gjendjen e veprimtarisë tregtare të një personi të licencuar, të regjistruar ose të njohur, pavarësisht nëse veprimtaria bën pjesë në veprimtaritë e rregulluara apo jo;
   b) për një aspekt të veçantë të veprimtarisë tregtare; ose

c) për pronësinë ose kontrollin e një personi të licencuar, të regjistruar ose të njohur.

2. Kompetenca e parashikuar në këtë nen mund të ushtrohet për një person që ka qenë i licencuar, i regjistruar ose i njohur më parë në lidhje me:

a) çdo veprimtari tregtare, pavarësisht nëse bën apo jo pjesë në veprimtaritë e rregulluara, të kryer gjatë kohës kur personi ka qenë i licencuar, i regjistruar ose i njohur; ose

b) pronësinë ose kontrollin e një personi, i cili ka qenë më parë i licencuar, i regjistruar ose i njohur gjatë kohës kur ai ka qenë person i licencuar, i regjistruar ose i njohur.

3. Nëse nga hetimi konstatohet se është kryer vepër penale, Autoriteti ua kalon menjëherë çështjen autoriteteve kompetente.

Neni 311

Ndihma për autoritetet e huaja rregullatore

1. Me kërkesën e një autoriteti të huaj rregullator, Autoriteti:

a) mund të ushtrojë kompetencën e parashikuar në nenin 310 të këtij ligji;

b) mund të caktojë një ose më shumë ekspertë për të hetuar një çështje të caktuar.

2. Për të vendosur nëse do ta ushtrojë ose jo kompetencën hetimore, Autoriteti mund të marrë në konsideratë, në veçanti:

a) nëse në vendin e autoritetit të huaj rregullator, Autoritetit do t'i jepej e njëjta ndihmë;

b) nëse çështja ka të bëjë me shkeljen e një kërkese ligjore ose tjetër, e cila nuk parashikohet në Republikën e Shqipërisë ose përfshin pranimin e një juridiksioni, i cili nuk njihet nga Republika e Shqipërisë;

c) seriozitetin e çështjes dhe rëndësinë e saj për personat që ndodhen në Republikën e Shqipërisë;

ç) nëse ofrimi i ndihmës së kërkuar është në interesin publik.

3. Autoriteti mund të vendosë të mos ushtrojë kompetencat e tij hetimore nëse autoriteti i huaj rregullator nuk merr përsipër të kontribuojë për mbulimin e kostove të hetimit të kërkuar, siç e konsideron të përshtatshme Autoriteti.

4. Nëse Autoriteti ka caktuar një ekspert për hetime administrative në përgjigje të një kërkese nga një autoritet i huaj rregullator, Autoriteti mund t'i japë urdhër ekspertit administrativ të lejojë një përfaqësues të autoritetit të huaj rregullator të marrë pjesë në çdo intervistë të kryer në kuadër të hetimit administrativ.

5. Urdhri, i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, nuk jepet nëse Autoriteti nuk krijon bindjen se informacioni që merr autoriteti i huaj rregullator nga intervista do të jetë objekt i masave mbrojtëse për ruajtjen e fshehtësisë së informacioneve konfidenciale sipas këtij ligji.

Neni 312

Kryerja e hetimeve administrative

1. Ky nen zbatohet për rastin kur Autoriteti cakton një ose më shumë ekspertë për hetime administrative për të kryer një hetim administrativ në emër të tij.

2. Autoriteti duhet të njoftojë me shkrim personin që është objekt i hetimit administrativ, kur mund të identifikohet një person i caktuar për caktimin e ekspertit administrativ.

3. Autoriteti mund të vendosë të mos e njoftojë personin e identifikuar nëse gjykon se njoftimi mund të cenojë interesat e investitorëve ose të rrezikojë pakësimin apo zhdukjen e aktiveve të investitorëve.

4. Njoftimi sipas pikës 2 të këtij neni duhet:

a) të përcaktojë dispozitat ligjore në bazë të të cilave është caktuar eksperti administrativ; dhe

b) të përcaktojë arsyen e caktimit të ekspertit për hetim administrativ.

5. Autoriteti mund të caktojë si ekspert për hetim administrativ edhe një person që është punonjës i tij.

6. Eksperti duhet t'i paraqesë Autoritetit një raport për hetimin administrativ të kryer.

7. Autoriteti përcakton:

a) objektin e hetimit administrativ;

b) periudhën gjatë së cilës kryhet hetimi administrativ;

c) mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ; dhe

ç) mënyrën e raportimit të hetimit administrativ.

Neni 313

Kompetenca për të kërkuar paraqitje dhe përgjigje për pyetjet

1. Eksperti mund t'i kërkojë personit nën hetim administrativ ose çdo personi të lidhur me personin nën hetim administrativ:

a) të paraqitet përpara ekspertit në kohën dhe vendin e caktuar dhe t'u përgjigjet pyetjeve; ose

b) të japë informacionet që mund të kërkojë eksperti.

2. Eksperti mund t'i kërkojë çdo personi të vendosë në dispozicion në kohën e caktuar çdo dokument të caktuar ose çdo dokument të lidhur me një çështje të caktuar.

Neni 314

Pranueshmëria e deklaratave

Deklarata që bën përpara ekspertit personi në përputhje me kërkesën për të dhënë informacion, është e pranueshme si provë në çdo proces gjyqësor, nëse përmbush edhe kërkesat që rregullojnë pranueshmërinë e provave në rrethanat në fjalë.

Neni 315

Dokumentet e mbajtura nga palët e treta

1. Nëse Autoriteti ose eksperti i ka kërkuar një personi t'i vendosë në dispozicion një dokument, por rezulton se dokumenti mbahet nga një person i tretë, kjo kompetencë mund të ushtrohet edhe në lidhje me personin e tretë.

2. Nëse një dokument vendoset në dispozicion në përgjigje të një kërkese të bërë në zbatim të kësaj pjese, eksperti, të cilit i është vendosur në dispozicion dokumenti, mund:

a) të bëjë kopje ose të nxjerrë ekstrakte nga dokumenti; ose

b) të kërkojë nga personi që i ka vendosur në dispozicion dokumentin, ose nga çdo person tjetër përkatës, të japë shpjegime për dokumentin.

3. Nëse personi, i cili duhet të vendosë në dispozicion një dokument, nuk e përmbush këtë kërkesë, Autoriteti ose eksperti i autorizuar mund t'i kërkojë të deklarojë ku ndodhet dokumenti.

4. Avokatit mund t'i kërkohet të japë emrin dhe adresën e klientit të tij.

5. Asnjë personi nuk mund t'i kërkohet të japë informacion ose të vendosë në dispozicion një dokument për të cilin ka detyrimin të ruajë fshehtësinë e informacionit për shkak të ushtrimit të veprimtarisë bankare, me përjashtim të rastit kur:

a) personi, të cilit i kërkohet informacioni apo dokumenti, është personi nën hetim administrativ ose është anëtar i grupit të një personi nën hetim administrativ;

b) personi, kundrejt të cilit ekziston detyrimi i ruajtjes së fshehtësisë së informacionit, është personi nën hetim administrativ ose është anëtar i grupit të personit nën hetim administrativ; ose

c) personi, kundrejt të cilit ekziston detyrimi për ruajtjen e informacionit, jep pëlqimin e tij për përhapjen e informacionit ose vënien në dispozicion të dokumentit.

Neni 316

Hyrja në mjedise

1. Gjykata mund të nxjerrë vendim me kërkesë të Autoritetit nëse ka baza të arsyeshme për të besuar se është plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) personi, të cilit i është kërkuar të japë një informacion, nuk e ka përmbushur këtë kërkesë (plotësisht ose pjesërisht); dhe

b) dokumentet ose informacionet e kërkuara ndodhen në mjediset e përcaktuara në urdhër;

c) mjediset e përcaktuara në urdhër janë mjediset e një personi të licencuar, të regjistruar ose të njohur dhe në këto mjedise ndodhen dokumente ose informacione për të cilat mund të urdhërohet vendosja në dispozicion, nëse do të jepej një urdhër i tillë, ai nuk do të përmbushej ose dokumentet apo informacionet e lidhura me të do të largoheshin, do të manipuloheshin ose do të shkatërroheshin;

ç) është kryer ose po kryhet nga një person një vepër penale, e cila dënohet me burgim dhe në mjediset e përcaktuara në urdhër ndodhen dokumente ose informacione që janë të rëndësishme për të treguar se është kryer ose po kryhet një krim dhe për të cilat mund të bëhet kërkesë për dhënie informacioni dhe,

nëse do të bëhej një kërkesë e tillë, ajo nuk do të përmbushej ose dokumentet apo informacionet e lidhura me të do të largoheshin, do të manipuloheshin ose do të shkatërroheshin.

2. Vendimi i gjykatës në zbatim të këtij neni duhet të autorizojë Autoritetin dhe ekspertin e emëruar prej tij dhe/ose prokurorinë, Policinë e Shtetit apo organe të tjera të zbatimit të ligjit:

a) të hyjnë në mjediset e përcaktuara në urdhër;

b) të kryejnë kontroll të mjediseve dhe të marrin çdo dokument ose informacion, që mendohet të jetë një dokument ose informacion i llojit për të cilin është dhënë urdhri në zbatim të këtij neni ose të marrin në lidhje me dokumente ose informacione të tilla çdo hap tjetër, që mund të mendohet i nevojshëm për ruajtjen e tyre ose parandalimin e ndërhyrjes në to;

c) të marrin kopje ose ekstrakte të çdo dokumenti ose informacioni që duket se ka rëndësi për çështjen në fjalë;

ç) t'i kërkojnë çdo personi që gjendet në mjediset në fjalë të japë shpjegime për çdo dokument ose informacion, që mund të ketë rëndësi për çështjen në fjalë ose të tregojë se ku mund të gjendet.

Neni 317

Ndërhyrja në lidhje me personat e huaj të njohur

Autoriteti mund të ushtrojë kompetencën e ndërhyrjes në lidhje me një person të huaj të njohur nëse çmon se:

a) personi ka shkelur ose ka të ngjarë të shkelë një kërkesë të vendosur mbi të nga ky ligj ose në zbatim të këtij ligji, nëse Autoriteti është përgjegjës për të siguruar zbatimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë;

b) personi, në funksion të përmbushjes së ndonjë kërkese të vendosur mbi të nga ky ligj ose në zbatim të këtij ligji, i ka dhënë Autoritetit me dashje ose nga pakujdesia informacion, i cili është i rremë ose keqinformues në masë materiale; ose

c) ushtrimi i kompetencës është i nevojshëm për të mbrojtur interesat e klientëve aktualë ose të mundshëm.

SEKSIONI III
MBROJTJA E INVESTITORËVE

Neni 318

Kompetenca e Autoritetit për të marrë masa në mbrojtje të investitorëve

1. Nëse ndonjë person shkel ndonjë nga dispozitat e këtij ligji ose të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji, ose ndonjë kusht ose kufizim të përcaktuar nga një licencë, regjistrim ose njohje e dhënë në zbatim të këtij ligji ose ndonjë dispozitë të rregullores së një institucioni tregu, Autoriteti mund të vendosë sanksione administrative ose mund të marrë ndonjë prej masave të mëposhtme administrative:

a) t'i japë urdhër personit që ka kryer shkeljen të zbatojë rregulloren, parashikimin, njoftimin me shkrim, kushtin ose urdhrin;

b) të vendosë gjobë në proporcion me rëndësinë e pasojave të shkeljes së personit;

c) t'i japë vërejtje personit që ka bërë shkeljen;

ç) t'i kërkojë personit që ka bërë shkeljen të marrë hapat që mund t'ia urdhërojë Autoriteti për të korrigjuar shkeljen ose për të zbutur efektin e shkeljes, përfshirë shpërblimin e dëmit personave të tjerë të dëmtuar nga shkelja.

2. Në interes të mbrojtjes së klientëve, Autoriteti mund të japë urdhër për ngrirjen e aktiveve të çdo personi, që bie ndesh me ndonjë dispozitë të këtij ligji, të akteve nënligjore ose urdhrave, për shtatë ditë kalendarike. Autoriteti, me vendim të arsyetuar, mund të zgjasë afatin e urdhrit për ngrirjen e aktiveve, për të parandaluar shpërndarjen e aktiveve të klientëve, deri në një afat maksimal prej 3 muajsh.

3. Në kuptim të pikës 1, shkronja "ç", gjatë marrjes së vendimit për të urdhëruar shpërblim të dëmit nga personi që ka bërë shkeljen, Autoriteti duhet të mbajë parasysh:

a) fitimet që ka realizuar personi që ka bërë shkeljen; ose

b) nëse një ose më shumë persona kanë pësuar humbje ose janë cenuar nga shkelja.

4. Kur Autoriteti merr një masë në zbatim të pikës 1 ndaj personit që është objekt i rregullores së një institucioni tregu, Autoriteti duhet të informojë institucionin e tregut për masat që ka marrë.

5. Dispozitat e këtij neni nuk e pengojnë Autoritetin:

a) t'i japë urdhër institucionit të tregut të marrë ndonjë masë disiplinore kundër pjesëmarrësve të tij, një shoqërie të listuar dhe ose një anëtari të këshillit të administrimit/këshilli mbikëqyrës të një shoqërie të listuar për shkelje të rregullave të institucionit të tregut, përfshirë vendosjen e gjobës; ose

b) të marrë një masë, për të cilën ka kompetencë ta marrë në zbatim të këtij ligji, kundër personit që ka bërë shkeljen.

6. Sanksionet me gjobë, të parashikuara në këtë ligj, arkëtohen në një llogari qëllimore të Autoritetit brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Kur shuma e gjobës që duhet paguar nuk është shlyer brenda afatit, personi përgjegjës paguan një interes prej 0,01 për qind të gjobës për çdo ditë vonese.

Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 319

Kompetenca e Autoritetit për të mbrojtur aktivet e investitorëve

Autoriteti mund të marrë një ose më shumë prej masave të mëposhtme, kur shoqëria komisionere që mban ose së cilës i janë besuar paratë ose aktivet e klientëve në rrjedhën e veprimtarisë së saj tregtare, bie ndesh me ndonjë dispozitë të këtij ligji, të akteve nënligjore ose të urdhrave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji dhe kur Autoriteti çmon se rrezikohen ose ka të ngjarë të rrezikohen interesat e investitorëve, klientëve të shoqërisë komisionere ose të zotëruesve të kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive:

a) mund të urdhërojë shoqërinë komisionere të mos tregtojë më paratë ose aktivet e investitorëve ose klientëve në atë mënyrë që e konsideron të përshtatshme Autoriteti ose të transferojë paratë ose pasuritë e investitorëve, ose klientëve të tillë apo dokumentet ose evidencat elektronike në lidhje me këto para ose pasuri te një person tjetër, i përcaktuar në njoftim nga Autoriteti;

b) mund t'i ndalojë shoqërisë komisionere kryerjen e transaksioneve, kërkimin e shërbimeve nga të tretë ose t'i kërkojë shoqërisë komisionere të ushtrojë veprimtarinë tregtare në mënyrën që mund të përcaktojë Autoriteti; ose

c) t'i kërkojë shoqërisë komisionere të mbajë pasuri në territorin e Republikës së Shqipërisë në një vendndodhje që e përcakton Autoriteti.

SEKSIONI IV
NJOFTIMET

Neni 320

Njoftimet e bëra nga Autoriteti

1. Kur Autoriteti çmon se një person nuk është i aftë dhe i përshtatshëm për të kryer ndonjë prej veprimtarive të rregulluara dhe/ose bie ndesh me ndonjë dispozitë të këtij ligji, Autoriteti mund t'i japë njoftim këtij personi për masën që propozon të marrë në ushtrim të kompetencave të tij në zbatim të këtij ligji dhe për datën kur fillon të prodhojë pasoja masa.

2. Njoftimi që jep Autoriteti duhet të parashtrojë arsyet mbi të cilat mbështetet Autoriteti për dhënien e njoftimit dhe të njoftojë marrësin e njoftimit për mundësinë për t'u shprehur përpara Autoritetit brenda afatit të përcaktuar në njoftim.

3. Autoriteti mund të zgjasë afatin brenda të cilit mund të shprehet marrësi i njoftimit, nëse e çmon të nevojshme.

4. Pasi dëgjon argumentet e marrësit, në rastet kur ky i fundit shprehet në lidhje me njoftimin, Autoriteti vendos:

a) të vijojë me masën e propozuar;
b) të ndryshojë masën e propozuar; ose
c) të revokojë masën e propozuar.

Autoriteti i jep marrësit njoftimin e vendimit.

5. Njoftimi i vendimit, i dhënë në zbatim të pikës 4 të këtij neni, duhet:

a) të përfshijë emrin e personit, të cilit i zbatohet njoftimi;
b) të përcaktojë afatet e njoftimit;
c) të japë arsyet e njoftimit; dhe
ç) t'i dorëzohet individit emri i të cilit është në urdhër.

6. Personi që pretendon se ka pësuar një dëm nga vendimi i Autoritetit, mund t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditësh pasi personi në fjalë merr njoftim për këtë vendim.

Neni 321
Bashkimi dhe ndarja

1. Asnjë shoqëri komisionere ose institucion nuk mund të bashkohet ose të ndahet pa miratimin paraprak të Autoritetit.

2. Autoriteti e jep miratimin pasi të ketë shqyrtuar dhe vlerësuar planin e bashkimit ose ndarjes dhe nëse çmon se kjo është në interesin më të mirë të aksionarëve të shoqërisë komisionere ose të institucionit.

KREU VIII
PROCESET GJYQËSORE, BASHKIMET, SHPËTIMI, FALIMENTIMI, LIKUIDIMI DHE MBYLLJA E SUBJEKTEVE

SEKSIONI I
SHPËTIMI DHE REHABILITIMI I SHOQËRIVE KOMISIONERE OSE I INSTITUCIONEVE

Neni 322
Administrimi i përkohshëm

1. Kur çmon se shoqëria komisionere ose institucioni ndodhet në vështirësi financiare dhe se rikthimi i tyre në gjendje të shëndoshë financiare është i mundshëm, Autoriteti mund të urdhërojë vendosjen e subjektit përkatës nën administrim të përkohshëm.

2. Autoriteti duhet t'i japë shoqërisë komisionere ose institucionit në fjalë arsyet e masave të propozuara, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, dhe periudhën e propozuar të administrimit të përkohshëm, që nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj.

3. Çdo urdhër që nxjerr Autoriteti në zbatim të pikës 1 të këtij neni, duhet të publikohet në faqen e internetit të Autoritetit dhe të institucionit në fjalë.

4. Vështirësia financiare përkufizohet si situata kur Autoriteti mendon se:

a) në mënyrë të arsyeshme, është e pamundur që shoqëria komisionere ose institucioni të jetë në gjendje të paguajë të gjitha borxhet e veta në afat brenda gjashtë muajve të ardhshëm; ose

b) në mënyrë të arsyeshme, është e mundur që shoqëria komisionere ose institucioni të kalojë në paaftësi paguese brenda gjashtë muajve të ardhshëm.

Neni 323
Pasojat juridike të administrimit të përkohshëm

1. Të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve, anëtarëve të organeve drejtuese dhe funksionarëve kryesorë të shoqërisë komisionere ose institucionit pezullohen gjatë të gjithë kohëzgjatjes së periudhës së administrimit të përkohshëm dhe i kalojnë administratorit të përkohshëm.

2. Ky pezullim duhet të fillojë nga data e marrjes së njoftimit për urdhrin e Autoritetit në zbatim të nenit 322 të këtij ligji.

Neni 324
Emërimi i administratorit të përkohshëm

1. Afati dhe fusha e veprimit të administratorit të përkohshëm përcaktohen nga Autoriteti në vendimin për marrjen në administrim të përkohshëm të shoqërisë komisionere ose institucionit në zbatim të nenit 322 të këtij ligji.

2. Në momentin e emërimit, administratori i përkohshëm mund të ushtrojë kompetencat dhe funksionet që përcakton Autoriteti për t'i dhënë mundësi këtij administratori të vlerësojë dhe të konstatojë nëse është i mundshëm rikthimi i shoqërisë komisionere ose institucionit në gjendje të shëndoshë financiare.

3. Autoriteti përcakton pagën dhe shpenzimet e administratorit të përkohshëm, të cilat paguhen nga shoqëria komisionere ose institucioni që vendoset nën administrim të përkohshëm.

Neni 325

Kushtet e emërimit të administratorit të përkohshëm

Autoriteti duhet të konstatojë nëse kandidati është i aftë dhe i përshtatshëm për pozicionin e administratorit të përkohshëm, sipas kërkesave të këtij ligji dhe ka të paktën pesë vjet përvojë pune si drejtues i një institucioni financiar, banke ose shoqërie auditimi.

Neni 326

Largimi dhe zëvendësimi i administratorit të përkohshëm

1. Administrues i përkohshëm nuk mund të caktohet personi:

a) nëse është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krimit ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare; për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, si dhe për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

b) për të cilin ka dyshime në momentin e caktimit për aftësinë dhe përshtatshmërinë e tij për të kryer detyrat e administrimit të përkohshëm;

c) që është subjekt i një vendimi gjykate, pasoja e të cilit ia bën të pamundur administratorit të përkohshëm përmbushjen e detyrave; ose

ç) ka konflikt interesi midis administratorit të përkohshëm dhe Autoritetit ose shoqërisë komisionere ose institucionit.

2. Autoriteti mund ta shkarkojë dhe zëvendësojë administratorin e përkohshëm në çdo moment nëse Autoriteti gjykon se administratori i përkohshëm nuk i përmbush cilësitë apo nuk është i aftë dhe i përshtatshëm për të zbatuar kërkesat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 327

Kompetencat dhe detyrimet e administratorit të përkohshëm

1. Administratori i përkohshëm duhet ta administrojë institucionin sa më mirë, me objektiv rivendosjen e shoqërisë komisionere ose institucionit në gjendje të shëndoshë financiare.

2. Kur emërohet, administratori i përkohshëm duhet:

a) sipas rastit, të njoftojë çdo degë të shoqërisë komisionere ose institucionit për datën dhe orën e hyrjes në fuqi të administrimit të përkohshëm;

b) ta publikojë njoftimin e parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike në një ose më shumë medie të shkruara dhe elektronike, me përhapje më të gjerë në publik dhe në faqen e internetit të shoqërisë komisionere ose institucionit të marrë në administrim të përkohshëm; dhe

c) t'ia vërë këtë njoftim në dispozicion Autoritetit.

3. Shoqëria komisionere ose institucioni duhet t'ia vendosë në dispozicion administratorit të përkohshëm të gjitha evidencat, llogaritë dhe dokumentacionet e tjera dhe të hartojë një raport për shëndetin financiar të shoqërisë komisionere ose institucionit për administratorin e përkohshëm dhe Autoritetin.

4. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të kërkojë informacione të tjera shtesë nga shoqëria komisionere ose institucioni në funksion të kryerjes së detyrave dhe funksioneve të veta.

5. Administratori i përkohshëm duhet të marrë të gjitha masat për ruajtjen e aktiveve të shoqërisë komisionere ose institucionit, përfshirë, ndër të tjera:

a) ruajtjen e pasurive ose evidencave (të kompjuterizuara ose të mbajtura në formate të tjera) dhe të drejtën e hyrjes në mjedise ose në një pjesë të tyre;

b) mbajtjen e personelit kyç për të kryer veprimtaritë e përditshme të punës;

c) njoftimin për këtë dhe dhënien e autorizimit paraprak për pagesën e shërbimeve duke filluar nga data e marrjes në administrim të përkohshëm; dhe

ç) ndërprerjen e pagimit të dividendëve ose të çdo forme tjetër shpërndarjeje të kapitalit tek aksionarët që nga data e marrjes në administrim të përkohshëm.

6. Të gjitha transaksionet e kryera gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm pa autorizim të rregullt nga administratori i përkohshëm konsiderohen të pavlefshme.

Neni 328

Plani i shpëtimit të biznesit

Kur emërohet, administratori i përkohshëm duhet:

a) të planifikojë për të parë nëse është e mundshme rimëkëmbja e shoqërisë komisionere ose institucionit nga kryerja e të paktën njërës prej masave të mëposhtme:

i. riklasifikimi i cilësisë së aktiveve të shoqërisë komisionere ose institucionit;

ii. riklasifikimi i veprimtarive të shoqërisë komisionere ose institucionit në veprimtari me shumë pak ose aspak risk; ose

iii. identifikimi i aktiveve dhe huave nën standard dhe kryerja e hapave për të siguruar vlerësimin dhe shlyerjen e tyre;

b) të përpilojë dhe të dorëzojë në Autoritet një plan biznesi për shpëtimin dhe rimëkëmbjen e shoqërisë komisionere ose institucionit, i cili i mbron më mirë interesat e shoqërisë komisionere ose të institucionit dhe të aksionarëve dhe kreditorëve të tij se sa do t'i mbronte likuidimi i detyruar;

c) t'i shesë të gjitha ose një pjesë të aktiveve nën standard të institucionit ose pjesëmarrësit të tregut;

ç) të negociojë bashkimin ose shitjen e shoqërisë komisionere ose institucionit në një shoqëri tjetër komisionere ose institucion tjetër ose të kërkojë kapital shtesë për shoqërinë komisionere ose institucionin; ose

d) nëse masat e propozuara që parashikohen në shkronjat "a" deri "ç" nuk mund të sjellin rezultate, ta informojë Autoritetin se nuk ka alternativë tjetër veç fillimit të procedurës së likuidimit të detyruar.

Neni 329

Raportet e administratorit të përkohshëm për Autoritetin

1. Administratori i përkohshëm duhet t'i raportojë periodikisht Autoritetit për ecurinë e procesit të administrimit të përkohshëm për sa më poshtë:

a) paraqet për aprovim pranë Autoritetit një raport për pozicionin financiar dhe gjendjen operative të shoqërisë komisionere ose institucionit gjatë administrimit të përkohshëm;

b) brenda 6 muajve pas marrjes në administrim të përkohshëm, një raport për pozicionin financiar dhe gjendjen operative të shoqërisë komisionere ose institucionit lidhur me rimëkëmbjen e mundshme, ku të jepen këto informacione dhe të dhëna:

1. një vlerësim i gatishmërisë së aksionarëve për të mbuluar humbjet përmes futjes së kapitalit shtesë ose përmes burimeve të tjera të injektimit të kapitalit;

ii. mundësia për mbulimin e humbjeve të mbetura pas injektimit të kapitalit sipas nënndarjes "i" të kësaj shkronje;

iii. çdo detyrim ose shpenzim të paparashikuar ose të kushtëzuar, që ka ndikim te borxhi i shoqërisë komisionere ose institucionit;

iv. një vlerësim i masave të mundshme për çlirimin nga vështirësitë financiare dhe kostoja e çmuar e vënies në zbatim të masave të tilla; ose

v. një vlerësim i kushteve, që bëjnë të nevojshëm fillimin e procedurës së likuidimit të detyruar.

2. Gjatë hartimit të raporteve, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, administratori i përkohshëm duhet të angazhohet për mbrojtjen e interesave të kreditorëve dhe klientëve të shoqërisë komisionere dhe institucionit. Kjo përfshin edhe angazhimin se çdo shumë, që përfaqëson paratë e klientëve ose që janë caktuar për shlyerjen e transaksioneve ende të pashlyera, nuk mund të përfshihet në vlerësimin e aktiveve financiare të gatshme të shoqërisë komisionere ose institucionit në fjalë.

3. Brenda 30 ditëve pune nga marrja e raportit, Autoriteti duhet të marrë vendim për rekomandimin e propozuar për shpëtimin dhe rimëkëmbjen e shoqërisë komisionere ose institucionit ose në mënyrë alternative për fillimin e procedurës së likuidimit të detyruar dhe ta njoftojë për këtë shoqërinë komisionere ose institucionin.

Neni 330
Vlerësimi i rezultateve

1. Autoriteti duhet të bëjë vlerësim të rezultateve të administrimit të përkohshëm çdo 3 muaj duke filluar nga data e marrjes së vendimit për administrimin e përkohshëm.

2. Autoriteti harton një raport vlerësimi përfundimtar të administrimit të përkohshëm të shoqërisë komisionere ose institucionit brenda 3 muajve nga marrja e raportit përfundimtar të administratorit të përkohshëm.

Neni 331
Përfundimi i administrimit të përkohshëm

1. Administrimi i përkohshëm duhet të përfundojë:

a) në përfundim të afatit të përcaktuar në vendimin e Autoritetit për ta vendosur shoqërinë komisionere ose institucionin në administrim të përkohshëm;

b) me vendim të Autoritetit përpara përfundimit të periudhës së administrimit të përkohshëm, kur e konsideron shoqërinë komisionere ose institucionin të rimëkëmbur, në bazë të raportit përfundimtar të vlerësimit, dhe kur:

i. Autoriteti konstaton se shëndeti financiar i shoqërisë komisionere ose institucionit është përmirësuar gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm;

ii. shoqëria komisionere ose institucioni i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij;

iii. shoqëria komisionere ose institucioni mund ta ushtrojë normalisht veprimtarinë e saj;

c) me vendim të Autoritetit për ta vendosur shoqërinë komisionere ose institucionin në procedurë likuidimi të detyrueshëm.

2. Vendimi i nxjerrë nga Autoriteti, në zbatim të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, duhet të shoqërohet me një plan të hollësishëm rimëkëmbjeje të përpiluar nga administratori i përkohshëm, ku të identifikohen pikat e dobëta në administrimin dhe funksionimin e shoqërisë komisionere ose institucionit, dhe të detajohen sa më poshtë:

a) masat korrigjuese të nevojshme për përmirësimin e situatës; dhe

b) një plan financiar për rehabilitimin e propozuar të shoqërisë komisionere ose institucionit.

SEKSIONI II
LIKUIDIMI DHE PAAFTËSIA PAGUESE

Neni 332
Likuidimi

1. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë komisionere ose institucionit mund të vendosë për mbylljen e shoqërisë apo për ndryshimin e veprimtarisë së saj vetëm pas miratimit paraprak të Autoritetit.

2. Kur merret vendimi sipas pikës 1, këshilli i administrimit ose këshilli mbikëqyrës bën kërkesë për likuidim, i cili duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) një kopje e vendimit të asamblesë së përgjithshme në lidhje me likuidimin e propozuar;

b) arsyet e likuidimit;

c) emrat e likuiduesve të propozuar;

ç) një raport i detajuar financiar për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim gjatë likuidimit, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe një parashikim të kohëzgjatjes së procesit.

3. Autoriteti merr vendim, nëse propozimet e paraqitura në zbatim të pikës 2 të këtij neni janë të përshtatshme, brenda 30 ditësh nga data e marrjes së kërkesës dhe informon shoqërinë komisionere ose institucionin për miratimin ose refuzimin, sipas rastit.

4. Nëse Autoriteti refuzon një propozim për likuidim brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, vendimi për mbylljen e shoqërisë ose për ndryshimin e veprimtarisë tregtare nuk mund të miratohet nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë. Çdo vendim që merr asambleja e përgjithshme në kundërshtim me këtë pikë, është i pavlefshëm dhe nuk mund të regjistrohet pranë regjistrit tregtar.

Neni 333

Likuiduesi i shoqërisë komisionere ose institucionit

1. Likuiduesit e shoqërisë komisionere ose të institucionit duhet të miratohen paraprakisht nga Autoriteti. Ata i përfaqësojnë bashkërisht interesat e shoqërisë komisionere ose të institucionit.

2. Likuiduesit duhet të jenë persona fizikë/individë, të cilët Autoriteti i konsideron se janë të aftë dhe të përshtatshëm për kryerjen e detyrave, kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara.

Neni 334

Kufizimet për licencën e shoqërisë komisionere ose të institucionit

1. Kur Autoriteti e ka miratuar procedurën e likuidimit vullnetar, mund të vendosë:

a) ta kufizojë licencën për të kryer veprimtarinë e rregulluar të shoqërisë komisionere ose të institucionit dhe ta lejojë të ndërmarrë veprimtaritë e përcaktuara ose ato veprimtari që janë të nevojshme për likuidimin vullnetar; dhe

b) të përcaktojë se deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të riskut në shoqërinë komisionere ose në institucionin në likuidim vullnetar.

2. Pas hapjes së procedurave të likuidimit, shoqëria komisionere ose institucioni mund të vazhdojë të kryejë veprimtaritë e përcaktuara në vendimin e Autoritetit, sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat janë të nevojshme për mbylljen e veprimtarisë së rregulluar dhe çdo veprimtari të nevojshme për transferimin e rregullt të veprimtarisë tregtare në një shoqëri tjetër komisionere ose në një institucion tjetër.

3. Pavarësisht nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë komisionere të bëjë organizime të posaçme për mbrojtjen e investitorëve ose pacenueshmërinë e tregut.

Neni 335

Vendimi për likuidimin e detyruar

1. Autoriteti mund të vendosë shoqërinë komisionere ose institucionin e tregut në proces likuidimi të detyruar, kur:

a) kjo shoqëri komisionere ose ky institucion nuk është në gjendje t'i shlyejë detyrimet financiare brenda afatit;

b) kjo shoqëri komisionere ose ky institucion kryen ose ka kryer një veprimtari të rregulluar në shkelje të këtij ligji; ose

c) kur gjatë administrimit të përkohshëm të subjektit apo në përfundim të tij konstatohet se rimëkëmbja financiare e subjektit është e pamundur.

2. Aktivet e llogarisë së klientëve të shoqërisë komisionere mbahen në llogari të veçanta nga llogaritë e shoqërisë komisionere dhe nuk preken gjatë procesit të likuidimit të detyruar të shoqërisë.

3. Autoriteti, për të siguruar mbrojtjen e klientëve individë të shoqërisë komisionere ose të institucionit, mund të kërkojë që klientët përkatës dhe aktivet e tyre t'i transferohen një shoqërie tjetër komisionere ose një institucioni tjetër.

Neni 336

Detyrimet dhe të drejtat e likuiduesit

1. Likuiduesi kryhen administrimin dhe shitjen e aktiveve e të pasivëve dhe shpërndarjen e shumave të arkëtuara te kreditorët.

2. Likuiduesi bashkëpunon me Autoritetin dhe zbaton udhëzimet e Autoritetit për procesin e likuidimit të detyrueshëm.

3. Menjëherë pas emërimit, likuidiuesi merr në kontroll shoqërinë komisionere, institucionin e tregut duke siguruar aktivët, librat dhe llogaritë e saj. Likuiduesi ka të drejtë aksesi në të gjitha aktivet, zyrat dhe librat e shoqërisë komisionere ose të institucionit të tregut.

4. Likuiduesi bën inventar të aktivëve dhe pasurive të shoqërisë komisionere ose institucionit të tregut dhe harton një pasqyrë bilanci e relacion shpjegues në lidhje me zërat e bilancit brenda 30 ditëve kalendarike pas fillimit të likuidimit, të cilat i dorëzohen Autoritetit, ndërsa një kopje i vihet në dispozicion publikut.

5. Likuiduesi synon arritjen e shumës maksimale nga shitja e aktivëve të shoqërisë komisionere ose

institucionit të tregut, duke kryer këto veprime:

a) vijon ose ndërpret transaksionet financiare;

b) punëson nëpunësit, punonjësit ose këshilltarët e nevojshëm profesionalë;

c) nënshkruan akte në emër të shoqërisë dhe depoziton e ndjek kërkesëpadi në emër të tij, pasi merr miratimin paraprak të Autoritetit.

6. Likuiduesi ka të drejtë të zgjidhë sa më poshtë:

a) kontratat e punësimit të shoqërisë me çdo person;

b) kontratat e shërbimit në të cilat është palë shoqëria komisionere ose institucioni i tregut;

c) çdo detyrim tjetër, i cili lind nga kontratat e qirasë për pasuri të paluajtshme që ka shoqëria komisionere ose institucioni i tregut në cilësinë e qiramarrësit.

7. Brenda 1 (një) muaji pas emërimit, likuiduesi vepron si më poshtë:

a) u dërgon me postë të regjistruar të gjithë aksionarëve dhe kreditorëve, në adresat e shënuara në regjistrat e shoqërisë, institucionit të tregut, operatorit të tregut, një pasqyrë për natyrën dhe shumën e detyrimeve të pretenduara sipas regjistrave;

b) regjistron pretendimet e ngritura e të dokumentuara të kreditorëve.

8. Brenda 1 (një) muaji pas datës së fundit të përcaktuar në njoftimin e dhënë në bazë të pikës 7 të këtij neni, për detyrimet e pretenduara likuiduesi:

a) përcakton shumën, nëse ka, që shoqëria komisionere ose institucioni i tregut i detyrohet secilit kreditor të ditur;

b) përgatit për regjistrim pranë Autoritetit një strukturë të detyrimeve të pretenduara.

9. Çdo kreditor ose aksionar, që përfaqëson të paktën 10% të aksioneve të emetuara, ka të drejtën të paraqesë kundërshtim në lidhje me regjistrimin e detyrimeve të pashlyera pranë Autoritetit brenda 20 (njëzet) ditëve pas regjistrimit të strukturës së detyrimeve të pretenduara në përputhje me pikën 8 të këtij neni. Autoriteti merr vendim për pranimin ose refuzimin e kundërshtimit brenda 1 (një) muaji nga data e regjistrimit të pretendimit.

10. Nëse kundërshtimi i parashikuar në pikën 9 të këtij neni pranohet, likuiduesi ndryshon dhe përmirëson përkatësisht strukturën e detyrimeve të pretenduara ose masat e propozuara për shlyerjen e detyrimeve.

Neni 337

Pasojat juridike të likuidimit të detyruar

1. Të gjitha kompetencat dhe detyrat e shoqërisë komisionere ose institucionit i kalojnë Autoritetit, i cili emëron likuiduesin për të shndërruar në mjete monetare dhe shpërndarë aktivet e subjektit, për të ruajtur interesat e klientëve të shoqërisë komisionere ose të institucionit dhe për të ruajtur pacenueshmërinë dhe stabilitetin e tregut.

2. Çelja e procedurës së likuidimit të detyrueshëm ka pasojën juridike të pezullimit të licencës së shoqërisë komisionere ose institucionit, i cili nuk mund të ndërmarrë veprimtari të reja të rregulluara, me përjashtim të atyre që kryhen në funksion të qëllimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Auditimi, për qëllime të këtij ligji, konsiderohet me interes publik. Çdo angazhim auditimi ligjor konsiderohet si angazhim i një njësie me interes publik dhe i nënshtrohet detyrimeve ligjore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

Neni 338

Rendi i përmbushjes së pretendimeve

1. Likuiduesi shpërndan aktivët e shoqërisë komisionere ose të institucionit duke shlyer detyrimet ndaj kreditoreve dhe aksionarëve sipas këtij rendi:

a) çdo kreditor i mbuluar me garanci kolaterali, i cili nuk mund ta përdorë pasurinë me të cilën është garantuar detyrimi i tij për shkak të kufizimeve të përcaktuara me këtë ligj, deri në shumën e të ardhurave nga shitja e kolateralit;

b) shpenzimet e likuiduesit dhe Autoritetit të konstatuara në funksion të likuidimit të detyrueshëm;

c) pagat e punonjësve të shoqërisë komisionere ose të institucionit, të mbajtur në punë nga likuiduesi për të asistuar në likuidimin e rregullt të sipërmarrjes;

ç) kreditorët e mbuluar dhe të pambuluar me garanci lidhur me vlerën e detyrimit, që e tejkalon vlerën e shitjes së kolateralit;

d) aksionarët.

2. Kur shuma për shlyerjen e kreditorëve me të njëjtin rend përparësie nuk është e mjaftueshme për t'i shlyer plotësisht këta kreditorë, atëherë ata shlyhen në mënyrë proporcionale me detyrimet ndaj tyre.

3. Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara shpërndahet mes aksionarëve në përpjesëtim me të drejtat dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital.

Neni 339

Raportimi në Autoritet

1. Likuiduesi i raporton Autoritetit çdo muaj për ecurinë e procesit të likuidimit. Këto raporte përmbajnë informacione për shumën totale të pasivëve të kërkuara, shumën totale të aktivëve të shitur të shoqërisë komisionere ose të institucionit dhe të shumës së të ardhurave të pritura nga shitja e aktivëve.

2. Likuiduesi i paraqet një raport përfundimtar Autoritetit pas mbylljes së procesit të likuidimit.

Neni 340

Ankimimi

1. Të gjitha detyrimet e pretenduara për dhe në lidhje me paaftësinë paguese të shoqërisë bëhen në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

2. Të drejtën për të nisur proces ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit për të kërkuar pezullim të procedurës së likuidimit të detyrueshëm, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimit në medien e shkruar dhe elektronike, me përhapje më të gjerë në publik për emërimin e likuiduesit, për të kërkuar ndërprerjen e procedurës së likuidimit të detyrueshëm e kanë:

a) aksionarët që përfaqësojnë të paktën 10% të aksioneve të emetuara;

b) kreditorët, të cilët përbëjnë të paktën 1/3 (një të tretën) e shumës totale të pasivëve, të pretenduar nga kreditorët e tjerë, me përjashtim të aksionarëve.

3. Gjykata vendos për padinë, vetëm nëse:

a) Autoriteti ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe me pakujdesi për vendosjen në procedurë likuidimi, sipas rrethanave faktike dhe dispozitave të këtij ligji për likuidimin e detyrueshëm të shoqërisë;

b) Autoriteti, likuiduesi dhe punonjësit profesionistë të emëruar për t'i asistuar likuiduesit janë përgjegjës ose jo për veprimet ose mosveprimet në bazë të dispozitave të këtij ligji, ku parashikohet mënyra e kryerjes së funksioneve dhe detyrimeve në procesin e likuidimit, me përjashtim të rasteve kur këto veprime ose mosveprime janë qëllimisht të gabuara.

4. Pavarësisht nga shqyrtimi gjyqësor në bazë të këtij neni, procesi i likuidimit të detyrueshëm i nisur nga Autoriteti kryhet pa kufizime deri në daljen e vendimit të gjykatës.

Neni 341

Shpërblimi i punës së likuiduesit

Punonjësit profesionistë, përfshirë konsulentët, juristët, kontabilistët dhe këshilltarët, që veprojnë me kontratë, të caktuar dhe të emëruar nga likuiduesi për ta asistuar në përputhje me procedurat në zbatim të kësaj pjese dhe në varësi të kërkesës dhe kushteve të shërbimit, nuk paguhen më shumë se punonjësit e shoqërisë komisionere ose institucionit të tregut për të njëjtat shërbime, me përjashtim kur Autoriteti ka autorizuar pagesën e shumave më të mëdha. Autoriteti e jep këtë autorizim kur konstaton se pagesa e shumave më të larta është më se e domosdoshme për rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të nevojshëm.

Neni 342

Likuidimi i detyruar i personit të huaj të njohur

Autoriteti mund të vendosë personin e huaj, që është njohur sipas këtij ligji, në procedurë likuidimi të detyruar nëse kjo nuk i kërkohet nga autoriteti i jashtëm rregullator i personit në fjalë.

KREU IX
ABUZIMI ME TREGUN, TREGTIMI BAZUAR NË INFORMACIONIN E PRIVILEGJUAR DHE VEPRAT E LIDHURA

Neni 343
Zbatimi i këtij kapitulli

Ky kapitull zbatohet për të gjitha veprimet e një shoqërie komisionere ose të cilitdo personi juridik fizik/ apo individi, që përbëjnë abuzim tregu, të cilat përfshijnë:

a) manipulim të çmimeve për të krijuar treg të rremë;
b) tregtim bazuar në informacionin e privilegjuar.

SEKSIONI I
MANIPULIMI I TREGUT

Neni 344
Zbatimi i përgjithshëm i kësaj pjese

1. Kjo pjesë zbatohet për veprimet dhe mosveprimet e çdo personi brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kur ky person ushtron aktivitet nga Republika e Shqipërisë në lidhje me të gjitha instrumentet financiare të mëposhtme:

a) të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar ose për të cilat është paraqitur një kërkesë për pranim në një treg të rregulluar;

b) të tregtuara në një platformë shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), të pranuara për tregtim në një (PSHT) ose për të cilat është paraqitur një kërkesë për t'u pranuar për tregtim;

c) të tregtuara në një platformë të organizuar të tregtimit;

ç) instrumentet financiare, që nuk parashikohen në shkronjat "a", "b" dhe "c", kur çmimi apo vlera e tyre varet ose ka efekt në çmimin apo vlerën e instrumentit financiar të referuar në këto pika, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kontratat e shkëmbimit për rrezikun e kreditit *(credit default swaps*) dhe kontratat financiare për diferencat.

2. Ky krye aplikohet edhe për:

a) kontratat e mallrave bazë, në rastet kur nuk janë produkte të shitjes me shumicë të energjisë, kur transaksioni, urdhri apo sjellja ndikon ose ka pasur për qëllim të ndikojë në çmimin apo vlerën e instrumentit financiar të përmendur në pikën 1 të këtij neni;

b) llojet e instrumenteve financiare, duke përfshirë kontratat derivative për transferimin e rrezikut të kreditit, kur transaksioni, urdhri, kuotimi apo sjellja ka ndikuar ose ka pasur për qëllim të ndikojë në çmimin apo vlerën e një kontrate të mallrave bazë, ku çmimi apo vlera e kësaj kontrate varet nga çmimi apo vlera e këtij lloji të instrumentit financiar;

c) sjelljen në lidhje me treguesit referencë *(benchmarks).*

3. Ky kapitull i aplikohet gjithashtu çdo transaksioni, urdhri apo sjelljeje për instrumentet financiare, ashtu si referohen në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, pavarësisht nëse këto transaksione, urdhra apo sjellje ndodhin në një treg të rregulluar apo platformë tregtimi.

Neni 345
Sjellja e ndaluar që krijon treg të rremë

1. Askush nuk duhet të kryejë apo të jetë shkak për kryerjen e çdo veprimi që synon të krijojë një dukje të rreme apo mashtruese sikur po kryhet tregtim aktiv me instrumente financiare në territorin e Republikës së Shqipërisë ose një dukje të rreme apo mashtruese për blerjen ose çmimin e cilitdo prej këtyre instrumenteve financiare.

2. Askush nuk ka të drejtë që me anë të shitblerjes së instrumenteve financiare, të cilat nuk përfshijnë ndryshim të përfituesit fundor të këtyre instrumenteve financiare, ose nëpërmjet cilitdo transaksioni apo mjeti fiktiv të mbajë, të rrisë, të ulë ose të shkaktojë luhatje në çmimin e tregut të çfarëdo instrumenti financiar.

3. Pa cenuar zbatimin e përgjithshëm të pikës 1 të këtij neni, kryen shkelje personi, i cili:

a) zbaton, merr pjesë, përfshihet ose kryen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo transaksioni shitblerjeje të një instrumenti financiar, kur ky transaksion nuk sjell asnjë ndryshim të përfituesit fundor të instrumentit financiar; ose

b) paraqet ose merr masa që të paraqitet një ofertë për shitblerje të çfarëdo instrumenti financiar për një çmim të caktuar, kur ka paraqitur ose ka marrë masat që të paraqitet, ose ka dijeni se një person i lidhur me të ka paraqitur ose ka marrë masat që të paraqitet, një ofertë për shitblerje të të njëjtit numër instrumentesh financiare, për një çmim që në thelb është i njëjtë me çmimin e parë të përmendur.

4. Në trajtimin e kundërvajtjes së parashikuar në pikën 3 të këtij neni, personi mund të mbrohet duke vërtetuar se:

a) qëllimi i kryerjes së veprimit nuk ka qenë apo nuk ka përfshirë krijimin e një dukjeje të rreme ose mashtruese tregtimi aktiv në bursë; dhe

b) nuk ka vepruar në kushtet e pakujdesisë, pavarësisht nëse ka krijuar një dukje të rreme apo mashtruese të tregtimit aktiv në bursë;

c) është bërë për stabilizim të tregut në rastin e një emetimi të ri titujsh, kur në raportin e emetimit janë paraqitur informacione të plota;

ç) është bërë si pjesë e një programi të riblerjes së aksioneve e janë bërë publike të gjitha informacionet e plota dhe qëllimi ka qenë:

i. zvogëlimi i kapitalit të një emetuesi;

ii. përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet financiare të borxhit, të cilat janë të këmbyeshme me instrumente kapitali;

iii. përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga programet e opsioneve për aksionet ose shpërndarje të tjera të aksioneve për punonjësit ose për anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit ose të një shoqërie të lidhur me të.

5. Në kuptim të këtij neni, shitblerja e instrumenteve financiare nuk sjell ndryshim të përfituesit fundor nëse personi, i cili ka pasur interes për instrumentet financiare përpara shitblerjes, ose personi i lidhur me të në raport me këto instrumente financiare ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për instrumentet financiare edhe pas shitblerjes.

6. Në kuptim të kundërvajtjes së parashikuar në pikën 2 të këtij neni, personi mund të mbrohet duke vërtetuar se ndryshimi në përfituesin fundor për shitblerjen e instrumenteve financiare nuk ka pasur si qëllim krijimin e një dukjeje të rreme ose mashtruese në lidhje me shitjen apo çmimin e instrumenteve financiare.

7. Transaksioni i shitblerjes së instrumenteve financiare, i përmendur në pikën 3 shkronja “a”, përfshin:

a) paraqitjen e një oferte për shitblerje të instrumenteve financiare; dhe

b) paraqitjen e një ftese, pavarësisht se si është shprehur, e cila shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar fton një person të ofrojë instrumente financiare për shitje apo blerje.

8. Shkeljet e dispozitave të pikave 1 dhe 2 të këtij neni përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 20.000.000 lekë deri në 30.000.000 lekë për personin juridik, si dhe përbëjnë vepër penale të dënueshme në përputhje me përcaktimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 346

Manipulimi i tregut

1. Do të përbëjnë manipulim të tregut:

a) transaksionet ose urdhrat për tregtim, të cilat japin ose ka gjasa të japin sinjale të rreme ose mashtruese për ofertën, kërkesën ose çmimin e instrumenteve financiare, të cilat sigurojnë mbajtjen nëpërmjet një personi ose disa personave, që veprojnë në bashkëpunim, e çmimit të një ose disa prej instrumenteve financiare në një nivel artificial, përveçse nëse personi, i cili ka kryer transaksionin ose ka dhënë urdhrin për tregtim, vërteton se arsyet e tij për ta bërë këtë veprim janë legjitime dhe se këto transaksione ose urdhra tregtimi përputhen me praktikën e pranuar të tregut në tregun e rregulluar në fjalë;

b) transaksionet ose urdhrat për tregtim të kryera nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiktive ose çdo formë tjetër mashtrimi;

c) shpërndarja e informacionit përmes medieve, përfshirë internetin, ose me çfarëdolloj mjeti tjetër, i cili jep apo ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose mashtruese për instrumentet financiare, përfshirë shpërndarjen e thashethemeve dhe lajmeve të rreme ose keqinformuese, në rastin kur personi që ka kryer shpërndarjen ka pasur dijeni ose duhej të kishte pasur dijeni se informacioni ka qenë i rremë ose keqinformues. Në lidhje me gazetarët, kur veprojnë me cilësinë e gazetarit, shpërndarja e informacionit do të

vlerësohet duke mbajtur parasysh rregullat që rregullojnë profesionin e tyre, me përjashtim kur ata përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një avantazh ose fitim nga shpërndarja e informacionit në fjalë.

2. Në veçanti, do të konsiderohen manipulim tregu veprimtaritë dhe sjelljet e mëposhtme, që rrjedhin nga përkufizimi i manipulimit të tregut sipas nenit të mësipërm:

a) veprimtaria e një personi ose disa personave, të cilët veprojnë në bashkëpunim për të siguruar një pozitë dominuese për ofertën ose kërkesën për një instrument financiar, me pasojë mbajtjen të pandryshueshme, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të çmimeve të shitblerjes ose krijimin e kushteve të tjera të padrejta tregtare;

b) shitblerja e instrumenteve financiare në mbyllje të tregut, me pasojë keqinformimin e investitorëve, të cilët veprojnë bazuar në çmimet e mbylljes;

c) përfitimi nga përdorimi i rastësishëm ose i rregullt i medieve tradicionale apo elektronike për shprehjen e një opinioni për një instrument financiar ose tërthorazi për emetuesin e tij, pasi është mbajtur paraprakisht një qëndrim për këtë instrument financiar, duke përfituar më pas nga ndikimi i opinionit të shprehur për çmimin e këtij instrumenti, pa informuar njëkohësisht publikun në mënyrë të duhur e me efikasitet për konfliktin e interesit.

Neni 347

Ndalimi i manipulimit të tregut

1. Askush nuk duhet të kryejë ose të përfshihet në kryerjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, e një numri transaksionesh me instrumente financiare të një shoqërie tregtare, transaksione të cilat kanë ose mund të kenë si pasojë:

a) ngritjen e rreme;

b) uljen e rreme; ose

c) përcaktimin, mbajtjen, stabilizimin e rremë të çmimit ose të vëllimit të tregtimit me instrumentet financiare të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim, ndër të tjera, nxitjen e personave të tjerë për të blerë apo shitur instrumentet financiare të shoqërisë në fjalë ose të një shoqërie të lidhur me të, pavarësisht nëse këta persona e kanë apo jo këtë qëllim.

2. Në kuptim të këtij neni, transaksioni për instrumentet financiare të shoqërisë tregtare përfshin:

a) paraqitjen e një oferte për shitblerjen e instrumenteve financiare të shoqërisë; dhe

b) paraqitjen e një ftese, pavarësisht si është shprehur, me të cilën shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar ftohet një person që të ofrojë për të shitur apo për të blerë instrumente financiare të shoqërisë.

3. Shkelja e dispozitave të pikës 1 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 20.000.000 lekë deri në 30.000.000 lekë për personin juridik dhe vepër penale të dënueshme në përputhje me përcaktimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 348

Përjashtimi i klasave të caktuara të transaksioneve

Autoriteti mund të miratojë rregullore për të përjashtuar klasa, kategori, persona të caktuar ose klasa, kategori apo transaksione të caktuara në lidhje me instrumentet financiare për të cilat nenet 344-347 të këtij ligji nuk zbatohen.

Neni 349

Detyrimi për raportim

1. Të gjitha institucionet e tregut përcaktojnë dhe zbatojnë procedura e masa, të cilat synojnë zbulimin dhe parandalimin e praktikave të manipulimit të tregut në tregun e rregulluar.

2. Shoqëritë komisionere, të licencuara nga autoritetet kompetente për të ofruar shërbime investimesh e për të kryer veprimtari investimi, dhe bankat, të licencuara nga autoritetet që i lëshojnë këto licenca, informojnë Autoritetin bazuar në informacionet tek të cilat kanë akses për rastet për të cilat dyshojnë në mënyrë të arsyeshme se përbëjnë abuzim tregu.

SEKSIONI II
TREGTIMI BAZUAR NË INFORMACIONIN E PRIVILEGJUAR

Neni 350
Përkufizimi i informacionit të privilegjuar

1. Në kuptim të veprës penale të tregtimit bazuar në informacionin e privilegjuar, ky informacion përfshin:

a) prezumime dhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me shoqëritë e listuara, të cilat nuk janë të përcaktuara mjaftueshëm për publikun;

b) çështje që kanë të bëjnë me qëllimet faktike apo të mundshme të një personi;

c) çështje që lidhen me bisedime ose propozime në lidhje me:

i. veprime tregtare; ose

ii. veprime me instrumente financiare;

ç) informacion për performancën financiare të një shoqërie;

d) informacion se një person propozon të lidhë ose ka lidhur më parë një ose më shumë transaksione, kontrata ose marrëveshje për instrumente financiare apo ka përgatitur ose propozon të bëjë një deklaratë në lidhje me këto instrumente financiare; dhe

dh) çështje lidhur me të ardhmen.

2. Informacioni do të konsiderohet në përgjithësi i disponueshëm nëse informacioni në fjalë është bërë i ditur në një mënyrë që do ta sillte në vëmendjen e personave të arsyeshëm, të cilët investojnë në instrumente financiare të një lloji, që çmimi apo vlera e të cilave mund të ndikohet nga informacioni, dhe që nga momenti kur është bërë i ditur ka kaluar një periudhë e arsyeshme për shpërndarjen dhe përthithjen e informacionit nga personat në fjalë.

3. Informacioni i përmendur në pikën 2 të këtij neni, përfshin informacione që konsistojnë në deduksione ose konkluzione të nxjerra nga këto informacione.

Neni 351
Ndalimi i tregtimit bazuar në informacionin e privilegjuar

1. Personi konsiderohet se ka informacion të privilegjuar nëse:

a) zotëron informacione, të cilat përgjithësisht nuk janë të disponueshme dhe, nëse bëhen përgjithësisht të disponueshme, do të kishin një ndikim të rëndësishëm në çmimin ose vlerën e instrumenteve financiare për një person të arsyeshëm; dhe

b) ka dijeni ose pritet në mënyrë të arsyeshme të ketë dijeni se ky informacion nuk gjendet përgjithësisht.

2. Personi me informacion të privilegjuar, qoftë ai subjekt përgjegjës apo agjent, nuk ka të drejtë sa i përket cilitdo instrumenti financiar të përmendur në pikën 1 të këtij neni:

a) të blejë, të shesë ose të lidhë kontrata apo marrëveshje me qëllim shitblerjen e këtyre instrumenteve financiare; ose

b) të organizojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi shitjen, blerjen, lidhjen e një kontrate ose të një marrëveshjeje, me qëllim shitjen apo blerjen e këtyre instrumenteve financiare.

3. Kur tregtimi me instrumente financiare, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, lejohet në një bursë të licencuar, personi me informacion të privilegjuar nuk duhet t'ia komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi informacionin e përmendur në pikën 1 apo të marrë masat që ky informacion t'i komunikohet një personi tjetër, nëse personi me informacion të privilegjuar ka dijeni ose pritet në mënyrë arsyeshme të ketë dijeni se personi tjetër:

a) ka gjasë ose tendencën të blejë, të shesë ose të lidhë kontratë apo marrëveshje me qëllim shitblerjen e instrumenteve financiare të përmendura në pikën 1; ose

b) ka gjasë ose tendencën të porosisë një person të tretë të blejë, të shesë apo të lidhë kontratë apo marrëveshje me qëllim shitblerjen e instrumenteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

4. Shkelja e dispozitave të këtij neni përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 20.000.000 lekë deri në 30.000.000 lekë për personin juridik dhe vepër penale të dënueshme në përputhje me përcaktimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 352

Dhënia e menjëhershme e informacionit të privilegjuar

1. Emetuesi i instrumentit financiar siguron që informacioni i privilegjuar, që ka lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë me të, të bëhet publik sa më parë duke siguruar që ky informacion të jetë i plotë, i vërtetë dhe i saktë në thelb.

2. Emetuesi nuk do të ketë të drejtë që në kuadër të aktiviteteve të tij të marketingut të bëjë publik informacionin e përmendur në këtë nen, në mënyrë keqinformuese.

3. Emetuesi do të bëjë publik informacionin në përputhje me dispozitat e këtij neni, duke mundësuar akses të shpejtë dhe vlerësim të plotë, të saktë e në kohën e duhur të informacionit. Emetuesi do të bëjë publik informacionin duke e aplikuar në mënyrë të përshtatshme. Emetuesi do të afishojë për një periudhë të përshtatshme në faqen e tij të internetit të gjitha informacionet e privilegjuara që kërkohet të bëhen publike.

4. Autoriteti mund të përcaktojë më tej me rregullore informacionin që ka gjasa të merret në konsideratë kur merret vendim për bërjen publike të informacionit të privilegjuar.

Neni 353

Kërkesa për të mbajtur një listë të personave me informacion të privilegjuar

1. Emetuesi ose personi që vepron në emër e për llogari të tij ose çdo shoqëri komisionere që ofron shërbime investimi apo cilido këshilltar i fushës harton listën e personave që punojnë për ta me kontratë pune apo në mënyra të tjera, të cilët kanë të drejtë të marrin informacion të privilegjuar që ka lidhje drejtpërdrejt ose tërthorazi me emetuesin, në mënyrë të rregullt ose rastësore (listat e personave me informacion të privilegjuar).

2. Emetuesi ose personi, që vepron në emër të tij apo për llogari të tij, përditëson rregullisht listën dhe ia dorëzon atë Autoritetit me kërkesën e tij dhe e mban listën për të paktën pesë vjet nga hartimi ose përditësimi.

3. Lista e personave me informacion të privilegjuar do të përfshijë të paktën të dhënat: emër dhe mbiemër, datëlindje, adresën e vendbanimit të përhershëm ose vendbanimit të përkohshëm, nëse ka, të personit që ka akses tek informacionet e privilegjuara, arsyet e përfshirjes së personit në listë dhe datën më të cilën është hartuar ose përditësuar lista e personave me informacion të privilegjuar.

4. Lista e personave me informacion të privilegjuar do të përditësohet sa herë që ka ndryshim të arsyes së përfshirjes së një personi në listë, sa herë që në listë duhet të shtohet një person i ri dhe sa herë një person, i cili është në listë, nuk ka më të drejtë të aksesojë informacionin e privilegjuar.

5. Personat, të cilët kanë detyrimin të hartojnë listat e personave me informacion të privilegjuar, ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që çdo person i përfshirë në listë, i cili ka akses tek informacioni i privilegjuar, njeh detyrimet ligjore e rregullatore dhe është i vetëdijshëm për penalitetet që shoqërojnë shpërdorimin ose përhapjen e gabuar të këtyre informacioneve.

Neni 354

Personi i ngarkuar me detyra administrimi

1. Personi i ngarkuar me detyra administrimi pranë emetuesit është personi, i cili është:

a) anëtar i organit administrativ ose mbikëqyrës të emetuesit;

b) funksionar kryesor, që nuk është anëtar i organeve të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike, i cili ka akses të marrë informacion të privilegjuar lidhur drejtpërdrejt apo tërthorazi me emetuesin dhe ka kompetencë për të marrë vendime administrimi, të cilat ndikojnë në zhvillimet e ardhshme dhe perspektivat e veprimtarisë tregtare të këtij emetuesi.

2. Personi i lidhur ngushtë me personin e ngarkuar me detyra administrimi pranë emetuesit të instrumenteve financiare do të ketë kuptimin:

a) bashkëshorti/bashkëshortja e personit që është ngarkuar me detyrat e administrimit, ose çdo person i cili konsiderohet nga ligji i njëjtë me bashkëshortin/bashkëshorten;

b) fëmijët në varësi të personit të ngarkuar me detyrat e administrimit;

c) personat e tjerë që banojnë në të njëjtën familje me personin që kryen detyra administrimi, për të paktën një vit nga data e transaksionit në fjalë;

ç) personi juridik, trusti apo ortakëritë, detyrat e administrimit të të cilëve përmbushen nga

personi i përmendur në shkronjat “a” ose “b” të pikës 1 të këtij neni, i cili kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ky person, apo i cili është themeluar në përfitim të këtij personi ose interesat ekonomikë të të cilit janë në thelb të njëjtë me ato të këtij personi.

3. Personat e parashikuar nga ky nen njoftojnë Autoritetin për të gjitha shitjet apo blerjet e kryera për llogari të tyre për aksionet e emetuesit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, si edhe për shitblerjet e instrumenteve financiare derivative apo të instrumenteve të tjera financiare të lidhura me këto aksione, në të cilin personi i përmendur në pikën 1 të këtij neni përmbush detyrat e administrimit brenda 5 ditëve pune nga dita e shitblerjes në fjalë.

4. Njoftimi i parashikuar në pikën më lart do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

a) emrin e personit që kryen detyrat e administrimit pranë emetuesit ose, kur ka, emrin e personit të lidhur ngushtë me këtë person;

b) arsyen e detyrimit për të njoftuar;

c) emrin e emetuesit përkatës;

ç) përshkrimin e instrumentit financiar;

d) natyrën e transaksionit;

dh) datën dhe vendin e transaksionit;

e) çmimin dhe vëllimin e transaksionit.

5. Detyrimet e parashikuara në këtë nen nuk zbatohen për aksionet e emetuesit, i cili nuk ka kërkuar apo miratuar pranimin e instrumenteve financiare për tregtim në një treg të rregulluar.

Neni 355

Ndikimi thelbësor në çmimin ose vlerën e instrumenteve financiare

Ndikimi thelbësor ndodh atëherë kur informacioni, i cili bëhet i ditur përgjithësisht, do të ndikonte ose ka pririen të ndikojë në çmimin ose vlerën e instrumenteve financiare, në bazë të të cilit një person i arsyeshëm, që investon në instrumente financiare, do të ndikohej në vendimmarrjen e tij për të blerë ose shitur instrumente financiare apo për të lidhur marrëveshje me qëllim shitblerjen e instrumenteve financiare.

Neni 356

Argumentet mbrojtëse

Nuk do të përbëjë vepër penale tregtimi bazuar në informacion të privilegjuar kur personi që ka përhapur informacion, që tregton me instrumente financiare ose nxit një person tjetër të tregtojë me instrumente financiare:

a) nuk ka pasur pritshmërinë në momentin në fjalë se tregtimi do të sillte përfitim, bazuar në faktin se informacioni në fjalë do të kishte ndikim në çmim për instrumentet financiare; ose

b) ka besuar në momentin në fjalë mbi baza të arsyeshme se informacioni ka qenë publik mjaftueshëm për të siguruar se asnjë prej personave që ka marrë pjesë në tregtim nuk do të cenohej nga mospasja e informacionit; ose

c) do të kishte vepruar në të njëjtën mënyrë edhe sikur të mos e kishte pasur informacionin. Në këtë pjesë, çdo referim tek “fitimi” do të përfshijë edhe “shmangien e humbjeve”.

Neni 357

Kufizimet për tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar

1. Tregtimi bazuar në informacion të privilegjuar nuk zbatohet për rastet kur individi vepron në emër të Bankës së Shqipërisë apo në emër të një organi tjetër publik, në zbatim të politikave monetare apo të politikave të lidhura me kursin e këmbimit, me menaxhimin e borxhit publik apo të rezervave valutore.

2. Asnjë kontratë nuk mund të shpallet e pavlefshme apo e paekzekutueshme vetëm se është lidhur si pasojë apo si rezultat i tregtimit, bazuar në informacion të privilegjuar.

KREU X
SKEMA E KOMPENSIMIT TË INVESTITORËVE

Neni 358
Të përgjithshme

1. Mbrojtja e investitorëve në kuptim të këtij ligji do të implementohet dhe do të mbikëqyret nga Autoriteti.

2. Për qëllimin e mbrojtjes së investitorëve, dispozitat e këtij kapitulli japin informacionin për menaxhimin e fondit të mbrojtjes së investitorit, përcaktimin e një rasti kompensimi, si dhe pagesën e pretendimeve.

3. Fondi duhet të krijohet dhe të menaxhohet nga një shoqëri e autorizuar nga Autoriteti, i cili në vijim do të quhet operatori i Fondit ose vetë Autoriteti.

4. Dispozitat e këtij kapitulli, kur i referohen operatorit të Fondit, do të aplikohen *mutatis mutandis* edhe ndaj Autoritetit në rastet kur menaxhon fondin.

5. Dispozitat e këtij kapitulli nuk aplikohen ndaj klientëve, të cilët veprojnë me tokena digjitalë të titujve.

Neni 359
Objekti i skemës së kompensimit të investitorëve

1. Parashikimet e këtij kapitulli do të rregullojnë pretendimet që lindin ndaj anëtarëve të Fondit, të cilët nuk janë në kushtet e paaftësisë paguese ndaj klientit kur:

a) kanë filluar procedurat e falimendimit ndaj anëtarit të Fondit;

b) Autoriteti përcakton se një anëtar i Fondit është në kushtet e paaftësisë paguese kundrejt klientëve të tij, në kuptimin që nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në para ose në instrumente financiare të mbajtura në emër të klientit, të administruara prej tij, dhe kur nuk parashikohet se do të jetë në gjendje të paguajë këto detyrime në të ardhmen.

2. Autoriteti miraton rregulla për përmbushjen e kritereve të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 360
Anëtarësimi në skemë

1. Anëtarësimi në Fond është i detyrueshëm për shoqëritë e mëposhtme me zyrë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, kur ofrojnë shërbimet e investimeve:

a) një shoqëri komisionere e autorizuar për të mbajtur fondet e klientit ose instrumentet financiare;

b) një bankë që ofron shërbime investimesh dhe kryen aktivitete investimesh dhe është e licencuar për të kryer këto aktivitete në zbatim të nenit 15 të këtij ligji;

c) anëtarësimi në Fond do të jetë i detyrueshëm edhe për një shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike në rastet kur kjo e fundit ofron shërbime investimesh.

2. Shoqëritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të quhen “Anëtarët e fondit”.

3. Kërkesat e këtij neni u aplikohen *mutatis mutandis* edhe degëve dhe zyrave të shoqërive të huaja komisionere, nëse ato nuk janë pjesë e skemës së mbrojtjes së investitorëve në vendin e origjinës.

Neni 361
Pretendimet e mbuluara në rast të paaftësisë paguese

Pretendimet e klientëve të siguruara nga aplikimi i këtij kapitulli do të jenë si më poshtë:

a) pretendime monetare që një anëtar i Fondit u detyrohet klientëve ose që i përkasin një klienti, të cilat mbahen në emër të klientit për shërbimet e investimeve të dakordësuara me të;

b) instrumente financiare, të cilat i përkasin klientit të një prej anëtarëve të Fondit dhe që mbahen prej tij në kujdestari për shërbimet e investimeve të dakordësuara me të;

c) fondet e klientëve të bankave, të mbuluara nga ligji në fuqi “Për sigurimin e depozitave”, për qëllimin e mbrojtjes së depozitave, do të përjashtohen nga aplikimi i këtij kapitulli;

ç) pretendimet e klientëve të anëtarëve të Fondit, që ngrihen nga transaksione për të cilat është dhënë një dënim penal, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, do të përjashtohen nga aplikimi i dispozitave të këtij kapitulli;

d) në rast dyshimi se pretendimet e klientëve të anëtarëve të Fondit rrjedhin nga një transaksion në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, pagesa e pretendimit nuk do të kryhet derisa të merret vendimi i formës së prerë nga gjykata për këtë transaksion;

dh) shuma e pretendimeve të klientit të një anëtari të Fondit do të përllogaritet si shuma totale e pretendimeve të referuara në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, pavarësisht nëse anëtarët e Fondit i mbajnë ato në një apo disa llogari, pavarësisht nëse kanë nënshkruar një ose më tepër kontrata, pavarësisht se i ofrohen një ose më tepër shërbime investimi, deri në shumën e siguruar të referuar në nenin 362 të këtij ligji. Kjo shumë do të përfshijë interesat nga data e hapjes së procedurave të falimentimit për një anëtar të Fondit, ose nga data e publikimit të vendimit të Autoritetit në lidhje me një nga rastet e referuara në nenin 364 të këtij ligji.

Neni 362

Shuma maksimale e kompensimit

1. Pretendimet e ngritura dhe të lidhura me një aktivitet të përbashkët investimi, ku dy ose më tepër persona kualifikohen si anëtarët e një partneriteti biznesi apo grupimi të një natyre të ngjashme, e cila nuk ka personalitet ligjor, mundet për qëllim të përllogaritjes së limitit të trajtohen se vijnë nga një investitor i vetëm.

2. Pretendimet e klientëve, të referuara në nenin 361 të këtij ligji, do të mbulohen në një maksimum prej 500.000 lekësh për klient të një anëtari të Fondit.

3. Të gjitha pretendimet e siguruara deri në shumën e përmendur në pikën 2 të këtij neni, do të mbulohen plotësisht.

4. Në procesin e kompensimit, interesi nuk do të përcaktohet dhe paguhet për shumën e vendosur pa kaluar data e hapjes së procedurave të falimentimit për një anëtar të Fondit ose nga data e marrjes së vendimit të Autoritetit sipas nenit 364 të këtij ligji.

Neni 363

Përcaktimi i klientit të fondit të kompensimit

1. Brenda kuptimit të këtij kapitulli, klienti i një anëtari të Fondit, pretendimet e të cilit mbrohen nga parashikimet e këtij kapitulli, do të jetë çdo person fizik/individ ose juridik, fondet e të cilit, të përshkruara në nenin 359 të këtij ligji, mbahen në emër të klientit ose administrohen nga një anëtar i Fondit për shërbimet e investimeve të dakordësuara me të.

2. Nuk do të konsiderohen si klientë në kuptimin e pikës 1 të këtij neni, pavarësisht vendit ku selia e këtyre personave ndodhet:

a) bankat;

b) shoqëritë komisionere;

c) institucionet financiare;

ç) shoqëritë e sigurimit;

d) sipërmarrjet e investimeve kolektive;

dh) shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve dhe fondet e pensioneve;

e) shoqëritë që janë pjesë e një grupi apo kanë lidhje të ngushta me një prej anëtarëve të fondit në rast të paaftësisë paguese të këtij anëtari;

ë) individët, personat fizikë/individët ose juridikë, që kanë më tepër se 5% të aksioneve të zakonshme në kapitalin e anëtarit të Fondit, i cili është në kushtet e paaftësisë paguese;

f) anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës apo administratorët e një anëtari të Fondit, të cilët janë në këto pozicione në datën e fillimit të procedurave të falimentimit apo likuidimit për anëtarin e Fondit ose marrjes së vendimit të Autoritetit, sipas nenit 359 të këtij ligji, ose kanë qenë në këto pozicione në 2 vjetët e fundit;

g) personat e punësuar nga anëtarët e Fondit në datën e fillimit të procedurave të falimentimit apo likuidimit të anëtarit të Fondit ose në datën e marrjes së vendimit të Autoritetit, sipas nenit 359 të këtij ligji;

gj) agjentët e lidhur të një shoqërie komisionere, që është në kushtet e paaftësisë paguese, të cilët janë agjentë të lidhur të kësaj shoqërie në datën e fillimit të procedurave të falimentimit apo të marrjes së vendimit të Autoritetit për këtë shoqëri ose kanë qenë në këto pozicione gjatë 2 vjetëve të fundit;

h) personat përgjegjës për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të anëtarit të Fondit dhe personat përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të anëtarit të Fondit;

i) admistratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, të cilët zotërojnë 5% ose më shumë në kapitalin e një shoqërie, që është shoqëria mëmë ose filiali në lidhje me anëtarin e Fondit dhe personat përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të kësaj shoqërie;

j) partnerët, bashkëshorti, bashkëshortja apo të afërmit e personave të referuar në shkronjat “ë”, “P’, “g”, “gj”, “h” e “i” të kësaj pike.

k) klientët e anëtarit të Fondit, të cilët kanë kontribuar në marrjen e vendimit të Autoritetit duke mos përmbushur detyrimet e tyre ndaj këtij anëtari të Fondit;

l) personat të cilët tregtojnë në tokena digjitalë të titujve.

Neni 364

Ndodhja e një ngjarjeje kompensimi

1. Në rastet e ndodhjes së njërës prej rrethanave, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 359 të këtij ligji, Autoriteti do të dërgojë vendimin e fillimit të procedurave të falimentimit ndaj anëtarit të Fondit dhe operatorit të Fondit.

2. Pas marrjes së vendimit të referuar në pikën 1 të këtij neni dhe në kushtet e ndodhjes së rrethanave të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 359 të këtij ligji, Autoriteti duhet të marrë një vendim për ndodhjen e një ngjarjeje kompensimi dhe duhet t'ua dërgojë pa vonesë operatorit të Fondit dhe anëtarit të Fondit, i cili është në kushtet e paaftësisë paguese.

3. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit.

Neni 365

Procedurat e mëtejshme

Autoriteti miraton rregullore për:

a) procedurat e operatorit të Fondit për ndodhjen e një ngjarjeje kompensimi;

b) mënyrën e anëtarësimit në Fond;

c) masën e kontributit të çdo anëtari të Fondit;

ç) pasojat e paaftësisë paguese nga ana e anëtarit të Fondit;

d) mbajtjen e librit të llogarive dhe raportimin ndaj Autoritetit dhe operatorit të Fondit;

dh) përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave;

e) mënyrën e mbikëqyrjes së detyrimeve të anëtarëve të Fondit;

ë) mbikëqyrjen e menaxhimit të Fondit;

f) mënyrën e investimit të aseteve të Fondit;

g) tarifat që operatori i Fondit mund të aplikojë ndaj anëtarëve të Fondit;

gj) informacionin që anëtarët e Fondit u japin klientëve për skemën e mbrojtjes së investitorëve.

KAPITULLI XI

MASAT NDËSHKIMORE DHE GJOBAT

Neni 366

Përgjegjësia civile ose penale

Masat ndëshkimore dhe dënimet e parashikuara në këtë ligj nuk përjashtojnë përgjegjësinë civile ose penale të përcaktuar në akte të tjera ligjore.

Neni 367

Personat që kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtaritë e rregulluara

Personi, që ushtron ose pretendon të ushtrojë veprimtari të rregulluara në apo prej territorit të Republikës së Shqipërisë, pa qenë i licencuar, i regjistruar, i njohur apo i përjashtuar, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kryen vepër penale sipas nenit 170 shkronja "ç" të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe dënohet sipas përcaktimeve të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 368

Deklaratat dhe praktikat keqinformuese

Kur nuk përbën vepër penale, kryerja me pakujdesi apo mashtrim, kryerja e deklaratave, premtimeve apo parashikimeve keqinformuese apo të rreme ose fshehja e fakteve me rëndësi thelbësore përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 3.000.000 lekë për personin juridik, si dhe gjobë deri në 1.000.000 lekë për individin përgjegjës.

Neni 369

Dispozita të përgjithshme

1. Çdo shkelje me dashje ose pa dashje e dispozitave të këtij ligji, e kryer me veprim ose mosveprim, për të cilat parashikohen ndëshkime administrative, përbën shkelje administrative.

2. Përveç masave të mbikëqyrjes, të parashikuara në këtë ligj, shkeljet administrative, të parashikuara në nenet e mëposhtme, sanksionohen me ndëshkim administrativ në formën e gjobës.

3. Gjatë vendosjes së sanksionit administrativ me gjobë, Autoriteti siguron që ndëshkimi administrativ të jetë:

a) efektiv dhe parandalues; dhe

b) proporcional me shkallën e pasojave që çuan në vendosjen e gjobës.

4. Autoriteti përcakton shumën e ndëshkimit administrativ në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke vlerësuar, gjithashtu, natyrën, ndikimin dhe fushën e veprimit të shkeljes.

5. Autoriteti, gjatë vendosjes së ndëshkimeve administrative, zbaton parimin e njëtrajtshmërisë, sipas të cilit për shkelje të ngjashme vendosen sanksione të ngjashme.

6. Shkeljet administrative dhe penale për veprimtaritë që lidhen me tokenat digjitalë të titujve ndëshkohen sipas ligjit të fushës përkatëse.

Neni 370

Ndëshkimet administrative subjekteve të licencuara, të njohura, të regjistruara

1. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ me gjobë nga 500 000 — 2 000 000 lekë ndaj shoqërisë komisionere, institucioneve dhe operatorëve të tregut të licencuar, të njohur ose të regjistruar, si edhe ndëshkim administrativ me gjobë nga 100 000 lekë në 500 000 lekë administratorit dhe personave përgjegjës të shoqërisë komisionere, institucioneve dhe operatorëve të tregut të licencuar, të njohur, të regjistruar, përgjegjës për shkeljet e mëposhtme:

a) nuk informon Autoritetin paraprakisht për ndryshim të zotëruesit të pjesëmarrjes influencuese dhe/ose nuk merr miratimin paraprak të Autoritetit për këtë ndryshim;

b) nuk informon Autoritetin paraprakisht për ndryshim të rëndësishëm të statusit të licencuar dhe/ose nuk merr miratimin paraprak të Autoritetit për këtë ndryshim;

c) nuk informon Autoritetin paraprakisht për ndryshim të personit kyç ose personelit kyç dhe/ose nuk merr miratimin paraprak të Autoritetit për këtë ndryshim;

ç) nuk dorëzon pasqyrat financiare vjetore, raportet vjetore, raportin e auditimit në Autoritet;

d) nuk i paguan Autoritetit tarifën vjetore;

dh) pengon Autoritetin në ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse në përputhje me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, dhe këtë ligj.

2. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ me gjobë nga 1.000.000 — 2.000.000 lekë ndaj

institucionit të tregut, i cili nuk respekton kërkesat e nenit 123 të këtij ligji për transaksionet me palët e lidhura.

3. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ me gjobë nga 2.000.000 — 3.000.000 lekë ndaj personit juridik, i cili nuk zbaton kërkesat e neneve 63-69 të këtij ligji për mbrojtjen e klientëve, të neneve 70-78 të këtij ligji për kërkimet dhe rekomandimet, të neneve 80-87 të këtij ligji për urdhrat e klientit, të nenit 88 të këtij ligji për transaksionet, të neneve 91-93 të këtij ligji për ekzekutimin më të mirë.

4. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ:

a) me gjobë nga 1.000.000 — 3.000.000 lekë ndaj bursës ose operatorit të platformës shumëpalëshe të tregtimit në rastet kur:

i. pranon, liston dhe pranon për tregtim tituj pa prospekt të plotë në rastet kur kërkohet miratimi i prospektit;

ii. ndërpret tregtimin pa shkaqe të arsyeshme, në kundërshtim me rregulloret e saj.

b) me gjobë nga 500.000 — 1.000.000 lekë ndaj administratorit apo personit përgjegjës.

5. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ:

a) me gjobë nga 5.000.000 — 10.000.000 lekë ndaj bursës ose ndaj platformës shumëpalëshe të tregtimit në rastet kur nuk raporton në Autoritet dhe në organet e tjera ligjzbatuese për rastet e abuzimit të tregut;

b) me gjobë nga 1.000.000 — 2.000.000 lekë ndaj administratorit apo personit përgjegjës.

6. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ me gjobë nga 3.000. 000 — 5.000.000 lekë ndaj Agjencisë së Licencuar të Vlerësimit të Kreditit për mosrespektim të detyrimeve të parashikuara në nenet 234—242 të këtij ligji.

7. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ ndaj emetuesit si më poshtë:

a) për mospublikimin e prospektit në përputhje me kërkesat e ligjit:

i. nga 2.000.000 — 3.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 500.000 — 1.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës;

b) për rastet kur nuk publikon prospekt, kur prospekti kërkohet të publikohet sipas këtij ligji, përveç sa parashikohet në Kodin Penal:

i. nga 10.000.000 — 20.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 2.000.000 — 5.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës për prospektin.

c) për mospërdorimin e fondeve sipas qëllimit të prospektit:

i. nga 10.000.000 — 20.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 2.000.000 — 5.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës për prospektin;

ç) për publikimin e të dhënave të rreme në prospekt, përveç sa parashikohet në Kodin Penal:

i. nga 20.000.000 — 30.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 5.000.000 — 10.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës për prospektin;

d) për fshehjen e deklarimit të fakteve me rëndësi materiale, konfliktit të interesit dhe transaksionet me palët e lidhura:

i. nga 10.000.000 — 20.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 5.000.000 — 10.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës për prospektin;

8. Autoriteti vendos gjobë ndaj shoqërive të listuara në rastet e mëposhtme:

a) për mosrespektimin e kërkesave të nenit 300- 301 të këtij ligji për raportimin në Autoritet:

i. nga 2.000.000 — 3.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 500.000 — 1.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës;

b) për shkeljen të dispozitave të nenit 302 të këtij ligji për publikimin e raportit vjetor:

i. nga 5% të kapitalizimit të tregut — maksimumi 30.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 1.000.000 – 3.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës;

c) për mospublikimin e menjëhershëm të informacionit, që ka ndikim mbi çmimet, në shkelje të dispozitave të parashikuara në nenin 303 të këtij ligji:

i. nga 10% të kapitalizimit të tregut — maksimumi 30.000.000 lekë ndaj personit juridik;

ii. nga 3.000.000 — 5.000.000 lekë ndaj administratorit dhe personit përgjegjës.

9. Autoriteti vendos ndëshkim administrativ me gjobë nga 500.000 lekë në 1.000.000 lekë ndaj shoqërisë komisionere, institucioneve dhe operatorëve të tregut të licencuar, të njohur, të regjistruar për shkeljet e mëposhtme:

a) nuk zotëron kapitalin përkatës sipas kërkesave të këtij ligji;

b) për shkelje tjetër të çdo kërkese të zbatueshme të përcaktuara në këtë ligj.

10. Krahas kësaj, Autoriteti i kërkon personit të licencuar të shkarkojë ose të pezullojë për një periudhë kohore të përcaktuar një person kyç ose një anëtar të personelit kyç, përgjegjës për shkelje të legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 371
Përsëritja e shkeljeve

1. Në rast se shkelja përsëritet nga i njëjti person i licencuar, i njohur ose i regjistruar, sipas parashikimeve të nenit 370 të këtij ligji, gjoba dyfishohet me çdo përsëritje të shkeljes.

2. Përsëritja e së njëjtës shkelje më shumë se dy herë përbën arsye që Autoriteti të kërkojë shkarkimin e personave ose personelit kyç në fjalë.

Neni 372
Ndëshkimet administrative kundër administratorëve të përkohshëm dhe likuiduesve

Autoriteti vendos ndëshkim administrativ me gjobë nga 1 000 000 - 2 000 000 lekë ndaj administratorit të përkohshëm, që nuk dorëzon raportet e kërkuara në zbatim të këtij ligji ose likuiduesit që nuk dorëzon raportet e kërkuara në zbatim të këtij ligji

KREU XII
MENAXHIMI I INFORMACIONIT

Neni 373
Regjistri i personave të licencuar, të regjistruar dhe të njohur

1. Autoriteti duhet të mbajë një regjistër, sipas formës që e gjykon të përshtatshme, i cili të jetë i aksesueshëm për publikun, në të cilin të regjistrohet çdo:

a) person i licencuar, i regjistruar ose i njohur;

b) institucion i licencuar ose i njohur i tregut;

c) çdo person për të cilin është marrë një vendim skualifikimi.

2. Regjistri duhet të përmbajë:

a) emrin e personit;

b) adresën e punës së personit;

c) llojin e licencës që mban;

ç) datën e dhënies së licencës;

d) emrat e personave të regjistruar, që veprojnë për llogari të personave të licencuar ose që punojnë për ta;

dh) çdo çështje tjetër që Autoriteti e konsideron të përshtatshme.

Neni 374
Kufizimet për përhapjen e informacionit

1. Informacioni do të konsiderohet informacion i kufizuar në kuptim të këtij ligji, kur ka lidhje me veprimtarinë tregtare ose çështje të tjera të personit të licencuar, të regjistruar ose të njohur dhe nuk duhet të bëhet publik nga personi i përmendur në pikën 3 të këtij neni ("marrësi parësor"), ose nga cilido person që e merr informacionin drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ky pa pëlqimin e personit nga i cili marrësi parësor e ka marrë informacionin dhe, nëse është tjetër, personi për të cilin bën fjalë.

2. Në varësi të pikës 4 të këtij neni, informacioni do të konsiderohet informacion i kufizuar në kuptim të kësaj pike nëse është marrë nga marrësi parësor në kuadër të ose në përmbushje të funksioneve të tij në zbatim të këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, marrës parësor është:

a) Autoriteti;

b) autoriteti ose organi që administron një skemë kompensimi të investitorëve të krijuar në zbatim të këtij ligji;

c) Banka e Shqipërisë;

ç) personi i emëruar për të ushtruar të gjitha kompetencat hetimore në zbatim të këtij ligji;

d) nëpunësi ose ndihmësi i personave të përmendura në pikën 3, shkronjat “a” deri në “ç”, të këtij neni;

Informacioni nuk duhet të trajtohet si informacion i kufizuar në kuptim të këtij neni, nëse është vënë në dispozicion të publikut duke u bërë publik në rrethana ose për qëllime për të cilat bërja publike nuk ndalohet nga ky krye.

Neni 375

Përjashtime nga kufizimet për dhënien e informacionit

1. Konsiderohen përjashtime nga kufizimi për dhënien e informacionit rastet kur informacioni jepet:

a) me qëllim çeljen e/apo në funksion të procedimit penal;

b) me qëllim çeljen e/apo në funksion të procesit civil ose disiplinor ose një procesi gjyqësor;

c) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e Autoritetit për ushtrimin e të gjitha kompetencave të dhëna nga ky ligj ose me çdo ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

ç) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e një institucioni të licencuar të tregut në kryerjen e funksioneve në zbatim të këtij ligji;

d) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e Autoritetit ose të një organi të emëruar për të administruar një skemë kompensimi të investitorëve në zbatim të këtij ligji në kryerjen e funksioneve të tij sipas skemës;

dh) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e Bankës së Shqipërisë në kryerjen e funksioneve të saj;

e) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e një likuiduesi në përmbushjen e funksioneve në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

ë) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e çdo personi të caktuar për të ushtruar një kompetencë hetimore ose çdo audituesi të emëruar në zbatim të këtij ligji në kryerjen e funksioneve të tyre;

f) me qëllim mundësimin ose mbështetjen e autoritetit të huaj rregullator në ushtrimin e funksioneve rregullatore.

2. Nuk ndalohet dhënia e informacionit Ministrisë së Financave nëse dhënia e informacionit bëhet në interes të investitorëve ose në interes të publikut.

3. Nuk ndalohet dhënia e informacionit me qëllim që të mundësojë ose të ndihmojë një organ publik ose një organ tjetër për të kryer funksionet e tij.

4. Nuk ndalohet dhënia:

a) e çdo informacioni që ndodhet në njoftime ose kopje të njoftimeve të parashikuara në zbatim të këtij ligji, përmbajtja e të cilave nuk i është dhënë publikut nga personi të cilit i është vendosur në dispozicion, ose nga persona që e kanë marrë informacionin drejtpërdrejt ose tërthorazi;

b) e çdo informacioni që gjendet në regjistrin e mbajtur në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nga një person që është konsultuar me regjistrin ose cilido person që e merr informacionin drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ai.

KREU XIII
ANKESAT E KONSUMATORËVE INDIVIDË

Neni 376

Ankesat e konsumatorëve

1. Autoriteti mund të marrë masa për të krijuar një skemë për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve individë, që lindin në lidhje me veprimtaritë e rregulluara të ushtruara nga persona të licencuar, të regjistruar ose të njohur.

2. Skema e ankesave duhet të projektohet në mënyrë të tillë që ankesat të shqyrtohen sa më shpejt.

KREU XIV
DISPOZITA KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 377

Dispozita kalimtare

1. Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji.

2. Dispozitat e kreut X “Skema e kompensimit të investitorëve” hyjnë në fuqi 5 vjet pas miratimit të këtij ligji, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme të tregjeve të kapitalit.

Neni 378
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, si dhe ligji nr. 10158, datë 15.10.2009, “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” shfuqizohen.

Neni 379
Aktet nënligjore

Autoriteti nxjerr aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 18 muajve nga miratimi i këtij ligji.

Neni 380
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 shtator 2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.5.2020.

Botuar ne F.Zyrtare 131/2020
Dale nga shtypi 14.07.2020